
'AKIDE-JA E VËRTETË

Omer Ef. Bajrami

Omer Ef. Bajrami

'AKIDE-JA E VËRTETË

www.OmerBajrami.com

Titulli:

'AKIDE-JA E VËRTETË

Autor:

Omer Ef. Bajrami

Përmbledhi dhe rradhiti:

Hetem Ibrahim

Realizoi:

"Rinia Islame - Saraj"

www.RI-Saraj.com

riniaislamesaraj@hotmail.com

Parathënie

Falënderimi i takon All-llahut, vetëm Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahut prej të këqijave të vetëvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu nuk ka kush që e lajthitë dhe kë e largon nga rruga e vërtetë Ai, nuk ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet pos All-llahut, i Cili është Një, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

“O All-llah, lartësoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e pate lartësuar Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar! O All-llah, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e pate bekuar Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar!”

Fjala më e mirë është fjala e All-llahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), gjërat më të urrejtura janë *bid’at*-et (risit), çdo *bid’at* (risi) sjell në humbje, çdo humbje sjell në zjarr të Xhehennemit.

**** Hyrje ****

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

- Çka don të thotë 'Akideh?

Në aspektin gjuhësorë, fjala 'akideh rjedh prej fjalës 'akadeh ose 'akduh, që don të thotë: të lidhësh, të shtrëngosh, të bashkosh apo të kapësh diçka fortë dhe mos ta lëshosh.

Në aspektin fetarë, fjala 'akideh don të thotë: të besosh në disa gjëra të caktuara¹, me *iman* të plotë, duke mos pasur asnjë dyshim në to.

- Cilat janë bazat e 'akide-s?

Bazat e 'akide-s, apo ato që duhet të besohen patjetër, janë ato që All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka përmendur në Kur'an, ku thotë:

¹ Të besosh në All-llahun, në Librat, në Pejgamberët, në Ringjalljen dhe në *Kaderin* (caktimin) e All-llahut. Kjo do të sqarohet në pyetjen e rradhës.

ءَامَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ ۚ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ
وَرُسُلِهِ ...

“I Dërguari beson në atë (Kur’anin) që i është shpallur nga Zoti i Tij, e po ashtu edhe besimtarët: të gjithë besojnë në All-llahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij ... ” (El-Bekarah: 285)

dhe ato të tjerat që janë përmendur në *hadith*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*): “... dhe ditën që do të dalim para All-llahut dhe kaderin (*caktimin*) e All-llahut”²

Pra, bazat e ‘*akide*-s janë: besimi në All-llahun, besimi në melaiket, besimi në Librat e shpallura, besimi në Pejgamberët, besimi në Ditën e Ringjalljes dhe besimi në *kader*-in (*caktimin*) e All-llahut.

- A ka ‘akideh vetëm në Islam?

‘*Akideh* nuk ka vetëm në Islam, por ka edhe te fetë tjera, edhe te grupet e devijuara, gjithë kanë ‘*akideh*.

Krishterët sot luftojnë me ‘*akide*-n e humbur të tyre që e kanë. Edhe jehudët sot luftojnë dhe mundohen që ta sundojnë botën me ‘*akide*-n që e kanë, duke thënë:

... نَحْنُ أَبْنَاءُ اللَّهِ وَأَحِبُّهُرُ ...

“Ne jemi bijtë e All-llahut dhe të dashurit e Tij” (El-Maideh: 18)

Dhe gjithë grupet e devijuara tjera, të gjitha kanë ‘*akideh*.

² Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe ‘Umer ibnul ‘Hattabi.

- Sa lloje është 'akide-ja?

'Akide-ja është dy lloje:

1. 'Akide-ja e vërjetë³
2. 'Akide-t e humbura⁴

- Cila është 'akide-ja e vërtetë?

'Akide-ja e vërtetë është 'akide-ja e Ehli Sunnet-it.

- Kush është Ehli Sunnet-i?

Ehli Sunneh janë ata që e pasojnë Sunnet-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe bashkohen përreth tij. Për atë edhe e kan marur emrin: *Ehli sunneh vel xhema'ah*. Ehli sunneh: që e pasojnë sunne-tin, dhe *vel xhema'ah*: që bashkohen pranë sunne-tit të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Kjo është 'akide-ja e Pejgamberëve të All-llahut, 'akide-ja e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e Sahabeve dhe e gjithë atyre që e pasojnë rrugën e tyre.

'Akide-ja nuk ndryshon te asnjë Pejgamber, 'akide-ja e Ademit ('*alejhis-selam*) është 'akide-ja e Nuhut ('*alejhis-selam*), e Musait ('*alejhis-selam*), e 'Isait ('*alejhis-selam*), dhe kështu me radhë deri te Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të gjithë e kanë pasur një 'akideh. Ndërsa ajo që ka ndryshuar është Sheri'a-ti (namazi, zekati, agjërimi etj.).

Jemi të obliguar ta pasojmë 'akide-n e Sahabeve, dhe si kanë besuar ata, duhet të besojmë edhe ne. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) na ka lajmëruar dhe ka thënë: "Do të ndahen Beni Israil-ët (jehudët) deri në shtatëdhjetë e një grup, do të ndahen krishterët deri në shtatëdhjetë e dy grupe, dhe do të ndahen muslimanët deri në shtatëdhjetë e tri grupe; të

³ Kjo është një.

⁴ Këto janë shumë: bindjet e devijuara të krishterëve, jehudëve, shi'iaive, sufive etj..

gjithë janë në Xhehennem, përveç një grupi⁵”.⁶ Sahabet e pyetën: “O i Dërguari i All-llahut, kush janë këta (që do të shpëtojnë)?” Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) tha: “Ata që janë në rrugën time dhe në rrugën e shokëve të mi”. Dhe All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

فَإِنَّ ءَامِنُوا بِمِثْلِ مَا ءَامَنْتُمْ بِهِ فَقَدْ أَهْتَدُوا ...

“Nëse ata besojnë në atë që besoni edhe ju, atëherë janë në rrugën e drejtë.” (El-Bekarah: 137)

- Cilat janë veçoritë e Ehli Sunnet-it?

Ehli Sunnet-i i ka disa veçori:

1. Ehli Sunnet-i për çdo send kthehen në Kur’an dhe Sunnet

Baza e çdo gjëje të kësaj feje është në Kur’an dhe Sunnet. Ehli Sunnet-i, në çështjen e ‘akide-s, nuk bazohet në asnjë send tjetër, përveç se në Kur’an dhe Sunne-t, në përjashtim të grupeve tjera të devijuara, të cilat bazohen dikund tjetër. Disa prej tyre bazohen në logjikë, e disa të tjerë në ëndërra dhe kështu me rradhë.

Për atë, dijetarët e Ehi Sunnet-it këtë term nuk e kanë përmendur rastësisht, sepse nuk mjafton që të thuhet vetëm: “Una jamë musliman”, por ia kanë shtuar edhe një emër tjetër: “Unë jamë musliman Ehli Sunneh”, për tu dalluar nga grupet tjera të devijuara. Sepse, po t’i pyesësh shi’iat, edhe ata thonë se janë musliman, apo nusajritë, ndërsa Alijjun (*radijall-llahu ‘anhu*) e konsiderojnë zot. Po t’i pyesësh sufitë, edhe ata thonë se janë musliman, ndërsa i adhurojnë varrezat. Apo, po t’i pyesësh kadjanitë, edhe ata thonë se janë musliman, ndërsa Kadjanin (Ahmed Gulamin) e konsiderojnë pejgamber pas Muhammedit (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*). Dhe çdo grup tjetër të devijuar, po ta pyesësh, të gjithë thonë se janë musliman. Për atë dijetarët kanë thënë: “Ne jemi musliman Ehli Sunneh vel xhema’ah - Musliman, pauses të Sunne-tit të Muhammedit (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*)”.

⁵ Për atë dijetarët e kanë quajtur Ehli Sunnetin edhe si: Grupi i shpëtuar.

⁶ Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh.

Çdo send që është në Kur'an dhe Sunnet ne e besojmë, ndërsa çdo send që nuk është në Kur'an dhe Sunnet ne nuk e besojmë.

2. Ehli Sunnet-i ndalen dhe nuk polemizojnë në fjalët e All-llahut dhe fjalët e Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)

Ka gjëra që ndoshta nuk mundën të kuptohen, nuk mundën të paramendohen, apo ndoshta duken të çuditshme, por nëse All-llahu apo Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) kanë thënë, ato duhet të pranohen patjetër, pa polemizuar fare. Dhe kjo është rruga e Ehli Sunne-tit, të cilët nuk i polemizojnë urdhërat e All-llahut dhe Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem).

Ka njerëz, të cilët i thonë vetes muslimanë dhe i polemizojnë urdhërat e All-llahut dhe Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). Për shmebull, për *hadith*-in në të cilin Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Zbret Zoti juaj çdo natë, në pjesën e tretë të natës dhe thotë: “A ka dikush që më lutet, t’ia pranoj lutjen? A ka dikush që kërkon falje, ta falë? A ka dikush që kërkon diçka, t’ia japë atë?”⁷, ka disa prej njerëzve, të cilët nuk mundën ta pranojnë, dhe filozofojnë, se si All-llahu zbret, si ka mundësi, në ndonjë vend është ditë e në ndonjë vend është natë, apo ndoshta edhe tallen dhe nuk e pranojnë fjalën e Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), ngase logjika dhe filozofia e tyre nuk e kapë, dhe se ata e mendojnë All-llahun (subhanehu ve te’ala) sikur krijesat tjera, ndërsa:

... لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ...

“Asgjë e askush nuk i shëmbëllen Atij.” (Esh-Shura’: 11)

dhe kur thotë All-llahu ndonjë send, ne themi:

... سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ...

“Ne dëgjojmë dhe bindemi.” (El-Bekarah: 285)

Ehli Sunne-ti e pranojnë çdo fjalë të All-llahut dhe Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), pa polemizuar dhe pa filozofuar. Për shmebull, për *hadith*-in që e përmendëm, thonë: “All-llahu zbret, në mënyrën që i takon Atij, Ai e din më së miri”.

⁷ Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Hurajrah.

3. *Ehli Sunnet-i, pa marë parasyshë në çfarë vendi dhe në çfarë kohe, çdo herë janë të njëjtë*

'Akide-ja e atyre që janë *Ehli Sunneh* në vendin tonë, është e njëjtë me të atyre në Saudi, me të atyre në Egjipt e në Jemen, po është e njëjtë edhe me të atyre që janë në Evropë dhe Amerikë, nëse janë *Ehli Sunneh*, sepse bazën e kanë të njëjtë (Kur'anin dhe *Sunnet-in*). Ndërsa ata që janë ithtarë të *bid'a-tit*, nuk i kanë sendet e njëjta, *bid'at-et* e tyre ndryshojnë nga vendi në një vend tjetër.

- Çfarë rëndësie ka 'akide-ja?

'Akide-ja është lëmia kryesore dhe bazore e kësaj feje. Nëse njeriu e ka 'akide-n e pastër ashtu siç duhet, e fiton Xhennetin dhe shpëton prej zjarrit të Xhehennemit. Nëse njeriu ka reziqe në 'akide-n e tij, ka mundësi që të del para All-llahut i humbur, me të gjitha punët e tij dhe ato t'i bëhen pluhur. Nëse njeriu e ka 'akide-n e mirë, prej tij dalin punë të mira, por nëse njeriu e ka 'akiden e prishur, prej tij dalin punë të fëlliqura. 'Akide-ja është ajo e cila e shpëton njeriun në dunja dhe A'hiret. Ndërsa nëse njeriu nuk e njeh këtë lëmi, ka mundësi që ai të bëjë *'ibade-t* shumë vite dhe në fund t'i bëjë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) dhe të futet në Xhehennem prjithmonë.

Rëndësia e 'akide-s është rëndësia më e madhe se sa çdo lëmi tjetër.

Kapitulli i parë:

BESIMI NË ALL-LLAHUN

**** Teuhid-i ****

- Cili është obligimi i parë i robërve?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾

“Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56)

Obligimi i parë i robërve është ai me të cilin Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e porositi Mu'adhin (*radijall-llahu 'anhu*) dhe i tha: “O Mu'adh, ti po shkon te një popull të cilët janë ithtarë të librit, së pari thirri ata në teuhid (ta njohin All-llahun), në fjalën LA ILAHE IL-LALL-LLAH, MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH ...”⁸

Pra, obligimi i parë i robërve është: ta njohin dhe ta adhurojnë All-llahun (*subhanehu ve te'ala*) - LA ILAHE IL-LALL-LLAH.

Shej'h Hafidhe El-Hakemij (*rahimehull-llah*) thotë: “Obligimi i parë për gjithë njerëzit është: ta njohin All-llahun me *teuhid* të pastër”.⁹

- Çka don të thotë teuhid?

Fjala *teuhid* rrjedh prej fjalës *vahadeh-juvahiduh*, që don të thotë: ta njesosh All-llahun (*subhanehu ve te'ala*).

⁸ Transmeton Bu'hariu dhe Msulimi - Nga Mu'adhi.

⁹ “Me'arixhul Kabul”.

- Sa lloje është teuhid-i?

Teuhid-i është tre lloje:

- 1. Teuhid Rububij-jeh*
- 2. Teuhid 'Uluhi-jeh*
- 3. Teuhid Esma'i ves-sifat*

**** Teuhud-i Rububij-jeh ****

- Ç'është teuhid-i rububij-jeh?

Teuhid-i rububij-jeh është: të njesuarit e All-llahut në krijimin e Tij.

Çdo send që është e krijuar, është e krijuar prej All-llahut. Furnizimi vjen vetëm prej All-llahut. Sundimi i çdo gjëje i takon vetëm All-llahut. Jetën në këtë dunja e jep vetëm All-llahu. Vdekjen e sjellë vetëm All-llahu, dhe kështu me radhë. Të njesuarit e All-llahut në këto gjëra, kjo është *teuhid rububij-jeh*.

Këtë lloj të *teuhid*-it nuk e mohojnë vetëm se shumë pak prej njerëzve. E ka mohuar Faraoni, i cili tha:

... أَنَا رَبُّكُمْ الْأَعْلَىٰ ﴿٢٤﴾

“Unë jamë zoti juaj më i lartë!” (*En-Nazi'at*: 24)

Por, nuk e kanë mohuar mushrikët e Mekkes. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) fjalët e tyre i përmendë në Kur'an, ku thotë:

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ ۚ اللَّهُ ۗ ...

“Nëse ti (o Muhammed) i pyet ata (mushrikët e Mekkes) se kush i ka krijuar qiejt e Tokën, me siguri që do të thonë: “All-llahu!”.” (*Ez-Zumer*: 38)

Dhe thotë:

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولُنَّ ۗ اللَّهُ ۗ ...

“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri që do të thonë: “All-llahu!”.” (Ez-Zuhruf: 87)

Por megjithëatë, ata përsëri nuk janë llogaritur musliman.

Nëse dikush thotë se All-llahu është i vetmi që e ka krijuar tokën dhe qiellin, All-llahu ka krijuar çdo send dhe furnizon çdo send etj., dhe e ka vetëm këtë, por nuk i ka llojet tjera të *teuhid-it*, ai nuk llogaritet musliman.

Këtë bindje e kanë pasur edhe mushrikët e Mekkes, edhe pse ata nuk e kanë pasur të plotë *teuhid-in rububij-jeh*. Ata nuk e kanë besuar All-llahun në këtë lloj të *teuhid-it* njejtë si ne. Ata e kanë ditur se krijues, furnizues etj. është All-llahu, por në disa gjëra kanë devijuar edhe në këtë lloj të *teuhid-it*. Për shembull, kanë thënë se shiun e sjellin yjet, apo kanë thënë se të fshehtën (*gajb-in*) e dinë sihrbazët etj., por megjithëatë e kanë ditur se si krijues është All-llahu (*subhanehu ve te’ala*).

**** Teuhid-i 'Uluhij-jeh ****

- Ç'është teuhid-i 'uluhi-jeh?

Teuhid-i 'uluhi-jeh është: njesimi i All-llahut në adhurim ('ibadet).

Çdo 'ibade-t, i madh apo i vogël, haptas apo fshehtas, i jashtëm apo i brendshëm, i takon vetëm All-llahut. Dhe kjo është kuptimi i fjalës LA ILAHE IL-LALL-LLAH - Nuk meriton të adhurohet askush pos All-llahut. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٢﴾

“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të botëve.” (El-En'am: 162)

Në këtë lloj të teuhid-it kanë devijuar shumë njerëz. Ka shumë prej njerëzve, të cilët e dinë se krijuesi i vetëm është All-llahu, por e adhurojnë dikënd tjetër pos Tij, dhe këta nuk quhen musliman. Edhe mushrikët e Mekkes e kanë ditur se krijuesi është All-llahu, por i kanë adhuruar idhujt. Por, për fat të keq, ka edhe shumë prej muslimanëve, të cilët thonë: LA ILAHE IL-LALL-LLAH, ndërsa nuk e dinë se çfarë janë duke thënë, dhe thonë: Nuk meriton të adhurohet askush pos All-llahut, dhe pastaj i adhurojnë varrezat, tyrbet, evlijatë, shehlerët dhe lloj lloj adhurimi tjetër pos All-llahut (subhanehu ve te'ala).

Teuhid-i 'uluhi-jeh është teuhid-i më i rëndësishëm dhe për të cilin All-llahu (subhanehu ve te'ala) i ka krijuar gjithë njerëzit. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾

“Unë nuk i krijova xhinnet dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56)

**** 'Ibadet-i ****

- Çka don të thotë 'Ibadet?

'Ibadet-i është emër i përgjithshëm, për çdo send që All-llahu e don dhe është i kënaqur me të, prej fjalëve dhe veprave, të jashtme dhe të brendshme.¹⁰

Njeriu ka mundësi që vazhdimisht të jetë në 'ibadet ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Edhe puna, nëse bëhet pastër dhe në hallall, edhe ajo shëndrohet në 'ibade-t. Edhe kujdesja për familjen, që ata të edukohen në frymën Islame, është 'ibade-t. Çdo send që bëhet pastër dhe hallall, All-llahu është i kënaqur me të, ndërsa çdo send që All-llahu është i kënaqur me të, është 'ibadet.

Dijetarët kanë thënë: Ka mundësi ta shfrytëzosh edhe gjumin, edhe ushqimin, edhe pijen, edhe çdo send dhe ta shëndrosh në 'ibadet. Kështu ka folur kur janë takuar Ebu Musa me Mu'adhin (*radijall-llahu 'anhuma*) dhe ka thënë: "Unë e llogaris gjumin tim sikur e llogaris namazin e natës¹¹".

'Ibadet-i mund të jetë me fjalë, me vepër dhe me zemër. Prej fjalëve janë: *dhikr-i* (përmendja e All-llahut), *du'a-ja* (lutja), *selam-i*, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, etj.. Prej veprave janë: namazi, zekati, Haxhxhi, etj.. Dhe prej zemrës janë: nijeti, sinqeriteti, dashuria ndaj All-llahut, frika ndaj Tij, etj..

- Cilat janë kushtet për pranimin e 'ibadet-it?

Kushtet për pranimin e 'ibadet-it janë dy:

¹⁰ Ky është definicioni i *Shej'hul Islam Ibn Tejmijjes*.

¹¹ Për shembull, ta bësh nijet që të fleshë apo të hashë ushqim, me qëllim për ta forcuar trupin, që pastaj të mundesh më mirë t'i bësh 'ibade-t All-llahut.

1. *'Ibadet-i të jetë sinqerisht, vetëm për All-llahun (subhanehu ve te'ala)*
2. *'Ibadet-i të jetë në pasim të Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)*

Nëse njëri nga këto dy kushtet nuk plotësohet, *'ibadet-i* nuk vlenë dhe nuk pranohet.

Çfarëdo *'ibadet-i* që bën, qoftë ai i madh apo i vogël, nëse nuk e bën sinqerisht, vetëm për hirë të All-llahut, ai *'ibadet* nuk pranohet.¹² Apo, sado *'ibadet* që të bësh, qoftë ai i madh apo i vogël, nëse nuk e bën në pasim të *Sunne-tit*, ashtu siç e ka bërë Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), ai *'ibadet* nuk pranohet.¹³

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: *"Kush e bën një punë që ne nuk e kemi urdhëruar, ajo është e refuzuar (e papranuar)"*.¹⁴

All-llahu (subhaehu ve te'ala) thotë:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ...

"Ai i ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë." (El-Mulk: 2)

Fudajl ibn Ijadi (rahimehull-llah) ka thënë: *"All-llahu (subhanehu ve te'ala), kur i përmendë punët më të mira, don të thotë: punët më të sinqerta dhe në pasim të Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)"*.

¹² Për shmebull, të jepësh *sadaka* shumë para, qoftë edhe me mijëra, por ato i t'i jepësh për të të parë njerëzit, etj..

¹³ Për shembull, nëse agjëron sinqerish për All-llaun, por prej iftarit deri në syfir, etj..

¹⁴ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga A'isheja.

**** Teuhid-i Esmā'i ves-Sifat ****

- Ç'është teuhid-i esma'i ves-sifat?

Teuhid-i esma'i ves-sifat është: të besuarit në emrat e All-llahut dhe cilësitë e Tij, që janë përmendur në Kur'an ose në *hadith*-e të vërteta, ashtu si All-llahu dhe Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i kanë përmendur ato. Të besosh në çdo emër të All-llahut dhe çdo cilësi të Tij, që është përmendur në Kur'an dhe në *hadith* të vërtetë, ashtu siç ka ardhur.

- Kush quhet emër i All-llahut?

Emër i All-llahut quhet: çdo emër që është përmendur në Kur'an, që është përmendur në *hadith* të vërtetë dhe që përmban lavdërim ndaj All-llahut¹⁵.

Nëse ndonjë emër nuk është në Kur'an ose nuk është në *hadith* të vërtetë, nuk mund të quhet emër i All-llahut, edhe nëse atë e ka thënë cilido dijetarë i madh, edhe nëse atë e ka thënë dikush prej *selef-it*, edhe nëse ka ardhur në ndonjë transmetim të dobët (*daiif*).

Emrat e All-llahut kanë bazë në Kur'an dhe *Sunnet*. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا ...

"All-llahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to ..." (El-A'raf: 180)

¹⁵ Nuk guxon të jetë emër i All-llahut dhe të përmbajë mangësi ndaj Tij.

Nuk ka mundësi ta lutësh, ta duash apo të keshë frikë prej All-llahut, nëse ti nuk e njeh Atë. Të gjitha gjuhahet, *kufri*-i dhe *shirk-u* që bëhen nga njerëzit sot, bëhen për shkak se ata nuk e njohin All-llahun. Nuk ka mundësi ta duash dikënd apo të keshë frikë prej tij, nëse nuk e njeh atë, apo të paktën as emrin nuk ia din. Ndërsa emrat e All-llahut e lidhin zemrën e muslimanit me All-llahun (*subhanehu ve te'ala*), dhe nëpërmjet emrave shtohet dashuria ndaj Tij.

- Sa janë emrat e All-llahut?

Ibn Hazmi dhe shumë pak prej dijetarëve kanë thënë se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka vetëm nëntëdhjetë e nëntë emra. Këtë e kanë bazuar në një *hadith*, në të cilin Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “All-llahu i ka nëntëdhjetë e nëntë emra, njëqind pa një, kush i mëson do të hyjë në *Xhennet*”.¹⁶ Dhe kanë thënë: Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë se All-llahu i ka nëntëdhjetë e nëntë emra, pra All-llahu i ka vetëm nëntëdhjetë e nëntë emra.

Shumica e dijetarëve kanë thënë se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra, dhe sa janë ato, vetëm All-llahu e din. Dhe kanë thënë: *Hadithi* i cili thotë: “nëntëdhjetë e nëntë emra”, nuk ka për qëllim kufizimin e emrave të All-llahut, por ka për qëllim se, kush i meson nëntëdhjetë e nëntë, do të hyjë në *Xhennet*.¹⁷ Sikur një njeri të thotë: “Unë i kam njëqind euro për t'i dhënë *sadaka*”, dhe kjo nuk don të thotë se ai i ka vetëm njëqind euro, ai mund të ketë më shumë, por njëqind i ka ndarë për *sadaka*.

Më e sakta është se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra, e sa janë ato, vetëm All-llahu e din.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ka bërë një *du'a* (lutje) dhe ka thënë: “O All-llah, unë po të lutem Ty, me çdo emër që Ti e ke, që Ti e ke emërtuar veten tënde, ose këtë emër e

¹⁶ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁷ Shih “*El-Esma'u ves-Sifatu lil Bejhaki*; “*Fet-hul Bari*; “*Sherhul Akidet-Tahavij-jeh*” dhe “*Sahihul Muslim bi sherhin-Nevevi*”.

ke zbritur në Kur'an, apo këtë emër ia ke mësuar dikujt prej krijesave Tua, apo me ato emra që Ti i ke mbajtur fshehur".¹⁸

- Çka don të thotë t'i mësosh emrat e All-llahut?

Dijetarët kanë thënë: "Kush i mëson emrat e All-llahut" don të thotë: kush i meson përmendësh, ua din kuptimin atyre dhe e adhuron All-llahun me ato emra.¹⁹

- "Kush i meson përmendësh" don të thotë: t'i dishë ato. Për shembull: *Er-Rahman, Er-Rahim, El-Melik, El-Kuddus, Es-Selam, El-Mu'min, El-Muhejmin*, e deri në fund. Edhe pse nuk është kusht që ato të dihen me rend, kryesorja është të dihen përmendësh.

- "Ua din kuptimin atyre" don të thotë: ta dishë kuptimin e tyre. Për shembull: *Er-Rahman* - Mëshiruesi, *Er-Rahim* - Mëshirëbërësi, *El-Melik* - Sunduesi, *El-Kuddus* - Shpëtimtari, dhe të gjithë të tjerat.

- "Dhe e adhuron All-llahun me ato emra" don të thotë: në çdo moment që emri i përshtatet gjendjes, ta lutësh All-llahun me atë emër. Për shembull, nëse je i sëmurë, të thuash: "*Ja Shafi'* (o Shërues), më shëro mua!"; nëse ke bërë gjuhë, të thuash: "*ALL-LLAHUM-ME IN-NKE AFUVUN TUHIBUL 'AFVE FA'FU'AN-NI* (O All-llah, Ti je falës, e don faljen, më fal mua)"; nëse ke fukarallëk, të thuash: "*Ja Razzak* (o Furnizues), më furnizo mua"; dhe kështu me rradhë.

Kush e bën gjithë këtë, do të hyjë në Xhennet.

- Sa lloje janë emrat e All-llahut?

Emrat e All-llahut janë dy lloje:

1. *Mutllak* - Emër i cili përdoret në vete dhe ka kuptim të plotë për All-llahun

¹⁸ Transmeton Imam Ahmedi, Ibn Hibbani dhe Ebu 'Avaneh. Imam Huthejmi në "*Mexhmeudh-dhe-void*" thotë: "Këtë e transmeton Ahmedi, Ebu Ja'la dhe El-Bazzari". Ibn Hibbani e konsideron të besueshëm. Sipas *Shej'h* Albanit *hadith*-i është i saktë.

¹⁹ Shih "*Fet-hul Bari*" dhe "*Sahihul Muslim bi sherhin-Nevevi*".

Ky emër nuk ka nevojë t'i shtohet diçka tjetër pas. Për shembull: *Er-Rahman, El-Melik*, etj..

2. *Mukajjed* - Emër i cili nuk përmendet në vete, por lidhet me diçka tjetër, me gjendjen që All-llahu e ka përmendur në Kur'an

Për shembull, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Kur'an thotë:

... وَاللَّهُ مُحِيطٌ بِالْكَافِرِينَ ﴿١٩﴾

"Kështu, All-llahu është rrethues i mosbesimtarëve (i ka nën kontrollë)." (El-Bekarah: 19)

Nuk mund të thuhet: "All-llahu është rrethues", sepse kjo nuk ka kuptim të plotë për All-llahun, por partjetër duhet t'i lidhet edhe gjendja të cilën All-llahu e ka përmendur në këtë ajet, dhe duhet të thuhet: "All-llahu është rrethues i mosbesimtarëve (i ka nën kontrollë)".

- A lejohet emërtimi i njerëzve me emrat e All-llahut?

Prej emërave të All-llahut, ka prej tyre me të cilat ndalohej të emërtohet njeriu me to dhe ka prej tyre me të cilat lejohet të emërtohet njeriu me to:

1. Nuk lejohet që njeriu të emërtohet me emrat e All-llahut, nëse para tyre vëndoset një shqese "El" - Për shembull: *El-'Aziz, El-Hakim*, etj..

2. Nuk lejohet që njeriu të emërtohet me emrat e posaçëm, që i takojnë vetëm All-llahut - Për shembull: *All-llah (All-llahu), Rahman (Mëshirues), Ehad (I Vetmi), Samed* (që nuk ka nevojë për asgjë), *'Halik (Krijues), Raz-zak (Furnizues)*, etj..²⁰

3. Lejohet që njeri të emërtohet me disa emra të All-llahut, të cilat përmbajnë edhe cilësi të njeriut - Për shembull: *Hakim, Kerim, 'Aziz, Besir* etj., edhe pse nuk krahasohet emri i njeriut me emrin e All-llahut dhe cilësia e njeriut me cilësinë e All-llahut.

²⁰ Nëse para këtyre emrave ju shtohet edhe fjala 'Abd, atëher lejohet dhe është e pëlqyer emërtimi me ato emra. Për shembull: *'Abdull-llah, 'Abdur-Rahman, 'Abdus-Samed*, etj..

Pra, lejohet emërtimi i njeriut me emrat e All-llahut, nëse nuk i shtohet nyja shquese “El” dhe nëse emri nuk është prej emrave të posatshtëm të All-llahut.

- Si duhet besuar cilsit e All-llahut?

Duhet besuar të gjitha cilësitë e All-llahut që janë përmendur në Kur’an ose në *hadith*-e të vërteta, ashtu siç janë përmendur.

Dijetarët e *Ehli Sunnet*-it kanë thënë: Duhet besuar cilësitë e All-llahut, pa ua ndryshuar kuptimin, pa i mohuar ato, pa e përshkruajtur formën e tyre dhe pa i përngjasuar cilësitë e All-llahut me cilësitë e krijesave.

Për shembull, një prej cilësive të All-llahut, që shumë prej grupeve të devijuara e kanë mohuar, është se All-llahu gëzohet. Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “All-llahu gëzohet me pendimin e robit të Tij, më shumë se ai personi i cili e humbë deven me gjithë pasurinë e tij në mesin e shkretirës, e pastaj shtrihet për t’ia dorëzuar shpirtin All-llahut, derisa e zen gjumi dhe kur zgjohet e sheh (e gjenë) deven me gjithë pasurinë e tij”.²¹ Pra, Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) thotë: “All-llahu gëzohet” dhe ne duhet të besojmë që All-llahu gëzohet, pa katër gjërat që i përmendëm më lartë:

1. *Pa ia ndryshuar kuptimin* - Sepse disa kanë thënë: “All-llahu gëzohet”, kjo don të thotë: “All-llahu e shpërblenë atë”.

2. *Pa e mohuar* - Sepse disa kanë thënë: “Jo, njeriu gëzohet, ndërsa All-llahu nuk gëzohet asnjëherë”.

3. *Pa e përshkruar formën e tyre* - Pa të interesuar se si gëzohet All-llahu (në çfarë mënyre), etj..

4. *Pa e përngjasuar me krijesat* - Mos të thuhet apo mendohet se All-llahu gëzohet si gëzohen njerëzit, etj..

Pra, duhet të besohen të gjitha cilësitë e All-llahut që kanë ardhur në Kur’an ose në *hadith*-e të vërteta, pa ua ndryshuar kuptimin, pa i mohuar, pa ua përshkruar formën dhe mënyrë se si e kanë dhe pa i përngjasuar ato me cilësitë e krijesave.

²¹ Transmeton Muslimi - Nga Enes ibn Malik.

- A duhet shtrembëruar cilësitë e All-llahut?

Grupet e devijuara, siç janë Mu'tezilet, Esh'aritetë, Maturiditetë etj., kanë thënë: Këto cilësi që ju i pranoni, me këto e pëngjasoni All-llahun me krijesat, për atë, këto cilësi, edhe pse janë përmendur në Kur'an, edhe pse janë përmendur në *hadith*-e, ato duhet të komentohen (në realitet duhet të shtrembërohen).

Kur ne themi: All-llahu e ka përmendur në Kur'an dorën e Tij, ku thotë:

... يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ ...

"Dora e All-llahut është mbi duart e tyre!" (El-Feth: 10)

apo ka përmendur dysi:

... بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ ...

"... të dyja duart e Tij janë të hapura." (El-Maideh: 64)

grupet e devijuara thonë: Nuk guxohet të thuhet: "Dora e All-llahut", sepse nëse thuhet: "Dora e All-llahut", dorë ka edhe njeriu, dhe kështu pëngjasohet All-llahu me krijesat, por "dora e All-llahut" e ka kuptimin: Fuqia e All-llahut. Ndërsa ne ju përgjigjemi: Nëse mendohet ashtu, atëherë përsëri pëngjasohet All-llahu me krijesat, sepse edhe njeriu ka fuqi dhe fuqinë e tij All-llahu e ka përmendur në Kur'an. Ne themi: "Dora e All-llahut", por dora e All-llahut nuk krahasohet me dorën e krijesave. Edhe krijesat në mes vete nuk i kanë gjërat e njejta, dhe nëse thuhet: "Dora e njeriut" dhe thuhet: "Dora e ariut", ato nuk janë të njejta edhe pse e kanë emrin dorë. Pra, duhet të themi: "Dora e All-llahut", por vetëm Ai e din si.

Apo themi: "Këmba e All-llahut", dhe kur themi kështu, atyre ju rrënoqethet lëkura, ngase mendojnë se jemi duke e përngjasuar All-llahun me krijesat, por nuk është ashtu, ngase ne e besojmë All-llahun ashtu siç Ai na ka urdhëruar dhe ashtu siç Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ka përmendur në *hadith*-e të vërteta. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Xhehennemi nuk do të ndalet duke thënë: "A ka edhe më, a ka edhe më!" ... deri sa All-llahu do ta shkelë Xhehennemin me këmbën e tij". Pra, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) thotë: "All-llahu do ta shkelë Xhehennemin me këmbën e tij", dhe ne nuk guxojmë të themi diçka tjetër, përpos asaj që e ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu*

'alejhi ve sel-lem). Themi: "këmba e All-llahut", por pa menduar si, sepse All-llahut nuk i përngjanë asnjë send:

... لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ...

"Asgjë e askush nuk i shëmbëllen atij." (Esh-Shura': 11)

dhe kush thotë se një cilsi e All-llahut i përngjanë një cilësie të krijesave, bën *kufër*.

Gjithashtu themi: "All-llahu qeshet", dhe për këtë kemi argument. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "All-llahu qeshet me dy persona, ku njëri ngritet dhe e vret tjetrin dhe të dy hyjnë në Xhennet! Njëri prej tyre lufton në rrugë të All-llahut, vritet (bie Shehid) dhe hyn në Xhennet; kurse vrasësin e mëshiron All-llahu, e ky e praon Islamit dhe pastaj edhe vet bëhet Shehid (vritet në Xhihad)".²² Pra, ne nuk guxojmë të themi diçka tjetër, përpos asaj që e ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Themi: "All-llahu qeshet", dhe mjaftojmë me kaq, pa komentuar dhe filozofuar dhe pa i shtrembëruar cilësitë e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Cilësitë e All-llahut janë cilësi absolute, që nuk ju përngjanë atyre askush dhe asgjë, dhe nuk duhet të shtrembërohen cilësitë për ta pastruar All-llahun, sepse All-llahu është i pastër nga çdo e metë; por duhet të pranohen të gjitha cilësitë e All-llahut që janë përmendur në Kur'an ose në *hadith*-e të vërteta.

- A nxjerret emër prej cilësive të All-llahut?

Prej emrave të All-llahut nxjerret cilësi, por prej cilësive të All-llahut nuk nxjerret emër.

- Prej të gjitha emrave të All-llahut nxjerret cilësi e All-llahut – Për shembull, prej emrit të All-llahut *Er-Rahman* (Mëshiruesi) nxjerret cilësia *Rahmeh* (Mëshirë); prej emrit *Melik* (Sundues) nxjerret cilësia *El-Mulk* (Sundimi); prej emrit *Hakim* (i Urti) nxjerret cilësia *El-Hikmeh* (urtësia); etj..

- Prej cilësive të All-llahut nuk nxjerret emër – Për shembull: "All-llahu flet":

²² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

“Dhe All-llahu i ka folur Musait me fjalë (drejtpërdrejt).” (En-Nisa’: 164)

Pra, All-llahu flet dhe kjo është cilësi e Tij, por nuk emërtohet All-llahu “Mutekelim” - Folës.

Cilësitë e All-llahut janë më shumë se emrat e Tij.

- Sa lloje janë cilësitë e All-llahut?

Cilësitë e All-llahut janë tre lloje:

1. *Es-sifat edh-dhatij-jeh* - Ato cilësi që nuk ndahen prej All-llahut asnjëherë – Për shembull: fuqia e All-llahut, dituria e All-llahut, shikimi i All-llahut, dëgjimi i All-llahut, etj..

2. *Es-sifat el-fi’lij-jeh* - Ato cilësi që janë të lidhura me dëshirën e All-llahut (nuk janë të vazhdueshme), që nëse don All-llahu e bën e nëse don nuk e bën – Për shembull: Zbritja e All-llahut në qiellin e dunjasë në pjesën e tretë të natës, etj..

3. *Es-sifat el-’haberij-jeh* - Ato cilësi për të cilat ka ardhur (lajm) ajet apo hadith, por logjika nuk ka vend në to - Këto cilësi pranohen ashtu siç janë përmendur. Për shembull: dora (apo duartë) e All-llahut, sytë e All-llahut, etj..

- Ku është All-llahu?

Grupet e devijuara, siç janë: Esh’aritetë, Xhehmitë, Maturiditetë etj., kanë thënë: “All-llahu është gjithkund” dhe “Kudo që të jeshë, All-llahu është me ty”. Ndërsa *Ehli Sunnet*-i kanë thënë: “All-llahu është mbi ‘Arsh-in e Tij, mbi shtatë kat qiej”.

All-llahu është mbi ‘Arsh-in e Tij, mbi shtatë kat qiej. All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى ﴿٥﴾

"I Gjithmëshirshmi mbi 'Arsh u ngrit." (Ta-Ha: 5)

Dhe thotë:

ءَأْمِنْتُمْ مِّنْ فِي السَّمَاءِ أَنْ تَخْسِفَ بِكُمْ الْأَرْضَ فَإِذَا هِيَ تَمُورُ ﴿١٦﴾

"A u siguruat se Ai që është në qiell, nuk do ta bëjë Tokën tju përpijë, kur të fillojë të dridhet papritmas?" (El-Mulk: 16)

Gjithashtu thotë:

وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مِنْ دَابَّةٍ وَالْمَلَائِكَةُ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٤٩﴾

مُخَافُونَ رَبَّهُمْ مِّنْ فَوْقِهِمْ ...

"All-llahut i përulet në sexhde çdo gjallesë, në qiej dhe në tokë, edhe engjëjt, të cilët nuk janë kryelartë. Ata i frikësohen Zotit të tyre lartë mbi ta ..." (En-Nahl: 49-50)

Për 'Isaun ('alejhis-selam) thotë:

بَلْ رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ ...

"por, All-llahu e ka ngritur pranë Vetes." (En-Nisa': 158)

Gjithashtu, në shumë ajete All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë: "Kemi zbritur", që don të tote se All-llahu është lartë. Gjithashtu thotë:

... إِلَيْهِ يَصْعَدُ الْكَلِمُ الطَّيِّبُ ...

"Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë." (Fatir: 10)

Dhe shumë ajet-e tjera tregojnë që All-llahu është mbi 'Arsh.

Pejgamberi (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "A nuk po më zini besë, kur mua më ka llogaritur besnik Ai që është mbi qiej".²³

Në një *hadith* tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Mëshironi ata që janë në tokë, ju mëshiron Ai që është në qiell".²⁴

Bashkëshortja e Pejgamberit (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*), Zejnebeja (*radijall-llahu 'anha*), është lavdëruar ndaj grave tjera dhe ka thënë: "Juve ju kanë martuar familjet tuaja, ndërsa mua më ka martuar All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) me Pejgamberin (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*) prej mbi shtatë kat qiej".²⁵

Te Pejgamberi (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*), ku erdhi një *xharije* (shërbetore), Pejgamberi (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*) i tha: "Ku është All-llahu?" Ajo tha: "All-llahu është në qiell". Pastaj i tha: "Kush jamë unë?" Ajo tha: "Ti je Pejgamber i All-llahut". Pejgamberi (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Lirojeni, se ajo është besimtare".²⁶

Dhe shumë argumente tjera flasin se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) është mbi 'Arsh. Një prej argumenteve është *Mi'raxh-i* i Pejgamberit (*sal-lall llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili u ngrit prej në tokë deri në qiellin e shtatë dhe foli drejtëpërdrejtë me All-llahun (*subhanehu ve te'ala*).

Gjithashtu, argument është edhe lutjet e besimtarëve, të cilët i ngrisin duart e tyre kah qielli dhe e lusin Zotin e tyre, i Cili është mbi shtatë kat qiej, mbi 'Arsh-in e Tij.

Imam Maliku (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Që All-llahu është ngritur mbi 'Arsh është e ditur, ndërsa si është ngritur, këtë nuk e kapë logjika, dhe besimi në të është *vaxhib* (obligim), ndërsa të bësh pyetje për të si, kjo është *bid'a-t* (risi)".²⁷

Ndërsa, kur themi: "All-llahu është me ty kudo që të jeshë", dhe për këtë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Kur'an thotë:

... وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ ...

"Ai është me ju kudo që të gjindeni ..." (El-Hadid: 4)

²³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

²⁴ Transmeton Tirmidhiu me zinxhirë të mirë.

²⁵ Transmeton Bu'haru - Nga Enes ibn Malik.

²⁶ Transmeton Muslimi dhe Nesaiu - Nga Mu'avijeh ibn El-Hakem.

²⁷ Shih "Er-Revdatur-nedij-jeh".

ka për qëllim: “All-llahu është me ty kudo që të jeshë, me diturinë e Tij, me shikimin dhe dëgjimin e Tij, etj.”, dhe këtë e komenton *ajet-i tjetër*²⁸, në të cilin All-llahu (*subhanhehu ve te’ala*), Musait dhe Harunit (*‘alejhim-mes-selam*), ju tha:

قَالَ لَا تَخَافَا إِنِّي مَعَكُمْ أَسْمَعُ وَأَرَىٰ

“Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh .” (Ta-Ha: 46)

“Unë jam me ju” nuk do të thotë se All-llahu është me Musain dhe Harunin në tokë, por nënkupton: All-llahu është me ju, ju dëgjon dhe ju sheh. Dhe kështu thotë All-llahu, kur Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), duke qenë në shpellë, i tha Ebu Bekrit (*radijall-llahu ‘anhu*):

... لَا تَحْزَنَ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا ...

“Mos u mërzit, se All-llahu është vërtetë me ne!” (Et-Teubeh: 40)

Kjo nuk don të thotë se All-llahu është me ne në shpellë, por nënkupton: All-llahu është me ne, me diturinë e Tij dhe Ai të mbron kudo që të jeshë.

- A ka dallim ndërmjet ‘Arsh-it dhe Kursijj-ës?

Kursijj-ën, All-llahu (*subhanhehu ve te’ala*) e ka përmendur në Kur’an, ku thotë:

... وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ...

“... Kursijj-a e Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën ...” (El-Bekarah: 255)

Dikush prej dijetarëve ka thënë: *Kursijj-a* dhe *‘Arsh-i* janë një. E vërteta është se *Kursijj-a* dhe *‘Arsh-i* nuk janë një, por ka dallim ndërmjet tyre.

‘Abdull-llah ibn Mes’udi (*radijall-llahu ‘anhu*) ka thënë: “Ndërmejt qiellit të parë të kësaj dunjaje deri në qiellin e dytë ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të dytë deri

²⁸ Kur’ani së pari komentohet *ajet me ajet*, e pastaj *ajeti me hadith* dhe kështu me rradhë.

në qiellin e tretë ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të tretë deri në qiellin e katër ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të katër deri në qiellin e pestë ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të pestë deri në qiellin e gjashtë ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të gjashtë deri në qiellin e shtatë ka sa pesëqind vite udhëtim; prej qiellit të shtatë deri te *Kursijj*-a e All-llahut ka sa pesëqind vite udhëtim; prej *Kursijj*-ës së All-llahut deri te *Uji* ka sa pesëqind vite udhëtim; prej *Ujit* deri te 'Arsh-i i All-llahut ka sa pesëqind vite udhëtim; dhe mbi 'Arsh është All-llahu, dhe i shikon, dhe i din të gjitha punët e juaja, dhe nuk i fshihet Atij asnjë send".²⁹

Kursijj-a është vendi i këmbëve të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

'Abdull-llah ibn 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "*Kursijj*-a është vendi i këmbëve të All-llahut"³⁰.³¹

Ndërsa për 'Arsh-in, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*Kursijj*-a, në *krahasim me 'Arsh-in e All-llahut, është sa një hallkë e hekurit ta hedhësh në shkretirë*".³²

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَتَحْمِلُ عَرْشَ رَبِّكَ فَوْقَهُمْ يَوْمَئِذٍ ثَمَنِيَّةٌ

"Engjëjt do të rrinë skajeve të tij, kurse tetë prej tyre do të mbajnë 'Arsh-in e Zotit tend." (*El-Hakkah*: 17)

Ndërsda për *melaik*e-t e 'Arsh-it, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*Më është lejuar të ju tregoj për një prej melaikëve të 'Arsh-it, prej te lapa e veshit deri te qafa e tij është sa të udhëtosh shtatëqind vite*".³³

²⁹ Transmeton Ibn 'Huzjemeh - Ibn Mehdiju nga Hamad ibn Selmeteja, ky nga Asimi, ky nga Zerri e ky nga 'Abdull-llahu. Imam Ibn Kajjim El-Xhevziyeh dhe Imam Dhehebiu e kanë llogaritur transmetim të vërtetë. Shih "*El-Uluw*" dhe "*Ixhtimil xhujushil Islamij-jeh*".

³⁰ Kur vijnë kësi lloj fjalësh prej Sahabeve, nuk ka mundësi ato të vijnë prej logjik së tyre, por kjo nënkupton se ato vijnë prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

³¹ Transmetimi është *hasen* (i mirë). E përmendë Hakimi në "*Mustedrek*" dhe thotë: "Kjo është thënie që i plotëson kushtet e Bu'hariut dhe Muslimit, ndërsa ata nuk e transmetojnë prej Ibn 'Abbasit". Këtë e përmendë edhe Suxha' ibn Muhal-laed El-Felasi në "*Tefsir*"-in e tij, prej Ebu Asim En-Nubejlit, ndërsa ai prej Theurit. Më mirë shtë të themi se ky është qëndrimi i Ibn 'Abbasit, të cilin e transmeton Ibn Xheriri.

³² E përmend Ibn Xherir Et-Taberi në "*Xhami'ul Bejan*" dhe Muhammed ibn Ebi Shejbeh - Nga Ebu Dherri. Sipas *Shej'h* Albanit *hadithi* është i saktë.

³³ Transmeton Ebu Davudi - Nga Xhabir ibn Abdull-llahu. Ky është *hadith sahih*, e ka nxjerrur *Shej'h* Albani.

- A del prej Islami ai që i mohon cilësitë e All-llahut?

Nëse dikush i mohon të gjitha cilësitë e All-llahut, cilësitë e qarta që kanë bazë në Kur'an dhe *Sunnet*, del prej Islami dhe nuk llogartitet musliman. Por, nëse dikush i komenton cilësitë e All-llahut dhe ua jep një kuptim tjetër atyre, atëherë varet prej mënyrës së komentimit.

Komentimi bëhet në dy mënyra:

1. Komentim i cili ka bazë në gjuhën arabe
2. Komentim i cili nuk ka bazë në gjuhën arabe

Nëse dikush i komenton cilësitë e All-llahut me llojin i cili nuk ka bazë në gjuhën arabe, bën *kufër* dhe del prej Islami. Për shembull, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Kur'an thotë:

... بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ ...

“... të dyja duart e Tij janë të hapura.” (El-Maideh: 64)

Nëse dikush thotë: “Dy duart e All-llahut janë qielli dhe toka”, ai me këtë i ka devijuar cilësitë e All-llahut dhe i ka komentuar ato duke mos u bazuar askund dhe me këtë ai bën *kufër* dhe del prej Islami. Kështu kanë vepruar edhe Shi'at e devijuar, të cilët i kanë komentuar *ajet*-et e All-llahut pa u bazuar askund. Për shembull, për *ajet*-in, ku All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَذَنُّوْا بَقْرَةَ ...

“All-llahu ju urdhëron ta therrni një lopë!” (El-Bekarah: 67)

kanë thënë: Këtu është fjala për A'ishen. “All-llahu ju urdhëron ta therrni një lopë” nënkupton: All-llahu ju urdhëron ta therrni A'ishen. All-llahu na ruajtë nga kjo! Apo për *ajet*-in, në të cilin All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ يَلْتَقِيَانِ ﴿١٩﴾

“Ai i ka lënë të lira dy detet që të takohen.” (Er-Rahman: 19)

kanë thënë: “Dy detet” janë: ‘Aliju dhe Fatimeja. Dhe për *ajet*-in:

مُخْرَجٌ مِنْهَا اللَّوْلُؤُ وَالْمَرْجَانُ

“Prej tyre nxirren margaritarë e diamantë.” (Er-Rahman: 22)

kanë thënë: “margaritarë e diamante” janë: Hasani dhe Husejni. Pra, ky lloj i komentimit është *kuf*r dhe të nxjerrë prej Islami.

Por, nëse dikush i komenton cilësitë e All-llahut me llojin i cili ka bazë në gjuhën arabe, bën gabim (ka gjuhah), por nuk bën *kuf*r. Për shembull, nëse dikush, për *ajet*-in:

... بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ ...

“... të dyja duart e Tij janë të hapura.” (El-Maideh: 64)

thotë: “Dy duart e All-llahut” nënkupton: Bujaria e All-llahut. Dhe ne themi: “Filani jep me dy duar”, ndërsa në relaitet ai nuk jep me dy duar, ai jep me një dorë, por kur është shumë bujarë, themi se jep me dy duar. Ky komentim ka bazë në gjuhën arabe, por është gabim dhe është devijim i cilësive të All-llahu, por megjithëatë nuk është *kuf*r. Në këtë lloj hynë grupi i Maturidive, Esh’arive, etj..

- Çka don të thotë emri All-llah?

Disa prej dijetarëve kanë thënë: Emri *All-llah* është vështirë të përthekohet dhe t’i jepet kuptimi i plotë që Ai e meriton. Ngase All-llahu është i plotë (i përsosur), pa asnjë të metë, ndërsa ne, për ta përshkruar emrin *All-llah*, jemi të dobët dhe me të meta dhe është vështirë për ta përthekuar dhe për t’ia dhënë kuptimin e plotë që ky emër e meriton. Ndërsa disa prej dijetarëve kanë thënë: *All-llah* don të thotë: *me’lu’* apo *ma’bud*, që don të thotë: *I adhuruar, i Cili e meriton adhurimin*.³⁴

³⁴ Këtë e ka përmendur *Shej’h* Ibn Uthejmini dhe shumë dijetarë tjerë para tij.

All-llah do të thotë: I adhuruar, i Cili e meriton adhurimin. Edhe pse kuptimi i emrit *All-llah* është shumë më i gjërë dhe shumë më i madh, por që ne jemi të dobët dhe të mangët për t'i dhënë kuptimin dhe përshkrimin e plotë që Ai e meriton.

Disa prej njerëzve kanë dhënë kuptime të ndryshme dhe janë munduar që ta zbukurojnë emrin e All-llahut me disa gjëra, që për to All-llahu nuk ka nevojë. Ka prej njerëzve dhe prej hoxhallarëve që mundohen Islamin ta zbukurojnë, ndërsa Islami është i qartë, është ka thënë All-llahu dhe ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe nuk ka shumë filozofi në të. Por disa njerëz, Islamin mundohen ta zbukurojnë, (kinse) që të tjerëve të ju duket më i mirë, dhe ka prej tyre që edhe emrin *All-llah* kanë dashur ta zbukurojnë. Ndërsa dijetarët e mëdhenj, kur e kanë përshkruar kuptimin e emrit *All-llah*, i kanë folur dy apo tri fjalë dhe nuk kanë pasur mundësi të hynë shumë më shumë dhe të bëjnë përshkrime për të cilat nuk ka bazë. Kështu është pyetur dijetari i dijetarëve, një prej Sahabeve me të medhenj, 'Abdull-llah ibn 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*), të cilin, kur e pyetën për emrin e All-llahut, tha: "*All-llah* është: Ai i cili është i adhuruar dhe e meriton adhurimin".

Por, disa njerëz, bile një rast i cili është i njohur, në Jordan, një profesoreshë në Univerzitetin e Jordanit, ju bën pyetje studenteve dhe ju thotë: "Kush ka mundësi të ma thotë mrekullinë e shqiptimit dhe të shkrimit që gjendet në emrin *All-llah*?" Në atë moment heshtën e gjithë klasa dhe nuk pati mundësi të ngritet asnjë dhe të japë përgjigje. Atëherë u ngrit një vajzë spanjolle dhe tha: "Emri *All-llah*, për nga shqiptimi, është emri i vaçant, që përmendet pa i mbyllur buzët fare, dhe shkronja "*he*" (*All-lla-h*) del nga mbrenda, që tregon se emri *All-llah*, kur të përmendet, nuk është vetëm prej majes së gjuhës, por duhet të përmendet edhe prej brendisë së njeriut". Atëherë shumë njerëzve ju pëlqeu kjo.

Kjo nuk është përshkrim i emrit të All-llahut, ngase edhe Sahabet apo dijetarët e mëdhej kanë pasur mundësi të bëjnë kësi lloj përshkrimi, por ata çdo herë janë bazuar në çështje dhe në argumente të qarta dhe nuk kanë filozofuar shumë. Dhe, nëse themi se emri *All-llah* është i veçant, ngase kur përmendet, nuk mbyllen buzët fare, nuk është ashtu, ngase kemi edhe emra tjerë të All-llahut, që kur përmenden, nuk mbyllen buzët fare. Për shembull, emri: *El-'Aziz*, *El-'Hlik*, *Er-Razzak*, etj.. Dhe për shkronjën "*he*", që tregon se del nga brenda, ka edhe emrave tjerë të All-llahut, që kur përmenden, nuk prekin buzët dhe e kanë shkronjën "*he*". Për shembull, emri: *El-Kahir*, *El-Kahhar* etj., që don të thotë se kjo nuk e ka ndonjë kuptim të veçant.

E pastaj, vazhdoi ajo vajza përgjijgen dhe tha: “Nga ana e shkrimit, emri All-llah ka një mrekulli, që cilën shkronjë që ti ia hjek, ai mbetet me kuptim. Për shembull, (الله) *All-llah*, nëse ia hjek *elif*-in, mbetet: (له) *lil-lah*:

لله مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ...

“All-llahut i përket gjithëçka që gjendet në qiej dhe gjithëçka që gjendet në Tokë ...” (El-Bekarah: 284)

Nëse ia hjek *lam*-in e parë, mbetet: *ilah* (إِله):

الله لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ...

“All-llahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithëkaje.” (El-Bekarah: 255)

Nëse ia hjek *lam*-in e dytë, mbetet: *lehu* (لَهُ):

... لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ...

“Atij i përket gjithëçka që gjendet në qiej dhe gjithëçka që gjendet në Tokë.” (El-Bekarah: 255)

Nëse ia hjek edhe *lam*-in, mbetet: *hu* (هُ):

اللهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ...

“All-llahu është një, nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) përveç Atij.” (El-Bekarah: 255)

Dhe përsëri gjithë mbetën të kënaqur nga kjo.

Kjo është teprim në fenë e All-llahut dhe nuk ka bazë askund, dhe po të kishte qenë e mirë dhe me vlerë, do ta kishte thënë Ebu Bekri, 'Umeri dhe Sahabet, dhe do ta kishin thënë dijetarët e *selef-it* me shekuj para nesh, por ata nuk kanë filozofuar, por kanë thënë: "Emri *All-llah* don të thotë: I adhuruar, i Cili e meriton adhurimin".

- Cili është emri më i madh i All-llahut?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Emri më i madh i All-llahut është në këto tre Surah: *El-Bekarah, Ali 'Imran dhe Ta-Ha*".³⁵ Në disa transmetime tjera ka thënë: "Nëse dikush e lutë All-llahun me këtë emër, Ai i përgjigjet, e nëse dikush i lypë All-llahut me këtë emër, Ai ia jep".³⁶

Disa prej dijetarëve kanë thënë: Emër më të madh të All-llahut nuk ka. Por *hadith-i "emri më i madh"* nënkupton: emri i madh. *A'dham* (më i madh) e ka kuptimin '*adhim* (i madh), ngase gjithë emrat e All-llahut janë të medhej dhe janë të bukur. Disa dijetarë tjerë kanë thënë: Po, gjithë emrat e All-llahut janë të bukur dhe gjithë e kanë kuptimin e plotë, por një prej emrave është më i madh se gjithë, por këtë emër e din vetëm All-llahu dhe nuk e din askush tjetër pos Tij. Ndërsa shumica e dijetarëve kanë thënë: All-llahu e ka një emër (prej atyre që i dimë), që është në Kur'an ose *hadith*, e që ky emër është më i madh se gjithë emrat tjerë.

Ibn Haxher El-Askalani (*rahimehull-llah*) ka përmendur katërmbëdhjetë mendime se cili është emri më i madh i All-llahut, dhe ka përmendur emrat: "1. *Huve*; 2. *All-llah*; 3. *All-llahur-Rahmanur-Rahim*; 4. *Er-Rahamanur-Rahimul Haj-jul Kaj-jum*; 5. *El-Haj-jul Kaj-jum*; 6. *El-Han-nanul Men-nan Bedius-semavati vel erdi Dhul Xhelali vel Ikram*; 7. *Bedius-semavati vel erdi Dhul Xhelali vel Ikram*; 8. *Dhul Xhelali vel Ikram*; 9. *All-llahu ledhi la Ilahe il-la Huve El-Ehad Es-Samed El-ledhi lem jelim ve lem juled ve lem jekul-lehu kufuven ehad*; 10. *Rabb*; 11. *La ilahe il-la ente subhaneke in-ni kuntu minedh-dhalimin*; 12. *Huve All-llah All-llah All-llah El-ledhi la ilahe il-la Huve Rab-bul 'Arshil Adhim*; 13. (I fshehur në emrat e bukur); 14. *La Ilahe il-la All-llah*".³⁷

Prej këtyre katërmbëdhjetë mendimeve, shumica e dijetarëve kanë thënë: Emri më i saktë, i cili është më i madh prej gjithë emrave të All-llahut, është emri: *ALL-LLAH*. Disa

³⁵ Transmeton Ibn Maxheh. *Shej'h* Albani këtë *hadith* e cilëson si të mirë (*hasen*).

³⁶ Transmeton Ebu Davudi - Nga Enesi.

³⁷ Ibn Haxher El-Askalani në "*Fet'hul Bari*".

dijetarë kanë thënë: Sepse gjithë emrat i kthehen emrit *All-llah*. Dikush prej dijetarëve ka thënë: Emri *All-llah* është më i madh dhe këtë emër All-llahu e ka përmendur më së shumti në Kur'an³⁸, e përderisa e ka përmendur më së shumti, nënkupton se është emri më i madh.

Pas kësaj, mendimi i cili është më afër emrit më të madh të All-llahut, është mendimi i dijetarëve të cilët kanë thënë: Emri më i madh i All-llahut është: *El Haj-jul Kaj-jum*.³⁹ Dhe kanë thënë: Sepse Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Emri më i madh i All-llahut është në këto tre Surah: *El-Bekarah*, *Ali 'Imran* dhe *Ta Ha*”⁴⁰, dhe ky emër është në këto tre Surah. Në Suran *El-Bekarah*, All-llahu (*subahnehu ve te'ala*) thotë:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ...

“All-llahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!” (El-Bekarah: 255)

Në Suran *Ali 'Imran* thotë:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ

“All-llahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!” (Ali 'Imran: 2)

Dhe në Suran *Ta-Ha* thotë:

وَعَنْتِ الْوُجُوهُ لِلْحَيِّ الْقَيُّومِ ...

“Fytyrat do t'i përulen të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të çdo gjëje ...” (Ta-Ha: 111)

Ajo që mendojmë se është më e saktë, është mendimi i shumicës së dijetarëve, se emri më i madh i All-llahut është emri: *ALL-LLAH*.

³⁸ Emri *ALL-LLAH* në Kur'an është përmendur: 2697 (dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) herë.

³⁹ Këtë mendim e përkrahë Imam Neveviu; pashtu edhe Imam Ibn Uttejmini dhe dijetarë tjerë.

⁴⁰ Transmeton Ibn Maxheh. *Shej'h* Albani këtë *hadith* e cilëson si të mirë (*hasen*).

**** Shehadeti ****

- Çka don të thotë Shehadeti?

Shehadeti është dëshmia: *ESH-HEDU EL-LA ILAHE IL-LALL-LLAH, VE ESH-HEDU EN-NE MUHAM-MEDEN 'ABDUHU VE RASULUH!*

ESH-HEDU don të thotë: dëshmoj. Nuk don të thotë: besoj, e as nuk don të thotë: deklaroj. Thuhet dëshmoj, ngase njeriu dëshmon për një send atëherë kur e sheh me sy, por ne All-llahun nuk e kemi parë me sy, mirëpo e besojmë Atë sikur me e parë.

EL-LA ILAHE IL-LALL-LLAH don të thotë: nuk meriton të adhurohet askush pos All-llahut. Nuk don të thotë: nuk ka zot pos All-llahut, edhe pse All-llahu është i vetmi zot i cili e meriton adhurimin, por njerëzit kanë shpikur shumë zotra pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Thuhet: nuk meriton të adhurohet askush pos All-llahut, ngase All-llahun (*subhanehu ve te'ala*) si furnizues, si krijues dhe si sundues e ka besuar edhe Ebu Xhehli, Ebu Lehebi dhe mushrikët e Mekkes, të cilët fjalën *LA ILAHE IL-LALL-LLAH* e kanë kuptuar më mirë se shumë musliman të kësaj kohe, se shumë njerëz të cilët e thonë këtë fjalë. Ebu Xhehlin, Ebu Lehebin dhe shumë mushrik të Mekkes, kur i ka thirrur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) që të dëshmojnë *LA ILAHE IL-LALL-LLAH*, ata nuk kanë pranuar, ngase ata e kanë kuptuar se çka don të thotë kjo fjalë dhe e kanë ditur se pas kësaj fjale vinë shumë punë tjera, për atë edhe nuk e kanë thënë. Mushrikët e Mekkes nuk e kanë dëshmuar Shehadetin, ndërsa shumë "musliman" të kësaj kohe e shqiptojnë atë, ndërsa kah ana tjetër nuk e praktikojnë, dhe dallimi është se, mushrikët e Mekkes e kanë ditur kuptimin e kësaj fjale, por nuk e kanë shqiptuar, ndërsa shumë njerëz të kësaj kohe e thonë atë, ndërsa nuk ia dinë kuptimin.

VE ESH-HEDU EN-NE MUHAMMA-MEDEN 'ABDUHU VE RASULUH don të thotë: dhe dëshmoj (edhe pse nuk e kemi parë, sikur me e parë) se Muhammedi është rob i All-llahut dhe i dërguar i Tij. Së pari thuhet '*abduhu*: rob i All-llahut, dhe me këtë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) na tregon se ai është rob, njeri i cili nuk e meriton adhurimin. Pra, përveç All-llahut, as Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) nuk guxon të

adhurohet, e jo më *evlija*-të, njerëzit e mirë, etj.. Dhe *ve Rasuluh*: dhe i dërguar i All-llahut, vulë e gjithë Pejgamberëve.

ESH-HEDU EL-LA ILAHE IL-LALL-LLAH, VE ESH-HEDU EN-NE MUHAM-MEDEN 'ABDUHU VE RASULUH don të thotë: Dëshmoj se nuk meriton të adhurohet askush pos All-llahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

- A mjafton Shehade-ti?

Për fat të keq, ka shumë prej hoxhallarëve dhe thirrësave, të cilët thonë: Nëse dikush thotë *LA ILAHE IL-LALL-LLAH*, çkado që të bëjë pastaj, Xhennetin e ka të sigurtë (të garantuar)!

Fjala *LA ILAHE IL-LALL-LLAH* mjafton për një njeri që të hyjë në Islam, dhe nuk mjafton për të që të mbetet në Islam. Për shembull, nëse një njeri është jomusliman dhe dëshiron të hyjë në Islam, ai duhet të thotë: *LA ILAHE IL-LALL-LLAH*, dhe mjafton për të për të hyrë në Islam, por nuk mjafton që ai pastaj të mbetet në Islame, ngase pastaj vjen koha e namazit dhe prej tij kërkohet namaz, vjen koha e Ramazanit dhe prej tij kërkohet agjërimit, vjen koha e zekatit dhe prej tij kërkohet zekatë (nëse ka pasuri), e kështu me rradhë.

Nëse dikush dëshiron të hyjë në Islam, mjafton për të që ta dëshmojë Shehadetin, që të hyjë në Islam, e jo që të mbetet në të përgjithmonë. Ndërsa për fat të keq, shumë prej njerëzve, nëse dikush dëshironë të hyjë në Islam, ata i vendosin edhe kushte tjera. Për shembull, në një rast në Evropë, një njeri (jomusliman) ka shkuar te një "hoxhë" dhe i ka thënë atij: "Unë kam ardhur në xhaminë tuaj për ta pranuar Islamin". Hoxha e ka pyetur: "A ke marur *gusl* (a je pastruar)?" Ai është përgjigjur: "Jo". Atëherë hoxha i ka thënë: "Shko një herë në shtëpi, pastroju dhe pastaj eja dhe pranoje Islamin!". E pastaj, është nisur ky personi, mbi njëzet kilometra udhëtim, për të shkuar në shtëpi, për të marur *gusl* (për tu larë-pastruar) dhe për të ardhur dhe për ta pranuar Islamin (për ta dëshmuar Shehadetin). Ky është një gabim shumë i madh dhe një katastrofë shumë e madhe. Këtë nuk e ka vepruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), që me mijëra njerëz kanë hyrë në Islam dhe asnjërit prej tyre nuk i ka thënë që të shkojë në shtëpi, të pastrohet një herë, e pastaj të vijë dhe ta pranojë Islamin. Çfarë bëhet me atë njërei, që duke shkuar në shtëpi për të marur *gusl*, vdes, apo e devijon rrugën, apo pendohet prej pranimit të Islamit?! Nëse ai vdes rrugës, nuk ka hyrë në Islam dhe ai mbetet

përgjithmonë në Xhehennem, si rezultat i gabimit të dikujt i cili është injorant. Pra, nëse një njeri dëshiron të hyjë në Islam, mjafton për të që ta dëshmojë Shehadetin, e pastaj gradualisht duke u njoftuar me Islamin, me Kur'anin dhe *Sunnet*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), për të vazhduar pastaj *'ibadet*-in ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), dhe çdo *'ibade*-t pastaj e ka vendin dhe kohën e vet.

Shehadeti mjafton për të hyrë në Islam, mirëpo nuk mjafton për të mbetur në të, ngase ashtu siç priset abdesi, ashtu siç priset namazi e agjërimi, ashtu priset edhe Shehadeti. Ka mundësi të hyhet në Islam, por ka mundësi edhe të dilet prej tij, si rezultat i prishjes së Shehadetit, ngase Shehadeti ka gjëra me të cilat priset.

- Cilat janë kushtet e Shehadetit?

Shumë njerëz mendojnë se Shehadeti është vetëm fjalë, dhe vazhdimisht e kanë përdorur këtë, duke thënë: “Fjala *LA ILAHE IL-LALL-LLAH* është çelsi i Xhennetit”, dhe e kanë përdorur vetëm kaq, pa e kuptuar këtë fjalë. Hasan El-Basriut (*rahimehull-llah*) i thanë: “Po thonë njerëzit që nëse e thua Shehadetin hyn në Xhennet?!” Ndërsa ai tha: “Po, kush e thotë Shehadetin dhe ia jep *hakk*-un (atë që duhet), hyn në Xhennet”. Dhe kështu e pyetën Imam Vehb ibn Munebbih (*rahimehull-llah*) dhe i thanë: “A nuk është Shehadeti çelsi i Xhennetit?” Ndërsa ai tha: “Po, Shehadeti është çelsi i Xhennetit, por secili çelsi i ka edhe dhëmbët e tij, e edhe Shehadeti i ka dhëmbët e tij. Nëse i ke dhëmbët e këtij çelsi, e çelë derën e Xhennetit, por nëse nuk i ke dhëmbët, dera e Xhennetit nuk çilet”.

Pra, Shehadeti nuk është vetëm fjalë, por i ka edhe kushtet e saj.

Shej'h Hafidh El-Hakemij (*rahimehull-llah*) i ka përmendur kushtet e Shehadetit në formë poezie dhe ka thënë: “Dituria, bindja e plotë, pranimi i kësaj fjale, nënshtrimi ndaj kësaj fjale, sinqeriteti dhe dashuria ndaj kësaj fjale. All-llahu e udhëzofrtë dhe i dhashtë sukses atij që e don këtë fjalë!”⁴¹

Nëse grumbullohen të gjitha thëniet e dijetarëve, arrinë deri në nëntë kushte të Shehadetit. Disa dijetarë i kanë përmendur: diturinë⁴², pranimin e kësaj fjale, bindjen,

⁴¹ “*Me'arixhul Kabul*”.

⁴² Të dihet kuptimi i kësaj fjale, ngase nuk ka mundësi që dikush ta shqiptojë Shehadetin dhe të hyjë në Islam, nëse nuk e din se çka është duke thënë.

nënshtrimin ndaj kësaj fjale, sinqeritetin, të dashurit e kësaj fjale dhe gjithë njerëzit e kësaj fjale. Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë shtuar edhe: Shqiptimi e kësaj fjale, mohimin e *tagut*-it dhe vdekjen me këtë fjalë⁴³.

Pra, kushtet e Shehadetit janë: 1. *Shqiptimi i Shehadetit*; 2. *Mohimi i tagut-it*; 3. *Dituria ndaj kësaj fjale*; 4. *Të qenit i bindur dhe i sigurtë në këtë fjalë*; 5. *Pranimi dhe nënshtrimi ndaj kësaj fjale*; 6. *Besnikëria dhe sinqeriteti në këtë fjalë*; 7. *Të vepruarit me këtë fjalë*; 8. *Të dashurit e kësaj fjale*; dhe 9. *Të vdekurit me këtë fjalë*.

- Kush quhet tagut?

Mohimi i *tagut*-it është kush i Shehadetit. Nëse nuk mohohet *tagut*-i, nuk pranohet Shehadeti. Nëse një person nuk e mohon *tagut*-in, nuk llogaritet musliman.

‘Umer ibnul ‘Hattabi (radijall-llahu ‘anhu) ka thënë: “*Tagut* është Shejtani”.

All-llahu (subhanehu ve te’ala) thotë:

﴿ أَلَمْ أَعْهَدْ إِلَيْكُمْ يَا بَنِي آدَمَ أَنْ لَا تَعْبُدُوا الشَّيْطَانَ ... ﴾

“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin ...”
(Ja-Sin: 60)

Ibrahimi (‘alejhis-selam) i tha babait të vet:

﴿ يَا أَبَتِ لَا تَعْبُدِ الشَّيْطَانَ ... ﴾

“O babai im, mos adhuro djallin ...” (Merjem: 44)

Në kohën e sodit, ka njerëz që drejtpërdrejtë e adhurojnë Shejtanin, por edhe gjithë tjerët që nuk e adhurojnë All-llahun, automatikisht e adhurojnë Shejtanin. Dikush e adhuron ‘Isain (‘alejhis-selam), dikush e adhuron dunjanë e dikush dikë tjetër, dhe për

⁴³ Këtu nuk është për qëllimi që patjetër para vdekjes të shqiptohet Shehadeti, por qëllimi është: të vdekurit duke qëndraur në këtë fjalë (moskthimi i shpinës ndaj kësaj fjale).

gjitha këto shkaktarë kryesorë është Shejtani, prandaj llogaritet adhurim ndaj tij. Çdo adhurim që bëhet pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) është adhurim i Shejtanit.

Imam Maliku (*rahimehull-llah*) dhe shumë dijetarë tjerë kanë thënë: “*Tagut* është çdokush që adhurohet pos All-llahut dhe është i kënaqur me atë adhurim”.

Shejhul Islam Muhammed Ibn Abdul Vehhabi (*rahimehull-llah*) ka thënë: “*Tagut*-at janë shumë, por kokat (kryesorët) e tyre janë pesë: 1. Shejtani; 2. Ai i cili i ndron ligjet e All-llahut; 3. Ai i cili gjykon me ligje tjera pos ligjit të All-llahut; 4. Ai i cili pretendon se e din të fshehtën (*gajb-in*); dhe 5. Ai që adhurohet pos All-llahut dhe është i kënaqur me atë adhurim”.

Tagut-i mohohet duke thënë: *LA ILAHE* (nuk meriton të adhurohet askush) *IL-LALL-LLAH* (përveç All-llahut), duke u disatncuar dhe duke u larguar prej tyre, dhe duke e adhuruar vetëm All-llahun (*subhanehu ve te'ala*).

- A është obligim mësimi i kushteve të Shehadetit?

Nuk është obligim të dihen përmendësh dhe me rend kushtet e Shehadetit, por obligim është praktikimi i tyre.

Nëse dikush nuk i din përmendësh dhe me rend kushtet e Shehadetit, por në praktikën e tij i ka të gjitha, kjo nuk i prishë punë asgjë. Dhe nëse dikush i din përmendësh dhe me rend kushtet e Shehadetit, por në praktikën e tij nuk ka asgjë, nuk i vlejné ato fare.

**** Islami ****

- Çka don të thotë Islam?

Në aspektin gjuhësirë, fjala *Islam* don të thotë: *Istislam* - Nënshtrim.

Në aspektin fetarë, fjala *Islam* vjen në dy gjendje: ose vjen e vetme (për shembull, vjen një *ajet* apo një *hadith*, ku fjala *Islam* përmendet e vetme), ose vjen së bashku me fjalën *Iman*. Nëse vjen e vetme, e ka kuptimin e gjithë fesë (çka ka në fenë e All-llahut, gjithë hynë në fjalën *Islam*). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ...

“Feja e vërtetë tek All-llahu është vetëm Islami.” (Ali ‘Imran: 19)

Gjithashtu thotë:

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخٰسِرِينَ ﴿٨٥﴾

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.” (Ali ‘Imran: 85)

Ndësa, nëse përmendet së bashku me fjalën *Iman* me një argument (me një *ajet* apo me një *hadith*), atëherë e ka kuptimin e punëve të jashtme. Në *hadith*-in, ku Xhibrili (*‘alejhis-selam*) e pyeti Pejgamberin (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*): “Çka është Islami?”, Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) u përgjigj: “Ta dëshmosh Shehadetin, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta kryesh Haxhxin”.⁴⁴

⁴⁴ Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe ‘Umer ibnul ‘Hattabi.

- Cili është vendimi i Sheri'at-it për atë i cili e mohon një prej shtyllave të Islamit?

Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. *Shehadeti*
2. *Falja e namazit*
3. *Dhënia e zekatit*
4. *Agjërimi i Ramazanit*
5. *Shkuarja në Haxh kush ka mundësi*

Nëse dikush e mohon, apo nuk e pranon, apo i duket e palogjikshme ndonjëra prej shtyllave të Islamit dhe e mohon atë, ai del prej Islami dhe nuk llogaritet musliman, edhe nëse i pranon gjithë shtyllat tjera dhe i vepron ato.

- Cili është vendimi i Sheri'at-it për atë i cili nuk e vepron asnjë prej shtyllave të Islamit?

Nëse dikush i pranon (i beson) gjithë shtyllat e Islamit, por nuk e vepron asnjërën prej tyre (nga përtacia apo nga diçka tjetër që në *Sheri'at* nuk llogaritet arsye), ai del prej Islami dhe nuk llogaritet musliman.

Shejhul Islam Ibn Tejmijeh (rahimehull-llahu) ka thënë: “Nëse dikush të kishte shkuar te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe t’i kishte thënë: “O Muhammed (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ne të besojmë ty që je Pejgamber; e besojmë që namazi është *farz*, por nuk e falim atë; e dimë që zekati është *farz*, por nuk e japim atë; e dimë që Ramazani është *farz*, por nuk e agjërojmë atë; dhe e dimë që Haxhhi është *farz*, por nuk e kryejmë atë; e besojmë që alkooli është *haram*, por e pimë atë; e besojmë që *zina*-ja është *haram*, por e bëjmë atë”, e kështu me rradhë. Çka do t’u kishte thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) këtyre? Pa kurrfarë dyshimi do ju kishte thënë: “Ju jeni kafirat (*mohuesit, mosbesimtarët*) më të mëdhenj!”.

Ai i cili i len gjithë veprat (gjithë *'ibadet-et*), edhe nëse i beson (i pranon) ato, ai nuk llogaritet musliman.

**** Iman-i ****

- Çka don të thotë Iman?

Në aspektin gjuhësorë, fjala *Iman* don të thotë: pranim. Disa dijetarë kanë thënë: Don të thotë: besim, apo pranim, apo miratim.

Në aspektin fetarë, fjala *Iman* vjen në dy gjendje: ose vjen e vetme (për shembull, vjen një *ajet* apo një *hadith*, ku fjala *Iman* përmendet e vetme), ose vjen së bashku me fjalën *Islam*. Nëse vjen e vetme, e ka kuptimin e gjithë fesë (çka ka në fenë e All-llahut, gjithë hynë në fjalën *Iman*). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُضِيعَ إِيمَانَكُمْ ...

"Dije se All-llahu nuk jua humbë besimin (iman-in) tuaj." (El-Bekarah: 143)

Ky *ajet* ka zbritur për ata njerëz të cilët ishin falur kah *Mesxhidul Aksa-ja*, e pastaj All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ndroi *kible-n* dhe i urdhëroi që të faleshin kah Ka'beja, e për namazet që muslimanët i kishin falur kah *Mesxhidul Aksa-ja*, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) tha: **"All-llahu nuk jua humbë besimin (iman-in) tuaj"**, që don të thotë: "All-llahu nuk jua humbë namzin tuaj". Pra, në këtë *ajet*, fjala *Iman* e ka për qëllim namazin.⁴⁵

Ndësa, nëse përmendet së bashku me fjalën *Islam* me një argument (me një *ajet* apo me një *hadith*), atëherë e ka kuptimin e bindjeve dhe e gjërave që janë të mbrendshme. Në *hadith-in*, ku Xhibrili ('*alejhis-selam*) e pyeti Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): **"Çka është iman-i?"**, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) u përgjigj: **"Ta besosh All-llahun, melaiket, Pegamberët, Librat, Ditën e Ringjalljes dhe kader-in dhe kada-në"**.⁴⁶ Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ju tha Sahabeve: **"Ju urdhëroj në iman ndaj All-llahun (subhanehu ve te'ala). A e dini çka është iman-i? Iman-i është: Dëshmia - LA**

⁴⁵ Imam Kurtubiu në "*Tefsir*"-in e tij.

⁴⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe 'Umer ibnul 'Hattabi.

ILAHE IL-LALL-LLAH, MUHAMMEDUR-RASULUL-LLAH, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e Haxhxit”.⁴⁷

- A shtohet dhe a pakësohet iman-i?

A shtohet dhe a pakësohet *iman-i*, këtë secili musliman është në gjendje ta thotë, në bazë të *iman-it* që e ka në zemrën e tij, pa e ditur asnjë argument. Por, megjithëatë, ka prej grupeve të devijuara, të cilët thonë se *iman-i* nuk shtohet dhe nuk pakësohet, ai (*iman-i*) rrin në një vend dhe *iman-i* i secilit musliman është i barabartë me *iman-in* e Ebu Bekrit (*radijall-llahu ‘anhu*), e kështu me radhë. Ngase, sipas tyre, *iman-i* është një. Ky mendim është i gabuar.

Sipas argumenteve të Kur’anit dhe *Sunne-tit*, *iman-i* shtohet dhe pakësohet. Shtohet me punë të mira dhe pakësohet me punë të liga. All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا

وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٢٠٠﴾

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve u fërgëllojnë zemrat kur përmendet All-llahu dhe u forcohet besimi kur u lexohen shpalljet e Tij dhe që mbështeten te Zoti i tyre.” (El-Enfal: 2)

Dhe shumë *ajet-e* tjera flasin se *iman-i* shtohet dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim në secilin musliman, përveç atyre që janë fundosur në devijimin e grupeve të humbura.

Handhale (*radijall-llahu ‘anhu*), një ditë prej ditëve, u nis për te Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) dhe rrugës e takoi Ebu Bekrin (*radijall-llahu ‘anhu*), i cili e pyeti: “Ku je nisur o Handhale?” Handhale (*radijall-llahu ‘anhu*) i tha: “Jam nisur për te Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), për t’i treguar se Handhale është bërë *munafik* (diftyrësh)!” Ebu Bekri (*radijall-llahu ‘anhu*) i habitur, e pyeti: “Pse?” Handhale (*radijall-llahu ‘anu*) tha: “Sepse, kur jam në shtëpinë time, mashtrohem me grate dhe fëmijët e mi dhe më dobësohet *iman-i*, ndërsa kur jamë me Pejgamberin (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), më

⁴⁷ Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi.

shtohet *imani* dhe paraqitem para tij shumë musliman i mirë, e për këtë më duket vetja si *munafik!*" Ebu Bekri (*radijall-llahu 'anhu*) tha: "Po edhe unë jamë njëjtë sikur ti, kur jamë në shtëpi, më dobësohet *iman-i*, ndërsa kur jamë me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), *iman-in* e kam më të fortë". Dhe tha: "Eja dhe të shkojmë bashkë te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). U nisën së bashku për te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Kur arritën atje, Handhale (*radijall-llahu 'anhu*) tha: "O i Dërguari i All-llahut, Handhale është bërë *munafik!*"⁴⁸ Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e pyeti: "Pse kështu, o Handhale?" Handhale (*radijall-llahu 'anhu*) ia tregoi rastin. Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "O Handhale, ka momente që *iman-i* shtohet dhe ka momente që *iman-i* dobësohet. Sikur ju ta kishit pasur *iman-in* çdo here, ashtu sikur kur jeni me mua, do të kishin zbritur melaiket dhe do tju kishin përshëndetur!"⁴⁹

- Sa mund të pakësohet *iman-i*?

Grupet e devijuara kanë thënë: *Iman-i* dobësohet aq shumë, saqë mbetet një grimcë e *imani-t*; mbetet *iman-i* shumë i dobët, por nuk bie i tëri (ende mbetet *iman*).

Ehli Sunne-ti kanë thënë: *Iman-i* dobësohet deri sa ka mundësi të bjerë edhe në *kufir* (të mos mbetet *iman* fare).

- Sa degë ka *iman-i*?

Iman-i ka disa degë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*Iman-i* ka mbi shtatëdhjetë (e disa) degë; më e larta është fjala *LA ILAHE IL-LALL-LLAH*, ndërsa më e ulëta është ta largosh një pengesë nga rruga; edhe turpi është pjesë e *iman-it*".⁵⁰

Nga ky *hadith* nënkuptojmë se *iman-i* përbëhet prej tri kategorive: prej fjalëve, prej veprave dhe prej bindjeve të zemrës. Të tre këto kategori së bashku e formojnë *iman-in*.

⁴⁸ Dijetarët kanë thënë: Handhale kishte mundësi të thoshte: "O i Dërguari i All-llahut, unë dhe Ebu Bekri jemi bërë *munafika!*", por Sahabet çdo herë për tjetrin kanë menduar se është më i mirë, ndërsa veten e kanë llogaritur më të dobët.

⁴⁹ Transmeton Muslimi - Nga Handhale.

⁵⁰ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

**** Ihsan-i ****

- Çka don të thotë Ihsan?

Në *hadith*-in, ku Xhibrili ('*aljh*-selam) e pyeti Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): “Çka është Ihsan-i?”, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) u përgjigj: “Ta adhurosh All-llahun sikur me e parë, edhe pse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty”.⁵¹

- Cila është shkalla (kategoria) më e lartë?

Pra, kategoritë (shkallët) e fesë janë tre: Islami, *Iman-i* dhe *Ihsan-i*. Shkalla e parë është *Islami*, ku secili musliman është në këtë shkallë. Shkalla e dytë është *Iman-i*, në të cilën shkallë janë muslimanët më të mirë (ata që bëjnë '*ibadet* dhe ruhen prej haramëve më së shumti). Dhe shkalla e tretë (dhe më e larta) është *Ihsan-i*: ta adhurosh All-llahun sikur me e parë.

⁵¹ Transmerton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe 'Umer ibnul 'Hattabi.

**** Kufr-i ****

- Çka don të thotë kufr?

Në aspektin gjuhësorë, fjala *kufr* don të thotë: të mbulosh diçka. Dhe këtë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka përmendur në Kur'an, ku thotë:

... كَمَثَلِ غَيْثٍ أَعْجَبَ الْكُفَّارَ نَبَاتُهُ ...

“Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit ...” (El-Hadid: 20)

Në këtë *ajet*, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) *el-kuffar* i ka quajtur bujqit. Kjo është në aspektin gjuhësorë, sepse bujku e futë farën në tokë dhe e mbulon atë, e jo që bujqësia është *kufr*. Dhe kjo e aspektit gjuhësorë përshtatet edhe me atë të aspektit fetarë, ngase ai i cili bën *kufr* e mbulon të vërtetën, i mbulon argumentet e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Në aspektin fetarë, fjalën *kufr* dijetarët e kanë definuar në mënyra të ndryshme:

Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh (rahimehull-llah) ka thënë: “*Kufr* është mohimi i asaj me të cilën ka ardhur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)”.

Ibn Hazmi (rahimehull-llah) ka thënë: “Mohimi i asaj që e ka zbritur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) dhe me të cilën ka ardhur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), qoftë me zemër, apo me fjalë, apo me vepër, e cila të nxjerrë nga Islami, kjo quhet *kufr*”.

Nëse përmbledhen të gjithë fjalët e dijetarëve, përfundimisht themi: Çdo bindje, çdo fjalë dhe çdo vepër, e cila në bazë të Kur'anit dhe *Sunne*-tit të nxjerrë nga feja, kjo llogaritet *kufr*.

Kjo është mënyra më e plotë e definimit të *kufr*-it, e cila i përfshinë të gjitha mënyrat e saj, ngase shumë grupe të devijuara (të cilët thirren në pasim të *Sunne*-tit) thonë se

kufri është vetëm me zemër, ndërsa nëse njeriu thotë ndonjë fjalë apo vepron ndonjë vepër të *kufri*-it, (sipas tyre) ne nuk guxojmë të flasim, ngase nuk e dimë se çka ka në zemër.

Kufri-i mund të jetë me zemër. Për shembull: mosbesimi në All-llahun apo në Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), urrejtja e Islamit dhe lloj lloj bindje tjera të *kufri*-it.

Kufri-i mund të jetë edhe me fjalë. Për shembull: thënia e ndonjë fjale të *kufrit*. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَلَقَدْ قَالُوا كَلِمَةَ الْكُفْرِ ...

“Po, në të vërtetë, ata thane fjalën e mosbesimit ...” (Et-Teubeh: 74)

Si dhe: sharja e All-llahut, apo sharja e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), tallja me fenë etj., të gjitha këto janë *kufri* me fjalë.

Dhe *kufri* mund të jetë edhe me vepër. Për shembull: shkelja e Kur'anit apo hedhja e tij në vende të fëlliqura, bërja *sexhdeh* idhujve, etj..

- Sa lloje është *kufri*-i?

Kufri-i, në formë të përgjithshme, është dy lloje:

1. *Kufri i madh*
2. *Kufri i vogël*

- Ç'është *kufri*-i i madh?

Çdo herë kur në ndonjë argument përmendet fjala *kufri*, nënkupton *kufri*-in e madh, përveç nëse vjen ndonjë argument tjetër i cili e zbret atë në *kufri* të vogël.

Kufr-i i madh është: çdo fjalë apo vepër, të cilën All-llahu apo Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e kanë quajtur kufr, dhe në bazë të argumenteve të nxjerrë nga feja.

- Ç'është kufr-i i vogël?

Kufr-i i vogël është: çdo fjalë apo vepër, të cilën All-llahu apo Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e kanë quajtur kufr, dhe në bazë të argumenteve nuk të nxjerrë nga feja.

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Sharja e muslimanit është gjuhah (fusuk-fisk), ndërsa vrasja e tij është kufr”.⁵²

Për ta ditur nëse *kufr-i* i përmendur në këtë *hadith* është i madh apo i vogël, duhet të tubohen të gjitha argumentet dhe të shihet, nëse vrasja e muslimanit të nxjerrë nga feja, atëherë llogaritet *kufr* i madh, e nëse nuk të nxjerrë nga feja, atëherë llogaritet *kufr* i vogël. Dhe në bazë të të gjitha argumenteve, vrasja e muslimanit nuk të nxjerrë nga feja⁵³. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَإِن طَآئِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلِحُوا بَيْنَهُمَا ...

“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata.” (El-Huxhurat: 9)

Pra, “nëse dy grupe të muslimanëve (besimtarëve)”, që don të thotë se, të dy grupet që luftojnë (vriten) mes vete, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka quajtur musliman, dhe nga kjo kuptojmë se vrasja e muslimanit nuk është *kufr* i madh (që të nxjerrë nga feja), por është *kufr* i vogël (që nuk të nxjerrë nga feja).

⁵² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi.

⁵³ Përveç nëse e llogaritë vrasjen e muslimanit *hallall* (të lejuar), atëherë kjo të nxjerrë nga feja me pajtimin e gjithë dijetarëve.

- Sa lloje është kufr-i i madh?

Kufr-i i madh nuk është vetëm një lloj, por është disa lloje. Ibn Kajjim El-Xheuzijeh (rahimehull-llah) i ka përmendur pesë lloje të kufr-it të madh dhe ka thënë:

1. Kufri i përgënjeshtimit

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَإِنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَالْكِتَابِ

الْمُنِيرِ ﴿٢٥﴾

“Edhe nëse të përgënjeshtrojnë ty, përgënjeshtrojnë edhe ata që ishin para tyre ...” (Fatir: 25)

2. Kufrul I'rad (t'ia kthesh shpinën fesë së All-llahut)

Shej'hul Islam Muhammed ibn Abdul Vehhabi, kur e përshkruan këtë lloj të kufr-it, thotë: “Mos ta mësosh fenë e All-llahut dhe as mos të të interesojë ajo”.

3. Kufrul Istikbar (të kesh mendjemadhësi dhe mos ta pranosh argumentin e All-llahut)

Në këtë lloj të kufr-it është Iblisi, për të cili All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

...إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَىٰ وَاسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ ﴿٣٤﴾

“...përveç Iblisit, i cili nuk deshi, u tregua arrogant dhe u bë mohues.” (El-Bekarah: 34)

4. Kufrun-nifak (të keshë dyftirësi)

Në këtë lloj të kufr-it hynë ata të cilët paraqiten musliman (besimtarë), ndërsa në mbrendinë e tyre nuk janë të tillë. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَيَالْيَوْمِ آخِرٍ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٦٤﴾

“Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit!”, por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë.” (El-Bekarah: 8)

5. *Kufrush-shek (të kesh dyshim në argumentet e All-llahut)*

Në këtë lloj të *kufrit* hynë ata të cilët kanë dyshime në All-llahun, në Pejgamberin (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), në Kur’anin, në Ringjalljel dhe kështu me radhë.

**** Tekfir-i ****

- Çka është tekfir-i?

Tekfir don të thotë: ta shpallësh dikënd *kafir* (jobesimtarë).

Tekfir-i është çështje shumë e rëndësishme, bile është çështje thelbësore dhe e patjetërsueshme e Islamit, saqë nëse nuk egziston *tekfir-i*, Islami nuk mundet të qëndrojë. Nëse krishterët, jehudët, ateistët etj. nuk shpallen *kafir-a*, atëherë të gjithë llogariten musliman dhe nuk mbetet në Islam asgjë. Bile dijetarët kanë thënë se edhe fetë tjera nuk kanë mundësi të qëndrojnë pa *tekfir*.

Tekfir-i është vendim i *Sheri'at-it* dhe ligj i All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- Cili është rreziku i tekfir-it?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “*Kush i thotë vëllaut të vetë: “O kafir!”, atëherë njërit i kthehet ajo*”.⁵⁴

Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka treguar për dy pesrona të mëhershëm të *Beni Israil-ëve*⁵⁵, që njëri prej tyre bënte shumë *'ibadet*, ndërsa tjetri bënte shumë gjunahe. Ky që bënte shumë *'ibadet* vazhdimisht e këshillonte këtë që bënte shumë gjunahe, që të ketë frikë All-llahun dhe të pendohet tek Ai, deri sa një ditë, ky që bënte shumë gjunahe, i tha: “Më lerë ti mua me Zotin tim!” Ndërsa ky që bënte shumë *ibadet*, i tha: “All-llahu ty kurrë nuk ta falë!” Këta të dy, kur të dalin para All-llahut, All-llahu ju thotë melaikeve: “*Merreni këtë që ka bërë shumë gjunahe dhe futeni në Xhennet, sepse ia kam falur gjunahet, dhe merreni këtë që ka bërë shumë 'ibadet dhe thuani:*

⁵⁴ Transmeton Bu'hariu - Nga Ebu Hurajrah.

⁵⁵ *Beni Israil* quhen bitë e Israilit, ndërsa Israil është quajtur Ja'kubi (*'alejhis-selam*).

“Kush të ka thënë ty që të ndërhyshë në Rahmetin (mëshirën) e All-llahut (kush të ka thënë ty që All-llahu nuk ia falë?)” dhe hudheni në Xhehennem!”. Ebu Hurajrah (radijall-llahu ‘anhu) tha: “Me një fjalë e humbi ky njeri edhe dunjanë edhe A’hiretin”.⁵⁶

Nëse i thua dikujtë *kafir*, don të thotë se ai është përgjithmonë në Xhehennem dhe se atij All-llahu kurrë nuk ia falë, dhe nëse gabohet në këtë është rrezik shumë i madh, për atë muslimani duhet të ketë shumë kujdes në këtë çështje dhe mos të bjerë në këtë rrezik, i cili shkakton dënimin e All-llahut (*subbhanehu ve te’ala*).

- Cilat janë gabimet në tekfir?

Në çështjen e *tekfiri*-t bëhen shumë gabime të cilat i kanë përmendur dijetarët. Disa prej tyre janë:

1. Nxitimi në tekfir

Dikush ka shumë dëshirë që ta shpallë dikënd *kafir* dhe kjo për të mendon se është një arritje e madhe, ndërsa kjo është rrezik i madh për të. Dijetarët e *Ehli Sunne*-tit kanë vendosur kushte dhe pengesa, e nëse plotësohen ato, atëherë është në rregull, por nëse nuk plotësohen ato, atëherë është rrezik i madh.

2. Mosdallimi i tekfirit mutllak (të përgjithshëm) dhe mu’ajen (të përvetshëm)⁵⁷

Ka prej njerëzve të ciliët nuk bëjnë dallim ndërmjet këtyre dyjava, dhe secili që bën *kufir*, (sipas tyre) shpallet *kafir*, ndërsa jo secili që bën *kufir* shpallet *kafir*, por duhet të plotësohen kushtet dhe të largohen pengesat.

3. Tekfir bil me’al, apo: bilazi mil kaul - ta shpallësh dikënd kafir me një fjalë që ai nuk e ka thënë, duke ia imponuar ti atë

Kjo është, për shembull, nëse e pyesim dikënd: “Çka është *iman*-i?”, dhe nëse ai përgjigjet: “*Iman*-i është ta besosh All-llahun”, atëherë t’i themi: “Nëse ti thua ashtu, All-llahun e ka besuar edhe Iblisi, e të thuash që Iblisi është musliman, bën *kufir*, e nëse ke

⁵⁶ Transmeton Ebu Davudi dhe Ahmedi - Nga Ebu Hurajrah. Sipas *Shej’h Albanit hadith*-i është *sahih*.

⁵⁷ *Tekfir*-i është dy lloje: 1. *Mutllak (i përgjithshëm)* - Për shembull, të thuash në formë të përgjithshme: “Kjo fjalë është *kufir*”, apo: “Kjo vepër është *kufir*”, etj.. 2. *Mu’ajen (i përvetshëm)* - Pë shembull, të thuash: “Filani është *kafir*” (në persona të caktuar). Këto të dyja kanë dallim në mes vete dhe muslimani duhet të bëjë dallim në mes tyre.

thënë kështu, atëherë ti je *kafir*". Në realitet, ai nuk ka thënë ashtu, por ti pastaj ia nxjerrë edhe fjalët tjera dhe ia imponon sikur t'i kishte thënë, ndërsa kjo nuk lejohet dhe është prej gabimeve.

4. Zinxhiri në *tekfir*

Dijetarët kanë thënë: Ta bësh *tekfir*-in si top të futbollit. Kështu ka njerëz të devijuar që këtë nuk e kanë dert fare dhe thonë: (Për shembull) Nëse një prej kryetarëve të kësaj kohe nuk është musliman dhe një dijetarë i atij vendi nuk e llogaritë atë (kryetarin) *kafir*, edhe ai është *kafir*; e nëse ti këtë dijetarin nuk e llogaritë *kafir*, edhe ti je *kafir*; e nëse dikush tjetër ty nuk të llogaritë *kafir*, edhe ai është *kafir*, dhe kështu me radhë. Të bëhet një lloh zinxhiri i tillë është prej rreziqeve dhe është prej gabimeve të mëdhaja të këtij lloji.

5. Shpallja e dikujt *kafir* me inatë (apo me epsh)

Për shembull, nëse dikush e shpallë dikënd *kafir*, dhe ai pastaj, për inatë të tij, ta shpallë edhe atë *kafir*. Nëse dikush të shpallë ty *kafir*, nuk ke të drejtë edhe ty ta shpallësh atë *kafir* (për shkak se ai të ka shpallur ty), ngase *tekfir*-i nuk është i askujtë dhe ka të duash ti ta çosh atë, por është vendim i *Sheri'a*-tit. Nëse Islami e shpallë dikënd *kafir*, atëherë është në rregull, por nëse jo, atëherë nuk mundesh ti ta shpallësh dikënd *kafir*, pse ai të ka shpallur ty.

6. *Tekfiri* për shkak të gjunaheve të mëdhaja

Për fat të keq, kjo bindje egziston edhe tek populli jonë. Ai i cili pin alkool, ai i cili bën *zina*, ai i cili e vret dikënd etj., sipas popullit tone, bëhet *kafir*⁵⁸, ndërsa koj është një bindje e një grupi të devijuar, të cilët quhen 'Havarixh.

⁵⁸ Kjo është një çudi e madhe e cila egziston në popullin shqiptarë. Në aspektin e *iman*-it, thonë: "Kush thotë *LA ILAHE IL-LALL-LLAH* do të hyjë në *Xhennet*", dhe binë, jo në *irxha*, por binë edhe në xhehmizëm, bindje të devijuara të një aspekti. Ndërsa kah ana e *tekfirit* dalin krejtësisht në një kategori tjetër, në një ekstremitet tjetër dhe i shpalli njerëzit *kafir*-a për shkak të gjunaheve të mëdhaja. Këto janë dy bindje që nuk kanë mundësi të bashkohen në ndonjë popull tjetër. All-llahu e din më së miri.

**** Shirk-u ****

- Çka don të thotë Shirk?

Shirk don të thotë: t'i përshkruash All-llahut shok.

- Sa lloje është shirk-u?

Shirk-u është dy lloje:

1. *Shirk i madh*
2. *Shirk i vogël*

- Çka është shirk-u i madh?

Shirk-u i madh është: t'i bësh All-llahut shok në *rububij-jeh*, në *'uluhij-jeh* apo në *esma'i ves-sifat*. Dhe: t'ia drejtosh dikujt tjetër ndonjë gjë që i takon vetëm All-llahut.⁵⁹

Shirk-u i madh të nxjerrë prej Islami.

Shirk-u i madh mund të bëhet me zemër. Për shembull: ta duash dikënd tjetër pos All-llahut njëjtë sikur All-llahun apo më shumë se All-llahun. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

⁵⁹ Kjo është në formë të përgjithshme, edhe pse dijetarët e kanë definuar *shirk-un* e madh deri në njëzet definicione, që secila e kompletton njëra tjetrën.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَتَّخِذُ مِن دُونِ اللَّهِ أَندَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ اللَّهِ ...

“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të All-llahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet All-llahu.” (El-Bekarah: 165)

Shirk-u i madh mund të bëhet edhe me fjalë. Për shembull: të shkosh te varrezat dhe ta lutësh të vdekurin për ndonjë çështje, etj..

Dhe shirk-u i madh mund të bëhet edhe me vepër. Për shembull: t’i bësh sexhdeh idhullit apo dikujt tjetër pos All-llahut, etj..

- Çka është shirk-u i vogël?

Shirk-u i vogël është: çdo ndalesë e cila ka ardhur prej All-llahut apo prej Pejgamberit (sal-lall-llahu ‘alji ve sel-lem) dhe është quajtur shirk, e cila nuk të nxjerrë prej Islami.

Shirk-u i vogël nuk të nxjerrë prej Islami, por ka mundësi të jetë shkak dhe të të dërgojë deri në shirk të madh, andaj edhe është quajtur shirk i vogël.

Shirk-u i vogël mund të bëhet me zemër. Pejgamberi (sal-lall-llahu ‘alji ve sel-lem) ka thënë: “Më së shumti që kam frikë për ju është shirku i vogël?” Sahabet e pyetën: “Çka është shirku i vogël, o i Dërguari i All-llahut?” Pejgamberi (sal-lall-llahu ‘alji ve sel-lem) u përgjigj: “Er-Rija’ (Syefaqsia)”.⁶⁰ Për shembull, nëse je duke falur namaz në xhami dhe e mbaron rek’a-tin e parë, ndërsa kur ngritesh në rek’a-tin e dytë, e sheh se dikush hyn në xhami, dhe ti pastaj fillon ta zbukurosh namazin për të (për hirë të tij). Nëse ‘ibade-ti bëhet për dikë tjetër pos All-llahut, është shirk i madh, por nëse ‘ibade-ti fillon për hirë të All-llahut dhe pastaj zbukurohet për dikë tjetër pos Tij, atëherë kalon në shirk të vogël.

Shirk-u i vogël mund të bëhet edhe me fjalë. Pejgamberi (sal-lall-llahu ‘alji ve sel-lem) ka thënë: “Kush betohet në dikë tjetër pos All-llahut, i ka bërë shirk Atij”.⁶¹ Betimi në dikë tjetër pos All-llahut është shirk i vogël. Për shembull: të betohesh në fëmijët, në bukën, në

⁶⁰ Transmeton Ahmedi. Sipas Shej’h Albanit *hadith-i është sahih.*

⁶¹ Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi në “*Musned*” - Të gjithë nga Ibn ‘Umeri. Tirmidhiu thotë se *hadith-i është hasen.*

natën etj.. Por, betimi në dikë tjetër pos All-llahut ka mundësi të jetë edhe *shirk* i madh, nëse fillojnë të madhërohen ata (për të cilët është bërë betimi). Ndërsa muslimani nuk betohet në askënd tjetër pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Shirk i vogël janë edhe thëniet: “Ka dashur All-llahu edhe ti!”, apo: “Mos të kishte qenë All-llahu edhe ti!”, etj.. Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alji ve sel-lem*) i thanë: “Ka dashur All-llahu edhe ti, o i Dërguari i All-llahut!” Ndërsa ai (*sal-lall-llahu 'alji ve sel-lem*) tha: “Ti a më bërë shok me All-llahun?! Thuaj: Ka dashur All-llahu i vetëm!”⁶² Por, ka mundësi të thuhet: “Ka dashur All-llahu e pastaj (apo: mandej) filani”⁶³.

Dhe, shirku i vogël mund të bëhet edhe me vepër. Për shembull: bartja e hajmalive, bartja e syrit të kaltërt apo diçkaje tjetër, si shkak (*sebeb*) për mbrojtje apo ndihmë pos All-llahut, te All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

- Cili është rreziku i *shirk*-ut?

Reziku i *shirk*-ut është shumë i madh; është rreziku më i madh që ka mundësi ta kaplojë njeriun.

1. *Shirk*-u është zullumi më i madh që njeriu e bën në këtë dunja

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٦﴾

“Pa dyshim, idhujtaria (*shirk*-u) është një padrejtësi shumë e madhe.” (Lukman: 13)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “A dëshironi të ju njoftoj për gjunahun më të madh?” E përsëriti këtë tre herë. Sahabet thanë: “Po, o i Dërguari i All-llahut”. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “T'i bësh shok All-llahut”⁶⁴. Në një transmetim

⁶² Transmeton Ahmed, Ibn Maxheh dhe Bu'hariu në “El-Ebed El-Mufred”. Sipas Shej'h Abdul Kadr Arnautit *hadith*-i është *hasen*. Ndërsa sipas Shej'h Albanit *hadith*-i është *sahih*.

⁶³ Transmeton Ebu Davudi me zinxhirë të saktë - Nga Hudhejfeh ibn Jemani. Sipas Shej'h Albanit *hadith*-i është *sahih*.

⁶⁴ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Bekrate.

tjetër, ‘Abdull-llah ibn Mes’udi (radijall-llahu ‘anhu) tha: “O i Dërguari i All-llahut, cili është gjunahu më i madh ndaj All-llahut?” Pejgamberi (sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem) tha: “T’i bësh shok All-llahut, ndërsa Ai të ka krijuar”.⁶⁵ Në një hadith tjetër, Pejgamberi (sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Largohuni prej shtatë gjunaheve shkatërruese: 1. T’i bësh shok All-llahut ...”.⁶⁶

2. Shirk-un All-llahu nuk e falë asnjëherë

All-llahu (subhanehu ve te’ala) thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ ۖ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ...

“S’ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do.” (En-Nisa’: 48)

Ka mundësi që njeriu ta bëjë një gjunah dhe mos të pendohet për të, e kur të del para All-llahut (subhanehu ve te’ala), Ai ia ka falur atë. Ndërsa shirk-un, All-llahu nuk e falë, përveç nëse njeriu pendohet prej tij.

3. Shirk-u i bën pluhur të gjitha veprat

All-llahu (subhanehu ve te’ala), Pejgamberit (sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem), i tha:

وَلَقَدْ أُوحِيَ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكَ لَئِنْ أَشْرَكَتَ لَيَحْبَطَنَّ عَمَلُكَ وَلَتَكُونَنَّ مِنَ

الْخٰسِرِينَ ﴿٦٥﴾

“Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhammed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: “Nëse i shoqëron All-llahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit.” (Ez-Zumer: 65)

Pejgamberët e All-llahut nuk kanë pasur mundësi t’i bëjnë All-llahut shirk, por me këtë, All-llahu (subhanehu ve te’ala) na tregon se, sikur edhe ata t’i kishin bërë shirk, edhe atyre All-llahu do t’ua kishte bërë veprat pluhur, e mos të flasim për dikënd tjetër.

4. Shirk-u ta bën haram (të ndaluar) Xhennetin dhe të futë në Xhehennem

⁶⁵ Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi - Nga ‘Abdull-llah ibn Mes’udi.

⁶⁶ Transmeton Bu’hariu - Nga Ebu Hurajrah.

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

... إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ



“Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç All-llahut, All-llahu do t’ia ndalojë Xhennetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës.”
(El-Maideh: 72)

- Kur dhe si filloi shirk-u?

Për këtë çështje, dijetarët janë ndarë në disa mendime. Disa kanë thënë se shirk-u ka filluar në kohën e Ademit (‘alejhis-selam), duke u bazuar në një ajet, në të cilin All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

﴿ هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَجَعَلَ مِنْهَا زَوْجَهَا لِيَسْكُنَ إِلَيْهَا فَلَمَّا تَغَشَّاهَا

حَمَلَتْ حَمْلًا خَفِيًّا فَمَرَّتْ بِهِ فَلَمَّا أَثْقَلَتْ دَعَا اللَّهَ رَبَّهُمَا لَئِنْ ءَاتَيْتَنَا صَالِحًا

لَنَكُونَنَّ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿١٨٩﴾ فَلَمَّا ءَاتَاهُمَا صَالِحًا جَعَلَا لَهُ شُرَكَاءَ فِيمَا ءَاتَاهُمَا

﴿١٩٠﴾ فَتَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ

“Është Ai që ju krijoi na një njeri i vetëm (Ademi), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo. Kur njeriu bashkohet me gruan e vet, e ngarkon atë me një barrë të lehtë, që ajo e kalon pa e ndier për ca kohë. Dhe, kur ajo rëndohet, ata të dy i luten All-llahut, Zotit të tyre: “Nëse na dhuron pasardhës të shëndoshë, do të jemi vërtetë mirënjohës!” Por, pasi Ai u dhuron pasardhës të shëndoshe e të mirë, ata i veshin All-llahut ortak në lidhje me atë që ju kishte dhënë. Por All-llahu është shumë lart nga ajo që ia veshin Atij si ortakë!” (El-A’raf: 189-190)

dhe sipas tyre, *shirk* kanë bërë Ademi dhe Hava (*'alejhim-mes-selam*). Pastaj e kanë përmendur një transmetim, në të cilin thuhet: "Iblisi shkoi përreth Havasë dhe u soll disa herë, ndërsa asaj i lindnin fëmijët meshkuj dhe i vdisnin. Atëherë Iblisi i tha: "A dëshiron që të të jetojnë fëmijët?!" Ajo i tha: "Pa". Iblisi i tha: "Atëherë, vëndoja emrin: Abdul Harith (rob i Harithit)^{67!}" Kështuqë, Hava ia vëndoi emrin Abdul Harith dhe filluan t'i jetonin fëmijët.⁶⁸

Ky transmetim është i dobët dhe nuk merret për argument. Gjithashtu, "*Harith*" nuk është prej emrave të Iblisit. Gjithashtu, Ademi (*'alejhis-selam*) është prej Pejgamberëve të All-llahut dhe All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka mbrojtur atë prej gjunaheve dhe rreziqeve të mëdhaja. Gjithashtu, kjo ka "ndodhur" pasi që Ademi dhe Havaja (*'alejhim-mes-selam*) kanë dalur prej Xhennetit, e ata nuk kanë pasur mundësi që të mashtrohen edhe një herë prej Iblisit assesi. Ndërsa *ajet*-i në të cili All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë: "**... ata i veshin All-llahut ortak në lidhje me atë që ju kishte dhënë. Por All-llahu është shumë lart nga ajo që ia veshin Atij si ortak!**", dijetarët kanë thënë se këtu është fjala për bitë e Ademit (pasardhësit e tij). Don të thotë: Ademi dhe Hava (*'alejhim-mes-selam*) janë krijuar në fillim, e pastaj bitë e Ademit (pasardhësit e tij) i bëjnë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). "**Por All-llahu është shumë lart nga ajo që ia veshin Atij si ortak!**": këtu, "*jushrikun*" ka ardhur në shumës, ndërsa Ademi dhe Havaja janë dy, e po të kishte qenë fjala për ata të dy, në gjuhën arabe ka dysi dhe thuht: "*jushrikan*". Pra, do të ishte përmendur në dysi: "ata dy".

Ky mendim, i cili thotë se *shirk*-u ka filluar prej në Ademin (*'alejhis-selam*), është mendim i gabuar.

Disa të tjerë thonë se *shirk*-u ka filluar menjëherë pas vdekjes së Ademit (*'alejhis-selam*), prej djemve të tij. Gjithashtu, edhe ky mendim është i dobët dhe i gabuar.

Mendimi i saktë dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, është se *shirk*-u ka filluar dhjetë shekuj pas Ademit (*'alejhis-selam*). Kjo është thënia e 'Abdull-llah ibn 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*), i cili ka thënë: "*Shirk*-u filloi dhjetë shekuj pas Ademit (*'alejhis-selam*)".⁶⁹

⁶⁷ Kanë thënë se Abdul Harith e ka pasur emnin Iblisi. Ndërsa kjo nuk është aspak e vërtetë dhe për këtë nuk ka asnjë argument.

⁶⁸ Transmeton Ibn Ebi Hatim - Nga Ibn 'Abbasi. Sipas Imam Ibn Kethirit dhe *Shej'h* Albanit transmetimi është i dobët.

⁶⁹ Transmeton Bu'hariu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Abbasi.

Shirk-u filloi pasi vdiqën pesë persona, të cilët ishin njerëz të mirë, të cilët i bënë shumë 'ibadet All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), emrat e të cilëve All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i përmendi në Kur'an, ku thotë:

... وَلَا تَذَرْنَّ وُدًّا وَلَا سُوءًا وَلَا يَغُوتَ وَيَعُوقَ وَنَسْرًا ﴿٢٣﴾

"... as *Vedda-in*, as *Suva'a-in*, as *Jeguth-in*, as *Je'uk-ën*, as *Nesra-in*." (Nuh: 23)

Kur vdiqën këta persona, njerëzit filluan të diskutonin, që atyre t'ua ngritnin varrezat, që të dalloheshin ata (njerëzi e mirë) prej njerëzve tjerë, dhe këshu ua ngritën varrezat. Pas një kohe, gjeneratë pas gjenerate, filluan që të thonin se këta janë njerëz të mirë e ata janë njerëz të dobët dhe me gjunahe, dhe thanë që t'i lusnin ata, që ata ta lusin All-llahun për ta, dhe kështu filluan t'i lutnin këta njerëz dhe t'i bënë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).⁷⁰ Atëherë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në këtë popull e dërgoi Nuhun ('*alejhis-selam*), që t'i thërriste ata në fenë e pastër (në *teuhid*). Pastaj All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e shkatërroi gjithë këtë popull dhe mbetën vetëm muslimanët në anije, bashkë me Nuhun ('*alejhis-selam*). Pas një kohe, *shirk-u* filloi përsëri. Ndërsa sa kohë, kurë dhe si filloi *shirk-u* përsëri, për këtë nuk ka ndonjë argument. All-llahu e din më së miri.

A ekziston shirku në këtë ummet?

A ekziston *shirk-u* në këtë *ummet*, në *ummet-in* e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ose a ka njerëz të cilët i thonë vetes musliman dhe i bëjnë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), është një pyetje e cila duhet të parashtrohet patjetër, ngase ka shumë prej njerëzve, prej sufive, prej adhuruesve të varrezave etj., të cilët thonë se *shirk-u* është i garantuar në këtë *ummet* dhe se ky *ummet* kurrë nuk ka për t'i bërë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te'ala*)⁷¹, ngase Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Pasha All-llahun, unë nuk kam frikë për juve për *shirk-un* pas meje, por kam frikë se do të bëni gara pas dunjasë".⁷²

⁷⁰ Transmeton Bu'hariu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Abbasi.

⁷¹ Është fjala për ata të cilët hynë në Islam.

⁷² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Ukbeh ibn Amir.

Dijetarët, në lidhje me këtë *hadith*, kanë thënë: Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “*unë nuk kam frikë për juve*” don të thotë: për juve Sahabet. Pra, që Sahabet kurrë nuk kan për t’i bërë *shirk* All-llahut, e jo që kurrë njerëzit deri në Kijamet nuk kanë për t’i bërë *shirk* All-llahut. Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë: “*unë nuk kam frikë për juve*” don të thotë: për gjithë juve muslimanëve. Pra, që të gjithë muslimanët do të kthehen në *shirk*, kjo nuk ndodhë asnjëherë.

Feja e All-llahut është e garantuar, por jo që askush nuk do t’i bëjë *shirk* All-llahut, dhe për këtë ka shumë argumente. Dihet shumë mirë, se pas vdekjes së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), shumë prej njerëzve bënë *riddeh* (dolën nga feja), ia kthyen shpinën fesë së All-llahut dhe filluan adhurimin e idhujve, apo iu bashkangjitën Musejleme El-Kedhdhabit⁷³, etj.. Dhe argumente tjera, që tregojnë se njerëzit pas vdekjes së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) do t’i bëjnë *shirk* All-llahut (*subhanehu ve te’ala*), deri sa Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Nuk do të kalojë dita dhe nata, përveç se do të vijë gjendja që njerëzit do ta adhurojnë Latin dhe ‘Uzzanë”. Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Do të vijë një fitneh (sprovë), e cila është e errët sikur mesi i natës; do të zgjohet ndojëri në mëngjesi si musliman, ndërsa do ta zen mbrëmja sikur kafir, dhe do ta zen mbrëmja ndonjërin sikur musliman, ndërsa do të zgjohet në mëngjes sikur kafir”.⁷⁴

Pra, *shirk*-u në këtë *ummet* ekziston. Gjithë *ummet*-i nuk ka për t’i bërë *shirk* All-llahut, por njerëz dhe individë po dhe për këtë ka lajmëruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Çka është *nifak*-u i madh?

Nifak-u i madh është: njeriu ta mbjellë në zemër *kufir*-in, ndërsa jasht ta paraqesë Islamin. All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

⁷³ Musejleme El-Kedhdhabi ishte njeri i cili e shpalli veten pejgamber, prandaj e mori emrin: *El-Kedhdhab*, që don të thotë: gënjeshtarë.

⁷⁴ Transmeton Bu’hariu - Nga Ebu Hurajrah.

“Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit!, por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë.” (El-Bekarah: 8)

Këta janë munafikët, të cilët thonë se e besojnë All-llahun, ndërsa në realitet ata në zemër e mbjellin *kufri*-in (nuk besojnë). Gjithashtu, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ ءَامَنُوا قَالُوا ءَامَنَّا وَإِذَا خَلَوْا إِلَىٰ شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا إِنَّا مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ

مُسْتَهْزِءُونَ ﴿١٤﴾

“Kur takohen me besimtarët, ata thonë: “Besojmë” - por, kur mbesin vetëm me djajt e tyre, thonë: Në të vërtetë ne jemi me ju; ne vetëm po talleshim”. (El-Bekarah: 14)

Kështu All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i përshkruan munafikët dhe thotë:

إِنَّ الْمُنَافِقِينَ فِي الدَّرَكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ وَلَنْ تَجِدَ لَهُمْ نَصِيرًا ﴿١٥﴾

“S'ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gesh mbrojtës.” (En-Nisa': 145)

- Çka është nifak-u i vogël?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Kush i ka katër cilësi, është munafik i vërtetë⁷⁵, e nëse dikush e ka vetëm njëren prej tyre, ai e ka një cilësi të munafik-ëve: kur i jepet emanet tradhëton, kur flet gënjen, kur i jepet besë e then atë dhe kur hidhërohet i kalon të gjitha kufitë”⁷⁶.

Ky është *nifak-u* i vogël, *nifak* në vepra, i cili nuk e nxjerrë njeriun nga feja.

⁷⁵ Jo *munafik* me *nifak* të madh, që del nga feja, por *munafik* në veprat e tij, me *nifak* të vogël, që nuk del nga feja dhe përsëri llogaritet musliman.

⁷⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Msulimi - Nga 'Abdull-llah bin 'Amr ibn El-As.

- Sa lloje është vizita e varrezave?

Në varreza bëhen gjëra të ndryshme dhe vizita e varrezave nuk është njëjtë për të gjithë. Dijetarët vizitën e varrezave e kanë ndarë në tre lloje:

1. Vizita e varrezave e cila është *mustehab* (e pëlqyer)

Kjo është nëse njeriu i viziton varrezat për ta kujtuar *A'hiret*-in dhe për këtë ka shpërblim. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Ju pata ndaluar më hrët që t'i vizitoni varrezat, por tash vizitoni ato, sepse ato ua përkujtojnë *A'hiret*in⁷⁷”.⁷⁸

Selef-i (gjeneratat e para) i kanë vizituar varrezat dhe e kanë kujtuar *A'hiret*-in. Një ditë prej ditëve, njerëzit e kërkuan Hasan El-Basriun (*rahimehull-llah*), por nuk e gjetën. Dikur më vonë e gjetën dhe i thanë: “Ku ke qenë deri tash, a e din sa të kemi kërkuar?” Hasan El-Basriu tha: “Isha te disa shokë të mi, kesh i vizitova. Ata shokë ma kujtojnë *A'hiret*in dhe kur ndahem prej tyre, nuk më bëjnë *gibet* (nuk më përgojnë)”. I thanë: “*MashaAll-llah*, çfar shokë të mirë, po kush janë ata?” Hasan El-Basriu tha: “Kesh i vizitova varrezat”.

2. Vizita e varrezave e cila është *bid'at* (risi në fe)

Ky lloj është, nëse njerëzit caktojnë ndonjë ditë dhe mendojnë se në atë ditë është mirë për t'i vizituar varrezat. Për shembull: vizita e varrezave në ditën e Bajramit, etj..

3. Vizita e varrezave e cila është *shirk*

Ky lloj është nëse njeriu shkon te varrezat dhe i lutë ata, i lutë të vdekurit dhe pret prej tyre që ta ndihmojnë, ndërsa të vdekurit nuk kanë mundësi ta ndihmojnë as vetëveten, e leje më dikënd tjetër.

⁷⁷ Vizitae varrezave për ta kujtuar *A'hiret*in është *'ibadet* dhe ka shpërblim për të, sidomos në këtë kohë, kur gjithë njerëzit janë duke vrapuar pas *dunjasë*, ku shumica e njerëzve e kanë harruar All-llahun, ku shumica e tyre “nuk kanë kohë” për t'i rënë në *sexhdeh* All-llahut, ku shumica merren me gjunahe ndaj All-llahut etj..

⁷⁸ Transmeton Muslimi, Ahmedi dhe mbledhësit tjerë të *haditheve* - Nga 'Abdull-llah ibn Burajdeh, e ky prej babait të tij.

- Kush janë evlija-të?

Evlija-të, sipas Kur'anit, janë ata për të cilët All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٦٢﴾ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَكَانُوا
يَتَّقُونَ ﴿٦٣﴾

“Pa dyshim, miqtë e All-llahut nuk do të kenë arsye për tu frikësuar dhe as për tu dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (All-llahut).”
(Junus: 62-63)

Evlija don të thotë: i dashur, mik i All-llahut. Atë njeri që e don All-llahu, ai është prej *evlija*-ve. Ndërsa All-llahu e don atë që është musliman i mirë dhe që ruhet prej gjunaheve.

Ne nuk mund ta dimë se kush është *evlija* (kënd e don All-llahu), përveç me argument. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Do t’ia jap flamurin një njeriut, i cili e don All-llahun dhe Pejgamberin e Tij dhe All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e duan atë”, dhe ia dha flamurin Alijgut (*radijall-llahu 'anhu*).⁷⁹ Atëherë, nga kjo nënkuptojmë se Aliju (*radijall-llahu 'anhu*) është prej të dashurive të All-llahut (prej *evlija*-ve).

Pra, *evlija* është ai të cilin e don All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

Ndërsa, në popullin tonë dhe nëpër shumë vende tjera, *evlija*-të i paramendojnë ndryshe, dhe thonë që *evlija*-të janë ata të cilët vinë me gjëra të jashtëzakonshme, ose e dinë të ardhmen, ose të bëjnë dëm apo dobi, etj., ndërsa të mendohet kështu është rrezik për *iman*-in e njeriut dhe kalon në *shirk* ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Imam Shafi’iu (*rahimehull-llah*) ka thënë: “Ai i cili e sheh dikënd duke fluturuar apo duke ecur mbi ujë dhe nuk e pason rrugën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është prej *evlija*-ve të Shejtanit”.

⁷⁹ Transmeton Bu’hariu - Nga Sehl ibn Se’adi.

- Sa lloje është sihr-i?

Dijetarët kanë thënë: *Sihr*-i është dy lloje:

1. *Sihr hakkiki* (i vërtetë)
2. *Sihr 'hajali* (iluzion)

Sihr hakkiki është ai *sihr*, që në realitet ndikon (është i vërtetë). Për shembull, ka shumë prej njerëzve, që dikush e don dikënd, ndërsa në realitet ai nuk e ka dashur, por tani e don atë, për shkak të *sihr*-it; apo dikush ndahet, burri nga gruaja, për shkak të *sihr*-it, etj.. Ndërsa *sihri 'hajali* është ai lloj i *sihr*-it, i cili është vetëm në sytë e njerëzve, ndërsa në realitet nuk ndodhë asgjë.

- Çka thotë Islami për sihr-in?

Njeriu i cili merret me *sihr*, e mëson atë dhe bashkëpunon me shejtanët, bën *kufr* dhe del nga feja. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَمَا كَفَرَ سُلَيْمَانُ وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ ...

"E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues. Ata ua mësonin njerëzve magjinë ..." (El-Bekarah: 102)

- Si bëhet njeriu sihrbaz?

Dijetarët kanë thënë: Për ta mësuar njeriu *sihr*-in, duhet të kalojë në disa procedura:

1. *Duhet t'ua shesë veten shejtanëve*. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

بِئْسَمَا اشْتَرَوْا بِهِ أَنْفُسَهُمْ ...

“Eh, sa e keqe është ajo për të cilën shitën shpirtërat e veta!” (El-Bekarah: 90)

“T’ua shesësh shpirtin” don të thotë: t’u nënshtrohesh shejtanëve dhe t’i kundërshtosh urdhërat e All-llahut; çka të thonë ata ti duhet të bësh, e nesë e bën këtë, atëherë ata bashkëpunojnë me ty.

Shejtanët, së pari prej njeriut kërkojnë që ai t’i bëjë *shirk* dhe *kufir* All-llahut (*subhanehu ve te’ala*). Pastaj kërkojnë që ta nënçmojë emrin e All-llahut (*subhanehu ve te’ala*). Në disa raste kërkojnë prej dikujtë që ta shkruajë emrin ALL-LLAH në këpucët e tij dhe kado që të ecë ta shkelë emrin e All-llahut. Në disa raste kërkojnë që emrin ALL-LLAH ta shkruajë me gjak të menstruacioneve. Në disa raste kërkojnë që njeriu të hajë prej gjërave të fëlliqura dhe të pijë prej gjërave të fëlliqura. E pastaj kërkojnë prej atij i cili dëshiron të bëhet sihrbaz, që të qëndrojë një kohë të gjatë pa e lajtur trupin. Gjithashtu kërkojnë që të largohet prej njerëzve dhe të qëndrojë i vetmuar një kohë të gjatë atje (për shembull: në mal, etj.), deri kur të fillojë bashkëpunimi i shejtanëve me të. E pastaj, kërkojnë edhe kushte tjera, deri sa njeriu të bëhet adhurues i shejtanëve. E kur t’i nënshtrohet në gjitha gjërat, atëherë ata ia mundësojnë dhe i ndihmojnë që t’u bëjë zullum njerëzve.

- Çka thotë Islami për sihrbazët?

Sihrbazëve Islami ua hjekë kokën, nëse ka *Sheri’at*.⁸⁰ Kështu ka ndodhur në kohën e *selefi-t*, në kohën e ‘Umerit (*radijall-llahu ‘anhu*)⁸¹, Hafsa (*radijall-llahu ‘anha*)⁸² etj., sihrbazëve ua kanë hjekur kokën, për shkak të zullumit që ua bëjnë muslimanëve dhe për shkak të *kufir-it* që e kanë në veten e tyre.

⁸⁰ Transmeton Tirmidhiu, i cili thotë se ky është transmetim *meukuf* - Nga Xhundubi. Sipas *Shej’h Albanit hadith-i është daif*.

⁸¹ Transmeton Bu’hariu - Nga Bexhaleh ibn ‘Abdeh. Shafi’iu në “*Bedaiu El-Einen*”, Ahmedi dhe Ebu Davudi. Sipas *Shej’h Albanit* transmetimi është *sahih*.

⁸² Transmeton Maliku në “*Muveta*” dhe Ahmedi. Sipas *Shej’h Abdul Kadir Arnautit sened-i është me shkëputje*.

- A janë të lejuara rukje-t?

Rukje-t në Islam janë dy lloje:

1. Rukje-t të cilat lejohen

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Kush ka mundësi që t'i ndihmojë dikujt, ta fryjë, le ta bëjë atë”. Dhe ka thënë: “Nuk ka problem te rukje-t, nëse në to nuk ka shirk”.⁸³

Rukje-t e lejuara janë ato *rukjeh* të cilat bëhen duke fryer me Kur'an (për shembull, me *Suran Fatihah, I'hlas, Felek, Nas* etj.), ato që bëhen duke përdorur *dhikr*, i cili ka ardhur prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) në *hadith*-e të vërteta, ato që bëhen duke përdorur fjalë të qarta, dhe e gjithë kjo, duke mos pasur bindje se fryma që t'i e bën, ajo e shëron atë⁸⁴.

2. Rukje-t të cilat ndalohen

Janë ato *rukjeh*, të cilat nuk bëhen me Kur'an dhe *Sunnet*, të cilat bëhet me fjalë të paqarta, dhe nëse njeriu i cili frynë, pyet apo kërkon disa gjëra. Për shembull, të pyet për emrin e nënës, kërkon që të therrësh ndonjë kafshë të caktuar, etj..

- A lejohet shkuarja te falltorët?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Ai i cili shkon te një falltorë dhe nuk i beson atij, nuk i pranohet namazi katërdhjetë ditë”.⁸⁵ Ndërsa nëse i beson, në një *hadith* tjetër, ka thënë: “... ai i ka bërë kufir All-llahut”.⁸⁶

⁸³ Transmeton Muslimi dhe Ebu Davudi - Të dy nga Ibn El-Eshxhe'ijju.

⁸⁴ Shërimi vjen vetëm prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ndërsa çdo gjë tjetër nëpërmjet të cilave shërohet njeriu, janë vetëm shkaqe.

⁸⁵ Transmeton Muslimi dhe Imam Ahmedi në “*Musned*”.

⁸⁶ Transmeton Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në “*Musned*” - Nga Ebu Hurajrah. Sipas *Shejh* Albanit *hadith*-i është *sahih*.

Pra, nëse njeriu nuk i beson falltorit, por shkon te ai vetëm për të parë se çka do t'i thotë, atij nuk i pranohet namazi katërdhjetë ditë, ndërsa nëse i beson, atëherë del nga feja e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Ndonjëherë, ti i cili shkon nëpër falltorë dhe të ndodhë ajo që të ka thënë falltori, e pastaj bëjnë pyetje se si, nga, a e din falltori të ardhmen etj., përgjigja është:

Së pari, kjo mundë të jetë sprovë prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) për atë që shkon te falltorët, dhe kur atij i ndodhë ajo që ata ia thonë, të fillojë të mendojë se ata e dinë të ardhmen dhe kështu ta rrezikojë *iman*-in e tij, ngase të ardhmen nuk e din askush tjetër pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Së dyti, kjo ka mundësi të ndodhë ashtu siç ka përmendur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe ka thënë: “Shejtanët renditen njëri mbi tjetrin, për t'i dëgjuar urdhrat që i zbret All-llahut te melaiket, dhe kur melaiket e përmendin një diçka në mesin e tyre, shejtanët e marrin dhe e përhapin atë. E marrin një të vërtetë dhe ia shtojnë nëntëdhjetë e nëntë gënjeshtër dhe i përhapin ato në mesin e njërezve”.⁸⁷

- A janë të lejuara hajmalitë?

Hajmalitë janë dy lloje:

1. *Hajmali me Kur'an* (me fjalë të All-llahut)
2. *Hajmali pa Kur'an*

Nëse hajmalitë janë me Kur'an (për shembull, nëse në të shkruan ndonjë *ajet* apo ndonjë *Surah*), dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa kanë thënë se lejohen, ndërsa disa kanë thënë se nuk lejohen. Mendimi më i saktë është se hajmalitë, edhe nëse kanë Kur'an, ato nuk lejohen të mbahen. Së pari, ngase ka mundësi që pastaj të të dërgojë deri te hajmalitë tjera, të cilat janë pa Kur'an. Dhe së dyti, ngase merret nëpër këmbë fjala e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Ndërsa, nëse hajmalitë janë pa Kur'an (për shembull: me vija, apo me rretha, apo me shkronja të pakuptimta, etj.) dhe dikush e mban atë dhe shpreson se ajo është *sebeb* (shkak), që All-llahu ta ndihmojnë dhe ta mbrojnë atë prej të këqiave, apo prej mësyshit

⁸⁷ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga A'isheja.

etj., është *shirk* i vogël. Por, nëse dikush e mban atë dhe mendon se ajo mbron dhe se e gjitha mvaret tek hajmalia, atëherë kjo kalon në *shirk* të madh dhe e nxjerrë njeriun nga feja.

- Çka don të thotë *tevessul*?

Fjala *tevessul* rrjedh prej fjalës *vesileh*, e cila përmendet në Kur'an, në *hadith*-e dhe në argument të ndryshme. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ ...

"O besimtarë! Kini frikë All-llahun, përpiquuni që t'i afroheni Atij ..." (El-Maideh: 35)

Pra, fjala *tevessul* e ka kuptimin: të afrohesh tek All-llahu.

Ndonjëherë, fjala *tevessul-vesileh* vjen me një kuptim tjetër. Kjo është përmendur në *hadith*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili ka thënë: *"Kur të thërret ezanin, thoni edhe jua atë që e thotë muezini, e pastaj dërgoni salavat-e mbi mua dhe kërkoni te All-llahu "vesile"-n për mua; ajo është një shkallë në Xhennet, të cilën do ta arrijë vetëm një rob i All-llahut dhe shpresoj që unë të jem ai"*.⁸⁸

Pra, *vesileh* e ka kuptimin edhe: shkalla më e lartë në Xhennet. Ndërsa ajo me të cilën kemi të bëjmë është fjala *tevessul*, e cila don të thotë: afrimin tek All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

- Sa lloje është *tevessul-i*?

Dijetarët kanë thënë: *Teveessul-i* është dy lloje:

1. *Teveessul meshru'* (i cili ka bazë në *Sheri'at*)

⁸⁸ Transmeton Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibni Amr ibni Asi.

2. *Teveessul memnu'* (i cili nuk ka bazë në Sheri'at)

- *Cili teveessul është i lejuar?*

Teveessul-i i lejuar ka ardhur në disa mënyra:

1. Të afroresh tek All-llahu dhe ta lutësh Atë duke i përmendur emrat dhe cilësitë e Tij

Për shembull, kur dëshiron ta lutësh All-llahu që të të mëshirojë, të t'i falë gjuhahet etj., të thuash: O Zot, Ti je *Rahim*, Ti je *Rahman*, Ti je *Afuw*, Ti je *Gafur* etj.; O Zot, m'i falë gjuhahet! O Zot, më mëshiro mua! etj.. Apo me cilësitë e All-llahu, sikur që tha Sulejmani ('*alejhis-selam*):

... وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ

"Më prano, me mëshirën tënde, në gjirin e robërve të Tu të mirë!" (En-Neml: 19)

2. Të afroresh tek All-llahu dhe ta lutësh Atë duke e përmendur ndonjë punë të mirë

Për shembull, nëse ke bërë ndonjë punë të mirë, të thush: "O Zot, për shkak të kësaj pune të mirë që e kamë bërë, ma plotëso këtë nevojë!", etj..

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Tre persona hyrën në një shpellë për të pushuar, dhe kyr hyrën aty, u rrotullua një gurë dhe ra në hymjen e shpellës. U munuduan ta lëviznin gurin, por nuk patën mundësi dhe mbetën mbrenda në shpellë dhe nuk kishin mundin të dilnin. Atëherë thanë se nuk kanë zgjidhje tjetër, përveç se ta lutnin All-llahun me ndonjë punë të mirë që e kishin bërë, e ndoshta për shkak të asaj pune të mirë, All-llahu do t'ua lironte rrugën. Atëherë, i pari i tyre bëri du'a dhe tha: "O Zot, unë i kam dy prindërit e mi pleq, të cilët i kam rrespektuar dhe i kam nderuar shumë, dhe kurrë nuk ju kam dhënë fëmijëve të mi para se t'u jap të hanë babait dhe nënës sime. Deri sa, në një natë jam vonuar shumë, ndërsa prindërit e mi kanë pritur që të shkoj dhe t'ua jap darkën, e kur kam shkuar e kam parë se ata kishin fetur. E e kam marur ushqimin dhe kam pritur se kur do t'u del gjumi që ta hanë darkën, ndërsa fëmijët qanin për buk. Nuk ju kam dhënë fëmijëve deri në mengjes, kur janë ngritur prindërit e mij dhe kanë hëngër, e pastaj ju kam dhënë fëmijëve⁸⁹. O Zot, nëse këtë punë e kamë bërë vetëm për hirë

⁸⁹ Dijetarët kanë thënë se këtë rrespekt ndaj prindërve, deri në këtë shkallë, e gjenë vetëm te Pejgamberët e All-llahut. Rrallë kush që ka mundësi t'i rrespektojë prindërit deri në këtë shkallë.

tëndin, na e liro rrugën!" Atëherë lëvizi guri pak, por nuk kishin mundësi të dilnin. Atëherë, i dyti i tyre tha: "O Zot, e kam pasur një të afërme në familje, një vajzë të cilën e kam dashur shumë, më shumë se çdo send tjetër në këtë dunja, dhe kam qenë në gjendje të bëj çka të jetë për të, e kam lutur dhe nuk kam pasur mundësi t'i afrohem asaj. Pas një kohe, kur njerëzit i kaploi fukarrallëku i madh dhe ajo kishte nevojë për fëmijët dhe familjen e sajë për ushqim, erdhi tek unë dhe më tha që nëse kam mundësi t'i ndihmoj, ndërsa unë i thash që po, por me një kusht, që ta kisha një kontakt me të. Atëherë, ajo grua, nga zorti i madh që e kishte, u pajtua, por mi tha disa fjalë. Më tha: "Ki frikë All-llahun!" Kur mi tha këto fjalë, u ndala dhe prej frikës ndaj Teje ia dhash të hollat dhe e lash të lire. O Zot, nëse këtë e kam bërë vetëm për hirë tëndin, na e liro rrugën!" Atëherë lëvizi guri edhe pak, por përsëri nuk kishin mundësi të dilnin. Atëherë, i treti i tyre tha: "O Zot, i kam pasur disa punëtorë dhe jam munduar të sillem sa më mirë ndaj tyre, dhe kur ka ardhur fundi i muajit, gjithë atyre punëtorëve ua kam dhënë hakun e tyre, përveç njërit, i cili kishte shkuar dikund dhe nuk e kishte marrur hakun e tij. Kur u kthye ai pas disa viteve, ma kërkoi hakun e tij dhe i thash që ta merrte gjithë atë pasurinë që e shihte (delt, deve etj.), (pasuria e tij kishte qenë e vogël, por gjatë gjithë atyre viteve ishte shtuar shumë). Ndërsa ai më tha: "Ti a po tallesh me mua?!" Atëherë ia tregova të vërtetën dhe ai e mori gjithë pasurinë që i takonte atij. O Zot, nëse këtë e kam bërë vetëm për hirë tëndin, na e liro rrugën!" Atëherë lëvizi guri edhe pak dhe dolën këta tre persona nga shpella!⁹⁰.⁹¹

3. Të kërkosh prej dikujt i cili është prej muslimanëve të mirë që të bëjë du'a për ty

Për shembull, ti ke mundësi ta lutësh All-llahun vetë, por ndonjëherë, kur ke ndonjë nevojë të madhe dhe e din që filani është më musliman i mirë, më shumë bën 'ibadet dhe më shumë ruhet prej gjunaheve etj., dhe ti i thua atij që ta lute All-llahun për nevojën që e ke dhe kështu me rradhë.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), një ditë prej ditëve, duke qenë në 'hutbe-n e *xhum'a-së*, hyri një A'rabi, dhe kur arriti te dera, tha: "O i Dërguari i All-llahut, lute All-llahun të na dërgojë shi, sepse është tharë toka dhe janë prishur bereqetet". Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ngriti duart dhe bëri *du'a*, dhe pas *xhum'a-së* filloi shiu nga qielli. Kaloi një javë dhe nuk u ndal shiu fare. Pas një jave, duke qenë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) në 'hutbeh, erdhi i njeiti njeri (apo dikush tjetër) dhe tha: "O i Dërguari i All-llahut, lute All-llahun që ta ndërprisë shiun". Atëherë buzëqeshi Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), bëri *du'a* dhe tha: "O Zot, dërgoje shiun përreth nesh, e mos e dërgo mbi ne". Atëherë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e largoi shiun dhe e dërgoi përreth tyre.

⁹⁰ Dijetarët kanë thënë: Këta kanë qenë tre persona, llogarit sikur ti të kishë qenë i katërti.

⁹¹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn 'Umeri.

Ky A'rabi kishte mundësi ta luste All-llahun vetë, por ai shkoi te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ngase Pejgamberit të All-llahut i pranohet *du'a*-ja.

Kështu veproi 'Umer ibnul 'Hattabi (*radijall-llahu 'anhu*) në kohën e tij, i cili e thirri 'Abbasin (*radijall-llahu 'anhu*) dhe tha: "Ne më herët kemi kërkuar prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa tash kërkojmë prej mixhës së tij, që ta lutë All-llahun të na dërguar shi!", dhe bëri *du'a* 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*) dhe All-llahu ju dërgoi shi muslimanëve në atë kohë.⁹²

Gjithashtu, kështu veproi edhe Muaviju (*radijall-llahu 'anhu*), i cili në *xhum'a* kërkoj dhe tha: "Ku është Jezidi⁹³?" I thanë: "Këtu është". Atëherë tha: "O Jezid, lute All-llahun që të na lëshojë shi". Atëherë bëri *du'a* Jezidi dhe All-llahu ju dërgoi shi.

Ndërsa, transmetimi në të cilin Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka thënë 'Umerit (*radijall-llahu 'anhu*): "O 'Umer, mos na harro neve në *du'a*!", është transmetim i dobët (*daif*).

- Cili *tevessul* është i ndaluar?

Ka shumë raste, që njerëzit e lusin All-llahun, bëjnë *du'a* dhe mundohen t'i afrohen All-llahu me atë që Ai nuk e ka caktuar për ta si afrim tek Ai. Ka shumë njerëz, të cilët thonë: "O Zot, për hirë të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), na e prano këtë *du'a*!", "O Zot, për hirë të Pejgamberëve!", "O Zot, për shkak të pozitës dhe vlerës që ka Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tek Ti, na e prano këtë *du'a*!", etj..

Ta lutësh All-llahun për hirë të dikujt, apo për pozitën e dikujt tek All-llahu, është *tevessul* i ndaluar (*haram*).

Ne e dimë çfarë vlere ka Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tek All-llahu, e dimë se ai e ka pasur një pozitë shumë të lartë, ka qenë dhe është i dobishëm me *Sunnet*-in e tij që na e ka lënë pas, por nuk mund të merret Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) si mjet, si *tevessul*, që ti ta lutësh All-llahun për hirë të tij (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

⁹² Transmeton Bu'hariu.

⁹³ Jezid ibn Esved, njëri prej muslimanëve të mirë.

Kështu kanë thënë dijetarët, Imam Tahaviu⁹⁴ dhe të tjerët, se kjo është një lutje e pakuptimt, sepse All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Kur'an thotë:

وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَىٰ ﴿٣٩﴾

“Dhe se njeriut do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.” (En-Nexhm: 39)

Pra, ty të takon ajo që ti e ke punuar, e jo për hirë të filanit, sepse kanë thënë: Ai i ka bërë *'ibadet* All-llahut, është ruajtur prej haramëve, është bërë prej muslimanëve më të mirë, ndërsa ti e lutë All-llahun për shkak të atij, ndërsa ai nuk ka lidhje me ty fare, dhe pse ai është musliman i mirë, ty nuk mundet të të bëjë dobi në pranimin e *du'a*-ve tua.

Teveessul-i ka mundësi të arrijë edhe në *shirk*, nëse dikush shkon dhe i lutë të vdekurit (për shembull: Pejgamberët, *evlija*-të etj.), duke menduar se kështu do të afrohet tek All-llahu. Nëse e lutë një të vdekur, apo e lute dikënd që nuk është prezent, apo e lute edhe atë që është prezent, për diçka që nuk i takon atij, por i takon vetëm All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), është *shirk*.

- Çka don të thotë *teberruk*?

Fjala *teberruk* rrjedh prej fjalës *berakeh*, që don të thotë: të kërkosh bereqet.

- Sa lloje është *teberruk*-u?

Kërkimi i bereqetit mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Për atë, dijetarët *teberruk*-un e kanë ndarë në dy lloje:

1. *Teberruk* i lejuar
2. *Teberruk* i ndaluar

⁹⁴ Shih “‘Akidet-Tahavij-jeh”.

- Cili teberruk është i lejuar?

'Ibadet-et: të bësh *dhikr* (ta përmendësh All-llahun), të lexosh Kur'an dhe në të gjitha *'ibadet-et* tjera, ka bereqet. Por, ajo për të cilën do të ndalemi dhe në të cilën binë shumë prej njerëzve të ndryshëm prej grupeve të devijuara, është: të bësh *teberruk* me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të kërkosh bereqet prej trupit të tij, prej gjërave të tij, etj.. Për shembull: t'ia prekësh dorën Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), t'ia pushërsh dorën atij, apo t'i ruash gjërat e tij, etj..

Në gjërat e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në trupin e tij etj., ka bereqet, edhe pse bereqeti vjen prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ashtu siç ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): "*Bereqeti vjen prej All-llahut*". Por, prap, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ka lënë *sebebe* (shkaqe) dhe e ka bërë Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) të vaçantë dhe tek i cili ka bereqet.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), kur merrte abdes, Sahabet i merrnin pikat e ujit që binin prej tij (për bereqet). Apo, kur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) hante ushqim, nëse linte diçka, e merrte Ebu Ejjub El-Ensari (*radijall-llahu 'anhu*) dhe thoshte: "Ku ka hëngër Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)?" Dhe pasi i tregonin, e merte dhe e hante aty ku e kishte lënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Apo, nëse Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) pinte diçka dhe e lente një pjesë, Sahabet dëshironin të pinin atë që e kishte lënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Sa që, në një rast, piju ujë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe u kthye nga ana e djathtë e tij dhe e pa një djalosh të vogël, ndërsa kur u khye nga ana e majtë e tij, i pa disa Sahabe të mëdhenj. Atëherë i tha këtij djaloshit të vogël: "*A bën që këtë ujin që kam pirë unë, t'ua japë njëherë këtyre më të mëdhenjëve*?" Djaloshi tha: "Pasha All-llahun, të gjithë i kisha lënë, por këtë rast që më ka ardhur, të pij ujë pas Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), nuk mundem t'ia lë askujt!" Pastaj e mori dhe piju pas ujit që kishte pirë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).⁹⁵ Enes ibn Malik (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "I hjeke flokët Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa Sahabet nuk e lan asnjë qime të tij për toke!" Dhe shumë rastet tjera.

Gjithashtu, lejohet që muslimanët t'i ruajnë gjërat që i ka lënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), pas vdekjes së tij. Për shembull, dikush e ka pasur një qime të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe e ka ruajtur atë. Por, Sahabet e kanë ditur sigurtë se qimja ka qenë e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Kështu vazhdoi kjo edhe pas Sahabeve, te Tabi'inët dhe me rradhë. Ibni Sirini, një prej dijetarëve të mëdhenj

⁹⁵ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Sehl ibn Sa'di.

të Tabi'inëve, tha: “E kemi marur një qime të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) prej Enesit (*radijall-llahu 'anhu*) dhe e kemi ruajtur atë”. ‘Ubejdeh, i cili i dëgjoi këto fjalë, tha: “Pasha All-llahun, ta kisha pasur unë një qime të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) në shtëpinë time, do të kishte pasur vlerë më shumë se sa të ma japësh gjithë dunjanë dhe çka ka në të!”

Gjithashtu, ka mundësi që diçka e cila është e sigurtë prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të vazhdojë edhe një kohë të gjatë (nëse ajo është e sigurtë). Por, sot, në këtë kohë, nuk lejohet të ruhen dhe të kërkohet bereqet prej gjërave që supozohen se janë të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ngase pasiguria në këtë kohë është shumë e madhe dhe nuk ka garancë për të. Për shembull, në disa vende sot (në Ulqin dikund dhe në Kosovë dikund), e ruajnë nga një qime në tegëll, duke thënë se është e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa kjo nuk është aspakt e sigurtë dhe nuk ka aspakt garancë për të.

- Cili teberruk është i ndaluar?

Më lartë thamë se ata që kanë qenë të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në to ka bereqet. Por, në varrin e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), për shembull: ta prekësh varrin e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e pastaj ta fërkosh trupin etj., apo në shtyllat e xhamisë, apo në dheun etj., në të gjitha këto nuk ka bereqet.

Dikush pastaj, e ka krahasuar Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) me njerëz tjerë dhe kanë thënë: Përderisa ka bereqet në trupin e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ka bereqet edhe në njerëzit e mëdhenj, te dijetarët, shehlerët etj.. E pastaj, e sheh që *sheh*-ut të tyre ia puthin duartë, ngase (sipas tyre) ka bereqet. Apo, ndonjë *sheh*-ut të tyre që ecë me shkop, kur ai ulet të pushojë, i sheh se si e prekin shkopin e tij, ngase (sipas tyre) te shkopi i tij ka bereqet. Kjo ndodhë te sufitetë e devijuar, të cilët kërkojnë bereqet në gjëra të ndryshme, të cilat nuk kanë bazë në fenë e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Nuk mund të krahasohet dikush me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa atë që i kemi përmendur më lartë, është e veçantë dhe i takon vetëm Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Ndërsa, sikur të kishte pasur bereqet te dikush prej muslimanëve të mirë, atëherë Sahabet do ta kishin kërkuar atë prej Ebu Bekrit, apo prej ‘Umerit, apo prej ‘Uthmanit, apo prej ‘Alijgut etj., por këtë nuk e ka bërë askush. Atëherë

nënkuptojmë që kjo vlenë vetëm te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe te askush tjetër prej muslimanëve të mirë.

Kapitulli i dytë:

BESIMI NË MELAIKET

**** Melaiket ****

- Çka janë melaiket?

Melaiket janë krijesa të All-llahut (*subhanehu ve te'alla*), të cilat All-llahu i krijoi prej dritës, siç ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): “Janë krijuar melaiket prej dritës”⁹⁶, të cilat i bëjnë ‘ibadet All-llahut vazhdimisht dhe nuk i bëjnë gjunahe asnjëherë, e kanë një jetë dhe kanë cilësi të veçanta me të cilat dallohen prej krijesave tjera.

- Si i besojmë melaiket?

Besimi në melaiket është kusht i *iman*-it. Çdo musliman e ka për obligim t’i besojë melaiket. Nëse dikush nuk i beson melaiket, ai njeri nuk llogaritet musliman.

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

ءَامَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ ۚ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلُّ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ ۖ وَكُتُبِهِ ۖ
وَرُسُلِهِ ۖ ...

“I Dërguari beson në atë (Kur’anin) që i është shpallur nga Zoti i Tij e po ashtu edhe besimtarët: të gjithë besojnë në All-llahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dëdruarit e Tij ...” (El-Bekarah: 285)

Së pari, besojmë bindshëm që melaiket ekzistojnë. Pastaj, ato melaiket që janë pëmendur në formë të përgjithshme, i besojmë në formë të përgjithshme. Ato melaiket

⁹⁶ Transmeton Muslimi dhe Imam Ahmedî në “*Musned*” - Nga A’isheja.

që janë përmendur me emra, në argumente të Kur'anit dhe Sunnet-it, i besojmë edhe në formë të hollësishme. Për shumë melaikëh dimë vetëm që ekzistojnë, por për disa i dimë edhe emrat dhe detyrat e tyre, etj.. E pastaj, i besojmë edhe gjithë detyrat e melaikëve që janë përmendur në Kur'an dhe Sunnet.

- Kur janë krijuar melaiket?

Në lidhje me krijimin e melaikëve, ne nuk e dimë se kurë janë krijuar ato, por ajo që e dimë është se melaiket janë krijuar para njerëzve, para Ademit ('*alejhis-selam*). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً ...

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në Tokë" ..." (El-Bekarah: 30)

- Sa është numri i melaikëve?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَمَا يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ ...

"Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd." (El-Muddeththir: 31)

Numrin e melaikëve nuk e din askush tjetër pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), por atë që e dimë në është se melaiket janë shumë.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka treguar se kur është ngritur me Xhibrilin (*'alejhis-selam*) për ta bërë *Mi'raxh-in*, e ka parë *Bejtul Ma'mur-in*⁹⁷ dhe e ka pyetur për të. Xhibrili (*'alejhis-selam*) i ka thënë: “Këtu për çdo ditë hynë nga shtatëdhjetë mijë melek dhe nuk kthehen më”.⁹⁸

Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Në Ditën e Gjykimit do të vijë Xhehennemi, të cilin do ta mbajnë melaiket, i cili është i lidhur me shtatëdhjetë mijë zinxhirë, në secilin zinxhirë janë nga shtatëdhjetë mijë melek”.⁹⁹

- Cilat janë dallimet ndërmjet njerëzve dhe melaikeve?

Njerëzit dhe melaiket kanë shumë dallime; prej tyre:

1. Melaiket janë të krijuara prej dritës, ndërsa njerëzit janë të rijuar prej dheut (prej baltës)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Janë krijuar melaiket prej dritës, janë krijuar xhinnët prej zjarrit dhe janë krijuar njerëzit prej asaj që u është përshkruar (prej dheut)”.¹⁰⁰

2. Melaiket nuk hanë dhe nuk pinë

Kur Ibrahimit (*'alejhis-selam*) i erdhën mysafir melaiket, për të cilët vrapoi, ua pregaditi ushqimin dhe ju tha:

... أَلَا تَأْكُلُونَ

“A nuk po hani?” (Edh-Dharijat: 27)

ndërsa ata nuk hëngrën, ngase ishin melaikëh.

3. Melaiket nuk kanë gjini, ndërsa njerëzit kanë, janë meshkuj ose femra

4. Melaiket i bëjnë 'ibadet All-llahut vazhdimisht dhe nuk i bëjnë gjunahe asnjëherë

⁹⁷ *Bejtul Ma'mur*-i është vend në të cilin melaiket i bëjnë 'ibadet All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Sikur Ka'beja që është në tokë për njerëzit, ajo është në qiell për melaiket.

⁹⁸ Transmeton Bu'hariu.

⁹⁹ Transmeton Muslimi - Nga Ibn Mes'udi.

¹⁰⁰ Transmeton Muslimi dhe Imam Ahmedi në “*Musned*” - Nga A'isheja.

5. Melaiket nuk flejnë dhe nuk lodhen kurrë

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... يُسَبِّحُونَ لَهُ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَهُمْ لَا يَسْأَمُونَ ﴿٣٨﴾

“... ata që janë te Zoti yt, e lavdërojnë Atë natën dhe ditën e kurrë nuk ndihen të lodhur.” (*Fussilet: 38*)

Dhe disa dallime tjera, të cilat ekzistojnë ndërmjet njerëzve dhe mealikeve.

- A mund të shihen melaiket?

Melaiket, në formën e tyre origjinale (ashtu siç janë të krijuara), nuk ka mundësi t'i shohë askush, dhe në këtë *ummet*, nuk i ka parë ato askush, përveç Pejgaberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili e pa Xhibrilin (*'alejhis-selam*) me sytë e tij vetëm dy herë. Herën e parë e ka parë kur i erdhi shpallja për herë të parë dhe tha: “E pashë Xhibrilin, madhësia e tij ishte sa prej tokës derin në qiell. E kishte mbuluar tërë horizontin”.¹⁰¹ Prej tij u trishtua Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe u kthye në shtëpinë e tij dhe tha: “Më mbulonun, më mbulonun!”, deri sa i zbriti ajeti tjetër:

يَأْتِيهَا الْمُدَّثِّرُ ﴿١٠١﴾

“O ti i mbuluar!” (*El-Muddeththir: 1*)¹⁰²

Ndërsa herën e dytë e ka parë kur ka udhëtuar në *Isra'* dhe *Mi'raxh*, siç thotë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*):

وَلَقَدْ رَآهُ نَزْلَةً أُخْرَىٰ ﴿١٣﴾ عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَىٰ ﴿١٤﴾

¹⁰¹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi.

¹⁰² Transmeton Bu'hariu. Imam Ibni Haxheri, gjithashtu edhe *Shej'h* Albani, e kanë cilësuar këtë *hadith* si të dobët (*daif*), ngase kjo është fjalë e Imam Zuhriut, e që nuk është fjalë e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

“Në të vërtetë, ai e ka parë (Xhibrilin) edhe një herë tjetër, te Sidretul Muntehaja.” (En-Nexhm: 13-14)

Por, melaiket, me lejen e All-llahut (*subhanehu ve te’ala*), kan mundësi të shëndërohen edhe në formë të njeriut, e kështu (në formë të njeriut) kanë mundësi t’i shohin edhe njerëzit tjerë, ashtu sikur ju paraqit Xhibrili (*‘alejhis-selam*), Merjemes (*‘alejhes-selam*), nënës së ‘Isait (*‘alejhis-selam*), për të cilin rast, All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

وَأَذْكُرُ فِي الْكِتَابِ مَرْيَمَ إِذِ انْتَبَذَتْ مِنْ أَهْلِهَا مَكَانًا شَرْقِيًّا ﴿١٦﴾ فَاتَّخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا

فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا ﴿١٧﴾ قَالَتْ إِنِّي أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ

تَقِيًّا ﴿١٨﴾

“Dhe trego (o Muhammed) në Libër për Merjemen, kur u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje, duke e fshehur veten nga ata. Ne i dërguam Shpirtin Tonë, i cili iu paraqit asaj si njeri i plotë. Ajo i tha: “Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh All-llahut.” (Merjem: 16-18)

Gjithashtu, te Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*), pranë të cilit ishin Sahabet (*radijall-llahu ‘anhum*), erdhi Xhibrili (*‘alejhis-selam*), në formë të njeriut dhe bëri pyetje: “Çka është iman-i?”, “Çka është Islami?”, “Çka është Ihsan-i?”, etj., dhe atë e panë edhe Sahabet (*radijall-llahu ‘anhum*).¹⁰³

- A vdesin melaiket?

Shumica e dijetarëve të *Ehli Sunnet*-it thonë se melaiket vdesin, duke u bazuar në argumentet e përgjithshme, ku All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) flet për shkatërrimin e çdo gjëje. All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ ﴿١٦﴾ وَيَبْقَىٰ وَجْهَ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿١٧﴾

¹⁰³ Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe ‘Umer ibnul ‘Hattabi.

“Çdo gjë që është në Tokë do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, plot Madhëri dhe Nderim.” (Er-Rahman: 26-27)

Dhe në një ajet tjetër, në të cilin All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ نُفِخَ فِيهِ أُخْرَىٰ فَإِذَا هُمْ قِيَامٌ يَنْظُرُونَ ﴿٦٨﴾

“Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej e në Tokë, përveç atyre që do All-llahu; pastaj do të fryhet për të dytën here në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.” (Ez-Zumer: 68)

Dhe kanë thënë: *“do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej”*, ndërsa në qiell janë melaiket. Pra, do të vdesin edhe melaiket.

Ibn Hazmi dhe pak prej dijetarëve kanë thënë: Melaiket nuk vdesin dhe ato hynë në këtë ajet: *“... përveç atyre që do All-llahu (të mos vdesin) ...”*. (Ez-Zumer: 68)

Ndërsa, për atë se cilët janë ato që All-llahu don të mos vdesin, dijetarët kanë dhënë shumë mendime, e dhjetë prej tyre i ka përmendur Imam Ibn Haxher El-Askalani (*rahimehull-llah*). Ndërsa, më afër për ta thënë, është ajo të cilën e ka thënë Hasan El-Basriu (*rahimehull-llah*): *“Atë që All-llahu e ka përjashtuar që nuk do të zhduket, atë e din vetëm All-llahu”*.

- Cilat janë frytet e besimit në melaiket?

Disa prej fryteve (dobive) të besimit në melaiket i ka përmendur Ibn Uthejmini (*rahimehull-llah*) dhe ka thënë:

1. Një prej dobive është se njeriu e kupton madhërinë e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) dhe i shtohet *iman*-i.
2. Një dobi tjetër është se njeriu e din që melaiket janë vazhdimisht me të, e ruajnë dhe e mbrojnë, por gjithashtu edhe i regjistrojnë veprat e tij.

Melaiket që janë me njeriun janë katër: dy melek, njëri në krahun e majtë dhe njëri në krahun e djathtë, të cilët i shkruajnë punët e njeriut. Dhe dy melek, të cilët All-llahu i përmendi në Kur'an, ku thotë:

لَهُ مَعْقَبَتٌ مِّنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ يَحْفَظُونَهُ مِنْ أَمْرِ اللَّهِ ...

“Njeriu ka përcjellës (engjëj), para tij dhe pas tij, që e mbikqyrin atë me urdhërin e All-llahut.” (Er-Ra’d: 11)

Për këto dy melaiket, që njëri është para njeriut e tjetri mbrapa tij, ‘Abdull-llah ibn ‘Abbasi (radijall-llahu ‘anhu) ka thënë: “E mbrojnë njeriun, deri sa të vijë *kader*-i (caktimi) për ndonjë çështje; kur vjen *kader*-i (caktimi), ato largohen dhe realizohet ajo që e ka caktuar All-llahu (*subhanehu ve te’ala*)”.

3. Prej dobive tjera është se njeriut i shtohet dashuria ndaj melaikeve, ndaj këtyre krijesave, duke e ditur se ato vazhdimisht i bëjnë *‘ibadet* All-llahu (*subhanehu ve te’ala*).

**** Xhinnët ****

- A ekzistojnë vërtetë xhinnët?

Xhinnët janë përmendur në shumë *ajet-e* dhe në shumë *hadith-e*, dhe një *Surah* të plotë në Kur'an, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka quajtur: *Suratul Xhinn* (*Kaptina e Xhennëve*).

Xhinnët eksistojnë, edhe pse ne nuk i shohim, dhe atë që ne nuk e shohim dhe e besojmë, quhet: *gajb* (e fshehtë). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), në fillim të Kur'anit, kur flet për njerëzit e devotshëm, si cilësi të parë të tyre, thotë:

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ ...

"Të cilët besojnë në të fshehtën ..." (*El-Bekarah: 3*)

Ky është *iman-i* që kërkohet, ta besosh atë që nuk e sheh, sepse ta besosh atë që e sheh, ajo nuk është besim.

Besimi në xhinnët nuk është kusht i *iman-it*, por përderisa janë përmendur në *ajet-e* dhe *hadith-e*, mohimi i xhinnëve është *kufër*, është mohim i fjalëve të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).¹⁰⁴

¹⁰⁴ Nëse njeriu e mohon qoftë edhe një shkronjë të Kur'anit, del nga feja dhe nuk llogaritet musliman.

- Si është jeta e xhinnëve?

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Janë krijuar melaiKET prej drite, janë krijuar xhinnët prej zjarri dhe janë krijuar njerëzit prej asaq që tani më u është treguar (prej dheut)”¹⁰⁵ Këtë All-llahu (subhanehu ve te'ala) e ka përmendur në Kur'an, ku thotë:

وَأَخْلَقَ الْجَانَّ مِنْ مَّارِجٍ مِنْ نَّارٍ ﴿١٥﴾

“Ndërsa xhinnët i krijoi prej flakës së zjarrit¹⁰⁶.” (Er-Rahman: 15)

Xhinnët hanë dhe pinë, martohen dhe shtohen. All-llahu (subhanehu ve te'ala) në Kur'an i ka përmendur pasardhësit e Iblisit, ku thotë:

... وَذُرِّيَّتَهُ ...

“... atë (Iblisin) dhe pasardhësit e tij ...” (El-Kehf: 50)

Xhinnët i kanë obligimet e tyre. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾

“Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56)

Pra, edhe xhinnët janë të obliguar t'i bëjnë 'ibadet All-llahut (subhanehu ve te'ala): ta falin namazin, ta japin zekatin, të agjërojnë, etj..

Dhe në fund, xhinnët vdesin ashtu sikurse edhe njerëzit, dhe një ditë do të ringjallen dhe do të dalin para All-llahut (subhanehu ve te'ala): nëse kanë qenë të mirë, e kanë shpërblimin e tyre Xhennetin, e nëse nuk kanë qenë të mirë, atëherë janë banorë të Zjarrit, bashkë me njerëzit. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

¹⁰⁵ Transmeton Muslimi dhe Imam Ahmedi në “Musned” - Nga A'isheja.

¹⁰⁶ Dikush mund të thotë, siç kanë thënë disa: Atëherë si do t'i djegë Xhehennemi xhinnët, kur ata janë të krijuar prej zjarrit?! Dijetarët kanë thënë: Nëse fillimi i krijimit të tyre është prej zjarri, nuk don të thotë që edhe sot ata janë zjarr. Edhe njeriu është i krijuar prej dheut, por ai sot nuk është dhé (baltë), dhe nuk don të thotë që edhe xhinnët sot janë zjarr. Edhe pse, All-llahu (subhanehu ve te'ala) dënimin e tij e çon në vend, edhe nëse ata janë prej zjarri. All-llahu ka mundësi për çdo send.

... لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿١٣﴾

"... por do të përmbushet fjala Ime: "Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhinnd dhe njerëz bashkarisht!" (Es-Sexhdeh: 13)

Ka prej xhinnëve që janë muslimanë të mirë, ka prej tyre që janë muslimanë gjunahqarë dhe ka prej tyre që nuk janë musliman fare. Xhinnët që nuk janë musliman, të cilët i bëjnë *kufër* All-llahut, quhen: *Shejtan*. Ndërsa xhinnët të cilët nuk i bëjnë *kufër* All-llahut, nuk quhen *Shejtan*, por quhen: *Xhinn musliman*. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمُونَ وَمِنَّا الْقَاسِطُونَ ...

"Ka prej nesh që janë muslimanë, por ka edhe të atillë që janë jobesimtarë." (El-Xhinn: 14)

- A mund të shihen xhinnët?

Xhinnët, në formën e tyre origjinale (ashtu siç janë të krijuar), nuk ka mundësi t'i shohë askush. Por, xhinnët kanë mundësi të marrin forma të ndryshme, me lejen e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ata mund të paraqiten në formë të njeriut, mund të paraqiten në formë të kafshëve dhe në forma të ndryshme. E, në këtë gjendje, ata ka mundësi të shihen. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i takoi xhinnët dhe i thirri ata në Islam, ua lexoi atyre fjalën e All-llahut, Kur'anin, dhe shumë prej tyre e pranuan Islamin dhe thanë:

... إِنَّا سَمِعْنَا قُرْءَانًا عَجَبًا ﴿١﴾ يَهْدِي إِلَى الرُّشْدِ فَآمَنَّا بِهِ ۗ وَلَنْ نُشْرِكَ بِرَبِّنَا أَحَدًا ﴿٢﴾

"Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm, i cili udhëzon në rrugën e drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj kurrësi më nuk do t'i shoqërojmë askënd Zotit tone (në adhurim)!" (El-Xhinn: 1-2)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në Ramazan, e caktoi Ebu Hurajran (*radijall-llahu 'anhu*) që ta ruante zekatin e muslimanëve. Duke qëndruar Ebu Hurajrah kujdestarë, erdhi një njeri që të vjedhte prej pasurisë së muslimanëve. Ebu Hurajrah e kapi atë dhe i tha: “Tash do të dërgoj te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)”. Ai i tha: “Falma dhe mos më dërgo te Muhammedi. Unë kam familje dhe kam fëmijë. Falma se nuk do të vi më!” Atëherë Ebu Hurajrah ia fali dhe e lëshoi. Në mëngjes e takoi Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili i tha: “O Eba Hurajrah, çka ndodhi me atë që e zure mbrëmë?” Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) i tha: “O i Dërguari i All-llahut, e lëshova dhe më tha që më nuk do të vijë”. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i tha: “Do të vijë përsëri!” Në mbrëmje, Ebu Hurajrah e priste se kur do të vinte, dhe duke pritur, erdhi i njejti njeri, dhe duke dashur të marrte, e kapi Ebu Hurajrah dhe i tha: “Tash do të dërgoj te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)”. Ai i tha: “Falma edhe kësaj here. Kam fëmijë dhe fëmijë. Falma se më kurrë nuk do të vijë!” Ebu Hurajrah ia fali edhe kësaj rradhe dhe e lëshoi. Në mëngjes e takoi Pejgambrin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili i tha: “Çka bëre me atë njeriun mbrëmë, të cilin e zure?” Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) tha: “O i Dërguari i All-llahut, mu ankua se kishte familje dhe fëmijë, dhe më tha që më kurrë nuk do të vijë dhe e lëshova”. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Dije që do të vijë përsëri!” Kësaj here, kur e kapi Ebu Hurajrah atë personin, ai i tha: “Falma edhe kësaj here se më nuk do të vijë!” Ndërsa Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) i tha: “Jo, por do të dërgoj te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)!” Ai i tha: “A më falë dhe lëshon, do të mësoj diçka të dobishme?” Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) i tha: “Urdhëro dhe fol”. Ai i tha: “Po të tregoj, që nëse njeriu në mbrëmje e lexon një *ajet* (*Ajetul Kursijj*), është i mbrojtur prej All-llahut deri në mëngjes dhe shejtanët nuk i afrohen atij!” Kur ia dha këtë mësim, Ebu Hurajrah e lëshoi atë. Në mëngjes, kur e takoi Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ai i tha: “Çka bëre me atë njeriun mbrëmë, të cilin e zure?” Atëherë Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) ia tregoi rastin. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Ta ka thënë të vërtetën, edhe pse ai është gënjeshtarë. A e din, o Ebu Hurajrah, kush ka qenë ai njeri?” Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) tha: “Nuk e di, o i Dërguari i All-llahut”. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Ai ka qenë shejtan!”¹⁰⁷

Xhinnët kanë mundësi të shëndrohen edhe në formë të kafshëve. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Nëse dikush hyn në shtëpi dhe e sheh ndonjë gjarpër, le të kërkojë leje prej tij tre herë, që të dalë për hirë të All-llahut dhe mos ta sulmojë, sepse ka mundësi të jetë prej xhinnëve dhe t’i bëjë zullujm, ndërsa nëse nuk del, atëher mundet ta sulmojë dhe ta mbysë atë”.

¹⁰⁷ Transmeton Bu’hariu - Nga Ebu Hurajrah.

Gjithashtu, xhinnët kanë mundësi të paraqiten edhe në forma tjera, ashtu siç ndodhi me Abdul Kadir Xhejlanin. Ky ishte një njeri i cili bënte shumë *'ibadet*. Një natë, duke bërë *'ibadet*, ju paraqit një dritë e madhe dhe i tha: “O Abdul Kadir, unë jam zoti yt! Prej këtij moment, t’i kam falur të gjitha gjunahet dhe më për ty nuk ka obligime!” Atëherë Abdul Kadir Xhejlani e kuptoi që ky ishte shejtani dhe tha: “*E’udhu bil-lahi minesh-shejtanir-raxhim* (kërkoj mbrojtje prej All-llahut nga shejtani i mallkuar)!” , dhe u largua ajo dritë! Kur e pyetën Abdul Kadir Xhejlanin, se si e ka ditur që ai ka qenë shejtani, tha: “E para, e dita, ngase nuk guxoi të më thoshte: “Unë jam All-llahu!” , sepse shejtani nuk ka mundësi të thotë ashtu, por tha: “Unë jam zoti yt^{108!}”. Dhe e dyta, kur All-llahu nuk ia bëri të gjitha gjërat të lejuara dhe nuk ia hoqi të gjitha obligimet Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), a do të mi bëjë mua?!” .

Gjithashtu, edhe kafshët mund t’i shoin xhinnët. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Kur këndon gjeli, kërkonin prej All-llahut nga të mirat e Tij, sepse ai i sheh melaiKET. Kur ta dëgjoni zërin e gomarit dhe të lehurat e qenit, atëherë kërkonin mbrojtje tek All-llahut, sepse ata i shohin shejtanët” .¹⁰⁹ Në një transmetim tjetër, thuhet: “nëse i dëgjoni natën” .¹¹⁰

- A ka prej xhinnëve Pejgamber dhe Sahabeh?

Sipas shumicës së dijetarëve, xhinnët nuk kanë pasur Pejgamber prej xhinnëve, por Pejgamberët e njerëzve (të cilët kanë qenë njerëz) kanë vlejtur edhe për njerëzit edhe për xhinnët. Pra, të gjithë Pejgamberët që ne i dimë (i njohim), të cilët kanë qenë njerëz, kanë vlejtur Pejgamber edhe për xhinnët. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رِجَالًا نُوْحِي إِلَيْهِمْ ...

“Para teje, Ne kemi dërguar vetëm burra nga banorët e qyteteve, të cilët i frymëzuam me shpallje.” (Jusuf: 109)

Pra: “Burra”, që don të thotë: njerëz të gjinisë mashullore.

¹⁰⁸ Shejtani ka mundësi të jetë zot i dikujt, i atyre që e adhurojnë atë.

¹⁰⁹ Transmeton Bu’hariu dhe Muslimi.

¹¹⁰ Transmeton Ebu Davudi dhe Ahmed. Sipas *Sej’h* Albanit *hadith*-i është *sahih*.

Ndërsa pak prej dijetarëve kanë thënë se xhinnët i kanë pasur Pejgamberët e tyre prej xhinnëve, deri në kohën e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është Vula e Pejgamberëve dhe ka vlejtur edhe për njerëzit edhe për xhinnët.

Sa i përket asaj se a ka *xhinn* prej Sahabeve, dijetarët e *Ehli Sunnet*-it kanë thënë: Sahabeh quhet ai i cili e ka takuar Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e ka besuar atë dhe ka vdekur duke qenë musliman, ndërsa të tillë ka edhe prej xhinnëve. Don të thotë: ata xhinn të cilët e kanë takuar Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e kanë besuar atë dhe kanë vdekur musliman, edhe ata llogariten Sahabeh.

- Si të mbrohemi prej xhinnëve?

Ka mundësi që njeriu të sulmohet prej xhinnëve. *Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh (rahimehull-llah)* thotë: "Ka mundësi që xhinnët ta sulmojnë dikënd prej njerëzve, për shkak të epsheve të tyre; ka mundësi që ta sulmojnë për shkak të hidhërimit të tyre; ka mundësi që njeriu të ju bëjë zullum xhinnëve, t'i urinojë ato (duke mos e bërë *dhikrin* e hyrjes në banjo, etj.); ka mundësi që njeriu t'i djegë xhinnët (duke ju hedhur vale, etj.); ka mundësi që njeriu t'i mbysë ata (duke gjuajtur diçka të rëndë, etj.); ka shumë prej xhinnëve që kanë *xhehl* (inJORANCË) dhe kanë zullum, dhe nëse ti ju bën atyre pak zullum, ata kanë mundësi të të bëjnë shumë zullum".

Njeriu duhet të mbrohet prej xhinëve në shumë mënyra. Ajo që kërkohet prej njeriut është që çdo herë ta përmendë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Për shembull, kur dëshion të hyjë në banjo, ta bëjë *dhikr*-in para se të hyjë aty; kur të hyjë në shtëpi, ta përmendë All-llahun (ta bëjë *dhikr*-in e hyrjes në shtëpi), dhe kështu me rradhë të gjitha *dhikr*-et që na i ka mësuar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).¹¹¹

Njeriu duhet të mbrohet prej xhinnëve duke lexuar *ajete* dhe *Surah* nga Kur'ani, të cilat na i ka mësuar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Për shembull: *Ajet-in Kursijj*, *Sura-n Felek*, *Sura-n Nas*, në çdo tre ditë *Sura-n Bekarah* dhe kështu me rradhë.

Gjithasht, njeriu duhet të qëndrojë vazhdimisht me abdes, me namaz dhe me *'ibadet* ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), kështu që të mbrohet dhe dyert e shejtanëve të jenë të

¹¹¹ Shih librin "MBUROJA E MUSLIMANIT" të Seid El-Kahtanit në gjuhën shqipe.

mbyllura për të. Ndërsa, nëse njeriu merret me harame dhe i bën gjunahe All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), duke qëndruar pa abdes dhe pa namaz, duke mos e përmendut All-llahun, duke mos lexuar Kur'an etj., të gjitha këto shkaktojnë dhe i hapin dyert, që shejtanët ta kenë rrugën të hapur për ta sulmuar atë.

Gjithashtu, nëse dikush prej njerëzve është i sëmure prej xhinnëve (i goditur me *sihir* apo mësysh), atëherë ka mundësi që dikush tjetër t'i lexojë atij Kur'an, që t'i ndihmojë dhe t'ia lehtësojë gjendjen. Për shembull, duke ia lexuar *Ajet-in Kursijj*, *Sura-n I'hlas*, *Felek* dhe *Nas*, *Sura-n Bekarah* (sa të jetë mundësia) dhe të gjitha *ajet-et* dhe *Sura-t* që kanë të bëjnë me *rukje-t*.

Ai i cili e mer përsipër që t'i lexojë njeriut të sëmure prej xhinnëve Kur'an, duhet të ketë parasysh dhe duhet të jetë më i fortë se xhinni me të cilin është sulmuar ai njeri. Kanë thënë: Nëse muslimani është i fortë e xhinni është i dobët, nuk ka qare pa u larguar prej asaj që i lexon ky muslimani i mirë, por nëse muslimani (i cili i lexon Kur'an) është i dobët, ndërsa xhinni është i fortë, nuk ka mundësi t'i bëjë asgjë. Dikush shkoi te Imam Ahmedi (*rahimehull-llah*) dhe i tha: "Kështu është rasti i një gruaje, e cila është e sëmure dhe është në familjen e 'Halifes". Imam Ahmedi (*rahimehull-llah*) i tha: "Meri këto nalle dhe shko tek ajo grua dhe thuaj: "A do të dalësh më shpejtë apo dë të vijë Imam Ahmedi?!" Ky person, kur shkoi me nallen e Imam Ahmedit, sa ja tha këto fjalë, xhinni doli dhe u largua! Më pas, pas vdekjes së Imam Ahmedit, shkoi i njejti person me nallet e Imam Ahmedit dhe i tha: "A do të dalësh apo do të godas me këto nalle?!" Ndërsa ai (xhinni) i tha: "E kemi respektuar Imam Ahmedin, por sot nuk të respektojmë ty!" Kështu bëri edhe Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) me atë që ishte sprovuar prej xhinnëve dhe me dy fjalë: "Dil o amik i All-llahut!", ishin shkak dhe u larguan xhinnët.

Pra, nëse dikush sulmohet prej xhinnëve, i lexohen fjalët e All-llahut, të cilat janë shërim për çdo gjë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَنَزَّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ ...

"Ne shpallim nga Kur'anin atë që është shërim ..." (El-Isra': 82)

Është shërim, qoftë shpirtërorë apo truporë.

Kapitulli i tretë:

BESIMI NË PEJGAMBERËT

**** Pejgamberët ****

- Si i besojmë Pejgamberët?

Besimi në Pejgamberët është kusht i *iman*-it. Nëse dikush nuk i beson Pejgamberët, ai nuk llogaritet musliman.

I besojmë të gjithë Pejgamberët, të cilët All-llahu i dalloi dhe ua shpalli atyre Shpalljen, që ta përcjellnin atë te njerëzit tjerë. Ata që janë përmendur në formë të hollësishme, i besojmë në formë të hollësishme, ata që janë përmendur me emra, i besojmë me emra.

Ai i cili nuk e beson apo e mohon qoftë edhe një Pejgamber, është njësoj sikur nuk i ka besuar apo i ka mohuar të gjithë Pejgamberët dhe nuk llogaritet musliman. Për atë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

كَذَّبَتْ قَوْمُ نُوحٍ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٥٥﴾

"Edhe populli i Nuhut gënjeu të Dërguarit." (*Esh-Shu'ara'*: 105)

Populli i Nuhut (*'alejhis-selam*) nuk i mohoi të gjithë Pejgamberët, ata e mohuan vetëm Nahun (*'alejhis-selam*), por ta mohosh një Pejgamber është sikur t'i mohosh të gjithë. Gjithashtu, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

كَذَّبَتْ قَوْمُ لُوطٍ الْمُرْسَلِينَ ﴿١٦٠﴾

"Populli i Lutit i quante gënjeshtarë të Dërguarit." (*Esh-Shu'ara'*: 160)

Pra, ta përgënjeshtrosh një, nënkupton: t'i përgënjeshtrosh të gjithë.

Ka Pejgamber, për të cilët ne nuk dimë për ta dhe i besojmë ata ashtu, në formë të përgjithshme. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ مِنْهُمْ مَّن قَصَصْنَا عَلَيْكَ وَمِنْهُمْ مَّن لَّمْ نَقْصُصْ عَلَيْكَ

...

“Edhe para teje (o Muhammed) Ne kemi nisur të Dërguar, për disa prej të cilëve të kemi treguar ty e për disa të tjerë nuk të kemi treguar.” (Gafir: 78)

I besojmë të gjithë Pejgamberët që All-llahu i ka dërgur. Ata për të cilët i dimë emrat dhe hollësitë e tyre, i besojmë në atë formë, e ata që nuk i dimë, i besojmë në formë të përgjithshme, pa pasur kurfarrë dyshimi.

- Pse janë dërguar Pejgamberët?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ka dërguar Pejgamberë, që ata t'ua përcjellin njerëzve mesazhin e Tij. Njëpërmjet Pejgamberëve njerëzit e kanë njohur All-llahun (*subhanehu ve te'ala*). Njëpërmjet tyre njerëzit e kanë gjetur rrugën, se si ta adhurojnë All-llahun (*subhanehu ve te'ala*). Dhe All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لَعَلَّ يُكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ ...

“(Këta janë) të Dërguar që kanë sjellë lajme të mira dhe paralajmërime, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë argument kundër All-llahut, pas ardhjes së të Dërguarve.” (En-Nisa': 165)

Pra, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) çdo popull i dërgoi Pejgamberë, për të mos pasur arsye për ta.

Nuk ka pasur asnjë popull që nuk ka pasur të Dërguar (Pejgamberë). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَإِنَّ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ﴿٢٤﴾

“... nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ket ardhur paralajmërues.” (Fatir: 24)

Ndërsa, për në Ditën e Gjykimit, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَسِيقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَىٰ جَهَنَّمَ زُمَرًا ۖ حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوهَا فَفُتِحَتْ أَبْوَابُهَا وَقَالَ لَهُمْ خَزَنَتُهَا
أَلَمْ يَأْتِكُمْ رُسُلٌ مِّنكُمْ يَتْلُونَ عَلَيْكُمْ آيَاتِ رَبِّكُمْ وَيُنذِرُونَكُمْ لِقَاءَ يَوْمِكُمْ هَٰذَا قَالُوا بَلَىٰ

...

“Jobsimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehennem, dhe kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t’u thonë atyre: “A nuk ju kanë ardhur të Dërguar nga gjiri juaj, të cilët ju lexonin Shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj dite?!” Mohuesit do të thonë: “Po, është e vërtetë!” ...” (Ez-Zumer: 71)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Nuk dëgjon për mua (për emrin tim) dikush prej jehudëve apo krishterëve dhe nuk më beson, përveç se do të jetë banorë i Xhehennemit”.¹¹²

- Cilat janë cilësitë e Pejgamberëve?

Pejgamberë e All-llahut, nga ana e dunjasë, i kanë disa cilësi:

1. Pejgamberët kanë qenë njerëz

All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) të gjithë Pejgamberët i ka bërë prej njerëzve. Të gjithë Pejgamberët kanë qenë njerëz, nuk kanë qenë as melaikë e as xhinnd. Kështu mushrikët e Mekkes mundoheshin ta fajsonin Pejgamberin (*sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*) dhe thonin:

وَقَالُوا مَا لِٰهَٰذَا الرَّسُولِ يَأْكُلُ الطَّعَامَ وَيَمْسِي فِي الْأَسْوَاقِ ...

“Ç’është ky i Dërguar që ha ushqim dhe shëtitë nëpër tregje?” (El-Furkan: 7)

All-llahu (*subhanehu ve te’ala*), me urtësinë e Tij, e bëri që Pejgamberët të jenë prej njerëzve dhe nuk e bëri të jenë prej xhinneve e as prej melaikëve. Sikur të kishte qenë ndonjë Pejgamber prej xhinneve, si do ta pasonim ne atë, kur ato as nuk i shohim?! Po sikur të kishte qenë ndonjë Pejgamber prej melaikëve, gjithashtu ne nuk kemi mundësi

¹¹² Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

që t'i pasojmë ato, nuk kemi mundësi të bëhemi sikur ato dhe nuk kemi mundësi t'i kundërshtojmë ato; atëherë *iman*-i nuk e ka vlerën e tij. Për atë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) Pejgamberët i bëri prej njerëzve.

2. Pejgamberët kanë qenë burra

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) të gjithë Pejgamberët i dërgoi burra (të gjinisë mashkulore). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رِجَالًا نُوحِيَ إِلَيْهِمْ مِنْ أَهْلِ الْقُرَىٰ ...

"Para teje, Ne kemi dërguar vetëm burra nga banorët e qyteteve, të cilët i furnizuar me shpallje." (Jusuf: 109)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), me urtësinë e Tij, e bëri që Pejgamberët të jenë burra, ngase Pejgamberët e All-llahut kanë pasur punë me njerëz (me popull), ata është dashur të flasin para gjithë njerëzve dhe është dashur që ndonjëherë të vetmohen me njerëzit, ata është dashur të udhëheqin popuj, është dashur edhe të luftojnë dhe të sakrifikojnë etj., e këtë gratë nuk kanë mundësi ta bëjnë. Gjithashtu, gratë, ka raste në të cilat nuk mund t'i udhëheqin edhe disa punë tjera, e jo më të udhëheqin një popull. Ato kanë kohën e menstruacioneve, kohën e shtatëzanisë, kohën e lindjes, kohën e gjdhënies etj., dhe nuk kanë mundësi.

3. Pejgamberët kanë qenë në pamjen më të mirë

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), Pejgamberët i zgjodhi ata, të cilët edhe në pamjen e tyre janë në pamjen më të mirë. Nuk ka pasur Pejgamber të All-llahut, i cili ka pasur ndonjë të metë, qoftë edhe trupore. Gjithashtu edhe në aspektin e moralit, mendjes së shëndoshë, etj..

- Cilat janë veçoritë e Pejgamberëve?

Pejgamberë e All-llahut i kanë pasur disa veçori:

1. Shpallja (Vahji)

Disa filozofë kanë thënë: Nëse njeriu mundohet shumë, bën *'ibadet* shumë dhe lodhet shumë, arrinë në shkallën e pejgamberllëkut. Ndërsa, nuk ka mundësi që një njeri të bëhet Pejgamber, çkado që të bëjë ai. Por, Pejgamberët, në shkallën e pejgamberllëkut, kanë arritur me zgjedhjen e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Atë që e zgjedhë All-llahu, ai është Pejgamber.

2. *El-'Ismeh (All-llahu i ka mbrojtur ata prej gabimeve)*

Të gjithë njerëzit janë gjuhahqarë, të gjithë janë gabimtarë, ndërsa Pejgamberët e All-llahut, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i mbronë prej ganimeve. Por, ka raste, të cilat ne i dimë, që ndonjë Pejgamber i All-llahut ka gabuar. Për shembull, Ademi (*'alejhis-selam*) gaboi dhe hëngri prej asaj pemës; apo Junusi (*'alejhis-selam*) gaboi me populli të tij, i la ato dhe u nis për në një vend tjetër; etj.. Pejgamberët e All-llahut nuk kanë mundësi të binë në gjuhahqari të mëdhaja (si për shembull: në zina, në vjedhje, në alkool etj.), ndërsa në gjuhahqari të vogla, dijetarët kanë thënë se kanë mundësi të gabojnë, vetëm se ata përmirësohen menjëherë (prej atij momenti, ata përmirësohen menjëherë prej atij gabimi).

3. *Pejgamberëve ju flejnë sytë, por nuk ju flen zemra*

Pejgamberët, kur kanë fjetur, u kanë fjetur sytë e tyre, ndërsa zemrat e tyre nuk ju kanë fjetur.

4. *Pejgamberët kanë pasur të drejtë të zgjedhin kur ju ka ardhur moment i vdekjes, për të vdekur apo për të jetuar më tutje*

Kështu i thanë Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa ai tha: *"Jo, por e dua vendin më të lartë, në shoqëri me Pejgamberët tjerë"*.¹¹³

5. *Pejgamberët varrosen atje ku vdesin dhe trupi i tyre në varr nuk priset*

Njerëzit tjerë, kur vdesin, kalon një kohë dhe trupi i tyre kalbet dhe priset, dhe nuk mbetet përveç se një pjesë e vogël e trupit, e cila është në shpinën e njeriut, prej të cilës pjesë njeriu do të ringjallet edhe një herë.¹¹⁴ Ndërsa trupi i Pejgamberëve të All-llahut nuk priset¹¹⁵, nuk kalbet dhe mbetet ashtu deri në Ditën e Ringjalljes. Në disa raster, edhe trupi i Shehidëve nuk priset, por te Shehidët është në formë të përgjithshme, ndërsa te Pejgamberët e All-llahut, trupi i tyre nuk priset asnjëherë.

¹¹³ Transmeton Bu'hariu - Nga A'isheja.

¹¹⁴ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹¹⁵ E transmeton Ebu Davudi me *sened sahih* - Nga Eus ibn Eusi.

6. Pejgamberët janë të gjallë në varret e tyre

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Pejgamberët e All-llahut janë të gjallë në varret e tyre”. Gjithastu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e pa Musain (*'alejhis-selam*) në varrin e tij duke falur namaz, e pastaj u ngrit Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) në *Mi'raxh* dhe gjithashtu e takoi Musain (*'alejhis-selam*) në qiellin e gjashtë.

Këto argument tregojnë se jeta e varrezave (*Berza'h-u*) është krejtësisht një botë ndryshe, e cila dallon nga jeta e kësaj bote. Ndërsa disa prej të devijuarëve kanë thënë që, përderisa Pejgamberët e All-llahut janë të gjallë në varret e tyre, atëherë ne lejohet që të shkojmë tek Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), për të folur me të, për t'ia qajtur dertin dhe hallet tona, për t'ia kërkuar nevojat tona, etj.. Saqë, një prej tyre, i cili ka shkruar edhe libër në këtë drejtim, thotë: “Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është i gjallë në varrin e tij, han dhe pin dhe ka marrëdhënie me gratë e tij”. Ky është *dalalet*, i cili kalon përtej kufive. Ndërsa, ajo të cilën e ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është se Pejgamberët janë të gjallë në varret e tyre, ndërsa çfarë gjallërie, ajo është krejtësisht ndryshe nga jeta e kësaj bote. All-llahu e din më së miri.

- Sa është numri i gjithë Pejgamberëve?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَإِنَّ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ﴿٢٤﴾

“... nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.” (Fatir: 24)

Ebu Dherri (*radijall-llahu 'anhu*) e pyeti Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): “O i Dërguari i All-llahut, sa janë Pejgamberët të cilët janë *Rusul*?” Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Treqind e diçka (310 deri 320)”. Ebu Dherri (*radijall-llahu 'anhu*) e pyeti përsëri: “E sa janë ata që janë *Embija*?” Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: “Njëqind e njëzet e katër mijë (124 000)”.

Për këtë *hadith*, shumica e dijetarëve kanë thënë se është i dobët (*daif*), ndërsa disa dijetarë kanë thënë se është i vërtetë (*sahih*).

Më e saktë dhe më e afërt është të themi, se numri i Pejgamberëve të All-llahut është i madh, por saktësinë e numrit të tyre e din vetëm All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).


- Sa janë Pejgamberët e përmendur në Kur'an?

Pejgamberët e përmendur me emër në Kur'an janë njëzet e pesë. Ato janë: Ademi, Idrisi, Nuhu, Hudi, Salihu, Ibrahim, Isma'ili, Is'haku, Luti, Shu'ajbi, Ja'kubi, Jusufi, Ejjubi, Dhulkifli, Junusi, Musai, Haruni, Iljasi, Eljesa'i, Davudi, Sulejmani, Zekerijja, Jahja, 'Isai dhe Muhammedi.

Ndërsa ka disa emra prej tyre, për të cilët dijetarët kanë diskutuar, nëse kanë qenë Pejgamberë apo jo. Ato janë: Dhulkarejni, Lukmani, 'Uzejri dhe Tubba'i. Për Tubba'in dhe Dhulkarnejin, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk e di nëse kanë qenë Pejgamberë apo jo". Ndërsa për Lukmanin dhe 'Uzejrin, dijetarët më shumë kanë thënë se nuk kanë qenë Pejgamberë. All-llahu e din më së miri.

Gjithashtu, për 'Hidrin¹¹⁶, i cili është i përmendur në Kur'an me rastin e tij, por nuk është i përmendur me emrin e tij, dijetarët kanë diskutuar, nëse ka qenë Pejgamber apo jo. Ajo që mendojmë se është më afër, është se 'Hidri (*'alejhis-selam*) ka qenë Pejgamber dhe këtë e vërtetojnë disa argument. Prej tyre:

1. 'Hidri e mbyti një djalosh dhe tha:

 وَأَمَّا الْغُلَامُ فَكَانَ أَبَوَاهُ مُؤْمِنَيْنِ فَخَشِينَا أَنْ يُرْهِقَهُمَا طُغْيَانًا وَكُفْرًا

"Sa i përket djaloshit, prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e denim se (dashuria për të) do t'i çonte ata në të keqe dhe mohim." (El-Kehf: 80)

Dhe pa dyshim, nuk e diti këtë, përveç se prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ngase nuk e din të ardhmen askush, përveç asaj që All-llahu ua ka treguar Pejgamberëve të tij.

2. Gjithashtu, në fund, kur 'Hidri iu drejtua Musait (*'alejhis-selam*), tha:

¹¹⁶ 'Hidri është shoqëruesi i Musait (*'alejhis-selam*), ngjarjen e të cilit All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e tregoi në Kur'an. Shih Sura-n El-Kehf: 65-82.

... وَمَا فَعَلْتُهُ عَنْ أَمْرِي ...

“Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim!” (El-Kehf: 82)

Dijetarët kanë thënë: Atë e ka bërë prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Dhe disa argument tjera, të cilat tregojnë se 'Hidri (*'alejhis-selam*) ka qenë Pejgamber i All-llahut.

Gjithasht, në *hadith*-e të vërteta është përmendur edhe një Pejgamber tjetër. Ai është: *Jusha' ibnu Nuni* (*'alejhis-selam*). Ky jetoi në kohën e Musait (*'alejhis-selam*), dhe pas Musait (*'alejhis-selam*), u urdhërua që ta çlironte një vend të shenjtë me ushtrinë e tij, për të cilin, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ndali diellin. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Nuk është ndalur dielli, përveç se për *Jusha' ibnu Nunin*”. *Jusha' ibnu Nuni* e kishte që ta çlironte vendin, para se të perendonte dielli. Kur erdhi momenti që të perendonte dielli, tha: “O diell, ti je i urdhëruar, por edhe unë jam i urdhëruar, ndalu deri sa ta çoj në vend urdhërin e All-llahut”. Atëherë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ndali diellin dhe kështu *Jusha' ibnu Nuni* e çliroi atë vend.

- Cili është dallimi ndërmjet Nebijj dhe Rasul?

Ka Pejgamberë të cilët janë *Embija*, që njëjisi i tyre është: *Nebijj* (Pejgamber), dhe ka Pejgamberë të cilët janë *Rusul*, që njëjisi i tyre është *Rasul* (i Dërguar).

Ndërmjet këtyre Pejgamberëve ka një dallim. Dallimi i tyre është se, ai i cili është *Rasul*, vjen me ligj (*Sheri'at*) të All-llahut, i cili *Sheri'at* për atë popull është i ri, ndërsa ai i cili është *Nebijj*, vjen dhe e vazhdon *Sheri'atin* e atij i cili ka qenë më herët. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “*Rasuli i parë është Nuhu*”. Dhe kështu erdhi Musai (*'alejhis-selam*) me Tevratin, e pastaj, pas tij erdhën shumë Pejgamberë dhe vazhduan duke punuar me Tevratin, si ligj për popullin e tyre dhe jo me *Sheri'at* të ri. Për shembull, erdhi Zekerijja (*'alejhis-selam*) dhe vazhdoi me Tevratin, erdhi Jahja (*'alejhis-selam*) dhe vazhdoi me Tevratin, e kështu me radhë. Këta, pra, janë në kategorinë e Pejgamberëve të cilët quhen *Embija-Nebijj*, ndërsa ata që vinë me ligj (*Shri'at*) të ri për një popull, ata quhen *Rusul-Rasul*.

- A janë të gjithë Pejgamberët në një shkallë?

Pejgamberët e All-llahut, në pejgamberllëkun e tyre, të gjithë janë të barabartë, gjithë janë njerëz dhe gjithë janë Pejgamberë. Por, pastaj All-llahu i dalloi dhe i ngriti disa mbi disa të tjerë. All-llahu (*subhaehu ve te'ala*) thotë:

﴿ تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ ... ﴾

“Nga këta të Dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët.” (El-Bekarah: 253)

Pejgamberët që janë *Rusul* janë në një shkallë më të lartë se ata që janë *Embija*. E pastaj, edhe në mesin e tyre ka dallime. Disa All-llahu i ngriti më shumë dhe i quajti: *Ulul 'Azm*. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

﴿ فَأَصْبَرَ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ ... ﴾

“Prandaj, ti (o Muhammed) bëhu i durueshëm, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur (Ulul-'Azmi).” (El-Ahkaf: 35)

Ulul 'Azmi janë pesë Pejgamberë: *Nuhu, Ibrahim, Musai, 'Isai* dhe *Muhammedi*.

Në mesin e *Ulul 'Azmit*, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i dalloi dy Pejgamberë dhe i quajti: *Halilull-llah* (të dashurit-miqtë e All-llahut). Ato janë: *Ibrahimi* dhe *Muhammedi*.¹¹⁷ Dhe prej këtyre dyve, më i dalluar është *Muhammedi* (*sal-lall-llau 'alejhi ve sel-lem*). Pejgamberi (*sal-lall-llau 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Unë jamë zotëriu i gjithë bijëve të Ademit dhe për këtë nuk ka mburrje”.¹¹⁸ All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e nderoi Pejgamberi tonë, *Muhammedin* (*sal-lall-llau 'alejhi ve sel-lem*), dhe e bëri njeriun më të zgjedhur prej të gjithë njerëzve dhe prej të gjithë Pejgamberëve.

Në disa transmetime, Pejgamberi (*sal-lall-llau 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: “Mos më ngritni mbi *Junusin*”.¹¹⁹ Në disa transmetime tjera: “Mos më ngritni mbi Pejgamberët e All-llahut”. Për këtë, disa prej dijetarëve kanë thënë: Këtë e ka thënë prej modestisë që e ka pasur (nuk ka dashur ta ngrejë veten prej modestisë). Disa dijetarë tjerë kanë thënë: E ka ndaluar Pejgamberi (*sal-lall-llau 'alejhi ve sel-lem*) me e ngritë atë, duke e nënçmuar një Pejgamber tjetër.

¹¹⁷ Transmeton Nesaiu - Nga Xhundubi.

¹¹⁸ Transmeton Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh - Nga Ebu Hurajrah.

¹¹⁹ Transmeton Bu'hariu dhe Ebu Davudi - Të gjithë nga Ebu Hurajrah dhe Ibn Abbasi.

**** Mu'xhize-t ****

- Çka janë mu'xhize-t?

Mu'xhize-t janë gjëra të jashtëzakonshme, mrekullira, të cilat nuk mund të ndodhin vetëm se me lejen e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), që Ai ua dha Pejgamberëve të Tij, për t'ua ngritur njerëzve argumentet. Edhe pse argumentet që i ngritnin Pejgamberët ishin bindëse dhe të mjaftueshme, por All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), me mëshirën dhe urtësinë e Tij, u dha Pejgamberëve mrekulli, që ato mrekulli, t'i shihnin njerëzit me sytë e tyre, që kur t'i shihnin, të bindeshin edhe më shumë, se ata vërtetë ishin Pejgamberë të All-llahut.

Këto mrekulli, që janë të njohura si *mu'xhizeh*, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Kur'an i ka quajtur edhe *ajet-e* (argumente).

- Çfarë mrekulli kishin Pejgamberët?

Mrekullitë e Pejgamberëve, të cilat janë të njohura si *mu'xhizeh*, apo të cilat All-llahu në Kur'an i ka quajtur *ajet-e*, nuk ishin të njejta te të gjithë Pejgamberët, por secili Pejgamber e pati mrekullinë e përshtatshme në vendin dhe popullin e tij. Për shembull, Musai (*'alejhis-selam*) e pati mrekulli *Dorën*, të cilën kur e nxirrte, bënte dritë (shkëlqente); dhe e pati mrekulli *Shkopin*, të cilin kur e hidhte, shëndrrohej në gjarpër të gjallë. Këtë mrekulli, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ia dha Musait (*'alejhis-selam*), sepse në atë kohë ishte përhapur me të madhe magjia (*sühr-i*) dhe e zhduki atë nëpërmejt shkopit.

Pra, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), Pejgamberëve të Tij u dha mrekulli, për secilin në kohën e tij. Dhe shumë prej tyre All-llahu i ka përmendur në Kur'an, që t'i bindë me ato njerëzit, se ata (Pejgamberët) vërtetë janë Pejgamber të All-llahut. All-llahu (*subhanehu ve*

te'ala), Salihut ('alejhis-selam) ia dhe mrekulli Deven, e cila doli nga ai shkëmbi (guri) i madh e gjallë, për të cilën All-llahu (subhanehu ve te'ala) tha:

... هَذِهِ نَاقَةُ اللَّهِ لَكُمْ آيَةٌ ...

"Kjo është deveja e All-llahut, shenjë e qartë për ju ..." (Hud: 64)

dhe e cila jetoi një kohë së bashku me popullin, deri sa ata e mbytën dhe All-llahu (subhanehu ve te'ala) e shkatërroi këtë popull.

All-llahu (subhanehu ve te'ala) tjetër mrekulli i dha Ibrahimit ('alejhis-selam), për të cilin, gjithë atij zjarrit të madh, i tha:

قُلْنَا يَنَّا نُكُونِي بَرْدًا وَسَلَامًا عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ ﴿٦٩﴾

"O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!" (El-Enbija: 69)

dhe gjithë ai zjarrë i madh nuk i bëri asgjë Ibrahimit ('alejhis-selam).

Gjithashtu, All-llahu (subhanehu ve te'ala) i dha mrekulli 'Isait ('alejhis-selam), i cili tha:

... أَنِّي أَخْلَقُ لَكُمْ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ وَأُبْرِئُ

الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ وَأُحْيِي الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ اللَّهِ وَأُنَبِّئُكُم بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ فِي

بُيُوتِكُمْ ...

"Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj (që vërtetojnë Profecinë time): për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e All-llahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e All-llahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë keni në shtëpitë tuaja." (Ali 'Imran: 49)

Dhe Vula e Pejgamberëve, Muhammedi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), i cili pati shumë mrekulli. Atij i kërkuan mushrikët e Mekkes dhe thanë: "Nëse je Pejgamber i All-llahut, le të ndahet hëna në dy pjesë!" Atëherë Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e luti All-

llahun (*subhanehu ve te'ala*) dhe hëna u nda në dy pjesë.¹²⁰ All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

أَقْرَبَتِ السَّاعَةُ وَأَنْشَقَّ الْقَمَرُ ﴿١﴾

"U afrua Ora dhe u ça hëna!" (*El-Kamer: 1*)

Dhe mrekulli tjera prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Gishtat e tij rrjedhë ujë, që pinë Sahabet.¹²¹ Pasjtaj, prej tij, prej një ushqimi sa për tre apo katër vetë, u ushqyen gjithë ushtria e tij dhe mbeti përsëri.¹²² Për Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e dëgjuan të qajturit e drurit edhe Sahabet. Druri, në të cilin hypte Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe i mbante 'hutbe-t, qajti dhe e dëgjuan zërin e tij (të drurit) edhe Sahabet, kur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ndërroi atë dhe doli në një 'hutbeh tjetër.¹²³ Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) thoshte: "I shikoj disa gurë, të cilët më kanë dhënë selam në Mekkeh, ende pa qenë Pejgamber".¹²⁴

Megjithatë, mrekullia më e madhe e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e cila nuk vdes kurrë, edhe pse Pejgamberi i All-llahut ka vdekur, është Kur'ani famëlartë, fjala e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

¹²⁰ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Ahmedi - Nga Enes ibn Malik.

¹²¹ Transmeton Bu'hariu - Nga Enes ibn Malik.

¹²² Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah ose Ebu Se'id El-'Hudrijju (transmetuesi dyshon se cili prej këtyre dyve e ka transmetuar).

¹²³ Transmeton Bu'hariu - Nga Xhabir ibn 'Abdull-llahu.

¹²⁴ Transmeton Muslimi - Nga Xhabiri.

**** Keramet-et ****

- Çka janë keramet-et?

Keramet-et janë gjëra të jashtëzakonshme që nuk i bëjnë njerëzit. Del prej asaj që ne jemi mësuar t'i shohim. Në raste të veçanta, ndodhë diçka e çuditshme te dikush prej njerëzve. Për shembull, një dijetarë e kanë lënë në burg dhe nuk i kanë dhënë për të hëngër dhe për të pirë një kohë të gjatë, e kanë lënë të vdesë, ndërsa kur kanë shkuar pas disa muajve, e kanë gjetur të gjallë dhe ia kanë gjetur ushqimet përreth. Apo, një dijetarit tjetër ia kanë futur luanin në vendin ku ka qëndraur ai dhe e kanë lënë deri kur të shkojnë më vonë për t'ia marrur eshtrat, ndërsa kur kanë shkuar, e kanë gjetur atë (dijetarin) duke u falur dhe luani duke u sillur përreth tij dhe duke e ruajtur atë. Dhe shumë raste tjera.

- Si i besojmë keramet-et?

Dijetarët e *Ehli Sunnet-it* thonë: Ne i besojmë *keramet-et*, por dallohemi prej grupeve të devijuara.

Disa prej gupeve të devijuara, sikur sufitë dhe disa të tjerë, nëse dikujt i ndodhë diçka e çuditshme, ato i thonë atij *evlija*, e bëjnë të shenjtë dhe e adhurojnë atë. Disa të tjerë i mohojnë të gjitha *keramet-et* dhe thonë se këto nuk ndodhin fare.

Ehli Sunnet-i janë mesatarë. Themi: *Keramet-et* ndodhin te muslimanët e mirë, te ata të cilët janë të sinqertë dhe të devotshëm ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ndodhin dhe ata njerëz ne nuk i shenjtërojmë.

Disa prej *keramete*-ve All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka përmendur në Kur'an. Te Merjemeja, nëna e 'Isait ('*alejhis-selam*), kur hynte Zekerijja ('*alejhis-selam*), shihte tek ajo *keramet-e* dhe thoshte:

... يَمْرِيْمُ اَنْى لِكْ هَذَا قَالَتْ هُوَ مِنْ عِنْدِ اللّٰهِ اِنَّ اللّٰهَ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿١٧﴾

"... "Oj Merjem! Nga të vjen ky ushqim?" Ajo përgjigjej: "Ky është nga All-llahu, se All-llahu e furnizon kë të dojë, pa kufi"." (Ali 'Imran: 37)

Merjemeja ('*alejhes-selam*) nuk ishte Pejgambere, por kjo ishte *kerameh*, me të cilën e nderoi All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Apo rasti i banorëve të shpellës, të cilët fjetën në shpellë treqind e nëntë vite dhe nuk u kalbën fare. Dhe shumë raste tjera të përmendura në Kur'an. E pastaj, edhe në kohën e Sahabeve dhe shekuj pas shekuj, deri në kohën e sodit, ndodhin *keramet-e*, gjëra të çuditshme, të cilat nuk ndodhin në jetën e përditshme.

Dijetarët kanë thënë: Me këtë, All-llahu ose e ndihmon një rob i cili ka nevojë; ose ka raste ku ka nevojë t'u ngritet argumenti dhe t'i luftojë me ata armiqët e All-llahut, dhe All-llahu e ndihmon këtë rob kundër armiqëve të Tij.

Pra, *keramet-et* ekzistojnë dhe ne i besojmë ato ashtu siç i beson *Ehli Sunnet-i*.

Kapitulli i katërt:

BESIMI NË LIBRAT

**** Librat e zbritura ****

- Cilët janë Librat e zbritura?

Librat e zbritura, të cilat janë të përmendura në Kur'an, janë: Libri që i zbriti Musait ('alejhis-selam), i cili quhet *Tevrat*; Libri që i zbriti Davudit ('alejhis-selam), i cili quhet *Zebur*; Libri që zbriti 'Isait ('alejhis-selam), i cili quhet *Inxhil*; dhe libri i fundit, që i zbriti Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili quhet *Kur'an*.

Gjithashtu, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka përmendur edhe *Fletushkat* (broshurat) që ia ka zbritur Ibrahimit ('alejhis-selam). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

بَلْ تُؤْتِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿١٦﴾ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى
صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٨﴾

"Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndërsa jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar. Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta, në Fletët e Ibrahimit dhe Musait." (El-A'la: 16-19)

Këto janë ato që janë përmendur në Kur'an, ndërsa ka edhe Libra tjera, të cilat All-llahu nuk i ka përmendur në Kur'an.

- Si i besojmë Librat e zbritur?

Besimi në Librat është kusht i *imani*-t. Nëse dikush nuk e beson ndonjë prej librave të All-llahut, nuk llogaritet musliman.

Ne obligohemi t'i besojmë të gjitha Librat. All-llahu (*subhaehu ve te'ala*) thotë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا ءَامِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ءَ وَالْكِتَابِ الَّذِي نَزَّلَ عَلَىٰ رَسُولِهِ ءَ وَالْكِتَابِ
الَّذِي أُنزِلَ مِن قَبْلُ ءَ ...

"O besimtarë! Besoni All-llahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë." (*En-Nisa': 136*)

E besojmë Tevratin, jo këtë që është në këtë kohë, të cilin e quajnë "Dhjata e vjetër", i cili është libër i jehudëve, por e besojmë atë që e ka zbritur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). E besojmë Inxhilin, jo këtë që është në këtë kohë, të cilin e quajnë "Dhjata e re", i cili është libër i krishterëve, por e besojmë atë që e ka zbritur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

Krishterët dhe jehudët i ndryshuan fjalët e All-llahut dhe i formuan *ajet*-et sipas qejfit dhe dëshirave të tyre, dhe nuk e lanë ashtu siç e zbriti All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Tevratit dhe Inxhilit që janë në këtë kohë, nuk janë gjithë gënjeshtër. Dijetarët kanë thënë: Edhe tek ato që janë sot, ka diçka të vërtetë. Ajo që përputhet me Kur'ain, ajo është e vërtetë, ajo që kundërshtohet me Kur'anin, ajo nuk është e vërtetë.

Pra, i besojmë Tevratin dhe Inxhilin që i ka zbritur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), ndërsa ato që janë sot, nuk i besojmë të tërat si libra të shnjta të All-llahut. I besojmë të gjitha librat që i ka zbritur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), dhe besojmë që të gjitha ato janë të vërteta dhe të sakta dhe në të cilat nuk ka kundërthënie në to, ndërsa nuk i besojmë librat e ndryshuara nga dora e njëjërëve.

- Pse ndryshuan librat e mëparshëm?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ تَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا لِلَّذِينَ هَادُوا
وَالرَّبَّانِيُّونَ وَالْأَحْبَارُ بِمَا اسْتَحْفَظُوا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ وَكَانُوا عَلَيْهِ شُهَدَاءَ ...

"Ne e dërguam Tevratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, Profetët që ia kishin dorëzuar veten All-llahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të All-llahut, për të cilin ata dëshmonin." (El-Maideh: 44)

Domethënë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ua la Tevratin amanet njerëzve, që ata ta ruanin atë, ndërsa ata i ndryshuan fjalët e Tij dhe i ndryshuan në libra tjerë, sipas dëshirave të tyre.

Në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e urdhëroi Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe tha:

وَلِيَحْكُمَ أَهْلُ الْأَنْبِيَاءِ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فِيهِ ...

"Le të gjykojnë ithtarët e Inxhilit ashtu siç ka shpallur All-llahu në të." (El-Maideh: 47)

Por, ata nuk gjykonin dhe e fshihnin atë që e ka zbritur All-llahu. E All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

يَأْهَلِ الْكِتَابِ لِمَ تَلْبُسُونَ الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ وَتَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

"O ithtarët e librit! Përse e përzieni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?" (Ali 'Imran: 71)

Kështu ndodhi kur jehudët deshtën të gjykohen te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), për zina-në që e bëjnë njerëzit e martuar¹²⁵. Jehudët e ndryshuan këtë ligj, i cili ishte mbytje me gurëzim dhe thanë: "Do t'ia vendosim një shenjë të zezë në fytyrë, që të gjithë ta dallojnë se është zinaqarë, por nuk do ta mbysim!" Atëherë dy persona thanë: "Do të shkojmë dhe do të gjykojmë te Muhammedi; nëse nuk na gjykon me vdekje, atëherë para All-llahut do të themi se jemi gjykuar te një Pejgamber i Yti!" Shkuan te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe thanë: "Nëse dy persona të martuar bëjnë zina, si i gjykon feja jote?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Po si e keni atë në Tevrat?" Thanë: "Në Tevrat është: t'u vëndohet nga një shenjë në fytyrë dhe jo të mbyten!" Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ju tha që ta hapnin dhe ta lexonin Tevratin. Ata filluan ta lexonin dhe e vendosën dorën mbi atë ku All-llahu

¹²⁵ Nëse dy njerëz të martuar bëjnë zina, Sheri'ati Islam për ta thotë se duhet të gurëzohen deri në vdekje. Ky ligj ishte edhe në Tevrat.

thonshte që duhet të gurëzohen me gurë. Afër Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ishte 'Abdull-llah ibn Selami, i cili më herët kishte qenë dijetarë i jehudëve, por pastaj e pranoi Islamit, dhe tha: "O i Dërguari i All-llahut, thuaj le ta heqë dorën". Dhe kur ia hoqi dorën, e pa se aty shkruante se ata të martuar që bëjnë *zina*, duhet të gurëzohen. Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i gjykoi ata dhe i dënoi me gurëzim.

Pra, librat e mëparshëm ndryshuan, ngase ato All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i la në dorën e njerëzve, që njerëzit të sprovoheshin dhe të shiheshin se sa do të jenë besnik në ruajtjen e tyre.

- Si u ruajtë Kur'anit nga ndryshimet?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), Kur'anin nuk e la në dorën e njerëzve, por thotë:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿٩﴾

"Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë." (El-Hixhr: 9)

Pra, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e mori përsipër ruajtjen e Kur'anit. Pastaj i dërgoi shkaqet, dhe në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), njerëzit e mësonin Kur'anin përmendësh dhe e shkruanin atë *ajet-e ajet-e*. Dikush e shkruante nëpër lëkura, dikush nëpër lëvozhga të drunjëve, dikush nëpër vende tjera dhe kështu, në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), u regjistrua Kur'anit. Kur vdiq Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në kohën e Ebu Bekrit, me insistimin e 'Umerit (*radijall-llahu 'anhuma*), e thirrën Zejd ibn Thabitin (*radijall-llahu 'anhu*) dhe e shkruajtën Kur'anin të tërën (komplet) në një *Mus'haf*. Pastaj, në kohën e 'Uthmanit (*radijall-llahu 'anhu*), u bënë edhe disa kopje dhe u shpërndajtën nëpër disa vende tjera. Dhe kështu muslimanët e ruajtën Kur'anin, brez pas brezi, shekull pas shekulli, saqë sot, edhe nëse zgjohen gjithë jomuslimanët për ta ndryshuar edhe një shkronjë të Kur'anit, ngriten me miliona fëmijë që e dinë Kur'anin përmendësh, e mos të flasim për njerëzit e rritur dhe për dijetarët.

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ruajti Kur'anin, prej kohës së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e deri në këtë kohë, edhe pse armiqët e All-llahut janë munduar në lloj lloj mënyra për ta ndryshuar fjalën e Tij dhe kurrë nuk kanë pasur mundësi të arrijnë në

atë që All-llahu e ka marur përsipër, dhe sot, thuaj se nuk ka vend që nuk ekzistojnë Kur'ana të shkruar apo të inçizuar në kokat e njerëzve. Dhe kështu do të ruhet fjala e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) deri në Ditën e Gjykimit.

Kapitulli i pestë:

BESIMI NË RINGJALLJEN

**** Jeta në varreza (Berza'h-u) ****

- Çka është jeta e Berza'h-ut?

Njeriu kalon nëpër disa jetë (botëra). Një herë në barkun e nënës, pastaj kalon në këtë dunja dhe jeton në një periudhë aq sa All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka caktuar për të, pastaj vdes dhe jeton në varreza, e pastaj ringjallet prej varrezave dhe del në botën tjetër (në A'hiret), para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Berza'h don të thotë: perde, diçka ndërmjet, e cila të pengon.

Berza'h-u është jeta në varreza, jeta ndërmjet kësaj dunjaje dhe A'hiretit (botës tjetër). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَمِنْ وَرَائِهِمْ بَرْزَخٌ إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ ﴿١٠٠﴾

"Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse (Berza'hun), deri në ditën kur do të ringjallen." (El-Mu'minun: 100)

- A do t'i shpëtojë dikush vdekjes?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ... ط

"Çdo njeri do ta provojë vdekjen ..." (El-Ankebut: 57)

Secili, çdo *nefs* (shpirtë) do ta shijojë vdekjen, njeri apo xhinn, qofshin ata edhe Pejgamber të All-llahut. Nuk ka asnjë Pejgamber të All-llahut i cili nuk ka vdekur, përveç 'Isait ('*alejhis-selam*), i cili është në qiell, por që edhe ai një ditë do të vijë në tokë dhe përsëri do të vdesë. Edhe Vula e Pejgamberëve, Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), njeriu më i mirë, edhe ai kaloi prej kësaj dunjaje dhe e shijoi vdekjen¹²⁶. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) tha:

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ ...

"Muhammedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të Dërguar të tjerë." (Ali 'Imran: 144)

që don të thotë: "të gjithë Pejgamberët kanë vdekur, e edhe Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) do të vdesë". Dhe All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i tha:

إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَيِّتُونَ

"Sigurisht që ti (o Muhammed) do të vdesësh një ditë, e sigurisht që edhe ata do të vdesin." (Ez-Zumer: 30)

Vdekja është prej atyre që nuk mund të shpejtohet dhe që nuk mund të vonohet. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ أَجَلٌ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا يَسْتَأْخِرُونَ سَاعَةً وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ

"Çdo popull ka afatin (*exhel-in*) e vet, e kur t'u vijë afati (*exhel-i*) atyre, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast, dhe as nuk mund ta shpejtojnë."¹²⁷ (El-A'raf: 34)

¹²⁶ Ka prej njerëzve, të cilët thonë se nuk duhet thënë: "Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka vdekur", por se duhet thënë: "Ai ka ndërruar jetë". Ndërsa, në realitet, nuk prishë punë edhe nëse thuhet: "Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka vdekur". Ndërsa *Sunneti* i tij, emir i tij, pasimi i rrugës së tij, të gjitha këto janë gjallë dhe nuk përfundojnë. Por ai (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), si njeri, ka vdekur ashtu siç vdesin të gjithë njerëzit.

¹²⁷ Për fat të keq, shumë njerëz mendojnë dhe thonë: "Sikur të kishte qenë kështu, do të kishte ndodhur kështu", "sikur mos të kishte qenë kështu, nuk do të kishte ndodhur kështu", etj., ndërsa kur vjen *exhel-i* (afati i caktuar), kudo që të jeshë dhe çkado që të bësh, ai është i caktuar prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) dhe ndodhë patjetër.

- Si i merret njeriut shpirti?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Kush e don takimin me All-llahun, All-llahu e don takimin me të, dhe kush e urren takimin me All-llahun, All-llahu e urren takimin me të". A'isheja (*radijall-llahu 'anha*) tha: "O i Dërguari i All-llahut, po nëse ne e urrejmë vdekjen, a don të thotë kjo se ne e urrejmë takimin me All-llahun?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Jo, por kjo është në momentin e fundit, kur njeriut i vjen vdekja, ai atëherë më e sheh se për ku është vendi i tij".¹²⁸

Nëse njeriut i vinë melaiket me të mirë dhe i thonë: "**O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar!**" (*El-Fexhr: 27-28*), ai njeri e don takimin me All-llahun. Ndërsa atij të cilit i thuhet: "**O ti shpirt i keq! Kthehu te Zoti yt i hidhëruar!**", ai njeri e urren takimin me All-llahun. Dhe kështu fillon vdekja e tij, kalimi i tij prej kësaj bote në botën tjetër.

Kjo është një sprovë e madhe dhe e vështirë, e cila ka dhimbje të mëdhaja, saqë edhe Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), njeriu më i mirë, Vula e Pejgamberëve, në momentet e vdekjes, thoshte: "**LA ILAHE IL-LALL-LLAH, vërtetë vdekja i ka dhimbjet e veta**".¹²⁹

Ky moment, vërtetë është shumë i vështirë dhe i dhimbshëm, të cilin do ta shijojë çdokush.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nëse njeriu është i mirë, i vijnë melaiket dhe e thërrasin atë me të mirë, dhe del shpirti i tij në një formë shumë të lehtë". Ndërsa nëse është i keq (apo nëse nuk është musliman), Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kur e sheh gjendjen e tij, fundin e tij, atëherë shtrëngohet shpirti në trup që mos të del dhe ia nxjerrin shpirtin me zor, sikur që njeriu e nxjerrë një dru me gjemba prej leshit të lagur".¹³⁰

Kështu njeriu vdes, e pasi vdes, atëherë kalon në një procedurë tjetër, e cila vijon me shpirtin e tij. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nëse është i mirë, ia shtrojnë një shtroje të Xhennetit, ia veshin petkat e Xhennetit, e parfymosin me parfym të Xhennetit dhe e marrin melaiket për ta ngritur në qiell. Melaiket nëpër qiell bëjnë pyetje dhe thonë: "Kush është ky njeri që i vjen kaq erë e mirë?" Melaiket thonë: "Ky është filani i biri i filanit!" dhe e thërrasin me emrat më të mirë që e kanë thirrur në dunja. Ngritet në qiellin e

¹²⁸ Transmeton Tirmidhiu - Nga A'isheja dhe Enes ibn Maliku, e ky nga Ubadeh ibn Samiti.

¹²⁹ Nga A'isheja.

¹³⁰ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi - Nga Bera' ibn 'Azib.

shtatë dhe regjistrohet në librin 'Il-lij-jin (i cili është libri i njerëzve të mirë). Pastaj kthehet në tokë dhe vazhdon jetën e tij në varreza. Ndërsa, nëse njeriu nuk është i mirë, e marin melaiiket, ia shtrojnë shtrojet e Xhehennemit, e veshin me petka të Xhehennemit dhe e marrin për ta ngritur në qiell. Melaiiket e qiellit bëjnë pyetje dhe thonë: "Kush është ky shpirtë kaq i keq, që i vjen kaq erë e rëndë?" Melaiiket thonë: "Ky është filani i biri i filanit!" dhe e thërrasin me emrat më të këqinj që e kanë thirrur në dunja. Kur arrinë në qiellin e parë të kësaj dunjaje, kërkojnë që të hapet qielli, ndërsa atyre nuk u hapet dera e qiellit. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ أَجَلٌ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا يَسْتَأْخِرُونَ سَاعَةً وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ

"Me të vërtetë, atyre që i mohuan shpalljet Tona me mendjemadhësi, nuk do t'u hapen dyert e qiellit dhe as që do të hyjnë në Xhennet, deri sa të kalojë deveja nëpër vrymën e gjilpërës. Kështu i ndëshkojmë gjynahqarët." (El-A'raf: 40)

Pastaj hudhet në tokë dhe regjistrohet në librin Sixh-xhin (i cili është libri i njerëzve të këqinj)" .¹³¹

- Cilat janë shpërblimet në varreza?

'Akide-ja e Ehli Sunnet-it thotë: Njeriu në varreza ka shpërblim dhe ka dënim, varrësish prej njeriut dhe varrësisht prej punëve të tij që i ka bërë në dunja.

Shpërblimi është ashtu siç e përmendëm më parë, se i shtrohet një shtroje e Xhennetit, vishet me petka të Xhennetit dhe parfymoset me parfym të Xhennetit. Pastaj i hapet një derë e Xhennetit dhe një derë e Xhehennemit dhe i thuhet atij: "A e sheh këtë derën e Xhennetit, ky është vendi në të cilin do të jeshë më vonë". Dhe i thuhet: "A e sheh këtë derën e Xhehennemit, ky është vendi yt, nëse ty do t'i kishe bërë gjunah All-llahut". Pastaj ky njeri thotë: "O Zot, bëre Kijametin!" .¹³²

Gjithashtu, All-llahu (subhanehu ve te'ala), kur flet për Shehidët, thotë:

وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَاتًا بَلْ أَحْيَاءٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ

¹³¹ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi - Nga Bera' ibn 'Azib.

¹³² Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi - Nga Bera' ibn 'Azib.

"Kurrresi mos i quani të vdekur ata që jan vrrarë në rrugën e All-llahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti ityre." (Ali 'Imran: 169)

- Cilat janë dënimet në varreza?

Sikur ata të mirët që kanë shpërblim, gjithashtu edhe ata të këqinjët kanë dënim në varrin e tyre. Sipas 'akide-s së Ehli Sunnet-it, njerëzit në varreza dënohen.

Ata që e kanë hidhëruar All-llahun, ata që i kanë marrur nëpër këmbë urdhërat e All-llahut, ata që në dunja nuk e kanë njohur All-llahun, ata që kanë harruar se një ditë do të vdesin, ata që kanë harrua se varri do të jetë vendbanim i tyre, ata do të kenë dënim në varreza, para se të ringjallen para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Që në fillim, atyre ju shtrohet shtroje e Xhehennemit, vishen me petka të Xhehennemit. Gjithashtu, edhe këtyre ju hapet nga një derë. Ju hapet dera e Xhehennemit dhe ju thuhet: *"Ky është vendi që ju do të qëndroni pastaj!"* Dhe ju hapet një derë e Xhenetit, ku e shohin Xhenetin dhe ju thuhet atyre: *"Ky është vendi juaj, sikur ju ta kishit fituar atë"*.¹³³ E pastaj kalojnë nën dënimin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), duke qenë në varreza.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), duke kaluar rruhës, ku i pa dy varre, tha: *"Këta të dy dënohen në varreza dhe nuk dënohen për diçka shumë të madhe"*¹³⁴! Njëri prej tyre, kur e ka kryer nevojën, është stërpikur, duke mos qenë i kujdesur fare; ndërsa tjetri është marrur me nemime: i ka bartur fjalët ndërmjet muslimanëve, për t'i prishur ata mes vete".¹³⁵

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), kur e bëri një udhëtim me melaiket, të cilat e morën atë, e pa një njeri i cili ishte shtrirë për toke dhe një tjetër i cili ia çkyente fytyrën: ia çkynte nga njërën anë, e kur dilte nga ana tjetër, pjesa e parë iu drejtonte dhe kështu vazhdonte dënimin me të! Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: *"Kush është ky njeri?"* I thanë: *"Ky është ai i cili ka përhapur gënjeshtër ndërmjet njerëzve"*. Gjithashtu, e pa një furrë, e cila ishte e gjërë poshtë dhe e ngushtë lartë, dhe i pa burra dhe gra lakuriq, të cilëve ju hynte zjarri prej organeve! Pejgamberi (*subhanehu ve te'ala*) tha: *"Kush janë këta?"* I thanë: *"Këta janë zinaqarët dhe zinaqaret!"* Poashtu, e pa një njeri duke notuar në

¹³³ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi - Nga Bera' ibn 'Azib.

¹³⁴ Që don të thotë se njerëzit do të dënohen për diçka që nuk e kanë llogaritur shumë të madhe, ndërsa në realitet ajo është e madhe.

¹³⁵ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh - Nga Ibn 'Abbasi dhe të tjerë.

një lum prej gjaku, dhe kur afrohej afër, një tjetër nga jashtë e godiste me gurë dhe e shtynte atë edhe më larg, duke e bërë këtë vazhdimisht! Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) tha: "Kush është ky njeri?" I thanë: "Ky është ai i cili është marrur me kamatë".¹³⁶

Dhe dënime tjera, të cilat janë në varreza.

Dënimi në varreza është prej 'akides së Ehli Sunnet-it, i cili ka bazë në Kur'an dhe Sunnet. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

النَّارُ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا^ط وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ أَدْخِلُوا آلَ فِرْعَوْنَ أَشَدَّ

الْعَذَابِ ﴿٤٦﴾

"Ata do të dërgohen para Zjarrit në mëngjes dhe mbrëmje (në jetën e varrit), e kur të arrijë Ora (e Kijametit), do të thuhet: "Hidhni ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!". (Gafir: 46)

- A e ndjen dënimin në varr trupi apo shpirti?

Në dunja, atë të cilën e shijon, qoftë e mirë apo e keqe, më shumë e shijon trupi (për shembull: dhimbjet, sëmundjet, ushqimet, pijet, etj.).

Në varr, dënimin e shijon shpirti.¹³⁷

Ndërsa Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh (rahimehull-llah) thotë: "Ka mundësi që, duke e përjetuar dënimin shpirti, ai (dënim) ta kaplojë edhe trupin e njeriut".

¹³⁶ Transmeton Bu'hariu - Nga Semurate ibn Xhundubi.

¹³⁷ Kjo është përgjigjeja për ata që thonë se nëse njeriu vdes në ujë, apo nëse ai digjet në zjarr, apo nëse atë e han kafsha dhe më nuk egziston as trupi i tyre, çka bëhet me ta, si dënohen ata? Pra, dënimin e përjeton shpirti i tyre.

- A takohen shpirtërat në varreza?

Për këtë çështje, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa dijetarë kanë thënë se njerëzit nuk takohen në varreza; secili qëndron në varrin e tij, secili është i vetmuar, secili e kalon jetën e varrezave, deri kur të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Disa dijetarë tjerë kanë thënë se njerëzit takohen në mes vete, shoqërohen në mes vete dhe e vizitojnë njëri tjetrin.

Ata që mendojnë se shpirtërat takohen në varreza, bazohen në një *hadith*, në të cilin Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Njeriu, kur vdes, takohet me shpirtërat tjerë dhe ata e pyesin: "Si është filani?" Ai ju përgjigjet. Dhe e pyesin: "Po filani?" Ai ju përgjigjet. Dhe kur e pyesin: "Po filani?" Ai (i posavdekuri) thotë: "A nuk ka ardhur ai te ju? Ai ka vdekur para meje!" Atëherë thonë: "Nëse ai ka vdekur para teje, atëherë ai ka kaluar në anën tjetër (ka vdekur si jomusliman)!"¹³⁸

Ata të cilët këtë *hadith* e llogarisin si të vërtetë (*sahih*), thonë se njerëzit në varreza takohen dhe vizitohen në mes vete. Ndërsa ata të cilët këtë *hadith* e llogarisin si të dobët (*daiif*), thonë se njerëzit nuk takohen në varreza. All-llahu e din më së miri.

- A e dinë të vdekurit gjendjen e të gjallëve?

Edhe për këtë çështje, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa dijetarë kanë thënë se ata e dinë se çka bëhet me njerëzit, ata e dëgjojnë edhe atë që e flasin njerëzit, ata i dëgjojnë gjërat e tyre. Disa dijetarë tjerë kanë thënë se të vdekurit nuk dëgjojnë më asgjë, ata janë në një botë krejtësisht tjetër.

Ata të cilët kanë thënë se njerëzit dëgjojnë dhe e dinë se çka bëhet në dunja, kanë thënë se njerëzit i dëgjojnë edhe nallet, kur të tjerët kthehen pasi e varrosin të vdekurin. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kur njerëzit e varrosin të vdekurin, duke u kthyer, i vdekuri i dëgjon edhe nallet e tyre".¹³⁹ Kanë thënë: Atëherë, i vdekuri i dëgjon të gjallët. Kur përfundoi lufta e Bedrit, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ju tha të vdeurve, pas tre ditëve: "A e gjetët atë që ua premtoi All-llahu si të vërtetë (*hakk*)?!" 'Umeri

¹³⁸ Transmeton Nesaiu. *Shej'h Albani* thotë se *hadith*-i është i vërtetë (*sahih*). Ndërsa disa dijetarë tjerë këtë *hadith* e llogarisin si të dobët (*daiif*).

¹³⁹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ibn Malik.

(radijall-llahu 'anhu) tha: "O i Dërguari i All-llahut, a po ju flet këtyre të cilët kanë vdekur?!" Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) tha: "Ata dëgjojnë sikur dëgjoni ju, vetëm se nuk kanë mundësi të përgjigjen". Kanë thënë: Atëherë, të vdekurit dëgjojnë.

Dijetarët tjerë kanë thënë: Jo, të vdekurit dëgjojnë vetëm në raste të caktuara. Të vdekurit nuk dëgjojnë, përveç kur të tjerët kthehen, ata i dëgjojnë nallet. Në rastin kur ju ka folur Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), ky është ras i veçant, që e kanë dëgjuar atë.

Mendimi që mendojmë se është më afër dhe më i saktë, është se të vdekurit nuk dinë se çka bëhet me njerëzit e gjallë. Përveç, nëse dikush vdes afër dhe ju tregon pak për gjendjen e atyre që i ka parë dhe i ka takuar. Ka mundësi të ju tregojë për raste të caktuara, por për të gjithë gjendjen që egziston, atë nuk e din askush, saqë nuk e din edhe Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). Kur njerëzit do të dalin para All-llahut (subhanehu ve te'ala) dhe do të shkojnë te *Havd-i* (kroi) i Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), për të pirë ujë prej tij, do të vijnë njerëzit grupe-grupe, deri sa do të vijnë disa njerëz, të cilët melaiket do t'i kapin dhe nuk do t'i lënë që të pinë ujë, ndërsa Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) do të thotë: "Të ummetit tim, të ummetit tim!" (Në një transmetim tjetër: "Shokët e mi, shokët e mi!") Atëherë melaiket do të thonë: "Ti nuk e din çka kanë vepruar ata pas teje".¹⁴⁰ Përderisa Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) nuk e din se çka kanë bërë të tjerët pas tij, atëherë është më e afërt që edhe të tjerët nuk mund ta dinë se çka bëhet me njerëzit në këtë dunja.

- Ku qëndrojnë shpirtërat e të vdekurve?

Në bazë të argumenteve, shohim se ka dallime ndërmejt shpirtërave të të vdekurive. Disa prej shpirtërave të të vdekurive janë në shkallën më të lartë, në qiellin më të lartë, ku shoqërohen mes vete, e këta janë shpirtërat e Pejgamberëve. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), duke ia dorëzuar shpirtin All-llahut (subhanehu ve te'ala), thoshte: "Jo, unë dua të shkoj në vendin më të lartë".¹⁴¹

¹⁴⁰ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Sehli, 'Abdull-llah ibn 'Amri, A'isheja dhe Ummu Selemeh.

¹⁴¹ Transmeton Bu'hariu - Nga A'isheja.

Shpirtrat e Shehidëve, edhe ata e kanë një vend të caktuar, për të cilët Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Ata shëndrrhen në zogj të gjelbërt dhe shëtisin në Xhennetin e All-llahut kado që dëshirojnë".¹⁴²

Për shpirtërat e njerëzve tjerë, dijetarët kanë thënë se ata, varësisht prej punëve, ashtu gjendet edhe jeta e shpirtërave në verreza. Ashtu është edhe jeta dhe shpirtërat e gjuhahqarëve dhe jomuslimanëve, ashtu siç kemi treguar më parë: disa prej shpirtërave janë në furrë prej zjarri, disa janë në lumin prej gjaku, disa përjetojnë dënime tjera dhe kështu me rradhë.

Pra, shpirtërat e të vdekurive varen prej punëve të tyre që i kanë bërë në dunja dhe vendet e tyre caktohen në bazë të punëve të tyre, edhe pse në fund, të gjithë do të kthehen në varrezat e tyre, e pastaj prej varrezave, do të dalin dhe do të ringjallen para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

¹⁴² Transmeton Muslimi - Nga Mesruki.

**** Kijameti dhe shenjat e tij ****

- Kur do të ndodhë Kijameti?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَلُهَا قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ رَبِّي لَا يُجَلِّئُهَا لَوْقَتًا إِلَّا هُوَ ...

"Ata të pyesin ty (Muhammed) rreth Orës (së Kijametit). Thuaj: "Atë e di vetëm Zoti im. Koha kur do të ndodhë ajo, do ta tregojë vetëm Ai." (El-A'raf: 187)

Gjithashtu thotë:

إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ ...

"Pa dyshim, vetëm All-llahu e di Orën e caktuar (Kijametin)." (Lukman: 34)

Në *hadith*-in e njohur, ku Xhibrili (*'alejhis-selam*) shkoi te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alehi ve sel-lem*) dhe i bëri pyetje për Islamin, *Iman*-in dhe *Ihsan*-in, e pastaj kur e pyeti: "Kur do të ndodhë Kijameti?", Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alehi ve sel-lem*) tha: "Ai që pyetet nuk e din më mirë se ai që bën pyetje".¹⁴³ Që don të thotë, se as Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alehi ve sel-lem*), e as Xhibrili (*'alejhis-selam*), nuk e dinë se kur do të ndodhë Kijameti. E nëse ndodhinë e Kijametit nuk e dinë Xhibrili (*'alejhis-selam*), e as Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alehi ve sel-lem*), çka mbetet për njerëzit tjerë?!¹⁴⁴

¹⁴³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe 'Umer ibnul 'Hattabi.

¹⁴⁴ Për fat të keq, njerëzit flasin dhe paraqesin tema të ndryshme rreth kësaj dite, dhe data të ndryshme, duke menduar që me përparimin e shkencës dhe gjërave të kësaj bote, do të mundohen ta afrojnë dhe ta caktojnë një datë, se kur do të ndodhë Kijameti, por këtë nuk ka mundësi ta dijë askush pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), sado që të përparojë dunjaja. Edhe disa prej dijetarëve, që disa prej tyre janë të njohur, kanë dhënë mendime, të cilat mendime janë të gabuara, edhe pse ato vijnë prej dijetarëve. Dikush prej dijetarëve ka përmendur se nuk do të kalojnë më shumë se pesëqind vite prej ardhjes së Pejgamberit (*sal-*

Pra, se kur do të ndohë Kijameti, atë nuk e din askush pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- Sa lloje janë shenjat e Kijametit?

Shenjat e Kijametit nuk janë të gjitha në një kategori. Disa prej dijetarëve i kanë ndarë ato në dy lloje: *shenjat e vogla* dhe *shenjat e mëdha*. Shenjat e mëdhaja janë përmendur të gjitha në një *hadith*, e përveç atyre, kanë thënë se janë shenja të vogla. Disa dijetarë tjerë i kanë ndarë në tre lloje: *shenjat e vogla*, *shenjat e mesme* dhe *shenjat e mëdha*. E disa pastaj, edhe shenjat e vogla i kanë ndarë dhe kanë thënë: *Shenja të vogla të cilat kanë dalur (kanë mbaruar), shenja të vogla të cilat janë sot (të cilat janë duke dalur dhe ne i shohim ato) dhe shenja të vogla të cilat ende nuk kanë dalur*.

Megjithatë, për të qenë më e lehtë dhe më e thjeshtë, ne do të flasim për shenjat e Kijametit, duke i llogaritur ato vetëm dy lloje: *shenja të vogla* dhe *shenja të mëdha*.

- Cilat shenja të Kijametit kanë dalur?

Ka disa prej shenja të Kijametit të cilat kanë dalur; prej tyre janë:

1. Ardha e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*Jam dërguar unë dhe Kijameti sikur këta dy gishta (gishti i mesëm dhe gishti tregues)*".¹⁴⁵

Kjo është shenjë e Kijametit, ngase Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është Pejgamber i fundit, pas tij më nuk vjen Pejgamber dhe ne jemi *ummet-i* i fundit, e Kijameti do të bëhet te *ummet-i* i fundit. Kjo është një shenjë që Kijameti është afër.

2. Ndarja e hënës në dy pjesë

lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) dhe do të ndohë Kijameti. Dikush tjetër ka përmendur një mijë vite. E dikush tjetër një mijë e pesëqind. Të gjitha mendimet që caktojnë data për ndodhinë e Kijametit, të gjitha janë të gabuara dhe të refuzuara, edhe nëse ato mendime vijnë prej dijetarëve të mëdhenj.

¹⁴⁵ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Sehl ibn Sa'di dhe Enesi.

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

أَقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَأَدْنَقَ الْقَمَرُ ﴿١﴾

"U afrua Ora dhe u ça Hëna." (El-Kamer: 1)

Kjo ndodhi në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).¹⁴⁶

3. Disa fitneh (sprova)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka paralajmëruar për disa *fitneh* (sprova) që do të vijnë në këtë *ummet*. Fitnet filluan prej kohës së 'Uthmanit (*radijall-llahu 'anhu*) dhe vazhduan me kohë deri sot.

4. Dhënia e pozitës atij që nuk e meriton

Një njeru shkoi te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), ndërsa ai ishte duke folur para Sahabeve, dhe i tha: "O i Dërguari i All-llahut, kur do të bëhet Kijameti?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e vazhdoi temën që e kishte. Pastaj Sahabet filluan të diskutonin. Disa menduan se nuk e kishte dëgjuar, ndërsa disa mendonin se e kishte dëgjuar, por nuk kishte dashur t'i përgjigjej. Ai njeriu përsëri bëri pyetje dhe tha: "O i Dërguari i All-llahut, kur do të bëhet Kijameti?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) nuk u përgjigj përsëri. Herën e tretë, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Ku mbeti ai njeriu i cili bëri pyetje për Kijametin?" Ai tha: "Unë, o i Dërguari i All-llahut". Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Kur të humbë emaneti, pritje Kijametin!" I thanë: "Çka është humbja e emanetit?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Kur t'i jepet pozita atij që nuk e meriton, prite Kijametin".¹⁴⁷

Ne të gjithë jemi dëshmitarë për këtë.

5. Paraqitja e policëve dhe zhvoshja e femrave

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka lajmëruar dhe ka thënë: "Do të vijë koha (kah fundi i kohës) dhe do të dalin dy grupe, të cilët janë banorë të Xhehnnemit, e që unë nuk i kam parë: Njëri grupë, janë disa njerëz, të cilët i rrahin njerëzit me kamxhik sikur bishtat e

¹⁴⁶ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Ahmedi - Nga Enes ibn Malik.

¹⁴⁷ Transmeton Bu'hariu - Nga Ebu Hurajrah.

lopës¹⁴⁸; ndërsa grupi tjetër, janë ato gra, të cilat janë të mbuluara të zbuluara. Nuk do të hyjnë në Xhennet, e as që do ta nuhasin erën e tij".¹⁴⁹

6. Përhapja e kamatës

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Në prag të Kijametit, do të përhapet kamata".

7. Përhapja e zinasë

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Do të përhapet zinaja dhe njerëzit do të bëjnë zina rrugëve sikur kafshët".

Për këtë, Imam Kurtubiu (rahimehull-llah), i cili ka jetuar para qindra viteve, ka thënë: "SUBHANALL-LLAH! Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e ka thënë të vërtetën, para sa kohe ka thënë: "do të përhapet zinaja", ndërsa ne e shohim atë me sytë tanë!"

SUBHANALL-LLAH, çka do të kishte thënë Imam Kurtubiu po të jetonte në kohën tonë?! All-llahu na ruajtë.

8. Shtimi i vrasjeve

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Do të shtohen vrasjet, saqë ai i cili e vret dikënd, nuk e din se pse e ka vrarë, dhe ai i cili vritet, nuk e din se pse është vrarë!"¹⁵⁰

9. Krenimi dhe lavdërimi me xhamitë

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Nuk do të bëhet Kijameti, deri sa të vijë koha që njerëzit të lavdërohen dhe të krenohen me shtëpitë e All-llahut (xhamitë)".¹⁵¹

10. Dalja e ëndërrava

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka lajmëruar dhe ka thënë: "Në prag të Kijametit, njerëzve do t'u dalin ëndërrat e vërteta (ashtu siç i shohin)¹⁵². Sa më besnik të jetë njeriu, aq ëndërrat e tij do të jenë më të vërteta. Deri sa, në prag të Kijametit, shumica e ëndërrave do të dalin të vërteta dhe pak prej tyre nuk do të dalin ashtu siç i shohin".¹⁵³

11. Vërsulja e jomuslimanëve kundër muslimanëve

¹⁴⁸ Për këtë grup, dijetarët kanë thënë se janë policët.

¹⁴⁹ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁵⁰ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁵¹ Transmeton Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxheh me zinxhirë të saktë transmetimi - Nga Enesi.

¹⁵² Do t'u ndodhë ashtu siç e kanë parë në ëndërr.

¹⁵³ Transmeton Muslimi, Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Hurajrah.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Do të vërsulen të gjithë popujt kundër muslimanëve, sikur i urituri pranë sofrës së tij!" I thanë: "O i Dërguari i All-llahut, a do të jemi ne pak atë ditë?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Jo, ju atë ditë do të jeni shumë, mirëpo do të jeni sikur shkua e detit. Do t'ju kaplojë juve "vehn"-i (një dobësi e madhe)!" I thanë: "Çka është "vehn"-i, o i Dërguari i All-llahut?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: ""Vehn"-i është: dashuria ndaj dunjasë dhe urrejtja e vdekjes".¹⁵⁴

Dhe shumë shenja tjera, të cilat i shohim me sytë tanë në këtë kohë, për të cilat ka lajmëruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e që nuk kemi mundësi t'i përmbledhim të gjitha ato.

- A kanë mbetur ende shenja të vogla të Kijametit?

Ka ende shenja të vogla të Kijametit të cilat nuk kanë dalur dhe të cilat do të dalin me siguri, përderisa ato i ka përmedur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*); disa prej tyre janë:

1. Shëndërrimi i tokave arabe në kopshte dhe lumenj

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk do të bëhet Kijameti, përderisa Xhezira (toka) arabe do të shëndërrohet në kopshte dhe lumenj".¹⁵⁵

2. Zulimi i një kodre me ari

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Afër Kijametit, do të vijë momenti që lumi Eufrad do ta zbulojë një kodër me ari. Mos iu afroni dhe mos merrni prej saj".¹⁵⁶ Në një transmetim tjetër, ka thënë: "Do të shkojnë njerëzit që ta marin atë pasuri të madhe, në çdo njëqind, do të vriten nga nëntëdhjetë e nëntë".¹⁵⁷

3. Të folurit e kafshëve

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka lajmëruar se, në prag të Kijametit, do të vijë momenti që do të flasin edhe kafshët. Duke qëndruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) me Sahabet, një njeri, i cili ishte çoban (bari), duke i ruajtur delet, erdhi një ujk, e

¹⁵⁴ Transmeton Ebu Davudi dhe Ahmedi - Nga Theubani. Sipas Shej'h Albanit *hadithi është sahih*.

¹⁵⁵ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁵⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

¹⁵⁷ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

kapi një dele dhe filloi të largohej. Ky bariu, për t'i mbrojtur delet, u vërsul dhe e ndali ujkun, dhe ujku e la delen të cilën e kishte kapur. Ujku iu kthye dhe i tha: "O ti filan, a po më ndalon prej rriskut që All-llahu e ka caktuar për mua?!" Bariu, i habitur, tha: "A ka mundësi që edhe kafshët të flasin?!" Ujku i tha: "Po, shko në Medineh te Pejgamberi i All-llahut dhe bëri pyetje për këtë!" Ky bari, shkoi në Medineh te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe ia tregoi rastin që i kushte ndodhur. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i thirri Sagabet dhe kur ata u tubuan, atij bariut i tha: "Tregoju atyre se çka të ka ndodhur". Bariu u tregoi Sahabeve se çka i kishte ndodhur. Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Nuk do të bëhet Kijameti, deri sa të vijë koha që edhe kafshët do t'u flasin njerëzve, edhe shkopi që njeriu e ka në dorë do t'i flet atij, saqë edhe nallet do t'u flasin njerëzve".¹⁵⁸

4. Ardhja e mbretit Xhahxhah

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka lajmëruar dhe ka thënë: "Afër Kijametit, do të vijë një mbret, një sundimtarë i cili quhet: Xhehaxhah, dhe i cili do t'i sundojë njerëzit me fuqinë e tij dhe do t'i drejtojë ata me skopin e tij".

5. Ardha e Imam Mehdiut

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka lamëruar për ardhjen e Imam Mehdiut, të cilin disa dijetarë atë e kanë llogaritur pre shenjave të mesme, për të cilin Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Emri i tij është sikur emri im (Muhammed) dhe emri i babait të tij është sikur emri i babait tim ('Abdull-llah)".¹⁵⁹ Dhe i cili është pasardhës i familjes së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), pasardhës i Fatimes (*radijall-llahu 'anha*).¹⁶⁰

Për Imam Mehdiun, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Do ta mbushë botën me drejtësi, ashtu siç është mushur me zullum".¹⁶¹

Dhe luftërat që i ka përmendur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të cilat do të ndodhin, si shenja në prag të Kijametit.

¹⁵⁸ Transmeton Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Se'id El-'Hudriju. Sipas Shej'h Albanit *hadith*-i është autentik. Shih "Silsileh ehadith sahiha".

¹⁵⁹ Transmeton Tirmidhiu dhe Ebu Davudi - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi. Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh në "Minhaxhus-Sunnah" *hadith*-in e ka konsideruar të saktë.

¹⁶⁰ Transmeton Ebu Davudi me zinxhirë të saktë tranmetimi - Nga Ummu Selemeh.

¹⁶¹ Transmeton Tirmidhiu dhe Ebu Davudi - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi. Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh në "Minhaxhus-Sunnah" *hadith*-in e ka konsideruar të saktë.

- Cilat janë shenjat e mëdha të Kijametit?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), një ditë prej ditëve, doli dhe i pa Sahabet duke biseduar, dhe ju tha: "Çka po diskutoni?" I thanë: "O i Dërguari i All-llahut, jemi duke diskutuar rreth Kijametit". Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Nuk do të ndodhë Kijameti, deri sa të dalin dhjetë shenja: Ed-Du'han (Tymi); Dexhxhali; Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët; Zbritja e 'Isait; lindja e diellit kah perendimi; kafsha e cila do t'ju flasë njerëzve; tre shafitjet në sipërfaqen e tokës (njëra në lindje, njëra në perendim dhe njëra në Xheziran arabe); dhe do të dalë zjarri, i cili do t'i tubojë njerëzit në mahsherr-in e tij (i cili është në Sham)".¹⁶²

- Cila është fitneja e Dexhxhalit?

Dexhxhali është një prej fitneve të mëdha, e cila do të egzistojë mbi sipërfaqen e tokës, saqë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk ka fitneh më të madhe, prej Ademit deri në Kijamet, sesa Dexhxhali".¹⁶³

Dexhxhali, siç na ka lajmëruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është prej bijëve të Ademit, që don të thotë se është prej njerëzve, por atë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka dalluar dhe ia ka dhënë disa mundësi, dhe kjo është një sprovë e madhe për të gjithë njerëzit që do ta takojnë atë. Do të del Dexhxhali dhe do ta paraqet veten si zot, dhe mundësitë që i ka, me to do të mundohet që t'i mashtrojë njerëzit. Do të del prej një vendi, i cili quhet: 'Horasan'.¹⁶⁴ Pastaj, jehudët e Esbehanit, për të cilët ka lajmëruar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), do ta pasojnë atë.¹⁶⁵ Dhe shumë njerëz pastaj do të bëhen pasues të Dexhxhalit.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) na ka treguar dhe ka thënë: "Dexhxhali është i vebër në njëri sy, ndërsa All-llahu nuk është i verbër në asnjërin sy".¹⁶⁶ Në ballin e tij shkruan: *KAFIR*; do ta lexojë atë ai i cili din të lexojë dhe ai i cili nuk din të lexojë.^{167, 168}

¹⁶² Transmeton Muslimi, Ebu Davudi dhe Nesaiu - Nga Hudhejfeh ibn 'Usejd.

¹⁶³ Transmeton Muslimi - Nga 'Imran ibn Husejni.

¹⁶⁴ Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Bekri. Sipas Shej'h Albanit *hadith*-i është *sahih*.

¹⁶⁵ Transmeton Muslimi - Nga Enes ibn Malik.

¹⁶⁶ Transmeton Bu'hariu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Umeri.

¹⁶⁷ Ata që nuk dinë të lexojnë, do ta lexojë atë me *iman*-in e tyre, ndërsa ata që nuk kanë *iman* dhe ata që do të devijojnë, nuk do të mundën ta lexojnë atë që shkruan në ballin e tij.

Dexhxhalit, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do t'ia japë disa mundësi. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ai me vete e ka xhennetin e tij dhe xhehennemin e tij; xhenneti i tij është zjarr, ndërsa xhehennemi i tij është ujë i freskët".¹⁶⁹ Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Do t'i thotë Dexhxhali qiellit: "Lësho shi!" dhe qielli do të lëshojë shi. Do t'i thotë tokës: "Nxjerre bereqetin!" dhe do të dalë bereqeti!".¹⁷⁰ Dhe kur njerëzit do t'i shohin këto gjëra, do të lëkundet edhe *iman-i* i atyre që kanë *iman* dhe shumë prej tyre do të devijojnë. Për atë, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) na ka porositur që kur të del Dexhxhali, mos të shkojmë dhe ta takjome atë, por të largohemi prej tij, për mos të rënë në *fitne-n* e tij.

Për t'u mbrojtur prej Dexhxhalit, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) na ka mësuar dhe ka thënë: "Lexoni ajetet e para të Suras *Kehf*".¹⁷¹ Ndërsa në një transmetim tjetër: "Lexoni ajetet e fundit të Suras *Kehf*".

Dexhxhali do të qëndrojnë mbi sipërfaqen e tokës katërdhjetë ditë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Dita e parë e Dexhxhalit është sa një vit, dita e dytë e Dexhxhalit është sa një muaj, dita e tretë e Dexhxhalit është sa një javë dhe ditët tjera janë sikur ditët normale".¹⁷² Dhe do të shkelë Dexhxhali mbi gjithë sipërfaqen e tokës, përveç dy vendeve: Mekkes dhe Medines, që nuk ka mundësi të hyjë në to.¹⁷³

Pastaj, do të vijë momenti që *Dexhxhali* do të përballet me ushtrinë e 'Isait (*'alejhis-selam*), dhe do ta takojë 'Isain (*'alejhis-selam*) në derën e cila quhet: *Lud* (në Palestinë, afër *Bejtul Makdis-it*), dhe do të fillojë të shkrihet sikur krypa në ujë, e atëherë do të vijë momenti që 'Isai (*'alejhis-selam*) do ta mbys Dexhxhalin.¹⁷⁴

- A do të zbret 'Isai ('alejhis-selam) përsëri në tokë?

Krishterët besojnë se 'Isain (*'alejhis-selam*) e kanë mbytur. Edhe jehudët gjithashtu. Ndërsa muslimanët besojnë në fjalët e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ku thotë:

¹⁶⁸ Transmeton Ahmedî dhe Hakimî në "*Mustedrak*", i cili e ka saktësuar. Huthejmîu ka thënë: "Këtë e ka transmetuar Ahmedî me dy zinxhirë transmetimi, ku transmetuesit e njërit prej tyre janë të saktë".

¹⁶⁹ Transmeton Muslimi - Nga Hudhefêh ibnul Jemani.

¹⁷⁰ Transmeton Muslimi - Nga Nevas ibn Sem'ani.

¹⁷¹ Transmeton Muslimi - Nga Nevas ibn Sem'ani.

¹⁷² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

¹⁷³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Enesi.

¹⁷⁴ Transmeton Ibn Maxheh me zinxhirë të mirë transmetimi - Nga Ebu Hurajrah.

... وَمَا قَتَلُوهُ وَمَا صَلَبُوهُ وَلَٰكِن شُبِّهَ هُمْ وَإِنَّ الَّذِينَ آخَذُوا فِيهِ لَكُنَّ مِنْهُمْ مَا هُمْ بِهِ

مِنْ عِلْمٍ إِلَّا اتِّبَاعَ الظَّنِّ وَمَا قَتَلُوهُ يَقِينًا ﴿١٥٧﴾ بَل رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا



"Por, ata as nuk e vranë, as nuk e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë nuk e kanë vrarë, por, All-llahu e ka ngritur pranë Vetes. All-llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijëshëm." (En-Nisa': 157-158)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ngriti 'Isain (*'alejhis-selam*) në qiell dhe e la atë si shenjë të madhe të Kijametit, për të zbritur në ditët e fundit të kësaj dunjaje.

'Isai (*'alejhis-selam*) do të zbret në Damaskë (Siri), te minareja e bardhë, të cilën e përmendi Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).¹⁷⁵ Atij do t'i bashkangjiten muslimanët, do të del për t'u përballur me Dexhxhalin dhe do ta mbysë atë me shpatn e tij. Pasi të përfundon Dexhxhali, atëherë do të vijë një ushtri tjetër shumë e madhe, e cila është ushtria dhe populli Je'xhuxh dhe Me'xhuxh, për të cilët All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), 'Isait (*'alejhis-selam*), do t'i thotë: *"Tash vjen një ushtri, të cilëve nuk ka kush që ju bëjë ballë!"*. Atëherë muslimanët bashkë me 'Isain (*'alejhis-selam*) do të hypin në kodrën Tur, deri sa të përfundojë kjo ushtri dhe ky popull.¹⁷⁶

Pas kësaj, do të zbret 'Isai (*'alehis-selam*) dhe do të qëndrojë me muslimanët së bashku shtatë vite, në ato vite të mira dhe të bereqetshme. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: *"Në vitet e 'Isait, do të ketë aq shumë bereqet, saqë as ujku nu do ta hajë delen, edhe fëmijët do të lozin me gjarpërinjtë dhe gjarpërinjtë nuk do t'i kafshojnë ato"*.¹⁷⁷

¹⁷⁵ Transmeton Ibn Maxheh me zinxhirë të mirë transmetimi. E ka shpjeguar Ibn Kethiri. Shih librin e tij *"Fundi, sprovat dhe trazirat"*.

¹⁷⁶ Transmeton Muslimi - Nga Neuas ibn Sem'ani.

¹⁷⁷ E ka theksuar Dejemiu në *"Musnedin e Firdevsit"*. Sipas Shej'h Albanit *hadith-i është sahih*. Shih *"Silsileh ehadith sahiha"*.

Kështu, do të ketë jetë të mirë dhe të bereqetshme, deri sa do të vijë momenti që të vdesë 'Isai ('alejhis-selam) dhe t'ia dorëzjë shpirtin All-llahut (subhanehu ve te'ala).¹⁷⁸

- Kush janë populli Je'xhuxh dhe Me'xhuxh?

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

ثُمَّ أَتْبَعَ سَبَبًا ﴿٣١﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ بَيْنَ السَّدَّيْنِ وَجَدَ مِنْ دُونِهِمَا قَوْمًا لَّا يَكَادُونَ
يَفْقَهُونَ قَوْلًا ﴿٣٢﴾ قَالُوا يَبْنَؤُا الْفَرْتَيْنِ إِنَّا يَا جُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ
نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا عَلَىٰ أَنْ نَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ سَدًّا ﴿٣٤﴾ قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ
فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا ﴿٣٥﴾ ءَاتُونِي زُبَرَ الْحَدِيدِ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ
الْصَّدَفَيْنِ قَالَ أَنْفُخُوا حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا قَالَ ءَاتُونِي أُفْرِغْ عَلَيْهِ قِطْرًا ﴿٣٦﴾ فَمَا
أَسْطَعُوا أَن يَصْهَرُوهُ وَمَا أَسْطَعُوا لَهُ نَقْبًا ﴿٣٧﴾ قَالَ هَذَا رَحْمَةٌ مِّن رَّبِّي فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ
رَبِّي جَعَلَهُ دَكَّاءَ وَكَانَ وَعْدُ رَبِّي حَقًّا ﴿٣٨﴾

"Pastaj mori një rrugë tjetër. Derisa, kur arriti në mes dy malesh, gjeti rrëze tyre një popull, i cili pothuaj nuk kuptonte asnjë të folme. Ata thanë: "O Dhulkarnejn, vërtetë, Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët janë ngatërrestarë në tokë. A të të japim një pagesë në një pagesë që të ndërtosh një pendë midis nesh dhe atyre?" Ai tha: "Ajo të cilën ma ka mundësuar Zoti im, është më e mirë (nga pagesa juaj), por më ndihmoni me punë! Do të ndërtoj një pendë midis nesh dhe atyre. Më sillni blloqe hekuri!" Dhe, kur ai rrafshoi dy anët e thepisura të maleve, tha: "Fryjini zjarrit, derisa hekuri të skuqet si zjarri". Pastaj tha: "Më sillni bakër të

¹⁷⁸ Transmeton Ahmedî dhe Hakimi - Nga Ebu Hurajrah. Hakimi ka thënë se zinxhiri i këtij transmetimi është *sahih*, por dy imamët (Bu'hariu dhe Muslimi) nuk e kanë transmetuar. Me këtë është në pajtim edhe Dhehebiu.

shkrirë që ta hedhë në të". Kështu, ata (Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët) nuk mundën që ta kapërcenin pendën dhe as nuk mundën që të hapnin vrimë në të. Ai tha: "Kjo është më shirë nga Zoti im! Kur të vijë premtimi i Zotit tim, Ai do ta rrafshojë atë (pendën). Premtimi i Zotit tim është (gjithnjë) i vërtetë." (El-Kehf: 92-98)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë se Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët për çdo ditë e prishin atë hekurin dhe dëshirojnë që të dalin, por nuk kanë mundësi të dalin. E gjejnë atë, dhe kur vjen mbrëmja, thonë: "Do të vazhdojmë nesër dhe do të dalim". Kur zgjohen të nesermen, e gjejnë ashtu siç ka qenë më herët (e pagrriyer). Fillojnë përsëri dhe e veprojnë këtë çdo ditë, deri sa të vijë momenti, me *kader-in* (caktimin) e All-llahut, të ju kujtohet atyre të thonë: "INSHALL-LLAH, nesër do ta vazhdojmë punën tonë!" Dhe kur do të zgjohen të nesermën, do ta gjejnë ashtu siç e kanë punuar, për ta hapur derën e tyre dhe do ta vazhdojnë atë, deri sa do të dalin mbi sipërfaqen e tokës.¹⁷⁹ Pasi do të dalin në tokë, do të fillojnë të bëjnë shkatërime të mëdhaja. Do të kalojnë pranë detit, janë aq shumë numër i madh, sa që do të vijë i fundit i tyre dhe do të thotë: "Këtu dikurë ka pasur ujë!"¹⁸⁰ Që don të thotë, se edhe detin do ta shterrin, nga numri i madh që janë ky popull. Pastaj do të bëjnë shkatërime të mëdhaja, deri sa muslimanët me 'Isain (*'alejhis-selam*) do të hypin në kodrën Tur. Kur do t'i bëjnë gjithë ato shkatërime, atëherë do të thonë: "I mbytëm gjithë ata që janë në tokë, hajde dhe t'i mbysim ata që janë në qiell!" Pastaj do të fillojnë t'i hedhin shigjetat e tyre për në qiell, ndërsa All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do t'ua kathejë shigjetat e tyre me gjak dhe do të fillojnë të mendojnë se i kanë mbytur edhe ata që janë në qiell. Atëherë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do ta lëshojë një ushri të vogël, disa insekte, të cilat do t'i mbysin gjithë atë popull zullumqarë. Dhe pasi bijnë për toke të gjithë, atëherë do të zbret 'Isai (*'alejhis-selam*) bashkë me muslimanët në tokë dhe do ta vazhdojnë jetën e tyre.¹⁸¹

¹⁷⁹ Transmeton Ahmed, Tirmidhiu dhe Hakimi - Nga Ebu Hurajrah. Hakimi ka thënë se *hadith-i* është i saktë konfirm kushteve të vëna nga dy *imam-ët* (Bu'hariu dhe Muslimi). Këto fjalë i ka miratuar edhe Dhehebiu.

¹⁸⁰ Transmeton Muslimi - Nga Nevas ibn Sem'ani.

¹⁸¹ Transmeton Muslimi.

- Si do të ndodhë fundi i botës (Kijameti)?

Nuk ka dyshim, se një ditë do të përfundojë çdo gjë. Pasi të përfundojnë muslimanët e mirë, që Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Do të vijë një erë dhe do t'i marrë të gjithë atë që kanë qoftë edhe një grimcë të imanit".¹⁸² Pra, do të vdesin të gjithë muslimanët.

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Nuk do të bëhet Kijameti, përveç se mbi njerëzit e këqinj". Dhe ka thënë: "Nuk do të bëhet Kijameti, deri sa të vijë momenti që nuk thuhet më mbi sipërfaqen e tokës: ALL-LLAH! ALL-LLAH!". Gjithashtu ka thënë: "Do të ngritet Kur'ani, dhe do të shkojnë njerëzit, me në krye me një njeri të zi, i cili quhet: Dhus-suvej Katejn, do të fillojë ai njeri që t'ia heqë perden Ka'bes dhe do të fillojnë që ta prishin Ka'ben, nga një tullë nga një tullë".¹⁸³

Pastaj, Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Si të kënaqem unë, kur e di se proari i Sur-it, e ka marur Surin dhe vetëm pret se kur All-llahu do t'i japë leje që t'i fryej atij!" Sahabet u rënduar ku i dëgjuan këto fjalë. Atëherë Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) tha: "Thoni: HASBUNALL-LLAHU VE NI'MEL VEKIL (neve na mjafton All-llahu, Ai është mbrojtësi më i mirë)!".¹⁸⁴

Pra, do të vijë momenti që Israfil t'i fryjë Sur-it. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ...

"Kur do t'i fryhet Sur-it, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do All-llahu ..." (Ez-Zumer: 68)

Do të shkatërrohet kjo dunja, do të vdesin gjithë njerëzit, gjithë xhinnët, gjithë kafshët dhe insektet dhe nuk do të mbetet gjallesë mbi sipërfaqen e tokës. Do të mbetet vetëm All-llahu (subhanehu ve te'ala). All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ ﴿٦٨﴾ وَيَبْقَىٰ وَجْهَ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿٦٩﴾

¹⁸² Transmeton Muslimi - Nga Nevas ibn Sem'ani.

¹⁸³ Transmeton Bu'hariu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Abbasi.

¹⁸⁴ Transmeton Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Ebu Se'id El-Hudrijju. Këtë hadith e kanë bërë daif: Ahmedi, Ebu Hatimi, Nesaiu dhe Dhehebiu.

"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, plot Madhëri dhe Nderim!" (Er-Rahman: 26-27)

Atëherë (pasi të zhduken-vdesin të gjithë), All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do të thotë:

... لِمَنِ الْمُلْكُ الْيَوْمَ لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ ﴿١٦﴾

"Kujt i përket pushteti i asaj Dite? All-llahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!" (Gafir: 16)

Dhe kështu do të përfundojë çdo gjë mbi sipërfaqen e tokës. E pastaj do të vijë momenti i Ringjalljes para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

**** Besimi në Ringjalljen ****

- Si e besojmë ne Ringjalljen?

Muslimani patjetër duhet të besojë, në mënyrë të plotë dhe të sigurtë, pa kurrfarë dyshimi, se pas vdekjes, pas jetës së varrezave, ka edhe një botë tjetër, e cila është dita ku njerëzit do të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), e cila është bota dhe jeta e A'hiretit, ku njerëzit do të llogariten para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Ne, besojmë që pas vdekjes ka ringjallje, dhe besojmë që pas ringjalljes ka llogari para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Besojmë që ka Peshore, ku veprat tona do të peshohen. Besojmë që ka Urë të *Sirat-it*, që njerëzit duhet ta kalojnë atë, varësisht prej punëve të tyre. Dhe besojmë që ka Xhennet dhe Xhehennem; Xhennet për ata që kanë bërë punë të mira dhe Xhehennem për ata që ia kanë kthyer shpinën All-llahut dhe nuk kanë punuar ashtu siç ka kërkuar Ai.

Nëse njeriu nuk beson se do të ringjallet edhe një herë, ose nëse vetëm dyshon se a do të ringjallet apo jo, ai nuk llogaritet musliman.

Besimi në ringjalljen është kusht i *iman-it*.

- Cilat janë argumentet e ringjalljes?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) në Librin e Tij përmendë argumente në mënyra dhe forma të ndryshme, që t'i bindë njerëzit, se në të vërtetë një ditë do të dalin para Tij.

Në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), kishte njerëz që nuk e besonin ringjalljen, dhe shumë kohë me rradhë, ka me shumicë njerëzish dhe popuj të tërë, të cilët nuk e besojnë ringjalljen. E, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), një prej formave të

argumentimit, që t'i bindë njerëzit se do të ringjallen dhe do të dalin para Tij, ua kujton fillimin e tyre dhe thotë:

وَيَقُولُ الْإِنْسَانُ أَإِذَا مَا مِتُّ لَسَوْفَ أُخْرَجُ حَيًّا ﴿٦٦﴾ أَوَلَا يَذْكُرُ الْإِنْسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِنْ

قَبْلُ وَلَمْ يَكُ شَيْئًا ﴿٦٧﴾

"Njeriu thotë: "Vallë, pasi të vdes, a do të ringjallem përsëri?" A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!" (Merjem: 66-67)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) përmendë edhe argumente në forma tjera dhu ju kujton njerëzve se kush e ka krijuar tokën dhe qiellin? E përderisa Ai e ka krijuar qiellin dhe tokën, të tjerat janë më të lehta se kjo. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

لَخَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَكْبَرَ مِنْ خَلْقِ النَّاسِ ...

"Krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve ..." (Gafir: 57)

Një njeri shkoi te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe e mori një asht i cili ishte kalbur. Pasi e mori ashtin, e shtypi dhe e bëri pluhur, e lëshoi atë dhe i tha: "O Muhammed, t'i po thua se këtë do ta ringjallë Zoti yt edhe një herë?!" E All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) tha:

وَضَرَبَ لَنَا مَثَلًا وَنَسِيَ خَلْقَهُ ۗ قَالَ مَنْ يُحْيِ الْعِظْمَ وَهِيَ رَمِيمٌ ﴿٧٨﴾ قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي

أَنْشَأَهَا أَوَّلَ مَرَّةٍ ۗ وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

"Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: "Kush do t'i ngjallë eshtrat kur të kalben?" Thuaj: "Do t'i ngjall Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë." (Ja Sin: 78-79)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), në një mënyrë tjetër, na argumenton se si do të ringjallen njerëzit dhe thotë:

فَأَنْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ تَحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِ الْمَوْتَىٰ ۗ وَهُوَ

عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٥٠﴾

"Andaj, shikoji gjurmët e mëshirës së All-llahut, se si e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Vërtetë, Ai do t'i ngjallë edhe të vdekurit, se Ai është i fuqishëm për çdo gjë." (Er-Rum: 50)

Edhe gjatë kësaj jete, në dunja, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ringjalli disa njerëz dhe ju dha argumente që ata t'i shihnin me sytë e tyre. E ringjalli njeriun në kohën e *Beni Israil-ëve*, të cilin e kishte mbytur dikush, dhe All-llahu urdhëroi që ta therrnin një lopë dhe ta godisnin me një pjesë të atij mishi, që ai njeri të ringjallej edhe një herë dhe të tregonte se kush e kishte mbytur, dhe kjo ndohej.¹⁸⁵ Edhe rasti i Ibrahimit (*'alejhis-selam*), për të cilin All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَىٰ ۗ قَالَ أُولَٰئِكَ تُؤْمِنُ ۗ قَالَ بَلَىٰ ۗ وَلَٰكِن لِّيَطْمَئِنَّ

قَلْبِي ۗ قَالَ فَخُذْ أَرْبَعَةً مِّنَ الطَّيْرِ فَصُرْهُنَّ ۗ إِلَيْكَ ثُمَّ أَجْعَلْ عَلَىٰ كُلِّ جَبَلٍ مِّنْهُنَّ جُزْءًا ۗ ثُمَّ

أَدْعُهُنَّ ۗ يَأْتِينَكَ سَعْيًا ۗ وَاعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٥١﴾

"Kur Ibrahim tha: "O Zoti im! Tregomë si i ngjallë të vdekurit!" Zoti i tha: "A nuk beson?" Ai (Ibrahimi) tha: "Besoj, por dëshiroj të më qetsohet zemër". All-llahu i tha: "Merri katër zogj dhe coptoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre, pastaj thirri. Ata do të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dishë se All-llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë"." (El-Bekarah: 260)

Dhe shumë argumente tjera bindëse, me të cilat All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) na tregon se, nuk ka dyshim, që një ditë njerëzit do të ringjallen dhe do të dalin para Tij. Kjo është prej urtësisë së All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Nuk ka mundësi që njerëzit të vijnë në këtë dunja, dikush të jetë zullumqarë, dikush të jetë besimtarë, dikush të punojë punë të mira e dikush punë të këqija, e pas vdekjes të jenë të gjithë të njejtë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

¹⁸⁵ Shih *Sura-n El-Bekarah*: 67-73.

أَفَجَعَلُ الْمَسَامِينَ كَالْجَرْمِينَ ﴿٣٥﴾ مَا لَكُمْ كَيْفَ تَحْكُمُونَ ﴿٣٦﴾

"Vaallë, a t'i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj me keqbërësit?!" (El-Kalem: 35-36)

Dhe thotë:

أَمْ نَجْعَلُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَالْمُفْسِدِينَ فِي الْأَرْضِ أَمْ نَجْعَلُ الْمُتَّقِينَ

كَالْفُجَّارِ ﴿٢٨﴾

"A t'i trajtojmë njëlloj ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira me turbulluesit në Tokë?! A t'i trajtojmë njëlloj njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!" (Sad: 28)

Pra, prej urtësisë së All-llahut, është që të gjithë të dalin para Tij dhe të shpërblehen apo të dënohen për punët e tyre.

**** Emrat e Ditës së Gjykimit ****

- Cilat janë emrat e Ditës së Gjykimit?

Dita e Gjykimit nuk e ka vetëm një emër, por ajo në argumente është përmendur me disa emra. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka emërtuar këtë ditë me shumë emra; prej tyre:

- *Jaumid-Din* (Dita e Gjykimit)

مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾

"Sunduesit të Ditës së Gjykimit." (El-Fatihah: 4)¹⁸⁶

- *Jaumil A'hir* (Dita e Fundit)

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٨﴾

"Ka disa njerëz që thonë: "Besojmë në All-llahun dhe në Ditës së Fundit!", po në të vërtetë ata nuk janë besimtarë." (El-Bekarah: 8)

- *Jaumul 'Huruxh* (Dita e Daljes)

... ذَلِكَ يَوْمُ الْخُرُوجِ ﴿٤٢﴾

"... ajo do të jetë Dita e Daljes." (Kaf: 42)

- *Jaumut-Telak* (Dita e Takimit)

¹⁸⁶ Në fakt, ky është *ajet-i* i tretë i *Sura-s El-Fatihah*, sepse ka dijetarë që e llogarisin si *ajet* edhe: *BSIMIL-LAHIR-RAHANIR-RAHIM*, ndërsa më e saktë është se *BISIIL-LAHIR-RAHAMNIR-RAHIM* nuk është *ajet*.

Dijetarët kanë parashtuar pyetje: Pse Dita e Gjykimit është quajtur edhe si: Dita e takimit? Disa prej dijetarëve kanë thënë: Sepse në atë ditë do të takohen banorët e tokës me banorët e qiellit (njerëzit me melaiket).¹⁸⁷ Disa dijetarë tjerë kanë thënë: Sepse në atë ditë do të takohen gjithë njerëzit.¹⁸⁸ E disa dijetarë tjerë kanë thënë: Sepse në atë ditë njerëzit do ta takojnë All-llahun dhe do të llogariten para Tij.

- *Jaumul Hasrah (Dita e Pikëllimit)*

وَأَنْذِرْهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ ...

"Paralajmëroji at (o Muhammed) për ditën e pikëllimit ..." (Merjem: 39)

- *Jaumul 'Hulud (Dita e Pafund)*

أَدْخُلُوهَا بِسَلَامٍ ذَٰلِكَ يَوْمُ الْخُلُودِ

"Hyni në të (Xhennet) me paqe e siguri. Kjo është Dita e amshimit (pa fund)."
(Kaf: 34)

- *Es-Sa'h-'hah (Ushtima)*

فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاحَةُ

"Por, kur të vijë Ushtima." ('Abese: 33)

- *El-Vaki'ah (Dita e Ngjarjes-Ndodhisë)*

إِذَا وَقَعَتِ الْوَاقِعَةُ

"Kur të ndodhë Ngjarja (e Kijameti)." (El-Vaki'ah: 1)

Dijetarët kanë thënë: E ka marur këtë emër (Dita e Ngjarjes-Ndodhisë), ngase kjo ngjarje do të ndodhë patjetër.

Gjithashtu, kjo ditë është quajtur edhe me shumë emra tjerë, që All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka përmendur në Kur'an.

¹⁸⁷ Katadeja, Sudiju, Bilal ibn Sa'idi dhe Sufjan ibn Ujejne.

¹⁸⁸ Zejdiju.

Dijetarët kanë thënë: Çdo emër i kësaj dite të jep të kuptosh dhe të rikujton gjendjen e njerëzve në atë Ditë.

Imam Kurtubiu (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Sa më shumë që është e madhe dhe e rëndësishme një gjë, aq më shumë mer emra në gjuhën arabe".

**** Ringjallja ****

- Si do të bëhet ringjallja e njerëzve?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka treguar se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do ta lëshojë një shi, pastaj do të vijë momenti që Israfil do t'i fryej *Sur-it*. Në momentin që Israfil do t'i fryej *Sur-it*, do të fillojë ringjallja e njerëzve, në një tokë, për të cilën Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë se do të jetë një tokë e cila nuk ka shenja, e cila nuk ka kodra, e cila nuk ka tragje ku kan ecur njerëz, një tokë e bardhë dhe e pastër, mbi të cilën do të dalin njerëzit dhe do të fillojnë rrugën e tyre për të dalur para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- Kush do të ringjalet i pari?

Pejgammberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Unë jamë zotëriu i bijëve të Ademit në Ditën e Gjykimit, dhe unë jamë i pari që do të më hapet toka dhe do të ringjallet para All-llahut".¹⁸⁹

Pra, i pari i cili do të ringjallet para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) është Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

¹⁸⁹ Transmeton Muslimi dhe të tjerë - Nga Ebu Hurajrah.

- Në çfarë gjendje do të ringjallen njerëzit?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Njerëzit do të ringjallen të zbathur, të çveshur dhe të pa bërë synet". A'isheja (*radijall-llahu 'anha*) i tha: "O i Dërguari i All-llahut, po burrat dhe gratë, a nuk do ta shiqojnë njëri-tjetrin?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Oj A'isheh, gjendja në atë ditë është më e madhe se sa ata ta shikojnë njëri-tjetrin".¹⁹⁰

Në një transmetim tjetër, Pejgambri (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Do të ringjallen njerëzit para All-llahut dhe do të dalin me ato tesha që kanë vdekur".¹⁹¹

Dijetarët kanë diskutuar dhe kanë shpjeguar, se me çfarë tesha do të dalin njerëzit, kur *hadith*-i tjetër thotë se ato do të dalin të çveshurat (pa tesha)? Disa prej dijetarëve kanë thënë: Veshja në këtë *hadith* e ka fjalën për veshjen e punëve dhe jo për veshjen e teshave, ngase All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ ...

"... por, petku i devotshmërisë është më i miri." (*El-A'raf: 26*)

Pra, është në pyetje punët e tyre e jo teshat e tyre, ngase njerëzit do të ringjallen të çveshur, e pastaj do të fillojnë të vishen dikurë dhe i pari i cili do të vishet në Ditën e Gjykimit është babai i Pejgamberëve, Ibrahim (*'alejhis-selam*).¹⁹²

- A do të ringjallen kafshët?

Dijetarët kanë diskutuar rreth kësaj dhe ajo që është më e saktë, është se përveç njerëzve dhe xhinnëve, do të ringjallen edhe kafshët. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

¹⁹⁰ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga A'isheja.

¹⁹¹ Transmeton Muslimi - Nga Xhabiri. Ngajshme transmeton Ebu Davudi, Ibn Hibbani dhe Hakimi - Nga Ebu Se'id El-Hudrijju.

¹⁹² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ibn 'Abbasi.

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا طَائِرٍ يَطِيرُ بِجَنَاحَيْهِ إِلَّا أُمَمٌ أَمْثَالُكُمْ ۚ مَا فَرَّطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ

شَيْءٍ ۚ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ تَحْشُرُونَ ﴿٣٨﴾

“Të gjitha kafshët në Tokë dhe të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.” (El-En’am: 38)

Pejgamberi (sal-lallahu ‘alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Ajo kafshë e cila ka qenë me brina në këtë dunja dhe i ka bërë zullum asaj që ka qenë pa brina, do të dalin në A’hiret dhe do t’ia kthejnë hakun njëra-tjetrës”. E pastaj Ebu Hurajrah (radijall-llahu ‘anhu) tha: “Atëherë All-llahu do t’ju thotë kafshëve: “Behuni dhè!”, dhe të gjitha kafshët do të bëhen dhé dhe do të zhduken, e kjo është fjala e All-llahut, ku thotë:

... وَيَقُولُ الْكَافِرُ يَلَيْتَنِي كُنْتُ تُرَابًا ﴿٤٠﴾

“... kur jobesimtari do të thotë: “Ah, sikur të isha pluhur!”.” (En-Nebe’: 40)

**** Sur-i ****

- Çka është Sur-i?

Sur-i është një Buri, të cilën e mban në dorë Israfil (‘*alejhis-selam*), i cili e pret momentin, se kur All-llahu do ta urdhërojë që t’i fryej atij (*Sur-it*).

- Sa herë do t’i fryhet Sur-it?

Sipas Imam Kurtubiut, Ibn Haxher El-Askalanit dhe shumë dijetarëve tjerë, *Sur-it*, Israfil (‘*alejhis-selam*) do t’i fryjë dy herë: një herë do t’i fryjë, ku njerzit do të vdesin gjithë dhe do të bëhet Kijameti; ndërsa herën e dytë, do t’i fryjë dhe njerëzit do të ringjallen para All-llahut (*subhanehu ve te’ala*).

Sipas *Shej’hul Islam* Ibn Tejmijes, Ibni Kethirit, Ibnul A’rabiut dhe disa dijetërve tjerë, *Sur-it*, Israfil (‘*alejhis-selam*) do t’i fryjë tre herë: herën e parë do t’i fryjë, ku gjithë njerëzit do të frikësohen dhe do të trishtohen. Këtë All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) e ka përmendur në Kur’an, ku thotë:

وَيَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَفَزِعَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ وَكُلُّ أَتَوَهُ

دَاخِرِينَ ﴿٨٧﴾

"Dhe Ditën, kur të fryhet në Sur, do të tmerrohet çdokush që gjendet në qiej e në Tokë, përveç atyre që All-llahu nuk dëshiron t’i frikësojë. Të gjithë do t’i vijnë Atij të përrulur." (En-Neml: 87)

Herën e dytë, është *ajet-i*, në të cilin All-llahu (*subhanehu ve te’ala*) thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا مَنْ شَاءَ اللَّهُ ...

"Kur do t'i fryhet Sur-it, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do All-llahu ..." (Ez-Zumer: 68)

Ndërsa herën e tretë, është vazhdimi i ajet-it:

... ثُمَّ نُفِخَ فِيهِ أُخْرَىٰ فَإِذَا هُمْ قِيَامٌ يَنْظُرُونَ ﴿٦٨﴾

"... pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin." (Ez-Zumer: 68)

Ndërsa, sipas Imam Ibn Hazmit, Sur-it, Israfil (‘alejhiss-salam) do t'i fryej katër herë.

Ajo që mendojmë se është më e saktë, është mendimi i dijetarëve të cilët thonë se Sur-it do t'i fryhet vetëm dy herë: herën e parë që do të vdesin të gjithë dhe herën e dytë që do të ringjallen të gjithë.

Ndërsa ajet-i, në të cilin All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë: *"... e të frikësohet kush është në tokë ..."*, Ibn Haxher El-Askalani (rahimehull-llah) thotë: *"Frikësimi i tyre dhe vdekja e tyre do të jenë përnjëherë"*.

**** Gjendja e njerëzve në Ditën e Gjykimit ****

- Si do të jetë gjendja e jobesimtarëve në Ditën e Gjykimit?

Jobesimtari, ende duke qenë në varr, e bën një lutje dhe thotë: "O Zot, mos e bën Kijametin! O Zot, mos e bën Kijametin!"¹⁹³, ngase ajo që vjen pas ringjalljes është edhe më e vështirë se dënimi i varrit. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَإِذَا هُمْ مِنَ الْأَجْدَاثِ إِلَىٰ رَبِّهِمْ يَنْسِلُونَ ﴿٥١﴾
قَالُوا يَا وَيْلَنَا مَنْ بَعَثَنَا
مِنْ مَرْقَدِنَا ...

"Dhe, kur të fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: "Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona? (Do t'u thuhet): "Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të Dërguarit kanë thënë të vërtetën!"." (Ja Sin: 51-52)

Gjithashtu thotë:

يَوْمَ تَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ سِرَاعًا كَأَنَّهُمْ إِلَىٰ نُصُبٍ يُوفِضُونَ ﴿٤٢﴾
خَشِيعَةً أَبْصَرُهُمْ
تَرَهْقُهُمْ ذِلَّةً ذَلِكَ الْيَوْمِ الَّذِي كَانُوا يُوعَدُونَ ﴿٤٤﴾

"Dita, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altarie, me shikim të frikësuar e të kapluar nga poshtërimi. Ajo është Dita që u është premtuar atyre." (El-Me'arixh: 44)

Dhe thotë:

¹⁹³ Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi - Nga Bera' ibni 'Azib.

يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتُ^ط وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ ﴿٤٨﴾ وَتَرَى
 الْمَجْرِمِينَ يَوْمَئِذٍ مُّقْرَّنِينَ فِي الْأَصْفَادِ ﴿٤٩﴾ سَرَابِيلُهُمْ مِنْ قَطْرَانٍ وَتَعْشَىٰ جُوهَهُمُ النَّارُ



"Ditën, kur Toka do të ndërrohet me Tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënyjesit All-llah. Dhe atë ditë do t'i shohësh keqbërësit të lidhur në pranga; rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'ua mbështjellë fytyrat." (Ibrahim: 48-50)

Gjithashtu, për zullumqarët, All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ غَفِيلاً عَمَّا يَعْمَلُ الظَّالِمُونَ^ع إِنَّمَا يُؤَخِّرُهُمْ لِيَوْمٍ تَشْخَصُ فِيهِ
 الْأَبْصَارُ ﴿٤٢﴾ مُهْطِعِينَ مُقْنِعِي رُءُوسِهِمْ لَا يَرْتَدُّ إِلَيْهِمْ طَرْفُهُمْ وَأَفْعَدْتُهُمْ هَوَاءً^ط ﴿٤٣﴾

"Mos mendo kurrresi që All-llahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe duke vrapuar me kokë lartë, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrasta (nga tmerri)." (Ibrahim: 42-43)

- A do t'u vlejnjë punët e mira jobesimtarëve?

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

وَقَدْ مَنَّآ إِلَىٰ مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَّنْثُورًا ﴿٢٣﴾

"Dhe ne do t'u qasemi veprave që i kanë bërë ata dhe do t'i shndërrojmë në pluhur e hi." (El-Furkan: 23)

Gjithashtu thotë:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَلُوهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيَعَةٍ تَحْسَبُهُ الظَّمْثَانُ مَاءً حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُمْ لَمْ يَجِدْهُ

شَيْئًا وَوَجَدَ اللَّهُ عِنْدَهُمْ فَوْقَهُمْ حِسَابَهُمْ ۗ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٣٩﴾

"Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë. Aty do të hasë në dënimin e All-llahut, i Cili ia paguan llogarinë e tij të plotë, se All-llahu është i shpejtë në llogari." (En-Nur: 39)

Dhe thotë:

مَثَلُ الَّذِينَ كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ أَعْمَلُهُمْ كَرَمَادٍ اشْتَدَّتْ بِهِ الرِّيحُ فِي يَوْمٍ عَاصِفٍ لَّا يَقْدِرُونَ

مِمَّا كَسَبُوا عَلَىٰ شَيْءٍ ۚ ذَٰلِكَ هُوَ الضَّلَالُ الْبَعِيدُ ﴿١٨﴾

"Veprat e atyre, që nuk e besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hyrit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbje e madhe." (Ibrahim: 18)

Gjithashtu thotë:

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٣﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيَّهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ

أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿١٤﴾

"Thuaj: "A doni t'ju lajmëroj për atë që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?".." (El-Kehf: 103-104)

Për pjesën: *"ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira"*, Se'ad ibni Ebi Vekkasi (radijall-llahu 'anhu) ka thënë: *"Është fjala për krishterët dhe jehudët"*.

Parashtrohet pyetja: Pse nuk ju vlejné punët e mira jomuslimanëve në A'hiret? Përgjigja është: se ata i kanë ndërtuar veprat e tyre pa themel, nuk e kanë njohur All-llahun (subhanehu ve te'ala) dhe nuk e kanë adhuruar Atë. Ai njeri i cili nuk hyn në Islam

(nuk e pranon Islamin), sado punë që të bëjë, ato nuk i vlejnë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿٨٥﴾

"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur." (Ali 'Imran: 85)

- Çka do të thotë Shejtani në A'hiret?

Njerëzit, kur do të dali para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), sidomos ata që janë për në Xhehennem, do të mundohen ta fajsojnë dikënd. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i përmendë ata që kanë devijuar për shkak të parisë së tyre dhe i kanë pasuar ata, se si paria do të fajsohen prej popullit dhe populli prej parisë së tyre, dhe kështu, secili do të mundohet ta fajësojë dikënd. Dikush tjetër do ta fajsojë shokun e tij. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَيَوْمَ يَعَضُ الظَّالِمُ عَلَى يَدَيْهِ يَقُولُ يَلِيَّتَنِي أَخَذْتُ مَعَ الرَّسُولِ سَبِيلًا ﴿٢٧﴾ يَوَيْلَ لِي لِيَتَنِي

لَمْ أَخَذْ فُلَانًا حَلِيلًا ﴿٢٨﴾

"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: "Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik!" (El-Furkan: 27-28)

Njeriu do ta fajsojë edhe trupin e vet, në atë Ditë që më do të mbyllet goja. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

الْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَىٰ أَفْوَاهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَا أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٦٥﴾

"Sot Ne do t'ua vulosim atyre gojat e do të na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë." (Ja Sin: 65)

E pastaj njeriu do t'i fajsojë gjymtyrët e veta. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَقَالُوا لَجُلُودِهِمْ لَمْ شَهِدْتُمْ عَلَيْنَا ۖ قَالُوا أَنْطَقَنَا اللَّهُ الَّذِي أَنْطَقَ كُلَّ شَيْءٍ وَهُوَ خَلَقَكُمْ

أَوَّلَ مَرَّةٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢١﴾

"Ata do t'u thonë lëkurave të veta: "Pse dëshmuat kundër nesh?" E ata do të përgjigjen: "All-llahu, i Cili ia jep aftësinë të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni"." (El-Fussilet: 21)

Pra, njerëzit do të mundohen ta fajsojnë dikënd, e do ta fajsojnë edhe Iblisin (*Shejtanin*). E atëherë Iblisi do t'ua mbajë një ligjeratë njerëzve, atyre që e kanë adhuruar atë dhe do t'ua thotë disa fjalë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَقَالَ الشَّيْطَانُ لَمَّا قُضِيَ الْأَمْرُ إِنَّ اللَّهَ وَعَدَكُمْ وَعَدَ الْحَقِّ وَوَعَدْتُكُمْ فَأَخْلَفْتُكُمْ ۖ

وَمَا كَانَ لِي عَلَيْكُمْ مِنْ سُلْطَانٍ إِلَّا أَنْ دَعَوْتُكُمْ فَاسْتَجَبْتُمْ لِي ۖ فَلَا تُلْمُونِي وَلَوْلَمْ

أَنْفُسَكُمْ ۖ مَا أَنَا بِمُصْرِخِكُمْ وَمَا أَنْتُمْ بِمُصْرِخِيَّ ۖ إِنِّي كَفَرْتُ بِمَا أَشْرَكْتُمُونِ

مِنْ قَبْلُ ۗ ...

"Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: "Vëretë, All-llahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjeshtë ju thirra e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi. Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me All-llahun (në adhurim)". Vërtet, keqbërësit do të kenë një dënim të dhembshëm." (Ibrahim: 22)

- Si do të jetë gjendja e mëkatarëve në Ditën e Gjykimit?

Kur mëkatarët do të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), në atë Ditë, që Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë më shumë, dhe nuk është hidhëruar me këtë hidhërim asnjëherë më parë dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë më vonë"¹⁹⁴, ata do t'i kaplojë dënimi i All-llahut, nëse All-llahu nuk do t'i falë me *Rahmet-in* (mëshirën) e Tij, dhë në bazë të gjunaheve vjen edhe dënimi i All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ata që kanë pasur medjemadhësi (*kibr*) në këtë dunja, kur do të dalin para All-llahut, do të jenë njerëzit më të nënçmuar dhe do të jenë të poshtëruar".

Në një *hadith* tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Njerëzit më të këqinj që do të dalin para All-llahut, janë ata që kanë qenë me dy fytyra"¹⁹⁵.

Pastaj, gjendja e atyre që kanë bërë gjunahe të mëdhaja: gjendja e atyre që kanë pirë alkool, gjendja e atyre që kanë bërë *zina*, gjendja e atyre që janë marrur me kamatë dhe gjendja e shumë gjunahqarëve që do të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

E atyre që ju ka ikur ndonjëherë ndonjë namaz, ata që nuk e kanë dhënë zekatin, ata që nuk e kanë agjëruar Ramazanin etj., gjendja e tyre do të jetë e tmerrshme në Ditën e Gjykimit. Për ata që nuk e kanë dhënë zekatin, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ari dhe argjendi i dunjasë do t'ju shëndërrohet në zjarr, në pllaka prej zjarri. E pastaj, me ato pllaka do t'u përshkohet barku i tyre, shpina e tyre dhe fytyra e tyre". Kjo është ende pa hyrë në Xhehennem. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَالَّذِينَ يَكْتُمُونَ الذَّهَبَ وَالْفِضَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ

أَلِيمٍ ﴿٢٤﴾ يَوْمَ تُحْمَىٰ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ فَتُكْوَىٰ بِهَا جِبَاهُهُمْ وَجُنُوبُهُمْ وَظُهُورُهُمْ

هَذَا مَا كَنْزْتُمْ لِأَنْفُسِكُمْ فَذُوقُوا مَا كُنْتُمْ تَكْتُمُونَ ﴿٢٥﴾

"Ata që grumbullojnë arin dhe argjendin dhe nuk e shpenzojnë për hirë të All-llahut, paralajmroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e

¹⁹⁴ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu - Nga Ebu Hurajrah dhe Enes ibn Malik.

¹⁹⁵ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

mbledhura) do të gjinden në zjarrin e Xhehunnemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t'u thuhet: "Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!"" (Et-Teubeh: 34-35)

Disa prej njerëzve, janë prej gjunahqarëv, që në Ditën e Gjykimit, All-llahu nuk do t'u flet fare, dhe këta Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka përmedur në disa *hadith*-e, në disa grupe. Disa prej tyre janë: "... *plaku zinaqarë, mbreti (kryetari) gënjeshtarë dhe fukaraja mendjemadh*".¹⁹⁶ Në një transmetim tjetër, ka thënë: "... *ai që nuk i respekton prindërit e tij, femrat që ju përngjajnë meshkujve dhe dejjuth-ët (ata që nuk xhelozojnë për nderin e tyre)*".¹⁹⁷

Dhe gjendjet e shumëta, të atyre që do të dalin me gjunahe të mëdhaja para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- Si do të jetë gjendja e besimtarëve në Ditën e Gjykimit?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٣﴾ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿١٤﴾ لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ۚ ...

"Pa dyshim, miqtë e All-llahut (evlija-të) nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (All-llahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S'ka ndryshim në fjalët e All-llahut; kjo është fitorja madhështore." (Junus: 62-64)

Kur do të dalin besimtarët para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ata që kanë qenë të devotshëm, gjendja e tyre dallon prej gjendjes së gjunahqarëve të mëdhenj dhe jobesimtarëve. Disa prej tyre, janë ata që do të jenë nën hije, në atë ditë që nuk ka hije pos një hije, dhe ata janë shtatë grupe, për të cilët Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*Shtatë grupe të njerëzve janë që do të jenë nën Hijen e All-llahut, në atë ditë që nuk ka hije tjetër pos kësaj hije: Imami (udhëheqësi) i drejtë; ai i ri i cili e ka kaluar rininë e tij duke i*

¹⁹⁶ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁹⁷ Transmeton Ahmedi dhe Nesaiu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Amri.

bërë 'ibade-t All-llahut; një person që zemra e tij ka qenë e lidhur për xhaminë; dy njerëz që e kanë dashur njëri-tjetrin për All-llah; një person të cilin e ka ftuar një grua e bukur dhe me pozitë, e ai ka thënë: "Unë i kam frikë All-llahut!"; një person i cili ka dhënë sadaka dhe e ka fshehur atë, derisa nuk e din dora e majtë se çka ka dhënë dora e djathtë; dhe ai person i cili e ka kujtuar All-llahun duke qenë i vetëm dhe i kanë lotuar sytë".¹⁹⁸

Gjithashtu, ata që do të dallohen në Ditën e Gjykimit, janë ata që janë zbardhur në këtë dunja në fenë e All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Ata, kur do të dalin para All-llahut, ato qimet e barëdha që i kanë pasur në dunja duke qenë nën nënshtrimin e All-llahut, do t'u bëhen dritë në Ditën e Gjykimit.¹⁹⁹

Ndërsa, njerëz që do të dallohen në Ditën e Gjykimit, që janë prej besimtarëve më të mirë, janë grupi i Shehidëve, një shkallë më e lartë, e cila nuk arrihet ndryshe. Shehidat, të cilët do të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), me shehidllëkun e pranuar, me shpirtin që e kanë dhënë për hirë të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Pejgamberi (*sal-lallahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Shehidat i kanë gjashtë dallime pre njerëzve tjerë: Me pikën e parë të gjakut që i rrjedh Shehidit, prej momentit kur ai bie Shehid, i falen të gjitha gjynahet; e sheh vendin e tij në Xhennet; shpëton prej dënimit të varrit; në Ditën e Gjykimit është i sigurtë, kur të gjithë njerëzit frikësohen në atë trishtimin e madh të asaj dite; i vendoset në kokë një taxh, që një dijamant i vogël i saj është më me vlerë se sa gjithë dunjaja dhe çka ka në të; martohet me shtatëdhjetë e dy Hyrij në Xhennet; dhe ka të drejtë të ndërmjetsojë për shtatëdhjetë vetë të të afërmeve të vet".²⁰⁰

Dhe shumë raste ('ibadet-e) tjera, të cilat e ndihmojnë njeriun dhe e bëjnë prej muslimanëve të mirë, që kur të dalë para All-llahut, të dalë me fytyrë të bardhë.

¹⁹⁸ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

¹⁹⁹ Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh - Nga Amr ibn Shu'ajbi e ky nga babai i tij. *Hadith-i është hasen-sahih*.

²⁰⁰ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Ahmedi - Nga Mikdam ibnu Ma'dijj Kurebi.

**** Llogaria (Hisab-i) ****

- Si do të jetë Llogaria para All-llahut?

Në atë ditë, njerëzit do të gjykohen para Kijuesit të tyre, në atë ditë që më nuk ka hile dhe mashtrime, në atë ditë që njeriu nuk ka rryshfet për ta shpëtuar veten e tij, por në atë ditë ka drejtësi para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَلَا يَظْلِمُ رَبُّكَ أَحَدًا ﴿٤٩﴾

"Zoti yt nuk i bën padrejt askujt." (El-Kehf: 49)

Secili njeri do të llogaritet për atë që e ka bërë në dunja. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿٥٠﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ﴿٥١﴾

"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë." (Ez-Zelzeleh: 8-9)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) të gjithë do t'i gjykojë me Drejtësinë e tij. Gjithashtu, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), me *Rahmet-in* e Tij, atyre që e kanë besuar All-llahun dhe kanë bërë punë të mira, do t'ua shtojë punët e mira. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ عَشْرُ أَمْثَالِهَا ^ط وَمَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَلَا تُجْزَىٰ إِلَّا مِثْلَهَا وَهُمْ لَا

يُظْلَمُونَ ﴿٥٢﴾

"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjuhahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie." (El-En'am: 160)

Gjithashtu, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) do t'i gjykojë dhe do t'i llogarisë njerëzit, në bazë të punëve që i kanë bërë ata vetë, dhe askush nuk do të gjykohet dhe nuk do të llogaritet dhe nuk do të dënohet për punët e tjerëve. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَىٰ ﴿١٦٠﴾

"Dhe se njeriut do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar." (En-Nexhm: 39)

Dhe thotë:

وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ۗ ... ﴿١٨﴾

"Asnjë shpirtë i ngarkuar nuk do të mbartë barrën e tjetrit." (Fatir: 18)

- Si do të llogariten besimtarët?

Edhe muslimanët nuk do të jenë të gjithë në një shkallë. Një grup në mesin e *ummet-it* të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), janë që do të hynë në Xhennet pa llogari. Sahabet (*radijall-llahu 'anhum*) ishin duke diskutuar se kush janë këta njerëz që do të hynë në Xhennet pa llogari. Disa thonin se ndoshta janë ata që nuk kanë qenë në *kufir* më herët dhe kështu me rradhë. Duke diskutuar, erdhi Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe ju tha: "Çka po diskutoni?" I thanë: "Jemi duke diskutuar për ata që do të hynë në Xhennet pa llogari". Pegamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Këta janë ata të cilët nuk kanë kërkuar t'u bëhet rukjeh, por për çdo send janë mbështetur te All-llahu!".²⁰¹ Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ishte lajmëruar se do të hynë në Xhennet pa llogari shtatëdhjetë mijë musliman.²⁰²

²⁰¹ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Ibn Hibbani - Nga Ibn 'Abbasi, Ebu Hurajrah dhe 'Umran ibn Hissin.

²⁰² Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah. Ky është një transmetim, ndërsa në një transmetim tjetër qëndron se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka shtuar numrin e atyre që do të hynë në Xhennet pa llogari dhe

Një grup tjetër i muslimanëve, janë ata të cilët kanë bërë gjunahe, por kanë qenë muslimanë të mirë. Këtyre vetëm do t'u paraqitet llogaria. Pejgamberi (*sal-lallahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "All-llahu, robin e tij do ta mbulojë dhe (në vetmi) do t'i thotë: "**O robi Im, a të kujtohet filan gjunahun që e ke bërë?**" Ai do t'i thotë: "Po, o Zot!" All-llahu do t'i thotë: "**A të kujtohet edhe filan gjunahu tjetër?**" Ai do t'i thotë: "Po, o Zot!" All-llahu do t'i thotë: "**Po filan gjunahu tjetër?**" Ai do t'i thotë: "Po, o Zot!" Do t'i pranojë robi të gjitha gjunahet dhe do të mendojë se më u shkatërrua. Ndërsa All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, t'i kam mbuluar ato në dunja dhe sot po t'i fali ato!**"."²⁰³

Grupi tjetër i muslimanëve, janë ata që do të kenë llogari të vërtetë. Pejgamberi (*sal-lallahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ai i cili do të merret në llogari (të vërtetë), është dënuar".²⁰⁴ Disa dijetarë kanë thënë: Vetëm llogaria e tij është dënim. Disa dijetarë tjerë kanë thënë: "Ai i cili do të merret në llogari, është dënuar" nënkupton: Kush merret në llogari dhe pas llogarisë e meriton Xhehennemin, ky është dënimi i tij.²⁰⁵

- A do të merren në pyetje Pejgamberët?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), në Ditën e Gjykimit, Pejgamberëve do t'ua bën një pyetje. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

﴿يَوْمَ تَجْمَعُ اللَّهُ الرُّسُلَ فَيَقُولُ مَاذَا أُجِبْتُمْ قَالُوا لَا عِلْمَ لَنَا إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّمُ الْغُيُوبِ﴾

"Një ditë All-llahu do t'i tubojë të Dërguarit e do t'u thotë: "Si ju janë përgjigjur?" Ata do të thonë: "Ne s'kemi dijeni, vetëm Ti i din të gjitha të fshehtësitë." (El-Maideh: 109)

Dijetarët kanë parashtruar pyetje, se pse Pejgamberët do të thonë: "Ne nuk e dimë ..."? Hasan El-Basriu, Muxhahidi dhe disa dijetarë tjerë, kanë thënë: Prej trishtimit të madh të asaj dite, edhe Pejgamberët e All-llahut do të thonë: "Ne nuk e dimë, o Zot!" Disa dijetarë tjerë, dhe ky është mendimi i Ibni 'Abbasit (*radijall-llahu 'anhu*), kanë thënë:

"Secilin prej shtatëdhjetë mijë-ve, edhe nga shtatëmbëdhjetë mijë tjerë". (Transmeton Ahmed, Tirmidhiu dhe Ibn Hibbani - Nga Ebu Uameh)

²⁰³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn 'Umeri.

²⁰⁴ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Nesaiu - Nga A'isheja.

²⁰⁵ Imam Neveviu thotë se ky është mendimi më i saktë.

Pejgamberët do të thonë: "Nuk e dimë, përveç asaj që Ti e din më mirë se ne". Ata, prej edukatës ndaj All-llahut, do të thonë: "nuk e dimë", edhe pse ata e dinë.

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَلَنَسْأَلَنَّ الَّذِينَ أُرْسِلَ إِلَيْهِمْ وَلَنَسْأَلَنَّ الْمُرْسَلِينَ ﴿٦﴾

"Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të Dërguar, e patjetër që do t'i pyesim edhe të Dërguarit." (El-A'raf: 6)

- A do të llogariten jobsimtarët?

A do të llogariten jobsimtarët apo jo, për këtë dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa dijetarë kanë thënë se jobsimtarët nuk do të kenë llogari fare.²⁰⁶ Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë se edhe jobsimtarët do të kenë llogari.²⁰⁷

Mendimi më i saktë është se edhe jobsimtarët do të kenë llogari. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَوَرَبِّكَ لَنَسْأَلَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٩٢﴾ عَمَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٣﴾

"Ashtu është e vërtetë, për Zotin tënd, se ne do t'i pyesim ata të gjithë, për gjithçka që kanë bërë!" (El-Hixhr: 92-93)

Ndërsa në një ajet tjetër, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَلَا يُسْأَلُ عَنْ ذُنُوبِهِمُ الْمُجْرِمُونَ ﴿٧٨﴾

"Por keqbërësit nuk do të pyeten për gjunahet e tyre." (El-Kasas: 78)

²⁰⁶ Ebu Bekr 'Abdul 'Aziz, Ebu Hasen, Et-Temimi, El-Kadi, Ebu Ja'la dhe tjerë.

²⁰⁷ Ebu Hafs El-Bermeki, Ebu Sulejman Ed-Dimeshki, Ebu Talibi dhe tjerë.

Në këto dy *ajet*-e nuk ka kundërshtim. 'Abdull-llahu ibn 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "All-llahu nuk do t'i pyesë jobesimtarët në *A'hiret*: A keni vepruar apo nuk keni vepruar, por do t'i pyes: Pse keni vepruar kështu?".

Ajet-i i cili thotë: "do të merren në pyetje" nënkupton që All-llahu do t'i pyes: "Pse?", ndërsa *ajet*-i i cili thotë: "nuk do të merren në pyetje" nënkupton që All-llahu nuk do t'i pyes: "a e keni bërë apo jo?", ngase All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e din më mirë se të gjithë.

Imam Kurtubiu (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Ka raste në Ditën e Gjykimit që njerëzit merren në pyetje dhe ka vende të caktuara që nuk merren në pyetje, andaj *ajet*-et flasin për vende të caktuara".

Jobesimtarët do të merren në pyetje, ngase edhe ata nuk janë të gjithë në një shkallë në Xhehennem, edhe *kufri*-i i tyre dallon. Për munafikat, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

إِنَّ الْمُنْفِقِينَ فِي الدَّرَكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ ...

"Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të zjarrit të Xhehennemit ..." (*En-Nisa'*: 145)

Nga kjo nënkuptojmë se nuk do të jenë të gjithë banorët e zjarrit në një shkallë, për atë edhe do të merren në llogari; do të peshohen punët e tyre dhe do të caktohet vendi i tyre në Xhehennem, se në cilin shkallë do të jenë. Dhe siç është e njohur, edhe Ebu Talibi, edhe Ebu Lehebi, të dytë kanë vdekur si jobesimtarë dhe të dytë do të jenë në Xhehennem përgjithmonë, por nuk do të jenë në një shkallë. Ebu Talibi do të jetë në dënimin më të lehtë, që do t'i veshen nallet prej zjarri, prej të cilave do t'i vlojnë trurët.²⁰⁸

- Për cilat gjëra do të pyetet njeriu?

Njeriu do të pyetet për disa gjëra, prej tyre:

²⁰⁸ Transmeton Muslimi - Nga Bera' ibn 'Azib.

1. Namazin

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Pyetja e parë e cila do t'ju bëhet njerëzve para All-llahut, është namazi. Nëse me namazin është mirë, ai njeri ka shpëtuar, e nëse me namazin nuk është mirë, ai njeri ka humbur. Pastaj, nëse i mungojnë diçka tek farzet (obligimet), All-llahu do të thotë: **"Shikojeni robin Tim nëse ka diçka nafileh?"** Nëse ka nafileh, i vendohen ato dhe ia kompenzojnë farzet (mangësitë e tyre)".²⁰⁹

2. Shikimin, dëgjimin dhe zemrën apo mendjen

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

... إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا ﴿٣٦﴾

"Vërtetë, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto do të merren në përgjegjësi."
(El-Isra': 36)

Katadeh (rahimehull-llah) ka thënë: "Do të pyetet për dëgjimin, nëse ka thënë: "e kam dëgjuar", e në realitet nuk e ka dëgjuar. Do të pyetet për shikimin, nëse ka thënë: "e kam parë", e në realitet nuk e ka parë. Dhe do të pyetet për mendjen, nëse ka thënë: "e di", e në realitet nuk e ka ditur!".

3. Jetën, diturinë, pasurinë dhe trupin

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Nuk do të lëvizë këmba e birit të Ademit, deri sa të merret në pyetje për katër gjëra: jetën e tij ku e kaloi; me diturinë e tij çka veproi; pasurinë e tij ku e fitoi dhe ku e harxhoi; dhe trupin e tij ku e shkatërroi".²¹⁰

4. Të gjitha të mirat

All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ ﴿٨﴾

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!" (Et-Tekathur: 8)

²⁰⁹ Transmeton Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Ebu Hurajrah. Ebu 'Isa thotë: "Hadith-i i transmetuar prej Ebu Hurajras në këtë formë arrin kategorinë e hadith-it hasen-garib".

²¹⁰ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadith-i është hasen-sahih.

**** Zbritja e librave ****

- Si do t'u zbresin njerëzve librat e tyre?

Grupi i parë, janë musliman e mirë, të cilëve librat do t'u zbresin nga ana (krahu) e djathtë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ ۖ فَيَقُولُ هَٰؤُلَاءِ أَقْرَبُ وَأَكْتَبُ ۗ ﴿١٩﴾
إِنِّي ظَنَنْتُ أَنِّي مُلْقٍ
حِسَابِيَّةٍ ﴿٢٠﴾ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ ﴿٢١﴾ فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ﴿٢٢﴾

"Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t'u thotë (njerëzve të tij): "Ja, lexoni librin tim! Vërtetë, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari". Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht me pallate e grada të larta." (El-Hak-kah: 19-22)

Grupi i dytë, janë jomuslimanët, të cilëve librat do t'u zbresin nga ana (krahu) i majtë apo prapa shpine. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِشِمَالِهِ ۖ فَيَقُولُ يَلِيَّتَنِي لِمَ أُوتِ كِتَابِي ۗ ﴿٢٥﴾ وَلَمْ أَدْرِ مَا حِسَابِي ۗ ﴿٢٦﴾
يَلِيَّتَهَا كَانَتْ الْقَاضِيَةَ ﴿٢٧﴾ مَا أَغْنَىٰ عَنِّي مَالِي ۗ ﴿٢٨﴾ هَلَكَ عَنِّي سُلْطَانِي ۗ ﴿٢٩﴾ خُدُوهُ
فَعْلُوهُ ﴿٣٠﴾ ثُمَّ الْجَحِيمَ صَلُّوهُ ﴿٣١﴾

"Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: "Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha mësuar llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më sooli

dobi dhe më la fuqia ime! (Do të thuhet): "Kapeni dhe lidheni në pranga, pastaj digjeni në Zjarrin përvëlues." (El-Hak-kah: 25-31)

Dhe grupi i tretë, janë muslimanët me gjunahe të mëdhaja.

Sa i përket zbritjes së librave ndaj kësaj kategori të njerëzve, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa dijetarë kanë thënë se atyre librat do t'u zbresin nga ana e djathtë (edhe pse do të dënohen në Xhehennem). Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë se atyre librat do t'u zbresin nga ana e majtë.

Ajo që mendojmë se është me e saktë, është se muslimanëve me gjunahe të mëdhaja librat do t'u zbresin nga ana e djathtë. Dhe disa dijetarë kanë thënë: Atyre që do t'u zbresin librat nga ana e djathtë dhe do të futen në Xhehennem, ata do ta dinë se nuk do të jenë në Xhehennem përgjithmonë.

- Çka do të ketë të shkruar në librat e zbritura?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i përmendë fjalët e atyre që do t'u vijë librat nga ana e majtë dhe do të thonë:

... يَنْوِيلَتْنَا مَالٍ هَذَا الْكِتَابِ لَا يُغَادِرُ صَغِيرَةً وَلَا كَبِيرَةً إِلَّا أَحْصَاهَا ...

"Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë." (El-Kehf: 49)

Ne e dimë prej në dunja, se melaiket i regjistrojnë punët tona, nga ana e dhathtë dhe e majta. Pra, çdo punë, e madhe apo e vogël, egziston në këtë libër.

Dijetarët kanë parashtruar pyetje, se njeriu, a do t'i gjejë në këtë libër edhe ata punë që ka dashur t'i bëjë me zemër apo jo? Dhe kanë thënë: Nëse njeru vetëm e bën nijet dhe nuk merr asnjë hap, për këtë ka shpërblim, nëse puna është e mirë. Por, nëse bën hapa për të shkuar dhe për ta bërë, atëherë këtë do ta gjejë të tërën (të plotë). Nëse është e mirë, do ta gjejë të mirë, dhe nëse është e keqe, do ta gjejë të keqe.

Një njeri, në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), u nis prej Mekkes për në Medineh, për t'u shpërngulur te Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), dhe duke

shkuar rrugës, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ia mori shpirtin dhe ai vdiq. Për këtë, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e zbriti ajet-in, ku thotë:

... وَمَنْ خَرَجَ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكُهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى

... اللَّهُ

"Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek All-llahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodhë që t'i vijë vdekja, All-llahu me siguri do ta shpërblejë." (En-Nisa': 100)

Pejgamber (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Vrasësi dhe i vrari janë në Xhehennem!" I thanë: "O i Dërguari i All-llahut, për vrasësin është në rregull, po pse edhe i vrari?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Edhe ai ka dashur ta vrasë".²¹¹

²¹¹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Bekrate Nufe'i ibn El-Harith Eth-Thekafijju.

**** Mizan-i (Peshorja) ****

- Si e besojmë ne Mizan-in (Peshoren)?

Sipas Mu'tezileve dhe një pakice të vogël të dijetarëve të *Ehli Sunnet-it*, Peshorja nuk egziston në realitet. Sipas tyre, më këtë nënkuptohet drejtësia e All-llahut.²¹²

Sipas gjithë dijetarëve të *Ehli Sunnet-it*, përveç një pakice të vogël, Peshorja egziston në realitet.

Ne e besojmë Peshoren, peshore të vërtetë, e cila i ka dy anë, nga njëra anë vendohen të mirat dhe nga ana tjetër të këqijat. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَالْوَزْنُ يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ فَمَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٨﴾ وَمَنْ خَفَّتْ
مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ بِمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا يَظْلِمُونَ ﴿٩﴾

"Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar; kurse ata që e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona."
(*El-A'raf*: 8-9)

Për dy anët e Peshores, që nga njëra anë vendosen të mirat dhe na njëra ana të këqijat, e argumenton *hadith-i* i *Bitaka-s*.²¹³

Disa dijetarë kanë thënë: Peshorja, përveç dy anëve, ka edhe gjuhë me të cilën flet.²¹⁴

²¹² Pse kanë thënë kështu? Ngase në bazë të logjikës së tyre, veprat nuk mund të peshohen, sepse gjërat që peshohen janë gjërat që duken dhe preken.

²¹³ Ky *hadith* do të përmendet më vonë gjërësisht.

²¹⁴ Këtë e kanë thënë disa prej dijetarëve dhe kanë thënë se kjo është fjala e 'Abdull-llah ibn 'Abbasit (*radijall-llahu 'anh*). Edhe pse për këtë nuk ka ndonjë *ajet* apo *hadith* të vërtetë të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Sa peshore do të ketë atë ditë?

Disa dijetarë kanë thënë: Peshorja në atë ditë është vetëm një dhe gjithë njerëzit do t'i vendojnë punët e tyre në atë peshore. Dhe janë argumentuar me *hadith*-in, ku Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Janë dy fjalë, që janë shumë të lehta në gjuhë, por janë shumë të rënda në Peshore dhe janë të dashura te All-llahu: SUBHANALL-LLAHI VE BI-HAMDIHI SUBHANALL-LLAHIL 'ADHIM!"²¹⁵

Hasan El-Basriu dhe disa dijetarë tjerë kanë thënë: Peshoret në atë ditë do të jenë shumë dhe secili njeri do ta ketë nga një peshore. Dhe janë argumentuar me *ajet*-in, ku All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَنَضَعُ الْمَوَازِينَ الْقِسْطَ ...

"Dhe në Ditën e Kijametit, Ne do të vendosim peshore²¹⁶ të sakta ..." (El-Enbija: 47)

Ibni Haxher El-Askalani (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Në bazë të të gjitha argumenteve, na e bën me dije të kuptojmë se peshorja në atë ditë është vetëm një. Ndërsa All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ka përmendur shumë: *mevzin* (peshore), dhe koje vjen për shkak të gjërave të shumëta që do të vendohen në Peshore".

Ajo që mendojmë se është më e saktë, është se në Ditën e Gjykimit do të ketë vetëm një peshore, mbi të cilën do të vendohen punët e gjithë njerëzve.

- Cilat gjëra do të vendohen në Peshore?

Në lidhje me gjërat që do të vendohen në Peshore, dijetarët janë ndarë në tre mendime:

1. Disa dijetarë kanë thënë se në Peshore do të vendohen punët e njerëzve. Shumë dijetarë kanë thënë se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) punët e njerëzve do t'i shëndërrojë në

²¹⁵ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ebu Hurajrah.

²¹⁶ "*Mizan*" është: një, ndërsa "*mevazin*" janë: shumë.

trupa.²¹⁷ Këta janë bazuar në disa argumente, prej tyre edhe *hadith*-in: "Janë dy fjalë që janë shumë të lehta në gjuhë, por janë shumë të rënda në Peshore ..." ²¹⁸

2. Disa dijetarë tjerë kanë thënë se do të peshohen njerëzit. Secili njeri, në bazë të punëve të tij, aq edhe do të ketë peshë. Këta janë bazuar në disa argumente. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... فَلَا تُقِيمُ هُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَرَنَا

"... andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta në Ditën e Kijametit." (El-Kehf: 105)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i pa Sahabet duke qeshur dhe ju tha: "Përse po qesheni?" I thanë: "Po qeshemi me këmbët e 'Abdull-llah ibn Mes'udit²¹⁹!" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Pasha All-llahun, këmbët e 'Abdull-llah ibn Mes'udit në A'hiret do të jenë më të rënda se sa kodra e Uhudit" ²²⁰

3. Disa dijetarë tjerë kanë thënë se do të peshohen Librat (Fletushkat), ku janë të shkruara punët e njerëzve. Këta janë argumentuar me *hadith*-in e *Bitaka*-s. ²²¹

Hafidh ibn Ahmed El-Hakemij (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Ka mundësi që të peshohen edhe veprat, edhe njerëzit, edhe fletoret e tyre".

Shej'h Ibni Utnejmini (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Ajo që në bazë të argumenteve është më afër, është se në peshore do të vendohen punët e njerëzve. Ndërsa, ka raste të caktuara, në persona të caktuar, që ka mundësi të peshohen edhe Librat, edhe njerëzit dhe kështu me rradhë. Ndërsa në formë të përgjithëshme, në Peshore do të vendohen punët e njerëzve".

²¹⁷ Këtë e ka përmendur *Shej'h* Ibni Utnejmini dhe dijetarë tjerë me rradhë, deri te 'Abdull-llah ibn 'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*).

²¹⁸ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ebu Hurajrah.

²¹⁹ 'Abdull-llah ibn Mes'udi ishte shumë i dobët (i thatë).

²²⁰ Transmeton Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ibn Mes'udi. Ky është *hadith hasen*.

²²¹ Ky *hadith* do të përmendet më vonë më gjërësisht.

- Cilat gjëra peshojnë rëndë atë ditë?

Ka shumë gjëra, të cilat peshojnë rëndë në atë ditë. Të gjitha punët e mira peshojnë te All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Prej tyre:

1. Shehadeti, fjala LA ILAHE IL-LALL-LLAH, MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Një njeri i cili do të dalë para All-llahut, do t'i vij në Peshoren e tij nëntëdhjetë e nëntë regjistara me gjunahe. Një regjistër i cili është plot me gjunahe, është sa të shohin sytë! Atëherë All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, mos të është bërë ty zullum?**" Ai do të thotë: "Jo, o Zot, të gjitha këto janë gjunahet e mija". Atëherë All-llahu do t'i thotë: "**Po, por ti ke edhe diçka që ke bërë prej punëve të mira, e ke një bitaka (kartelë), në të cilën shkruan: LA ILAHE IL-LALL-LLAH, MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH!**" Ai do të thotë: "O Zot, të gjithë këto regjistra me gjunahe, dhe kjo kartelë, çka do të bëjë?" All-llahu do t'i thotë: "**Megjithatë, sot ty nuk të bëhet zullum!**" Atëherë do të vendohet kjo kartelë në Peshore nga ana e djathtë dhe regjistrat me gjunahe nga ana e majtë. Atëherë, do të rëndojë kjo fjalë dhe do të fluturojnë regjistrat! Nuk e rëndon diçka fjalën LA ILAHE IL-LALL-LLAH, MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH!"²²²

2. Fjalët: SUBHANALL-LLAHI VE BIHAMDIHI, SUBHANALL-LLAHIL 'ADHIM

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Janë dy fjalë, të cilat janë shumë të lehta në gjuhë, por janë shumë të rënda në peshore dhe janë të dashura te All-llahu: SUBHANALL-LLAHI VE BIHAMDIHI, SUBHANALL-LLAHIL 'ADHIM!"²²³

3. Morali i mirë

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk ka ndonjë gjë që peshon më rëndë në Ditën e Gjykimit, se sa morali i mirë"²²⁴

Dhe shumë punë tjera të mira, që pushojnë shumë atë ditë.

²²² Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se *hadith-i* është *hasen-garib*. Po ashtu edhe Ibn Maxheh, Ahmedi, Ibn Hibbani dhe Bejhekiu, ndërsa Hakimi i bën *sahih*.

²²³ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ebu Hurajrah.

²²⁴ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se *hadith-i* është *hasen-sahih* - Nga Ebu Ed-Derda.

**** Haud-i ****

- Çka është Haud-i?

Fjala *Haud* don të thotë: një vend ku mbledhet uji. Don të thotë, sikur ky të jetë kroi i Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), apo bazeni i Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), apo një koritë e madhe, ku është tubuar një ujë i madh, i cili është vend që All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka nderuar me këtë Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Haud-i është një ujë, i cili është mbledhur dhe prejardhjen e ka prej Xhennetit.

Te *Haud-i*, i pari do të vijë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e pas tij do të vijnë muslimanët tjerë me rradhë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "I pari që do të vijë te *Haud-i*, jamë unë". Në një *hadith* tjetër, ka thënë: "Të parët që do të pijnë prej *Haudit*, janë fukaratë *muhaxhirë*". E pastaj, gjithë muslimanët me rradhë do të jpinë prej *Haud-it* të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ky ujë, është më i ëmbël se mjalta, më i bardhë se qumshti dhe era e tij është më e mirë se era e *miskut*. Kush pin prej tij, nuk etet më asnjëherë. Gjatësia e tij është sakur njeriu të udhëtojë një muaj dhe gjërësia e tij është sakur gjatësia e tij. Enët e tij janë sakur yjet".²²⁵

- Sa vetë do të pijnë prej Haud-it?

Njëri prej Sahabeve tregon dhe thotë: Ishim me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe duke qëndruar me të, ai tha: "Ju nuk jeni, përveç se një pjesë e njëqind mijë pjesëve

²²⁵ Transmeton Bu'hariu - Nga 'Abdull-llah ibn 'Amr. Të njëjtin *hadith* e transmeton edhe Muslimi.

që do të pijnë te Haud-i im". I thanë: "Po sa ishit ju atë ditë?" Ai tha: "Ne ishim, prej shtatëqind deri tetëqind vetë".

- Kush nuk do të mund të pijë prej Haud-it?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Unë, në atë ditë, pranë Haudit tim, do t'i largoj disa njerëz, sikur që njeriu i largon devet e huaja të mos pijnë te vendi i deveve të tij". Në një transmetim tjetër, ka thënë: "Do të vinë disa njerëz, pastaj do të humbet pamja e tyre menjëherë. Do të them: "Shokët e mi, shokët e mi!" (Në një transmetim tjetër: "Ummeti im, ummeti im!") Melaiket do të më thonë: "Ti nuk e din çka kanë vepruar ata pas teje!" Atëherë do të them: "Larg meje, larg meje!"."²²⁶

Imam Kurtubiu (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Këta janë ata njerëz që kanë bërë *riddeh*²²⁷. Gjithashtu këtu hynë grupet që janë përçarë, që kanë dalur prej rradhëve të *Ehli Sunneh vel Xhema'ah*, dhe këtu hynë 'Havarixhët, Rafiditë dhe Mu'tezilet. Këtu hynë edhe ata që kanë bërë gjunahe të mëdhaja haptaz dhe janë krenuar me gjunahet e tyre. Dhe këtu hynë ata që ju kan bërë zullum muslimanëve; dhe ata që kanë bërë *bid'at*-e (risi në fë), ata që i kanë shpikur *bid'at*-et, ata që i kanë përhapur *bid'at*-et, dhe ata që i kanë pasuar *bid'at*-et dhe epushet e tyre".

- A kanë Haud edhe Pejgamberët tjerë?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Atë ditë (Ditën e Gjykimit), gjithë Pejgamberët do ta kenë Haud-in e tyre dhe secili do të mundohet që të krenohet me numrin e njerëzve që do ta ketë pranë Haud-it të tij. Unë shpresoj që më së shumti njerëzit të jenë prej ummet-it tim".²²⁸

²²⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Sehli, 'Abdull-llah ibn 'Amri, A'isheja dhe Ummu Selemeh.

²²⁷ Ata që kanë dalur nga feja pasi kanë qenë musliman.

²²⁸ Sipas *Shej'h* Albanit hadith-i është i vërtetë (*sahih*). Ndërsa ka dijetarë tjerë të cilët e llogarisin të dobët (*daiif*).

Sipas këtij *hadith*-i nënkuptohet se secili Pejgamber e ka *Haud*-in e tij. Ndërsa atë që këtë *hadith* e kanë llogaritur të dobët (*daif*), kanë thënë se, nëse *hadith*-i nuk qëndron, atëherë nënkupton se kjo është veçori e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Ajo që shpresojmë se është më e saktë, është se secili Pejgamber do ta ketë *Haud*-in e tij.

- Çka është Keuther-i?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), duke qëndruar një ditë me Sahabet, filloi të qeshë. I thanë: "O i Dërguari i All-llahut, çka të bëri të qeshësh?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Më ka zbritur një Surah:

... إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ ﴿١﴾

"Vërtet, Ne të keni dhënë ty Keuther-in." (El-Keuther: 1)

Fjala *Keuther* don të thotë: diçka e shumë (kur tubohen shumë gjëra në një vend).

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ky është një lum në Xhennet, të cilin All-llahu ma ka pregaditur dhe ma ka premtuar mua". Në një *hadith* tjetër, ka thënë: "Uji i tij është më i ëmbël se mjalta, më i bardhë se qumshti dhe era e tij është më e mirë se era e miskut. I ka dy kanale, njëri është prej ari dhe tjetri prej argjendi".

Dijetarët kanë thënë: Prej *Keuther*-it tubohet uji i *Haud*-it të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Ibni Haxher El-Askalani (*rahimehull-lla*) ka thënë: "*Haud*-i dhe *Keuther*-i nuk janë të njejtë. *Keuther*-i është lum brenda në Xhennet, ndërsa *Haud*-i është kroi i Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) jashtë Xhennetit".

- A egzistojnë sot Haud-i dhe Keuther-i?

*Haud-i edhe Keuther-i egzistojnë sot. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë:
"Unë jamë duke e parë tash Haud-in tim".²²⁹*

²²⁹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga 'Ukbeh ibn 'Amir.

**** Ura e Sirat-it ****

- Çka është Ura e Sirat-it?

Ura e Sirat-it është: një urë e cila do të shtrohet mbi Xhehennem.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Atëherë shtrohet një urë mbi Xhehennem".²³⁰ Në një transmetim tjetër, thuhet: "Është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata".²³¹

Mbi këtë Urë duhet të kalojnë njerëzit, për të dalur nga ana tjetër dhe për të hyrë në Xhennet.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kjo Urë i ka disa grrepa (pengesa), që njeriu duhet të kalojë mbi to (për ta kaluar atë)".²³²

Ndërsa, nuk ka ndonjë transmetim se sa është e gjatë kjo urë. Por, kur të paramendohet se sa është i madh Xhehennemi, sa njerëz dhe xhinnd kan për të hyrë në të, sa është i thellë Xhehennemi dhe kështu me rradhë, na jep të kuptojmë se edhe Ura e Sirat-it do të jetë shumë e gjatë.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ky vend është i rrëshqitshëm".

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَإِنْ مِنْكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا ...

"Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do hypë mbi të (Urën e Sirat-it)." (Merjem: 71)

²³⁰ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²³¹ Nga Ebu Se'id El-'Hudrijju.

²³² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

Për fjalën "*variduha*", disa dijetarë e kanë thënë: Do të duhet që të hypë mbi Urë dhe të kalojë. Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë: "*Variduha*" nënkupton: të kalosh nëpër Xhehennem dhe të dalësh prej tij, dhe ata që do ta kalojnë këtë, Xhehennemi për ta do të jetë sikur zjarri që hyri në të Ibrahimimi (*'alejhis-selam*) dhe nuk e djegi.

Mendimi më i saktë është se secili do të hypë mbi Urën e *Sirat-it*, e a do ta kalojë apo jo, atëherë varet prej punëve të tij.

- Si do të jetë gjendja e njerëzve në Urën e Siratit?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Atëherë do vijë një zë dhe do t'u thuhet njerëzve: "**Secili, kënd e ka adhuruar, le ta pasojë atë!**" Ata që e kanë adhuruar diellin, do ta pasojnë diellin dhe do të hudhen në Xhehennem. Ata që e kanë adhuruar hënën, do ta pasojnë hënën dhe do të hudhen në Xhehennem. Ata që i kanë adhuruar tagut-ët e kësaj dunjaje, bashkë me ta do të hudhen në Xhehennem. Dhe nuk do të mbeten përveç, muslimanët, munafikat dhe ithtarët e Librit (krishterët dhe jehudët). Pastaj do t'u thuhet jehudëve: "**Ju kënd e keni adhuruar?**" Ata do të thonë: "E kemi adhuruar 'Uzejrin, birin e All-llahut!" All-llahu do t'u thotë: "**Po gënjeni, ngase All-llahu nuk ka pasur fëmijë asnjëherë**". Pastaj do t'u thotë: "**Po ju, çka kërkon sot?**" Do të thonë: "Kërkojmë ujë, o Zot, të freskohemi, sepse jemi etur shumë!" Atëherë ju bëhet me shenjë dhe hudhen në Xhehennem. Pastaj do t'u thuhet krishterëve: "**Ju kënd e keni adhuruar?**" Ata do të thonë: "Ne e kemi adhuruar Mesihun ('Isain), birin e All-llahut!" All-llahu do t'u thotë: "**Po gënjeni, ngase All-llahu nuk ka pasur fëmijë asnjëherë**". Pastaj do t'u thotë: "**Po ju, çka kërkon sot?**" Do të thonë: "Kërkojmë ujë, o Zot, të freskohemi, sepse jemi etur shumë!" Atëherë ju bëhet me shenjë dhe hudhen në Xhehennem".

Pra, jomuslimanët, krishterët dhe jehudët, nuk do të kenë nevojë të hypin mbi Urën e *Sirat-it*, ata e kanë Xhehennemi e sigurtë.

Pastaj, do të mbesin muslimanët dhe munafikët.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "*I pari i cili do të kalojë mbi Urën e Sirat-it jam unë, pastaj do të vinë njerëzit tjerë mbi Urën e Sirat-it dhe do ta kalojnë atë në bazë të punëve të tyre. Dikush do ta kalojë sa duke i hapur dhe duke i mbyllur sytë, dikush do ta kalojë sikur rrufeja, dikush sikur të udhëtojë me kalë, dikush do ta kalojë duke ecur në këmbë, e dikush do ta kalojë zhag, disa do ta kalojnë e disa do të binë prej saj*".

'Abdull-llah ibn Mes'udi (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "Njerëzit, atë ditë, do të kenë dritë dhe secili e ka dritën, në bazë të *iman*-it që e ka pasur në dunja. Dikush e ka dritën sakur kodrat, dikush sa një pallmë, dikush sa trupi i tij, etj."

Munafikët nuk do të kenë dritë në atë ditë, por do të mundohen që mbi Urën e *Sirat*-it të kalojnë nëpërmejt dritës së muslimanëve, e atëherë All-llahu do t'ua pengojë dritën që e kanë muslimanët, që mos ta shohin munaikët. Atëherë munafikët do të thonë: "***Na pritni edhe ne që të marrim nga drita juaj!***" Por atyre do t'u thuhet: "***Kthelhuni prapa (në dunja) e kërkoni tjetër dritë!***" (*El-Hadid*: 13). E pastaj, pasi ta kalojnë një pjesë të Urës së *Sirat*-it, do të binë munafikët në Xhehennem, edhe gjuhahqarët e mëdhenj gjithashtu, ndërsa muslimanët e mirë do ta kalojnë Urën e *Sirat*-it.

- Si e kujtonin selef-i²³³ Urën e Sirat-it?

Në kohën e mëherëshme, muslimanët e parë (*selef-i*), e kujtonin shpesh Urën e *Sirat*-it, ngase ky është një moment shumë i rëndësishëm. Nëse njëriu shpëton prej kësaj (e kalon Urën e *Sirat*-it), ai më ka shpëtuar, por nëse nuk e kalon, ai njeri ka humbur dhe ka hyrë në Xhehennem.

'Abdull-llah ibn Ravaha (*rahimehull-llah*), duke qëndraur në shtëpinë e tij, filloi të qajë. Bashkëshortja e tij, kur e pa se burri i saj është duke qarë, filloi ta pyeste se përse po qante, ndërsa ai vazhdonte dhe lotët nuk i ndalte. Pataj filloi të qajë edhe bashkëshortja e tij dhe i tha: "Përse po qanë, o burri im?" Ai i tha: "Po ti përse po qanë?" Ajo i tha: "Unë po qaj ngase të pashë ty duke qarë!" Ai i tha: "Oj bashkëshortja ime, mu kujtua një ajet, që All-llahu në të thotë: "***Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do hypë mbi të (Urën e Siratit).***" (*Merjem*: 71), e nuk e di, a thua kam për ta kaluar urën apo kam për të ra prej saj!"

Ebu Mejserah (*rahimehull-llah*), i cili ra në shtratin e tij, thoshte: "Ah sikur nëna ime të mos më kishte lindur në këtë dunja fare!" I thanë: "Përse i thua këto fjalë?" Tha: "Sepse më kujtohet *ajet-i*, që secili njeri ka do të hypë mbi Urën e *Sirat*-it, dhe nuk e di a do të jem prej të shpëtuarve apo prej të dënuarve!"

²³³ Selefët janë të parët tanë, gjeneratat e para të arta të muslimanëve.

Hasan El-Basriu (*rahimehull-llah*), duke kaluar rrugës, e pa një të ri i cili qeshte me zë dhe i tha: "O ti filan, a të ka ardhur argumenti që do të hypësh mbi Urën e *Sirat-it*?" Ai tha: "Po". I tha: "Po a të ka ardhur argumenti që do ta kalosh Urën e *Sirat-it*?" Ai tha: "Jo". I tha: "Atëherë, përse po qeshë?" Prej atij momenti, thuhet që ky i ri kurrë më nuk u pa duke qeshur.

Njërin prej dijetarëve, kur e pyetën dhe i thanë: "Kur do të rehatohet njeriu?", ai tha: "Njeriu do të rehatohet atë ditë kur do ta kalojë Urën e *Sirat-it*".

Imam Kurtubiu (*rahimehull-llah*) porositë dhe thotë: "O ti njeri, kujtoje në jetën tënde momentin që të vjen rradha ta vëndosh këmbën mbi Urën e *Sirat-it*".

**** Kantarrah ****

- Çka është Kantarah?

Kantarrah është një urë tjetër.

Imam Kurtubiu (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Në A'hiret ka dy ura: Ura e *Sirat-it* dhe Ura *Kantarrah*. Ura e *Sirat-it* është: njerëzit për ta kaluar dhe për të dalur në *Xhennet*. Ura *Kantarrah* është: një urë, për ata që do ta kalojnë Urën e *Sirat-it*, dhe do të ndalen në këtë urë, para se të hynë në *Xhennet*. Në këtë Urë, njerëzit do të pastrohen prej padrejtësive që i kanë pasur ndërmejet vete. Do t'u largohet inati, xhelozia, urrejtja etj..²³⁴ Ai i cili arrinë në këtë Urë, më nuk do të kthehet në *Xhehennem*".

Ndërsa për *hadith-in*, ku Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ai i cili ka falur namaz, ka dhënë zekatë, ka agjëruar etj., kur do të del para All-llahut, e ka sharë filanin, e ka ofenduar filanin etj., të gjithë do të kthehen pastaj, do t'ia marrin sevapet, do t'ia japin gjuhahet dhe ai do të hudhet në *Xhehennem!*"²³⁵, kjo do të ndodhë para Urës së *Sirat-it*.

²³⁴ Transmeton Bu'hariu dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ebu Se'id El-'Hudrijju.

²³⁵ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

**** Ndërmjetësimi (Shefa'at-i) ****

- Sa lloje është Shefa'at-i?

Dijetarët shefa'at-in e kanë ndarë në dy lloje:

1. Shefa'at-i i kotë (i papranuar)
2. Shefa'at-i i vërtetë (i pranuar)

- Cili shefa'at është i kotë (i papranuar)?

Shefa'at-i i papranuar është i atyre, të cilët mundohen të ndërmjetësojnë në këtë dunja nëpërmjet dikujt, për të arritur te All-llahu. Kështu ka filluar *shirk-u*, në kohën e Nuhut ('*alejhis-selam*), prej njerëzve që i adhuronin të vdekurit, që të vdekurit të ndërmjetësonin te All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Ky lloj ndërmjetësimi është *shirk*. Kështu kanë qenë edhe mushrikët e Mekkes në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të cilët thonin:

... هَتُّوْا لَّآءِ شَفَعْتُوْنَا عِنْدَ اللّٰهِ ...

"Këta janë ndërmjetësit tanë te All-llahu!" (Junus: 18)

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَمَا تَنْفَعُهُمْ شَفَاعَةُ الشَّافِعِينَ ﴿٤٨﴾

"Prandaj, kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësues nuk do t'i ndihmojë ata." (El-Mudeth-thir: 48)

Ta lutëdh dikënd (i cili është i vdekur), që ai ta lutë All-llahun, ky është ndërmjetësim i ndaluar. Për shembull: të shkosh te verri i ndonjë *evlija*-së, apo te varri i ndonjë muslimani të mirë, apo qoftë edhe te varri i Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), dhe t'u thuash atyre që ata ta lusin All-llahun për ty.

Për fat të keq, ka edhe në këtë kohë, njerëz të cilët shkojnë nëpër tyrbe, teqe apo varreza dhe i lusin të vdekurit, për t'ua shëruar fëmijët, për t'ua dhënë *evlad*, për t'ua larguar problemet, për t'ua dhënë të mira dhe kështu me rradhë. Të gjitha këto janë *shirk* dhe është *shefa'at* i ndaluar.

- Cili shefa'at është i vërtetë (i pranuar)?

Shef'a'at-i i pranuar, është për ata njerëz, që All-llahu është i kënaqur me ta që ata të ndërmjetësojnë. Për shembull, në Ditën e Gjykimit do të ndërmjetësojë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), do të ndërmjetësojnë Pejgamberët tjerë, do të ndërmjetësojnë Shehidët dhe kështu me rradhë. Do të ndërmjetësojnë për ata që All-llahu është i kënaqur me ta, për muslimanët, e nuk mund të ndërmjetësojnë për jomuslimanët dhe idhujtarët; dhe për ata që All-llahu jep leje. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ...

"Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai për ndokënd, pa lejen e Tij?" (El-Bekarah: 255)

Pra, për t'ua pranuar ndërmejtësimi, duhet të plotësohen tre kushte:

1. All-llahu të jetë i kënaqur me ndërmjetësuesin
2. All-llahu të jetë i kënaqur me atë që ndërmjetësohet
3. All-llahu të japë leje që të ndërmejtësojë dikush

- Cili shefa'at është i veçant për Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

1. Ndërmjetësimi i parë, i cili është i veçant vetëm për Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), është para se të fillojë llogaria, ku njerëzit do të qëndrojnë në Ditën e Gjykimit dhe dielli do të jetë mbi kokat e tyre, ku do të presin para All-llahut pesëdhjetë mijë vite.

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Unë jamë zotëriju i gjithë njerëzve në Ditën e Gjykimit. A e dini Pse? -Sepse njerëzit në Ditën e Gjykimit do të tubohen para All-llahut, të parët edhe të fundit, e pastaj, kur të vështirësohet gjendja e tyre, kur të zbret dielli mbi kokat e tyre, atëherë njerëzit do të vinë në një gjendje që nuk do të mundën ta përballojnë, dhe do të thonë: “Sikur të shkonim te ndokush e t’i themi që t’i lutet All-llahut për të fillojë llogaria”. Njerëzit pastaj do të shkojnë te Ademi dhe do t’i thonë: “O Adem, t’i je njeriu i parë, ty All-llahu të ka krijuar me Dorën e Tij, ty All-llahu të ka futur në Xhennetin e Tij. O Adem, lute All-llahun që të na e lehtësojë gjendjen e kësaj dite”. Ademi do të thotë: “All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë, e që nuk është hidhëruar asnjëherë para dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë mbrapa, më shumë se këtë ditë! Unë kam ngrënë prej pemës që All-llahu ma pat ndaluar. Vetja ime, vetja ime! Shkoni te Nuhu”. Njerëzit do të nisen dhe do të shkojnë te Nuhu dhe do t’i thonë: “O Nuh, ti je i Dërguari i parë, lute All-llahun që të na e lehtësojë gjendjen e kësaj dite”. Nuhu do të thotë: “All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë, e që nuk është hidhëruar asnjëherë para dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë mbrapa, më shumë se këtë ditë! Unë e kam lutur All-llahun një herë, për ta shkatëruar popullin tim, nuk kam mundësi që ta lus edhe një herë. Vetja ime, vetja ime! Shkoni te Ibrahim”. Njerëzit do të shkojnë te Ibrahim dhe do t’i thonë: “O Ibrahim, ti je i dashuri i All-llahut, ti je miku i All-llahut, lute All-llahun që të na e lehtësojë gjendjen e kësaj dite”. Ibrahim do të thotë: “All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë, e që nuk është hidhëruar asnjëherë para dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë mbrapa, më shumë se këtë ditë! Unë i kam pasur tre gënjeshtër gjat jetës sime dhe nuk kam mundësi që ta lus All-llahun. Vetja ime, vetja ime! Shkoni te Musai”. Njerëzit do të shkojnë te Musai dhe do t’i thonë: “O Musa, lute All-llahun që të na e lehtëson gjendjen e kësaj dite”. Musai do të thotë: “All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë, e që nuk është hidhëruar asnjëherë para dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë mbrapa, më shumë se këtë ditë! Unë e kam mbytur një njeri, që nuk kam qenë i urdhëruar ta mbys atë. Vetja ime, vetja ime! Shkoni te ‘Isai”. Njerëzit do të shkojnë te ‘Isai dhe do t’i thonë: “O ‘Isa, lute All-llahun që të na e lehtësojë gjendjen e kësaj dite”. ‘Isai do të thotë: “All-llahu është i hidhëruar në këtë ditë, e që nuk është hidhëruar asnjëherë para dhe as që do të hidhërohet ndonjëherë mbrapa, më shumë se këtë ditë! (Dhe nuk do të përmendë ndonjë gjë) Shkoni te Muhammedi”. Njerëzit pastaj do të vinë te unë dhe do të më thonë: “O Muhammed, ti je Vula e Pejgamberëve, All-llahu ty t’i ka falur të gjitha ghyndet, lute All-llahun për neve, a nuk po e

sheh në çfarë gjendje jemi". Do të afrohem unë nën 'Arsh-in e All-llahut, do të bie në sexhdeh dhe do të filloj që ta falënderoj All-llahun, ta falënderoj dhe lavdëroj me disa fjalë, që nuk e kam falënderuar dhe lavdëruar asnjëherë ashtu, e pastaj do të më thuhet: "**O Muhammed, ngrite kokën tënde, kërko, të të jepet ty, ndërmjetëso, të të pranohet ndërmjetësimi yt!**" Do ta ngriti pastaj unë kokën dhe do të them: "O Zoti im, ummet-in tim! O Zoti im, ummet-in tim!" Dhe pastaj do të më thuhet: "**O Muhammed, meri me vete prej ummet-it tënd ata që do të hynë në Xhennet pa llogari dhe pa dënim**".²³⁶

2. Ndërmjetësimi i dytë, i cili është i veçant vetëm për Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është kur njerëzit do të arrijnë para derës së Xhennetit.

Njerëzit, pasi do ta kalojnë Urën e *Sirat-it* dhe pasi do ta kalojnë Urën *Kantara*, do të arrijnë para derës së Xhennetit. Dera e Xhennetit do të jetë e mbyllur dhe askush ende nuk ka hyrë në Xhennet, e atëherë njerëzit do të presin që të hyjnë në Xhennet. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Atëherë unë do të trokas në derën e Xhennetit", dhe pastaj do të ndërmjetësojë te All-llahu që të fillojë hyrja e muslimanëve të mirë në Xhennet.²³⁷

3. Ndërmjetësimi i tretë, i cili është i veçant vetëm për Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është ndërmjetësimi për mixhën e tij Ebu Talibin.²³⁸

'Abbasi (*radijall-llahu 'anhu*) i tha Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): "A do të kesh mundësi ta ndihmosh ti Ebu Talibin, ngase ai të ka ndihmuar ty në dunja?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Po mos të jemë unë, ai do të ishte në shkallën më të thellë të Xhehennemit, por me ndërmjetësimin tim, atij do t'i vishen nallet e Xhehennemit, prej të cilave do t'i vlojnë trutë".²³⁹

²³⁶ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu - Nga Ebu Hurajrah dhe Enes ibn Malik.

²³⁷ Transmeton Muslimi - Nga Enes ibn Malik.

²³⁸ Ky është përjashtim prej rregullit. Nuk ka mundësi që askush të ndërmjetësojë për ndonjë jomusliman, përveç Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) në këtë ras, i cili, jo që do të ndërmjetësojë për ta future Ebu Talibin në Xhennet, por për t'ia lehtësuar dënimin në Xhehennem. Dhe ky ndërmjetësim, jo që do të bëhet për shkak se e ka pasur atë mixhë, por për shkak se ai e ndihmoi dhe e mbrojti atë.

²³⁹ Transmeton Bu'hariu.

- Në cilat raste do të ndërmjetësojnë edhe tjerët?

Kjo vlenë për ata që ende nuk kanë hyrë në Xhehennem, ndërsa gjunahet i kanë pak më shumë dhe e meritojnë Xhehennemin; do të ndërmjetësohet për ta që mos të hynë në Xhehennem. Apo, kjo vlen për ata që kanë hyrë në Xhehennem dhe kanë qenë musliman; do të ndërmjetësohet për ta që të dalin prej Xhehennemit.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Do të ndërmjetësojnë Pejgamberët, do të ndërmjetësojnë melaiket, do të ndërmjetësojnë muslimanët e mirë, që njerëzit të dalin prej Xhehennemit. Atëherë, All-llahu, me një Grusht, do t'i nxjerrë një grup të madh të njerëzve prej Xhehennemit. Pastaj do të pastrohen te një ujë, i cili quhet: Maul Hajah (uji i gjallërisë), ku do t'u drejtohet (rregullohet) trupi i tyre, e pastaj do të hynë në Xhennet". Në një hadith tjetër, thuhet: "All-llahu do t'u thotë melaikëve: **"Shkoni në Xhehennem dhe nxjerrni të gjithë ata që nuk më kanë bërë Mua shok (që kanë thënë LA ILAHE IL-LALL-LLAH)"**. Atëherë do të shkojnë melaiket dhe do t'i nxjerrin prej aty. Do t'i dallojnë ata në bazë të shenjave të sexhdes".²⁴⁰

Pra, përveç Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), do të ndërmjetësojnë edhe Pejgamberët tjerë, edhe melaiket, edhe Shehidat, e edhe muslimanët tjerë.

- Cilat vepra do të ndërmjetësojnë për njeriun?

Ka vepra ('*ibadet-e*), të cilat, nëse njeriu i bën në dunja, ato do të ndërmjetësojnë te All-llahu në Ditën e Gjykimit. Prej tyre janë:

1. Agjërimi dhe Kur'ani

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Agjërimi dhe Kur'ani do të ndërmjetësojnë te All-llahu në Ditën e Gjykimit. Do të flet agjërimi dhe do të thotë: "O Zot, lehtësoja gjendjen dhe fale, sepse ky ka qëndruar në dunja duke agjëruar ditën e nxehtë, ka qëndruar pa ngrënë dhe pa pirë për hirë Tëndin!" Do të flet Kur'ani dhe do të thotë: "O Zot,

²⁴⁰ Transmeton Muslimi.

lehtësoja gjendjen dhe fale, sepse ky i ka kaluar netët pa gjum, duke e lexuar fjalën Tënde!" All-llahu do t'ua pranojë këtë ndërmjetësim dhe do t'ua lehtësojë gjendjen atyre".²⁴¹

2. Leximi i du'a-së pas ezanit

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Ai njeri i cili pasi të thërret ezani e thotë këtë du'a: O All-llahu im, Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që do të falet, jepi Muhammedit ndërmjetësimin dhe nderimin dhe ngreje atë në vendin e lavdishëm, të cilin ia ke premtuar!, atij do t'i mundësohet ndërmjetësimi im në Ditën e Gjykimit".²⁴²

3. Dërgimi i salavateve mbi Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Kush dërgon salavate mbi mua në mëngjes dhjetë herë dhe në mbrëmje dhjetë herë, atij do t'i mundësohet ndërmjetësimi im në Ditën e Gjykimit".²⁴³

²⁴¹ Transmeton Ahmedî - Nga 'Abdull-llah ibn 'Amri. Sipas Shej'h Albanit *hadith*-i është *hasen*. Shih "Temamul Minneh".

²⁴² Transmeton Bu'hariu - Nga Xhabiri.

²⁴³ Transmeton Tabaraniu me dy senede, njëri prej tyre është i mirë. Shih "Mexhmeuz-Zevaid" dhe "Sahihut-tergib ve terhib".

**** Disa çështje të rëndësishme ****

- Si do ta përballojnë njerëzit diellin mbi koka?

Në Ditën e Gjykimit, dielli do të zbret mbi kokat e njerëzve dhe njerëzit do t'i mbulojnë djersët: dikënd deri te nijet e këmbëve, dikënd deri në gjunj, dikënd deri në mes, dikënd derin në fyt, e dikënd do ta mbulojnë djersët e tij. E si do ta përballojnë njerëzit këtë?

Shumë njerëz i analizojnë gjërat në bazë të logjikës së tyre dhe thonë: Dielli është shumë lartë dhe nëse pak zbret, shkrihet e gjithë dunjaja, ndërsa në A'hiret do të jetë mbi kokat e njerëzve, e si do ta përballojnë këtë?

Shej'h Ibni Uthejmini (*rahimehull-llah*) thotë: "Përgjigja e kësaj është në dy mënyra: E para, është ngase ajo është botë e *gajb-it*, është fshehtësi dhe ne nuk e dimë se si është A'hireti. E dyta, është ngase në atë ditë njeriu nuk do të jetë me fuqinë që e ka sot, por do ta ketë një fuqi më të madhe, ku do të qëndrojnë në këmbë pesëdhjetë mijë vite, pa ngrënë dhe pa pirë".

Kjo tregon se njeriu në atë ditë do të ketë fuqi tjetër, All-llahu do t'ia mundësojë të qëndrojë në atë mënyrë, por si, kjo është një botë e *gajb-it* (e fshehtë), për të cilën ne nuk kemi mundësi të themi diç, përveç asaj që e ka thënë All-llahu dhe Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Kush janë As'habul A'raf-i?

Në Ditën e Gjykimit, ku njerëzit e mirë do të hynë në Xhennet dhe njerëzit e këqinjë do të hynë në Xhehennem, do të mbeten një grupë, të cilët quhen *As'habul A'raf* (banorët

e A'rafit). Këta janë një grup, që nuk kanë hyrë as në Xhennet e as në Xhehennem. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَبَيْنَهُمَا حِجَابٌ وَعَلَى الْأَعْرَافِ رِجَالٌ يَعْرِفُونَ كُلًّا بِسِيمَاهُمْ ۖ وَنَادَوْا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ أَنْ سَلِّمُوا
عَلَيْكُمْ ۖ لَمْ يَدْخُلُوهَا وَهُمْ يَطْمَعُونَ ﴿٤٦﴾ وَإِذَا صُرِفَتْ أَبْصَارُهُمْ تِلْقَاءَ أَصْحَابِ النَّارِ
قَالُوا رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٤٧﴾

"Një mur do t'i ndajë ata, ndërsa në lartësitë e tij do të ndodhen njerëz, të cilët i njohin të dyja palët sipas tipareve. Ata do t'u thërrasin banorëve të Xhennetit: "Paqja qoftë mbi ju!". Ata nuk do të kenë hyrë ende në Xhennet, ndonëse shpresojnë. E kur t'i kthejnë sytë nga banorët e Zjarrit, do të thonë: "O Zoti ynë! Mos na hidh midis këtyre njerëzve të këqij!"." (El-A'raf: 46-47)

Kështu do të qëndrojnë *As'habul A'raf*-i mbi këtë vend të lartë, deri sa duke qëndruar në atë vend, duke e përjetuar këtë frikë dhe këtë dhimbje dhe këtë trishtim, se a do të jenë banorë të Xhennetit apo banorë të Xhehennemit, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), nëpërmjet kësaj, do t'ua lajë (pastrojë) disa gjunahe atyre dhe në fund do t'u thuhet që të hyjnë në Xhennet.

Dijetarët kanë diskutuar shumë, se kush janë këta njerëz? Disa dijetarë kanë thënë: Këta njerëz janë ata që sevabet dhe gjunahet do t'i kenë në një shkallë (baraz). Disa dijetarë tjerë kanë thënë: Këta janë ata njerëz që kanë marur pjesë në *Xhihad* (luftë) për hirë të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), por që kanë shkuar pa leje e prindërve. Dhe dijetarë tjerë, të cilët kanë dhënë shumë mendime në lidhje me *As'habul A'raf*-in. E disa prej dijetarëve kanë thënë: Për deri sa nuk ka *ajet* dhe *hadith*, argument të prerë, se kush janë këta, është më mirë që ne mos të flasim reth tyre dhe të caktojmë se kush janë ata. All-llahu e din më mirë për ta.

- Ku është vendi i atyre që nuk u ka arritur Islami?

Ka njerëz, të cilët kanë ardhur në këtë dunja, kanë jetuar në të dhe kanë vdekur, ndërsa Islami nuk ju ka arritur. Për këta njerëz, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e

tyre. Disa dijetarë kanë thënë se ata janë në Xhehennem, ngase nuk kanë hyrë në Islam. Disa dijetarë tjerë kanë thënë se ata janë në Xhennet, ngase ata nuk i kanë kundërshtuar urdhërat e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Disa të tjerë kanë thënë se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e din se si do të jetë gjendja e tyre. Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë se ky grup do të kenë provim në A'hiret, kur të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Mendimi që shpresojmë se është më i vërtetë dhe më afër argumenteve, është se ky grup, të cilëve nuk u ka arritur asgjë për Islamin, në A'hiret do të kenë provim.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Katër grupe njerëzish do të sprovohen (do të kenë provim) në Ditën e Gjykimit: ata të cilët nuk kanë dëgjuar, nuk kanë ditur të lexojnë apo nuk kanë parë; i çmenduri; ata të cilët kanë qenë në pleqëri të rëndë; dhe ata të cilët kurr nuk kanë dëgjuar për Islamin. Atëherë All-llahu do t'i urdhërojë ata dhe do t'u thotë: "**Hyni në zjarr!**" Nëse hyjnë, ai ju bëhet i fladitshëm dhe i freskët dhe nuk i djegë ata, e pastaj hyjnë në Xhennet. Por, nëse nuk hyjnë në të, atëherë përfundojnë në Xhehennem".²⁴⁴

Disa dijetarë, prej tyre edhe Ibni Abdul Berr dhe pak prej dijetarëve, kanë thënë: Nuk ka argumente të mjaftueshme se njerëzit në A'hiret do të sprovohen në këtë mënyrë. *Hadith*-et që kanë ardhur, i kanë llogaritur të dobëta. Këtë qëndrim e kanë kundërshtuar në këtë mënyrë: Kanë thënë: E para, në A'hiret nuk ka provim, provimi është në dunja. E dyta, të ju thuhet atyre: "hyni në zjarr", kjo është diçka e cila është mbi kapacitetin e njeriut, të kërkosh prej tij aq sa nuk ka mundësi. Për atë, nuk themi për ta asgjë, vetëm All-llahu e din se çka do të ndodhë me ta.

Dijetarët, si Ibn Tejmijje dhe tjerë, e kanë kundërshtuar këtë mendim në formë të përgjithshme, ndërsa Ibn Kajjim El-Xheuzijeh e ka kundërshtuar në mënyrë të hollësishme dhe i ka përmendur deri më ntëmbëdhjetë arsye se pse ky mendim nuk qëndron, dhe ka thënë: "Të thuash se në Ditën e Gjykimit nuk ka provim, kjo nuk është e vërtetë. Provim (obligime) nuk ka në Xhennet, ndërsa para se njeriu të hyjë në Xhennet, ka mundësi të ketë provim. Njeriu ka provim në varr dhe atij i thuhet: "Kush është Zoti yt?", "Cila është feja yte?" dhe "Kush është Pejgamberi yt?". Dhe, njeriu do të ketë provim edhe në A'hiret, All-llahu do t'i urdhërojë që t'i binë në *sexhdeh* Atij dhe do të binë ata që kanë ranun në dunja. Kjo pra është obligim (provim)".

Ndërsa thënia: "kjo është diçka e cila është mbi kapacitetin e njeriut, të kërkosh prej tij aq sa nuk ka mundësi", themi se kjo nuk është prej gjërave që e ngarkon njeriun më shumë se sa ka mundësi. Njeriu kur do të del para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ai më

²⁴⁴ Transmeton Ahmed i me zinxhirë të vërtetë transmetimi. *Hadith*-i është *sahih*. Ky është mendimi i *Shej'hul Islam* Ibn Tejmijjes. Edhe pse, në lidhje me këtë çështje, ka disa *hadith*-e, që disa janë të vërteta e disa janë të dobëta.

do ta sheh veten se është ringjallur dhe më nuk do të ketë vend për të dyshuar. Dhe, në atë ditë do të urdhërojë All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Nëse All-llahu urdhëron edhe në dunja, edhe nëse është e vështirë për neve që ta bëjmë, ne e kemi obligim ta bëjmë. Kështu All-llahu i ka urdhëruar *Beni Israil*-ët:

... فَتُوبُوا إِلَىٰ بَارِئِكُمْ فَاقْتُلُوا أَنفُسَكُمْ ...

"Prandaj kthehuni të penduar te Krijuesi juaj dhe vritni njëri-tjetrin!" (El-Bekarah: 54)

Pra, All-llahu ju ka thënë që, nëse dëshirojnë t'ua pranojë pendimin, ta mbysin veten, dhe kjo nuk është ngarkim i njeriut sa ai nuk ka mundësi. E njëjtë është t'u thuash edhe të hidhen në zjarr. Pejgamberi (*sal-lall-llahu ve sel-lem*) thotë: "Ai i cili hudhet në zjarr, i bëhet atij shpëtim dhe zjarri i bëhet i freskët dhe nuk e djegë atë. Ndërsa ai i cili nuk e çon në vend urdhërin e All-llahut, ai njeri hudhet në Xhehennem".

Megjithatë, mbi të gjitha, është ajo mbi të cilën nuk kemi kurfarë dyshimi, se All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) nuk i bën zullum dhe padrejtësi askujt, dhe atyre që nuk u ka arritur Islami, All-llahu do t'i gjykojë me drejtësinë e Tij në Ditën e Gjykimit; nëse janë prej atyre që e meritojnë Xhennetin, do të jenë prej banorëve të Xhennetit, e nëse janë prej atyre që e meritojnë atë, do të jenë prej banorëve të Xhehennemin. All-llahu e din më së miri.

- Ku është vendi i fëmijëve të vdekur të muslimanëve?

Me pajtimin e gjithë dijetarëve të *Sunnet*-it, fëmijët e vdekur të vegjël të muslimanëve, do të jenë banorë të Xhennetit. Bile do të ndërmjetësojnë edhe për prindërit e tyre. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kur do të ringjallen këta fëmijë²⁴⁵, kur do të dalin para All-llahut, All-llahu do t'u thotë: "Hyni në Xhennet". Ata do të thonë: "O Zot, edhe prindërit tanë". All-llahu do t'u thotë: "Hyni në Xhennet". Ata do të thonë: "O Zot, edhe prindërit tanë". Deri sa All-llahu do t'u thotë: "Hyni në Xhennet, ju, së bashku me prindërit tuaj"."

²⁴⁵ Ata do të ringjallen fëmijë, ashtu si kanë vdekur, ashtu do të ringjallen.

Në një transmetim tjetër, një person e pyeti Ebu Hurajran dhe i tha: "Na i qetso zemrat neve që na ka vdekur ndonjë fëmijë i vogël në dunja, na trego diçka prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), a ka diçka lehtësim për neve?" Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) tha: "Ka thënë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): "Fëmijët e muslimanëve që vdesin të vegjë, do të jenë ata që do të shëtiten nëpër Xhennetet e All-llahut. E pastaj do t'i kapin prindërit e tyre për tesha (apo për dore) dhe nuk do të hyjnë në Xhennet, deri sa t'i marrin edhe prindërit e tyre". "

Ndërsa për në Xhennet, a do të jetojnë si fëmijë apo do të jetojnë si të rritur, këtu dijetarët kanë diskutuar shumë. Disa dijetarë kanë thënë se do të jetojnë si fëmijë dhe do të ecin (shetisin) nëpër Xhennet. Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë se do të arrinë në moshën tridhjetë e tre vjeçkare, sikur gjithë banorët e Xhennetit. All-llahu e din më së miri.

- Ku është vendi i fëmijëve të vdekur të idhujtarëve?

Disa prej dijetarëve kanë thënë se ata janë prej banorëve të Xhehennemit, sepse prindëri e tyre janë në Xhehennem dhe fëmijët shkojnë së bashku me prindërit e tyre, ngase për ta, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), për në dunja, ka thënë: "Ata janë prej tyre", që don të thotë se ata shkojnë së bashku me ta.

Disa dijetarë tjerë kanë thënë se ata do të jenë në Xhennet, ngase Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ka parë Ibrahimin (*'alejhis-selam*), i cili i kishte përreth shumë fëmijë. E pastaj kur i thanë: "O i Dërguari i All-llahut, a edhe fëmijët e idhujtarëve?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Po, edhe fëmijët e idhujtarëve".²⁴⁶

E disa dijetarë tjerë kanë thënë se edhe fëmijët e idhujtarëve do të sprovohen në A'hiret, sikur që do të sprovohen ata që i përmendëm më herët. Ky është mendimi i *Shej'hul Islam Ibn Tejmijes*, *Ibn Kajjimit*, *Ibn Kethirit* dhe disa dijetarëve tjerë.

Ajo që mendojmë se është më afër të vërtetës, është se fëmijët e vdekur të idhujtarëve do të kenë provim në A'hiret, kur të dalin para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

²⁴⁶ Nga Berkaniu.

**** Xhenneti ****

- A egziston tash Xhenneti?

Sipas 'akide-s së Ehli Sunnet-it, sipas argumenteve të Kur'anit dhe Sunnet-it, Xhenneti dhe Xhehennemi egzistojnë (janë të krijuar dhe egzistojnë edhe sot).²⁴⁷ All-llahu (subhanehu ve te'ala) nëpër shumë ajet-e përmendë se Xhenneti është i pregaditur, dhe për muslimanët e mirë, thotë:

... أَعَدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٣﴾

"... që është përgatitur për të devotshmit." (Ali 'Imran: 133)

Ndërsa për Xhehennemin, thotë:

... أَعَدَّتْ لِلْكَافِرِينَ ﴿١٣٤﴾

"... i cili është përgatitur për jobesimtarët." (Ali 'Imran: 131)

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), një ditë prej ditëve, tha: "Sikur të kishit parë ju çka kam parë unë, do të kishit qeshur pak dhe do të kishit qarë shumë!" I thanë: "Çka ke parë ti, o i Dërguari i All-llahut?" Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) tha: "E kam parë Xhennetin dhe e kam parë zjarrin e Xhehennemit!"²⁴⁸

²⁴⁷ Grupet e devijuara, si Mu'tezilët dhe Kaderitë, sikurse për Xhehennemin ashtu edhe për Xhennetin, besojnë se nuk janë të krijuar, por do të krijohen pasi të ringjallen njerëzit.

²⁴⁸ Transmeton Muslimi - Nga Enesi.

- Kush do të hyjë i pari në Xhennet?

I pari i cili do të hyjë në Xhennet është Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Unë jamë zotëriu i gjithë bijëve të Ademit në Ditën e Gjykimit. Unë jamë i pari i cili do të trokas në derën e Xhennetit". Në një transmetim tjetër, thuhet: "Do të pyesin melaiket (rojet) e Xhennetit dhe do të thonë: "Kush është?" Do të them: "Jam Muhemmedi!" Atëherë do të hapet dera dhe i pari që do të hyjë në Xhennet jamë unë".²⁴⁹

Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ne jemi të fundit (si ummet) dhe të parët (që do të hyjnë në Xhennet)".²⁵⁰

Pra, nuk do të hyjë në Xhennet asnjë Pejgamber, pa hyrë Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), dhe nuk do të hyjë në Xhennet asnjë ummet, pa hyrë ummet-i i Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

I pari i këtij ummet-i, që do të hyjë në Xhennet pas Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), është Ebu Bekër Es-Siddikku (*radijall-llahu 'anhu*)²⁵¹, e pastaj pas tij do të hyjnë fuakratë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Do të hynë në Xhennet fukaratë, para atyre të pasurive, pesëqind vite më herët".²⁵²

- Kush është i fundit që do të hyjë në Xhennet?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "I fundit i cili do të del prej Xhehennemit, do të del zhag, dhe kur do të del, do ta kthejë kokën kah Xhehennemi dhe do të thotë: "O Zot, çfarë më keni dhënë mua, nuk i ke dhënë askujt në dunja!" Pastaj do të niset për në Xhennet. All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, hyn në Xhennet**". Do të niset ky njeri për në Xhennet dhe kur do ta sheh atë, do të thotë: "O Zot, nuk paska vend për mua!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, shko dhe hyn në Xhennet**". Ai do të thotë: "O Zot, po nuk paska vend në Xhennet, ku të hyjë unë?" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, shko dhe hyn në Xhennet**". Do të niset ky njeri për në Xhennet dhe kur do ta sheh, do të kthehet mbrapa dhe do të thotë: "O Zot, po nuk paska vend për mua në Xhennet!" Atëherë All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, hyn në**

²⁴⁹ Transmeton Muslimi - Nga Enesi.

²⁵⁰ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Nesaiu - Nga Ebu Hurajrah.

²⁵¹ Transmeton Muslimi - Nga Enesi.

²⁵² Transmeton Tirmidhiu, Ahmedi dhe Ibn Hibbani - Nga Ebu Se'idi dhe Ebu Hurajrah.

Xhennet dhe ti ke vend në të sa dhjetë herë dunjaja!" Ai do të thotë: "O Zot, a po tallesh me mua?!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, nuk tallem, por Unë jam Ai i cili kam mundësi dhe fuqi dhe e bëj atë që dëshiroj!**"."²⁵³

Në një transmetim tjetër, nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi (radijall-llahu 'anhu), thuhet: "Pasi do të del ky njeri prej Xhehenemit, kur do ta sheh Xhehennemin dhe kur do ta sheh që ka shpëtuar, do të thotë: "Çka kam fituar unë, nuk ka fituar askush prej mbarë njerëzimit". Dhe duke qenë në atë gjendje, do ta sheh në një vend larg një dru (pemë), një hije dhe një ujë, dhe do të thotë: "O Zot, a ma mundëson të qëndroj pranë atij drurit dhe të pij prej atij ujit?" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, nëse ta mundësoj atë, a do të kishe kërkuar diçka tjetër?**" Do të thotë: "Jo, o Zot". Atëherë All-llahu do t'ia mundësojë të qëndrojë pranë asaj pemës (edhe pse All-llahu e din se ai nuk ka mundësi të bëjë durim). Duke qëndruar në atë vend, do ta sheh më larg një pemë tjetër më të mirë dhe më të bukur. Pasi do të bëjë durim një kohë, do t'i humbet durimi dhe do të thotë: "O Zot, a ma mundëson të qëndroj pranë asaj pemës tjetër?!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, a nuk më premtove që më nuk do të kërkoj diçka tjetër?**" Do të thotë: "O Zot, ma mundëso vetëm edhe këtë dhe më nuk do të kërkoj diçka tjetër". Atëherë All-llahu do t'ia mundësojë që të qëndrojë pranë kësaj pemës tjetër (edhe pse All-llahu e din se ai nuk ka mundësi të bëjë durim). Duke qëndruar aty, do ta sheh më larg një pemë tjetër më të mirë dhe më të bukur. Pasi do të bëjë durim një kohë, do t'i humbet durimi dhe do të thotë: "O Zot, a ma mundëson të qëndroj pranë asaj pemës tjetër?!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, a nuk më premtove që më nuk do të kërkoj diçka tjetër?**" Do të thotë: "O Zot, ma mundëso vetëm edhe këtë dhe më nuk do të kërkoj diçka tjetër!" Atëherë All-llahu do t'ia mundësojë që të qëndrojë pranë kësaj pemës tjetër, e cila është pranë derës së Xhennetit. Duke qëndruar aty, do t'i dëgjojë zërat e njerëzve në Xhennet. Pasi do të bëjë durim një kohë, do t'i humbet durimi dhe do të thotë: "O Zot, a ma mundëson edhe mua të hyjë në Xhennet?!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, a nuk më premtove që më nuk do të kërkoj diçka tjetër?**" Do të thotë: "O Zot, ma mundëso vetëm edhe të hyjë në Xhennet dhe më nuk do të kërkoj diçka tjetër!" Atëherë All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, hyn në Xhennet dhe ti ke në të sa gjithë dunjaja dhe çka ka në të!**" Do të thotë: "O Zoti, a po tallesh me mua?!" All-llahu do t'i thotë: "**O robi Im, hyn në Xhennet dhe ti ke në të sa dhjetë herë dunjaja!**" Do të thotë: "O Zot, a po tallesh me mua, ndërsa Ti je Rabbul 'Alemin (Zoti i gjithë botërave)?!" Atëherë 'Abdull-llah ibn Mes'udi filloi të qeshë dhe tha: "A nuk po më pyetni se pse po qeshi?" I thanë: "Pse po qeshë, o 'Abdull-llah?" Tha: "Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), kur na e tregoi këtë hadith, qeshi dhe tha: "A nuk po më pyetni se pse po qeshi?" I thamë: "Pse po qeshë, o i Dërguari i All-llahut?" Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) tha: "Ngase me këtë njeri (rob) qeshet edhe All-llahu!"."²⁵⁴

²⁵³ Transmeton Muslimi.

²⁵⁴ Transmeton Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi.

- Cilat janë dyert e Xhennetit?

Xhenneti i ka tetë dyer. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Xhenneti i ka tetë dyer, njëra prej tyre quhet Rajjan, nuk do të hyjë nga kjo derë, përveç atyre që kanë agjëruar për hirë të All-llahut".²⁵⁵

Në një hadith tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ai i cili e ka falur namazin, do të hyjë nga dera e namazit; ai i cili ka dhënë sadaka, do të hyjë nga dera e sadakasë; ai i cili ka agjëruar, do të hyjë nga dera Rajjan; ai i cili ka luftuar në rrugë të All-llahut, do të hyjë nga dera e Xhihadit".²⁵⁶

Në transmetime tjera, përveç këtyre katër dyerve, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka përmendur edhe emrat e dyerve tjera. Një derë tjetër quhet *El-Ejmen*, nga e cila do të hynë ata që për çdo gjë janë mbështetur te All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Një tjetër derë quhet *El-Valid*, nga e cila do të hynë ata që i kanë rrespektuar prindërit e tyre. Dera tjetër quhet *LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH*, nga e cila do të hynë ata që vazhdimisht e kanë thënë dhe e kanë zbatuar këtë fjalë. Ndërsa për derën tjetër, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa dijetarë kanë thënë se është dera e pendimit, ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë se është dera e Haxhxhit.

Pra, dyert e Xhennetit janë tetë: 1. Dera e namazit; 2. Dera e sadakasë; 3. Dera e agjërimit; 4. Dera e Xhihadit; 5. Dera *El-Ejmen*; 6. Dera *El-Valid*; 7. Dera *LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH*; 8. Dera e pendimit apo dera e Haxhxhit.

- Kur hapen dyert e Xhennetit?

Dyert e Xhennetit ka kohë që hapen dhe mbyllen. Ka dy transmetime të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), që na tregojnë se dyert e Xhennetit hapen duke qenë në këtë dunja.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Dyerte e Xhennetit hapen çdo të hënë dhe të enjte. All-llahu i falë ata që nuk i kanë bërë shirk Atij, dhe ngriten veprat, përveç të atyre që janë të hidhëruar në mes vete, All-llahu ju thotë melaikeve: **"Pritni këta të dy deri sa të**

²⁵⁵ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Sehl ibn Sa'di.

²⁵⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

pajtohen! Pritni këta të dy deri sa të pajtohen! Pritni këta të dy deri sa të pajtohen!".²⁵⁷

Në një transmetim tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Në muajin Ramazan, hapen dyert e Xhennetit, mbyllen dyert e Xhehennemit dhe prangosen shejtanët".²⁵⁸

Pra, dyert e Xhennetit hapen çdo të hënë dhe të enjte dhe në muajin Ramazan.

- Sa shkallë ka Xhenneti?

Xhenneti i All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) nuk është një shkallë, por është disa shkallë. Njerëzit, në bazë të *iman*-it që e kanë pasur në dunja, do të jenë në shkallët e Xhennetit. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَلِكُلِّ دَرَجَةٍ مِمَّا عَمِلُوا ...

"Secili do të ketë shkallën e tij, sipas veprave që ka bërë." (*El-En'am*: 132)

Gjithashtu thotë:

... فَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ عَلَى الْقَاعِدِينَ دَرَجَةً ...

"All-llahu i ngre një shkallë më lartë ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta." (*En-Nisa'*: 95)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Xhenneti i ka njëqind shkallë. Secila shkallë (prej njërës deri te tjetra) është sa ka prej në tokë deri në qiell. Këto shkallë janë për ata që luftojnë në rrugë të All-llahut. Kërkojeni prej All-llahut Xhennetul Firdeus-in. Xhennetul Firdeus-i është në mes (të Xhennetit) dhe lartë (Xhennetit) dhe mbi të është 'Arshi i All-llahut".²⁵⁹

²⁵⁷ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁵⁸ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁵⁹ Transmeton Bu'hariu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Mu'adhi, Ebu Hurajrah dhe 'Ibeadetu ibn Es-Samiti.

Shkalla më e lartë në *Xhennetul Firedevs* është shkalla e cila quhet *El-Vesileh*, e cila i takon vetëm një njeriu. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kur ta dëgjoni *ezan-in*, thoni ashtu siç thotë *muezin-i* dhe pastaj dërgoni *salavat-e mbi mua*, sepse kush dërgon një herë *salavat-e mbi mua*, All-llahu dërgon mbi të dhjetë herë. Kërkoni prej All-llahut që të ma jepë *mua Vesile-n*, se ajo është një shkallë që nuk i takon askujt, pos një robi prej robëve të All-llahut. Shpresoj që unë të jem ai".²⁶⁰

Pra, Xhenneti i ka njëqind shkallë, ndërsa shkalla më e lartë në Xhennet është shkalla *El-Vesileh*, e cila i takon vetëm Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Kujt i takojnë pallatet e Xhennetit?

Në Xhennetin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) ka pallate, ndërtesa dhe dhoma, të cilat i ka përshkruajtur Islami, Kur'ani dhe *Sunnet-i*. Disa prej tyre, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka përmendur me emër dhe na ka treguar se atyre njerëzve ju takjnë pallate të Xhennetit, e disa të tjerë i ka përmendur me punët e tyre. Ato të cilët i ka përmendur me emra, janë:

1. *'Hadixheja* (*radijall-llahu 'anha*), *bashkëshortja e Pejgamberit* (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)

Një ditë prej ditëve, Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i erdhi Xhibrili (*'alejhislam*) dhe i tha: "O Muhammed, është duke ardhur te ti *'Hatixheja*, është duke ta sjellur *ushqimin dhe pijen*, kur të vjen ajo, bëri *selam* prej All-llahut, dhe bëri *selam* prej meje, dhe përgëzoje atë me një pallat, i cili është prej diamanti (*gurëve të çmuar*)".²⁶¹

2. *'Umer ibnul 'Hattabi* (*radijall-llahu 'anhu*)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Duke fjetur, e pash një endër, e pash veten sikur jamë në Xhennet dhe e pash një grua e cila merte abdes pranë një shtëpie të Xhennetit. Bëra pyetje dhe thash: "Për kënd është kjo shtëpi dhe për kënd është kjo grua në Xhennet?" Më thanë: "Kjo është për *'Umer ibul 'Hattabin*". E kujtova xhlozinë e *'Umerit* dhe ia ktheva shpinën që mos ta shikoj atë grua". *'Umeri* (*radijall-llahu 'anhu*) tha: "O i Dërguari All-llahut, a edhe në ty të xhelozojmë?!"²⁶²

²⁶⁰ Transmeton Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibni 'Amr ibni 'Asi.

²⁶¹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁶² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Xhabiri.

3. Asieja, gruaja e Faraonit

Kjo grua, prej torturave të mëdhaja të Faraonit, në momentet e fundit, e luti Allahun dhe tha:

... رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ وَنَجِّنِي مِنْ فِرْعَوْنَ وَعَمَلِهِ وَنَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ

الظَّالِمِينَ ﴿١١﴾

"O Zoti im! Ndërtromë një shtëpi tek Ti, në Xhennet; më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!" (Et-Tahrim: 11)

Përveç atyre me emra, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka përmendur edhe disa të cilëve nuk ju dihen emrat, por në bazë të punëve të tyre, fitojnë pallate në Xhennetin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ato janë:

1. Ata që ndërtojnë xhami për hirë të All-llahut

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kush e ndërton një xhami për hirë të All-llahut, All-llahu ia ndërton një shtëpi në Xhennetin e Tij".²⁶³

2. Ai që i ushqen fukaratë, ai i cili flet fjalë të buta, ai i cili agjëron për hirë të All-llahut dhe ai i cili falet natën, kurtë tjerët janë në xhum

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Në Xhennet ka dhoma, që nga jashtë duket brendia e tyre dhe nga brenda duket e jashtëmeja e tyre: për atë që i ushqen fukaratë; për atë që flet fjalë të buta; për atë që agjëron për hirë të All-llahut; dhe për atë që falet natën, kur të tjerët janë në gjum".

3. Ai i cili i falë dymbëdhjetë rek'at-e namaz nafileh gjatë ditës

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ai i cili i falë dymbëdhjetë rek'at-e brenda ditës²⁶⁴, All-llahu ia ndërton atij një shtëpi në Xhennet".²⁶⁵

²⁶³ Transmeton Imam Ahmedi - Nga 'Abdull-llah Ibn 'Abbasi. Ngajshëm transmetojnë edhe Bu'hariu, Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga 'Uthman ibn Affani.

²⁶⁴ Këto dymbëdhjetë rek'at-e janë: dy rekat-et sunnet para farz-it të sabahut; katër reka't-et sunnet para dhe dy rek'at-et sunnet pas farz-it të drekës; dy rek'at-et sunnet pas farz-it të akshamit; dhe dy rek'at-et sunnet pas farz-it të jacisë.

²⁶⁵ Transmeton Muslimi, Ahmedi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxheh - Nga Ummi Habibeh.

- Si t'i mbjellësh pemët tua në Xhennet?

Njeriu ka mundësi që prej në dunja t'i mbjellë pemët në Xhennet. Si në dunja që njeriu mundohet ta ndërtojë shtëpinë, ta zbukuron atë, ta zbukurojë jetën etj., ashtu ka mundësi ta zbukurojë edhe A'hiretin e tij. Kur e pyetën një prej të parëve, i cili quhej Ibrahim ibn Ed-hem: "Përse ne e duam dunjanë, ndërsa e urrejmë vdekjen?", ai tha: "Ngase ju e keni ndërtuar dunjanë dhe e keni prishur A'hiretin!".

Në Xhennet ka pemë, për të cilat Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Drunjët (pemët) e Xhennetit, rrënjët e tyre janë prej ari".²⁶⁶ Dhe ka thënë: "Ka pemë të Xhennetit, që hija e saj është sa të udhëtojë një kalorës njëqind vite".²⁶⁷ Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ka përmendur një pemë e cila quhet *Tuba*²⁶⁸, një tjetër e cila quhet *Sidretul Munteha* dhe pemë të shumta të Xhennetit.

Për t'i mbjellur pemët e Xhennetit, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Natën e Isra'-së dhe Mi'raxh-it e takova Ibrahimin, i cili më tha: "O Muhammed, bëri selam ummet-it tënd prej meje dhe thuaju atyre se Xhenneti i All-llahut është tokë pjellore, uji i tij është ujë i freskët dhe i ëmbël, ndërsa pemët në Xhennet mbjellen me: SUBHANALL-LLAH, ELHAMDULIL-LAH, LA ILAHE IL-LALL-LLAH, ALL-LLAHU EKBER!".²⁶⁹

Pra, pemët e Xhennetit mbjellen me *dhikr*: SUBHANALL-LLAH, ELHAMDULIL-LAH, LA ILAHE IL-LALL-LLAH, ALL-LLAHU EKBER!

- Cilët janë lumenjtë e Xhennetit?

Në Xhennetin e All-llahut ka lumenj dhe lumenjtë e Xhennetit nuk krahasohen me lumenjtë e dunjasë, edhe pse All-llahu i ka përmendur dhe na i ka përshkruar ato dhe emërtimet janë të njerjta, por dallimi është shumë i madh. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

²⁶⁶ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Hibbani dhe Bejhekiu - Nga Ebu Hurajrah.

²⁶⁷ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Se'idi.

²⁶⁸ Transmeton Ahmedi, Ibni Xheriri dhe Ibni Hibbani - Nga Ebu Se'id El-Hudriju.

²⁶⁹ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se *hadith*-i është *hasen* - Nga 'Abdull-llah ibn Mes'udi.

... فِيهَا أَنْهَرُ مِنْ مَاءٍ غَيْرِ آسِنٍ وَأَنْهَرُ مِنْ لَبَنٍ لَمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ وَأَنْهَرُ مِنْ حَمْرٍ لَذَّةٍ لِلشَّرْبِينَ
وَأَنْهَرُ مِنْ عَسَلٍ مُصَفًّى ...

"... një vend, ku ka lumenj me ujë vazhdimisht të pastër, lumenj qumshti që nuk prishet, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pijnë dhe lumenj prej mjaltit të kulluar." (Muhammed: 15)

Këta emërtime, vetëm emrat i kanë të njerjtë, ngase mjalti i Xhennetit, uji i tij, vera e tij dhe qumshti i tij, me ato të dunjasë, nuk krahasohen; vetëm emrat i kanë të njejtë, ndërsa cilësia e tyre dallon shumë dhe nuk krahasohen në asnjë aspekt.

Prej lumenjëve të Xhennetit, është një lum, të cilin All-llahu ia përmendi Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe tha:

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ

"Vërtet, Ne ta kemi dhënë ty Keutherin." (El-Keuther: 1)

Një lum tjetër quhet *Barik*, të cilin e ka përmendur Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe ju takon Shehidave.²⁷⁰

Në një *hadith* tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka përmendur katër lumenj të Xhennetit dhe ka thënë: "Sejhani, Xhejhani, Nili dhe Furati, janë prej lumenjëve të Xhennetit".²⁷¹

Pra, lumenjë e Xhennetit janë: 1. Lumi prej uji të flladitshëm; 2. Lumi prej qumshti; 3. Lumi prej vere; 4. Lumi prej mjaltit të kulluar; 5. *Keutheri*; 6. Lumi *Barik*; 7. *Sejhani*; 8. *Xhejhani*; 9. *Nili*; 10. *Furati*.

²⁷⁰ Transmeton Ahmedi, Taberani dhe Hakimi - Nga 'Abdull-llah ibn 'Abbasi.

²⁷¹ Transmeton Muslimi dhe Imam Ahmedi në "*Musned*" - Nga Ebu Hurajrah.

- A ka natë në Xhennet?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... وَهُمْ رَزَقُهُمْ فِيهَا بُكْرَةً وَعَشِيًّا ﴿٦٢﴾

"... dhe do të ushqehen në mëngjes dhe në mbrëmje." (Merjem: 62)

Komentuesit e Kur'anit, si Ibn Kethiri dhe tjerë, kanë thënë: "Mëngjes dhe mbrëmje" nuk don të thotë që ka ditë dhe natë. Imam Kurtubiu ka thënë: "Mëngjes dhe mbrëmje" don të thotë që mëngjesi është dritë e cila vjen prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ndërsa mbrëmjen do ta dallojnë me perdet që do të lëshohen dhe dyert që do të mbyllen". Kështu thotë edhe Ibn Tejmijeh dhe dijetarët tjerë.

Pra, në Xhennet nuk ka natë, por mbrëmja do të dallohet me shtruarjen e perdeve dhe mbylljen e dyerve.

Shej'hul Islam Ibn Tejmijeh (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Në Xhennet nuk ka diellë dhe nuk ka hënë, nuk ka ditë dhe natë, por ka dritë e cila vjen në të".

- Si do të jenë njerëzit në Xhennet?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Njerëzit në Xhennet do të jenë më gjatësinë e Ademit, i cili ka qenë gjashtëdhjetë kutë".²⁷²

Në një transmetim tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk do të kryejnë nevoja, por çdo send do të del prej djersëve të tyre, që do t'i vijë sikur era e miskut".²⁷³

Gjithashtu, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Njerëzit në Xhennet nuk do të kenë qime në trupat e tyre".²⁷⁴

Mosha e banorëve të Xhennetit do të jetë e njejtë, të gjithë do të jenë tridhjetë apo tridhjetë e tre vjeçarë.²⁷⁵

²⁷² Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁷³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁷⁴ Transmeton Ahmedu dhe Tirmidhiu - Nga Mu'adh ibn Xhebeli.

Gjithashtu, banorët e Xhennetit nuk do të flejnë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Gjumi (përafërsisht) është një lloj vdekje, ndërsa në Xhennet nuk ka gjum".²⁷⁶

Ndërsa transmetimet të cilat flasin se banorët e Xhennetit do të jenë me bukurinë e Jusufit (*'alejhis-selam*), me zemrën e Ejjubit (*'alejhis-selam*), me faljen e Ja'kubit (*'alejhis-selam*) etj., të gjitha janë të dobëta dhe disa prej tyre nuk kanë bazë fare.

Pra, banorët e Xhennetit do ta kenë këtë pamje dhe këtë gjendje: do të jenë me gjatësinë e Ademit (*'alejhis-selam*)²⁷⁷, nuk do të kryejnë nevoja, nuk do të kenë qime në trup dhe nuk do të flejnë.

E pastaj do të vjen një thirrës dhe një zë dhe do t'u thuhet banorëve të Xhennetit: "Ju jeni të rinjë në Xhennet dhe nuk plakeni kurrë, jeni të shëndoshë dhe nuk sëmureni kurrë, jeni të gjallë dhe nuk vdisni kurrë, dhe knaqeni në Xhennet dhe nuk mrziteni kurrë".²⁷⁸

- Burra apo gra ka më shumë në Xhennet?

Në *hadith*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), që Ebu Hurajrah e përmendi këtë dhe tha: "Çdo njeri (*mashkull*) në Xhennet do të ketë nga dy *Hyri*"²⁷⁹, dijetarët kanë thënë se së paku do t'i kenë nga dy *Hyri*, ndërsa ka prej atyre që do të kenë deri shtatëdhjetë e dy *Hyri*, e këto janë Shehidët.²⁸⁰

Andaj, dijetarët kanë thënë se në Xhennet, më së shumti janë gra.

Ndërsa, në një transmetim tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Gratë janë shumica e banorëve të Xhehennemit".²⁸¹

Pra, gratë do të jenë shumicë e banorëve të Xhehennemit, atëherë ku do të ketë më së shumti gra, në Xhennet apo në Xhehennem?

²⁷⁵ Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu - Nga Mu'adh ibn Xhebeli. Në këtë transmetim përmendet moshja tridhjetë e tre vjeçare.

²⁷⁶ Nga Xhabir ibn 'Abdull-llahu dhe Abdurrrhman ibn Aufi.

²⁷⁷ Pra, Ademi (*'alejhis-selam*) ka qenë i gjatë gjashtëdhjetë kutë. Një kutë është e barabartë me përafërsisht 30 cm, që don të thotë se ka qenë i gjatë përafërsisht tridhjetë metra.

²⁷⁸ Transmeton Muslimi, Tirmidhiu, Nesaiu - Nga Ebu Hurajrah dhe Ebu Se'id El-'Hudrijju.

²⁷⁹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

²⁸⁰ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Ahmedi - Nga El-Mikdem ibn Me'd Jekribi.

²⁸¹ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

Imam Ibn Haxher El-Askalani (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Në bazë të këtyre *hadith*-eve kuptojmë se edhe në Xhennet edhe në Xhehennem ka më shumë gra, ngase edhe në dunja gratë janë më shumë". Ndërsa Imam Kurtubniu ka thënë: "Gratë do të jenë në Xhehennem më shumë, e pastaj, kur të dalin muslimanet gjunahqare që kanë qenë në Xhehennemit dhe të hyjnë në Xhennet, atëherë në Xhennet bëhen më shumë gra". All-llahu e din më së miri.

- Çka ka për gratë në Xhennet?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) nëpër *ajet*-e të tëra përmendë edhe për gratë edhe për burrat të mirat e Xhennetit. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيٰوةً طَيِّبَةً ۖ وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ

أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٧﴾

"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira që ka bërë." (En-Nahl: 97)

Pra, çka kanë gratë kanë edhe burrat dhe çka ka burrat kanë edhe gratë. Pallatet e Xhennetit vlejné edhe për burrat edhe për gratë. Lumenjtë e Xhennetit vlejné edhe për burrat edhe për gratë. Ushqimet e Xhennetit vlejné edhe për burrat edhe për gratë. Dhe të gjitha të mirat e Xhennetit vlejné edhe për burrat edhe për gratë.

- Në cilën gjuhë do të flasin banorët e Xhennetit?

Është një transmetim, në të cilin thuhet se Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Doni arabët, ngase unë jam arab, dhe Kur'ani është zbritur në gjuhën arabe, dhe xhennetitë do të flasin në gjuhën arabe".²⁸²

Ky transmetim është i dobët (*daif*), prandaj nuk ka ndonjë argument që na tregon se në çfarë gjuhe do të flasin banorët e Xhennetit. Këtë e din vetëm All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

- Cila është kënaqësia më e madhe në Xhennet?

Xhenneti i All-llahu ka shumë kënaqësi (të mira), por mbi gjitha këto kënaqësi, është një kënaqësi më e madhe. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Banorët e Xhennetit, duke qëndruar në Xhennet, All-llahu ju bën pyetje atyre dhe ju thotë: "A dëshironi diçka që t'u shtohet në Xhennet?" Ata thonë: "O Zot, a nuk na i zbardhe fytyrat tona, a nuk na shpëtove prej Xhehennemit, a nuk na fute në Xhennet, çka mund të kërkojmë diçka më shumë se sa Xhenneti?!" Atëherë hapet Perdeja dhe ju mundësohet banorëve të Xhennetit që ta shohin Fytyrën e All-llahut!"²⁸³

Kënaqësia më e madhe është që njerëzit ta shohin Fytyrën e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاضِرَةٌ ۖ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ ﴿٣٣﴾

"Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin." (El-Kijameh: 22-23)

Gjithashtu thotë:

لِّلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ... ﴿٣٤﴾

²⁸² Hadith *daif*.

²⁸³ Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga Suhejb Er-Rumi.

" Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër (e shohin All-llahun)!" (Junus: 26)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) bënte *du'a* (lutje) dhe thoshte: "O Zot, kërkoj prej Teje të ma mudësosh ta shoh Fytyrën Tënde!".

Në disa transmetime thuhet që çdo të *xhum'a* muslimanët do ta shohin All-llahun (*subhanehu ve te'ala*). Në disa transmetime tjera thuhet se disa njerëz do ta shohin All-llahun në mëngjes dhe mbrëmje.²⁸⁴

Dijetarët, duke u bazuar në argumente të përgjithshme, kanë thënë se njerëzit do ta shohin All-llahun në bazë të punëve dhe *iman*-it të tyre në dunja. Sa më musliman i mirë që ka qenë në dunja, aq më shpesh do ta sheh All-llahun, dhe sa më musliman i dobët që ka qenë në dunja, aq më rrallë do ta sheh All-llahun.

Në një transmetim thuhet se pastaj All-llahu do t'u lexojë njerëzve Kur'an, do t'ua lexojë atyre *Sura-n Er-Rahman* dhe do të kënaqen ata duke e dëgjuar Kur'anin prej vetë All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Por, ky transmetim është i dobët (*daif*) dhe nuk ka bazë.

Pra, kënaqësia më e madhe në Xhennet është kur njerëzit do ta shohin Fytyrën e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). All-llahu na e mundësoftë këtë. AMIN!

²⁸⁴ Ka dijetarë që thonë se transmetimet që flasin për shikimin e All-llahut në mëngjes dhe mbrëmje janë të dobëta (*daif*).

**** Xhehennemi ****

- Ku është Xhehennemi?

Kur kemi treguar për Xhennetin, kemi thënë se Xhenneti është lartë në qiell dhe për këtë nuk ka *i'htilaf* (mospajtime) në mesin e dijetarëve. Dhe, kemi përmendur se Xhenneti më i lartë është *Xhennetul Firdeos*-i dhe mbi të është *'Arsh-i* i All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Gjithashtu, më herët kemi përmendur se shpirti i muslimanëve të mirë ngritet në qiell, deri në qiellin e shtatë dhe regjistrohet në librin *'Il-lij-jin*. Dhe kështu me rradhë.

Në lidhje me Xhehennemin, dijetarët i kanë ndryshuar mendimet e tyre. Disa prej dijetarëve kanë thënë se Xhehennemi është në qiell ashtu si Xhenneti. Argument për këtë e kanë përmendur *hadith*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të *Isra'*-së dhe *Mi'raxh*-it, ku Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) u ngrit në qiell, e pastaj tha: *"E kam parë Xhennetin dhe Xhehennemin"*.

Disa dijetarë tjerë kanë thënë se Xhehennemi është nën tokë (e disa kanë thënë: nën deti) dhe e kanë kundërshtuar mendimin e parë. *Shej'h* Ibni Uttejmini ka thënë: *"Pse ka thënë Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem): "e kam parë Xhehennemin", nuk don të thotë që Xhehennemi është në qiell. (Ngase edhe sot, ti ka mundësi të jeshë dikund lart, si për shembull, duke udhëtuar me aeroplan dhe prej lart ta shohësh tokën, shtëpinë dhe kështu me rradhë). Dhe nuk don të thotë, pse ka thënë: "e kam parë Xhennetin dhe Xhehennemin", të jenë të dyja në një vend, ka mundësi që prej qielli ta kishte pasë parë që Xhehennemi është në tokë"*. Ky mendim i dijetarëve është se Xhehennemi është nën tokë dhe argumente për këtë i kanë përmendur disa transmetime, fjalë të Sahabeve. Pastaj, disa prej dijetarëve e kanë përkrahur këtë mendim dhe janë argumentuar me shpirtërat e këqinj, të cilët fillojnë të ngriten në qiell dhe në qiellin e parë nuk u hapet dera, e pastaj hidhen në tokë dhe regjistrohen në librin *Sixh-xhin*.

Ndërsa disa dijetarë tjerë kanë thënë: Përderisa nuk ka *ajet* dhe *hadith* të vërtetë se ku është Xhehennemi, e jona është që të ndalemi dhe të themi se vetëm All-llahu e din se

ku është Xhehennemi. Këtë e ka thënë Imam Sujuti dhe disa dijetarë tjerë. Ndërsa për disa transmetime që kanë ardhur, thonë se gjitha ato transmetime janë të dobëta (*daif*) dhe se nuk ka asnjë *hadith* të vërteta që argumenton se ku është Xhehennemi.

Më afër dhe më e vërtetë është që të themi se vendin e Xhehennemit e din vetëm All-llahu (*subhanehu ve te'ala*).

- Sa dyer ka Xhehennemi?

Xhehennemi i ka shtatë dyer. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

لَهَا سَبْعَةُ أَبْوَابٍ لِّكُلِّ بَابٍ مِنْهُمْ جُزْءٌ مَّقْسُومٌ

"Ai ka shtatë dyer e për çdo derë do të ketë një pjesë të caktuar." (El-Hixhr: 44)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Xhehennemi i ka shtatë dyer, një derë e tij është për ata që e ngritin shpatën kundër ummet-it tim".

- Kur mbyllen dyert e Xhehennemit?

Dyert e Xhehennemit mbyllen gjatë muajit *Ramazan*, atëherë kur hapen dyertë e Xhennetit. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Në muajin *Ramazan*, hapen dyert e Xhennetit, mbyllen dyert e Xhehennemit dhe prangosen shejtanët".²⁸⁵

Gjithashtu, dyert e Xhehennemit mbyllen kur njerëzit do të dalin në A'hiret, para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), deri në momentin që do të vinë njerëzit pranë dyerve të tij (Xhehennemit). All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَسِيقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَىٰ جَهَنَّمَ زُرًّا ۖ حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوهَا فَتَحَتْ أَبْوَابُهَا ...

²⁸⁵ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

"Jobsimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehennem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij ..." (Ez-Zumer: 71)

Pra, dyert e Xhehennemit mbyllen në muajin *Ramazan* dhe kur njerëzit të dalin para All-llaut (*subhanehu ve te'ala*), e kur të pastrohet Xhehennemi dhe të mbeten në të vetëm jomuslimanët, atëherë mbyllet përgjithmonë dhe më nuk hapen dyert e tij.

- Sa është nxehtësia e zjarrit të Xhehennemit?

Zjarri i Xhehennemit është aq i nxehtë, sa që atë nuk mund ta krahasosh asesi me zjarrin e dunjasë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

فَرِحَ الْمُخَلَّفُونَ بِمَقْعَدِهِمْ خِلْفَ رَسُولِ اللَّهِ وَكَرِهُوا أَنْ يُجَاهِدُوا بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَقَالُوا لَا تَنْفِرُوا فِي الْحَرِّ قُلْ نَارُ جَهَنَّمَ أَشَدُّ حَرًّا لَوْ كَانُوا يَفْقَهُونَ

"Ata që mbetën në shtëpit e tyre, pas daljes (për luftë) të Dërguarit të All-llahut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e All-llahut me pasurinë dhe jetën e tyre dhe thanë: "Mos shkoni në luftë, në vapë!" Thuaju: "Zjarri i Xhehennemit është edhe më i nxehtë!" Veç sikur të kuptonin!" (Et-Teubeh: 81)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Zjarri i dunjas është një pjesë e shtatëdhjetë pjesëve të zjarrit të Xhehennemit". Sahabet i thanë: "O i Dërguari i All-llahut, me qenë edhe sa zjarri i dunjasë, do të kishte mjaftuar". Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Jo, ai është edhe gjashtëdhjetë e nëntë herë më i nxehtë".²⁸⁶

Ndërsa për Xhehennemin, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Kërkoi Xhehennemi leje prej All-llahut dhe tha: "O Zot, ma mundëso që të marr frymë, sepse (prej nxehtësisë së madhe) jamë duke e hëngër veten!" Atëherë All-llahu i dha leje atij që të merr frymë. Dita më e nxehtë kur është në këtë dunja, është frymëmarrja e Xhehennemit (të nxehtë), dhe dita më e ftohetë kur është në këtë dunja, është frymëmarrja e Zemheririt të Xhehennemit (të ftohtë)".²⁸⁷

²⁸⁶ Transmeton Bu'hariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Imam Maliku në "Muvete" - Nga Ebu Hurajrah.

²⁸⁷ Transmeton Bu'hariu - Nga Ebu Hurajrah.

Përveç kësaj, Xhehennemi ka edhe nxehtësinë e tij, edhe gjërat e tij që pëlçasin dhe shpërndahen nëpër trupat e njerëzve. Gjithashtu ka katranin i cili vishet, për të cilin All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

سَرَابِيلُهُمْ مِّنْ قَطِرَانٍ وَتَغَشَىٰ أُجُوهَهُمُ النَّارُ ﴿٥٠﴾

"Rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'uambështjellë fytyrat." (Ibrahim: 50)

Gjithashtu, Xhehennemi ka pluhur dhe tym, në të cilin do të qëndrojnë njerëzit e tij. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk bashkohet pluhuri i atij që është pluhurosur duke luftuar në rrugë të All-llahut me pluhurin e Xhehennemit".²⁸⁸

Kjo është nxehtësia e madhe e zjarrit të Xhehennemit, i cili, sa më thellë që është, aq edhe është më i nxehtë.

Pra, Xhehennemi i ka shkallët teposhtë. Transmeton Ebu Hurajrah (*radijall-llahu 'anhu*) dhe thotë: "Duke qëndruar një ditë me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e dëgjuam një zë, sikur ra diçka. Pastaj Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "A e dëgjuat këtë zë?" I thamë: "Po, o i Dërguari i All-llahut". Ai tha: "A e dini çka është ky zë?" Thamë: "All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri". Atëherë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Ky është një gurë, i cili është lëshuar në Xhehennem para shtatëdhjetë viteve, ndërsa sot ka arritur në fundin e saj".²⁸⁹

Kjo pra është thellësia e zjarrit të Xhehennemit, që në fund të tij do të jenë ata që i ka përmendur All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), ku thotë:

إِنَّ الْمُنْفِقِينَ فِي الدَّرَكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ ...

"Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehennemit ..."
(*En-Nisa'*: 145)

²⁸⁸ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se *hadith*-i është *hasen-sahih* - Nga Ebu Hurajrah.

²⁸⁹ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

- Si do të jenë njerëzit në Xhehennem?

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) trupat e njerëzve në Xhehennem do t'i zmadhojë shumë. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Trupi i tyre do të zmadhohet aq shumë, saqë prej te veshi i njërit prej tyre e deri te shpina (qafa) e tij, do të jetë sakur të udhëtojë njeriu shtatëqind vite". Ndërsa në një transmetim tjetër, ka thënë: "Vetëm një dhëmballë i njeriut në Xhehennem, do të jetë sakur kodra e Uhudit".²⁹⁰

Ky zmadhim do të bëhet që ata ta përjetojnë zjarrin më shumë, saqë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Dhe lëkura e tyre do të jetë aq e trashë, sa njeriu të udhëtojë tri ditë".²⁹¹ Dhe, çdo herë që ju digjet lëkura e tyre, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... كَلَّمَا نَضِجَتْ جُلُودُهُمْ بَدَّلْنَاهُمْ جُلُودًا غَيْرَهَا لِيَذُوقُوا الْعَذَابَ ...

"Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për ta përjetuar dënimin." (En-Nisa': 56)

- Sa janë rojet e Xhehennemit?

Për Xhehennemin, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) ka caktuar disa melek, si roje të tij. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا قُوًا أَنفُسِكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ غِلَاظٌ

شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ﴿٦٠﴾

"O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga Zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbykqirin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhërat e All-llahut, por i zbatojnë menjëherë ato." (Et-Tahrim: 6)

²⁹⁰ Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Hurajrah.

²⁹¹ Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Hurajrah.

Dhe në një ajet tjetër, thotë:

عَلَيْهَا تِسْعَةَ عَشَرَ ﴿٣٠﴾

"Atij i rrinë roje nëntëmbëdhjetë (engjëj)." (El-Mudeth-thir: 30)

Ndërsa kryesori i tyre është një melek, i cili quhet Malik. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَنَادُوا يَمْلِكُ لِيَقْضِ عَلَيْنَا رَبُّكَ قَالَ إِنَّكُمْ مَكْتُوبُونَ ﴿٧٧﴾

"Ata do të thërrasin: "O Malik, le të na vdesë Zoti yt!" Ndërsa Ai do t'u thotë: "Ju do të qëndroni përherë aty!" (Ez-Zu'hruf: 77)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e pa këtë kryesorin e melaikëve, në udhëtimin e tij, në ëndrën e gjatë që e pa, që në fund të saj, e pa një person, që fytyra e tij ishte e trishtueshme dhe vetëm e ndizte një zjarr të madh, sa më shumë që shtohet zjarri, atij i shtohet vullneti që ta ndizte edhe më shumë, e pastaj Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i pyeti melaiket (Xhibrilin dhe Mikailin) dhe ju tha: *"Kush është ky?"* Ata i thanë: *"Ky është Maliku"*.²⁹²

Pra, rojet e Xhehennemit janë nëntëmbëdhjetë (*melek*), ndërsa kryesori i tyre është Maliku.

- Pse gratë janë më shumë në Xhehennem?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: *"E pash Xhenetin dhe e pashë që shumica e banorëve të tij ishin fukaratë, dhe e pash Xhehennemi dhe e pashë që shumica e banorëve të tij ishin gratë"*.²⁹³

Në një transmetim tjetër, tha: *"E pashë Xhehennemin dhe pamje më të trishtueshme se të tij nuk kam parë asnjëherë, dhe e pashë që shumica e banorëve të tij ishin gra"*. I thanë: *"Pse, o i Dërguari i All-llahut?"* Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: *"Sepse ato bëjnë kufr!"*

²⁹² Transmeton Bu'hariu - Nga Semurate ibn Xhundubi.

²⁹³ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

I thanë: "O i Dërguari i All-llahut, a i bëjnë *kufir* All-llahut?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Jo, ato i bëjnë *kufir* burrit dhe të mirave të tij".²⁹⁴

Në një transmetim tjetër, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "O ju gra, jepni *sadaka* sa më shumë, ngase unë ju kamë parë juve shumicë e banorëve të Xhehennemit". Pastaj pyeti një grua dhe tha: "E pse, o i Dërguari i All-llahut?" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Ngase ju i shtoni mallkimet dhe i bëni *kufir* burrit".²⁹⁵ E në një transmetim tjetër qëndron se gratë e asaj kohe, kur i dëgjuan fjalët e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), filluan t'i hiqnin zinxhirët, unazat dhe arin që e patën dhe filluan t'i shpërndanin *sadaka* për hirë të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), për ta shpëtuar veten prej zjarrit të Xhehennemit.²⁹⁶

- A do të përfundojë Xhehennemi?

Ka prej njerëzve që thonë se Xhehennemi do të përfundojë, do të zhduket, do të shkatërrohet dhe kështu me rradhë. Këto janë mendime të gabuara dhe të devijuara.

Sipas 'akide-s së Ehli Sunnet-it, sipas argumenteve të Kur'anit dhe Sunnet-it dhe sipas gjitha fjalëve të dijetarëve të *selef*-it, Xhehennemi nuk përfundon, nuk zhduket dhe nuk shkatërrohet, por ata që kanë vdekur në *kufir* dhe ata që janë banorë të Xhehennemit përgjithmonë, Xhehennemi do të qëndrojë (nuk do të zhduket) dhe ata do të qëndrojnë në të përgjithmonë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٣٩﴾

"Kurse ata që i mohojnë dhe i përgënjeshtrojnë Shpalljet Tona, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të mbeten përgjithmonë." (El-Bekarah: 39)

Gjithashtu thotë:

وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا ...

²⁹⁴ Transmeton Bu'hariu.

²⁹⁵ Transmeton Muslimi - Nga 'Abdull-llah ibn 'Umeri.

²⁹⁶ Transmeton Muslimi.

"Ndërsa atë që nuk i bindet All-llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, All-llahu e shpie në Zjarr, ku do të qëndrojë përherë ..." (En-Nisa': 14)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kur të hyjnë njerëzit në Xhennet dhe ata tjerët në Xhehennem, atëherë vinë melaiket me një kafshë në formë të deles, e marin atë dhe u thonë banorëve të Xhennetit: "A e njihni këtë?" Ata thonë: "Po, kjo është vdekja". Pastaj u thonë banorëve të Xhehennemit: "A e njihni këtë?" Ata thonë: "Po, kjo është vdekja". Atëherë e therrin atë kafshë (vdekjen) dhe u thonë banorëve të Xhennetit: "Ju jeni përgjithmonë në Xhennet dhe nuk ka vdekje në të!" Dhe ju thonë banorëve të Xhehennemit: "Ju jeni përgjithmonë në Xhehennem dhe nuk ka vdekje në të!"²⁹⁷

Pra, në Xhehennem nuk ka vdekje, ai nuk zhduket asnjëherë, por do të qëndrojë përgjithmonë.

²⁹⁷ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Tirmidhiu - Nga Ebu Se'idi.

Kapitulli i gjashtë:

BESIMI NË KADER

**** Besimi në Kader ****

- Si të besojmë në kader?

Besimi në *kader* është kusht i *iman*-it, nëse mungon, mungon *iman*-i. Ai që nuk beson në *kader*-in e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), nuk llogaritet musliman.

Në *hadith*-in e Xhibrilit (*'alejhis-selam*), kur i bëri pyetje Pejgammberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*): "Çka është *imani*?", Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) u përgjigj: "Të besosh All-llahun, *melaiket*, *Librat*, *Pejgamberët*, *Ringjalljen dhe kaderin*".²⁹⁸

Muslimani duhet të besojë bindëshëm dhe pa kurfarë dyshimi, se çdo send që ndodhë mbi sipërfaqen e tokës, çdo gjë që bëhet mbi sipërfaqen e tokës, e madhe apo e vogël, ndodhë me caktimin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), i cili i përfshinë katër etapat²⁹⁹.

Besimi në *kader* është shumë i rëndësishëm, që njeriu të ketë kujdes dhe mos të hyjë me logjikën e tij dhe të bëjë pyetje të tepruara, për t'i kuptuar disa gjëra të *kader*-it, ngase ka urtësi të All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) që kanë të bëjnë me *kader*-in, e që ne nuk i dimë.

'Alijju (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "Kaderi është deti, kush mundohet të hyjë më thellë në të, funoset".

Në vazhdim do ta përmendim një rast, që ndoshta do të na ndihmojë sadopak, që njeriu të kuptojë dhe të din se çdo send është me *kader*-in e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*) dhe me Urtësinë e Tij. Nuk ka diçka që ndodhë me *kader*-in e All-llahut e që në të nuk ka një urtësi. Ebu *Shej'h* El-Esbehani, tregon për një rast që ka ndodhur në kohën e *Beni Israil*-ëve, për një Pejgamber të *Beni Israil*-ëve, dhe thotë: "Ky Pejgamberi i All-llahut, ishte duke pushuar në një vend, që afër tij ishte një pus. Duke qëndruar aty ky Pejgamber i All-llahut (duke e përcjellur ngjarjen), vjen një njeri me kali, ndalet aty, zbret, pin ujë dhe e vazhdon rrugën, mirëpo kur pin ujë, i bjen një qese me para, por

²⁹⁸ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah dhe 'Umer ibn 'Hattabi.

²⁹⁹ Këto etapa do t'i përmendim në vijim. Shih pyetjen e radhës.

nuk e vëren. Pas një kohe, vjen një çoban (bari) me delet e veta, pin ujë dhe e sheh qesen me para, e mer atë dhe e vazhdon rrugën. Pas një kohe, vjen një plak. Ai personi me kali, i cili piju ujë i pari, duke shkuar rrugës, e sheh që qesen me para nuk e ka dhe duke menduar se ku i ka ra, i bije në mend se mund t'i kishte ra te ai bunari dhe kthehet për atje. Kur kthehet, te pushi e gjen atë plakun dhe i thotë: "O ti filan, mos ishte këtu dikush para teje?" Ai i kthen që jo. Pastaj ky i thotë: "Atëherë t'i ma paske marrur mua qesen, nxjerre atë menjëherë!" Ai ia kthen që nuk e ka marrur dhe kështu fillojnë të shtyhen në mes vete, deri sa ky personi me kali, e nxjerr shpatën dhe ia hjekë kokën (e mbytë atë), pastaj e vazhdoi rrugën. Ky Pejgamber i All-llahut, e vëzhgoi ngjarjen komplet. Pasi e pa ngjarjen, tha: "SUBHANALL-LLAH! Njëri i mori paratë, tjetri i humbi dhe nuk ju kthyen, ndërsa i treti u vra pa kurfarë faji!" Pastaj tha: "O Zot, a ma tregon urtësinë e kësaj, pse ndodhi e gjithë kjo?" Atëherë All-llahu (subhanehu ve te'ala) iu përgjigj, i tregoi dhe tha: "O robi Im, babai i atij që ishte me kali, ka qenë hajn dhe ia ka vjedhur paratë babait të atij çobanit!" Ky Pejgamber i tha: "SUBHANALL-LLAH! Po këtë që ai e vrau?" All-llahu (subhanehu ve te'ala) tha: "Ky plaku i cili vdiq (u vra), ka qenë vrasës, e ka vrarë babain e atij i cili ishte me kali!"

Pra, të gjitha këto janë me *kader*, por urtësinë e tyre e din vetëm All-llahu (subhanehu ve te'ala), e ne, nëse nuk e dimë, duhet të thëmi se All-llahu e ka caktuar dhe Ai e din pse.

Përfundimisht, neve na mbetet që të besojmë se çdo gjë është me *kader* dhe me urtësinë e All-llahut (subhanehu ve te'ala). Asnjë gjeth nuk bije në tokë pa urtësinë e All-llahut. Asnjë pikë shiu nuk bije në tokë pa urtësinë e All-llahut. Çdo send All-llahu e ka bërë me *kader*. All-llahu (subhanehu ve te'ala) thotë:

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ﴿٤٩﴾

"Vërtetë, Ne çdo gjë e kemi krijuar me (*kader*) masë të përcaktuar." (El-Kamer: 49)

- Cilat janë etapat e *kader-it*?

Etapat e *kaderit* (të cilat duhet të besohen patjetër) janë katër:

1. Dituria e All-llahut

Çdo send që ndodhë, ndodhë me diturinë e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

2. Shkrimi i All-llahut

Çdo send që ndodhë është e shkruar. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) e ka shkruar çdo send që do të ndodhë deri në ditën e fundit.

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), për të dyja këto etapa, thotë:

﴿ وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبُرِّ وَالْبَحْرِ وَمَا تَسْقُطُ مِنْ

وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظُلْمَتِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴾

"Ai i ka çelsat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di çka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokër në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qarftë (Leuhi Mahfudh)." (El-En'am: 59)

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Gjëjën e parë që All-llahu e krijoi është Lapsi³⁰⁰. Pastaj i tha: "Shkruaj!" I tha: "Çka të shkruaj, o Zot?" I tha: "Shkruaj çdo send që do të ndodhë deri në ditën e fundit!".³⁰¹

3. Dëshira e All-llahut

Çdo send është me dëshirën e All-llahut. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

﴿ وَلَا تَقُولَنَّ لِشَايٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَٰلِكَ غَدًا ﴾ ﴿ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۗ وَادْخُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ

﴿ وَقُلْ عَسَىٰ أَنْ يَهْدِيَنِّي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنْ هٰذَا رَشَدًا ﴾

"Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: "Me siguri që nesër do ta bëj këtë!", pa shtuar: "Në dashtë All-llahu!". Dhe, kur të karrosh (të thuash "në dashtë All-llahu") - kujtoje Zotin tënd e thuaj: "Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo". (El-Kehf: 23-24)

³⁰⁰ Dijetarët kanë thënë se Lapsin që All-llahu e ka krijuar, mos të të shkojë mendja se është si lapsat e kësaj dunjaje, por ajo është një krijsë e veçantë, e cila e ka emrin Laps.

³⁰¹ Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga 'Ubadeh ibn Samiti. Teksti është prej Ahmedit. Tirmidhiu thotë se *hadith*-i është *hasen-sahih-garib*.

4. Krijimi i All-llahut

Çdo send që ndodhë, e ka krijuar All-llahu. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

اللَّهُ خَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ ...

"All-llahu është krijues i çdo gjëje ..." (Ez-Zumer: 62)

Pra, këto janë katër etapat e *kader-it*: dituria e All-llahut, shkrimi i gjitha gjërave, dëshira e All-llahut dhe krijimi: All-llahu e ka krijuar çdo send që do të ndodhë deri në ditën e fundit.

Muslimani, kur e beson *kader-in*, i beson edhe gjitha këto etapa, e nëse dyshon apo mendon ndryshe, atëherë rrezikohet *iman-i* i tij.

- Cilët njerëz kanë devijuar rreth *kader-it*?

Ka njerëz që kanë devijuar, janë ndarë dhe janë larguar prej rrugës së *Ehli Sunnet-it* dhe nuk e kanë besuar *kader-in* sipas Kur'anit dhe *Sunnet-it*. Ka shumë grupe dhe shumë mendime të gabuara dhe të devijuara, e në mesin e gjithë atyre, dijetarët i kanë përmendur dy grupe kryesore, të cilat kanë devijuar rreth *kader-it*. Ato janë:

1. Xhebritë

Këto janë një grup, të cilët mendojnë dhe besojnë se njeriu në këtë botë është i imponuar. Sipas tyre, njeriu nuk bën diçka në këtë botë, përveç se All-llahu ia ka imponuar atë. Dhe mendojnë se njerëzit në këtë botë janë sikur dielli, sikur hëna, sikur yjet dhe sikur gjithë gjërat tjera.

2. Kaderitë

Sipas këtij grupi, njeriu jo që është i imponuar, por është i lirë total dhe çka don ai bën në këtë dunja, ndërsa All-llahu e ka krijuar atë dhe e ka lënë të lirë, dhe atë që e bën njeriu, nuk është me dëshirën e All-llahut. Saqë disa prej kaderive, të cilët janë *gula'* (e kanë teruar), thonë se All-llahu nuk e din se çka do të bëjnë njerëzit, por kur njerëzit e bëjnë, atëherë All-llahu e kupton. All-llahu na ruajtë, kjo kalon edhe në *kufr*.

- A ndodhin edhe të këqijat me kader?

Më herët thamë se çdo send All-llahu e din, çdo send Ai e ka shkruar, çdo send ndodhë me dëshirën e Tij; e nëse e kemi kuptuar të parën, e kuptojmë edhe të dytën. A ka mundësi të ndodhë diçka pa dashur All-llahu? Nuk ka mundësi.

Për atë, ndëgjojmë në disa raste, ndoshta edhe prej hoxhallarëve, që thonë: All-llahu ka dashur që ti të bësh mirë, Ai nuk ka dashur që ti të pishë alkool, të vjedhësh etj., por ti vet ke dashur kështu dhe ti e ke bërë! Kjo është rrezik. Nëse mendon që dikush ka mundësi të bëjë diçka që nuk don All-llahu, atëherë të jep të kuptosh se dëshira jote është mbi dëshirën e All-llahut, ndërsa nuk ka mundësi që dikush të ja kalojë dëshirës së All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Nuk ka mundësi të dalë asnjë send, qoftë edhe më e vogël, prej dëshirës së All-llahut. Për atë, në një rast, një prej njerëzve, i cili nuk ka pasur besim të pastër në *kader* dhe ka thirrur në rrugën e All-llahut, e ka thirrur një jomusliman në Islam. Ai jomuslimani e ka pyetur dhe i ka thënë: "O ti filan, a ka dashur All-llahu që unë të jemë jomusliman apo jo?" Ai i është përgjigjur dhe i ka thënë: "Jo, All-llahu nuk ka dashur!" Ai jomuslimani ia ka kthyer: "Po kush paska dashur?" Ai i ka thënë: "Kështu ka dashur Shejtani, ai të ka mashtruar!" Atëherë ai jomuslimani i ka thënë: "Atëherë Shejtani qenka në një shkallë më të lartë se All-llahu, atëhere unë e besoj Shejtanin!" *SUBHANALL-LLAH*, të thërrasësh në rrugë të All-llahut pa dije dhe me bindje të gabuara, vetëm se devijon edhe më shumë.

Pra, çdo send ndodhë me *kader-in* e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*); edhe *kufr-i*, edhe *shirk-u*, edhe haramet, të gjitha ndodhin me *kader-in* e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Por, si ka mundësi kjo? Kjo ndodhë, ngase dëshira e All-llahut është dy lloje, dhe me këtë dëshirë të All-llahut e cila është dy lloje, ndodhë çdo send në sipërfaqen e tokës:

1. *Irade Keunijeh* (dëshira e All-llahut univverzale)

Kjo dëshirë e All-llahut të jep të kuptosh që çdo send që ndodhë në sipërfaqen e tokës, ndodhë me dëshirën e All-llahut, qoftë ajo e mirë apo e keqe, qoftë ajo *iman* apo *kufr*, qoftë ajo *hallall* apo *haram*, çkado që të jetë, All-llahu me këtë dëshirë dëshiron të bëhet dhe ajo bëhet.

2. *Irade Sher'ijeh* (dëshira e All-llahut fetare)

Me këtë dëshirë të All-llahut, All-llahu i don vetëm të mirat dhe jo të këqijat. Me këtë dëshirë, All-llahu don që gjithë njerëzit të jenë musliman, etj..

Dallimi ndërmjet këtyre dyjave është se, dëshira e All-llahut univerzale patjetër duhet të ndodhë. Nëse All-llahu don diçka me këtë dëshirë, ajo patjetër duhet të ndodhë, çkado që të jetë ajo. Ndërsa dëshira e All-llahut fetare nuk është që patjetër të ndodhë çdo send që All-llahu e don me këtë dëshirë. Për shembull, All-llahu don që gjithë njerëzit të jenë muslima, por nuk janë të gjithë. All-llahu don që njerëzit të mos vriten në mes vete, por ata përsëri vriten. All-llahu don që njerëzit mos të bëjnë gjunahe të mëdhaja, por ata bëjnë, etj..

Nga kjo, dikush mund të mendojë se sherri (e keqja) i kthehet All-llahut, ngase nëse vrasjet, haramet, alkooli, *zina*-ja, droga, bixhozi etj. qekan me dëshirë e All-llahut, atëherë sherri (e keqja) i kthahet All-llahu?! Përgjigjemi se sherri (e keqja) nuk i kthehet All-llahut, se atë që e cakton All-llahu, ajo për All-llahun, ose është mirësi, ose është drejtësi. E si ta kuptojmë këtë? Për shembull, nëse ndodhë një krim mbi sipërfaqen e tokës dhe dy njerëz vriten ndërmjet vete (njëri e vret tjetrin), për All-llahu është njëra prej dyjave: ose e ka vrarë me drejtësi, sepse ai e ka merituar, ka qenë ndonjë zullumqarë, ka vrarë njerëz, ka bërë krime të mëdhaja në tokë etj.; ose është prej atyre që nuk e ka merituar, por All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), me *Rahmet*-in e vet, ia mundëson që ai të jetë Shehid në A'hiret dhe të ngritet në shkallët më të larta të Xhennetit, e kjo është mirësi prej All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Çdo send që ndodhë, prej All-llahut është, ose mirësi, ose drejtësi, dhe nuk del prej këtyre dyjave, dhe sherri (e keqja) nuk vjen prej All-llahut.

- A është njeriu i lirë apo i imponuar?

Kjo pyetje i është bërë edhe *Shej'h* Ibni Utthemint (*rahimehull-llah*), i cili përgjigjen e ka dhënë në një formë shumë të thjeshtë, që ta kuptojë çdokush. Dikush e pyeti: "A është njeriu i lirë apo i imponuar?" *Shej'hu* i tha: "O ti filan, ti që e bërë pyetjen, a e bërë atë me vet dëshirë apo të shtyu dikush me dhunë?" Ai i tha: "Jo, e bëra vet, i lirë". *Shej'hu* i tha: "Ti që ke ardhur në këtë *mexhlis* (në ligjeratë), a ke ardhur me vet dëshirë apo të ka sjellur dikush me dhunë?" Ai i tha: "Jo, kam ardhur me vet dëshirë". *Shej'hu* i tha: "Ti që qëndron këtu, a qëndron me vet dëshirën tënde apo të mban dikush me dhunë?" Ai i tha: "Jo, qëndroj me vet dëshirë". Atëherë *Shej'hu* i tha: "Në këto aspekte, ti je i lirë". Pastaj *Shej'hu* ia bëri edhe disa pyetje tjera dhe i tha: "Ti që ke ardhur në këtë dunja, në këtë kohë (në këtë shekull), a ke zgjedhur ti vetë apo të ka sjellur All-llahu?" Ai i tha:

"Jo, nuk e kam zgjedhur unë". *Shej'hu* i tha: "Prindërit që ti i ke, a i ke zgjedhur ti apo jo?" Ai i tha: "Jo". *Shej'hu* i tha: "Vendin ku ke lindur, a e ke zgjedhur ti apo jo?" Ai i tha: "Jo". *Shej'hu* i tha: "A vdes ti kur don apo kur don All-llahu". Ai i tha: "Kur don All-llahut". Atëherë *Shej'hu* i tha: "Në këto raste, njeriu nuk është i lirë".

Pra, në disa gjëra: kur lindë, në çfarë familje lindë, në çfarë vendi lindë, kur vdes dhe kështu me rradhë, njeriu nuk ka zgjithje në to, nuk ka të drejtë në to asgjë, gjithë është me caktimin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ndërsa në gjërat tjera, njeri është i lirë, edhe pse, edhe këto janë me caktimin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), mirëpo njeriu nuk është i imponuar, i bën ato me dëshirën e vet. Kur i bën ato me dëshirën e vet, a nënkupton se njeriu është plotësisht i lirë dhe çka të dojë ai i bën të gjitha? Përgjigjeja është se edhe dëshira e tij është nën dëshirë e All-llahut. Atë që njeriu e bën me dëshirën e vet, ajo është me dëshirë e All-llahut. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ...

"Po ju nuk mund të dëshironi, përveç me vullnetin e All-llahut!" (El-Insan: 30)

Pra, çdo send ndohë nëse don All-llahu (*subhanehu ve te'ala*). Në disa raste, njeriu nuk ka të drejtë zgjedhje, ndërsa në raste të tjera, njeriu ka të drejtë zgjedhje dhe i bën me dëshirën e tij, e dëshira e tij është e lidhur me dëshirën e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- A mund të arsyetohet njeriu me kader?

Nëse njerëzit arsyetohen me *kader*-in e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), atëherë gjithë feja e All-llahut merret nëpër këmbë, Pejgamberët e All-llahut atëherë nuk kanë vlerë, muslimanët e mirë atëherë nuk kanë vlerë, ato njerëzit e prishur atëherë nuk kanë faj, etj..

Në raste të haramit (gjunaheve) nuk ka arsyetim me *kader*. Një njeri në kohën e 'Umerit (*radijall-llahu 'anhu*), për të cilin u dëshmuar se kishte vjedhur, kur e mori 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) para *Sheri'at*-it, që atij t'i pritej dora, ai tha: "O 'Umer, o 'Halifeja i muslimanëve, unë kam vjedhur dhe kjo është realitet, por kam vjedhur me *kader*-in e All-llahut!" 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) i tha: "Atëherë, edhe ne po ta presim dorën me *kader*". Dhe ia prejtën dorën.

Ata që arsyetojnë me *kader*, e kanë përmendur bisedën ndërmjet Ademit dhe Musait ('*alejhim-mes-selam*). Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Diskutuan Ademi dhe Musai. Musai i tha Ademit: "O Adem, ti je ai që All-llahu të krijoi me duart e tij dhe të futi në Xhennet, ndërsa ti na nxorre prej Xhennetit!" Ademi i tha: "O Musa, a don të më fajsosh ti mua për atë që All-llahu e ka caktuar katërdhjetë vite para se unë të vij në këtë dunja?!" E fitoi Ademi, Musain, me argumente".³⁰²

A është arsyetuar Ademi ('*alejhis-selam*) për gjuhahun e vet me *kader*? Përgjigjeja është: "Jo". Dijetarët kanë thënë: Ademi ('*alejhis-selam*) në këtë e ka përmendur *musibet*-in e vet, sprovën që i ka ndodhur. All-llahu atë e nxorri prej Xhennetit dhe kjo është një sprovë. Kur të ndodhë një sprovë, ke të drejtë të thuash: "All-llahu e ka caktuar". Pra, Ademi ('*alejhis-selam*) e ka përmendur si shkak i *musibet*-it e jo si shkak i gjuhahut.

Në lidhje me këtë *hadith*, disa dijetarë tjerë kanë thënë: Nëse njeriu bën gjuhahë dhe pendohet te All-llahu, ka të drejtë të arsyetohet me *kader*. Njeriu kur gabon, është gabimi i tij dhe *kader*-i, ndërsa kur pendohet, gabimi fshihet dhe mbetet vetëm *kader*-i, për atë, në këtë rast, lejohet të përmendet *kader*-i. Ndërsa, nëse vazhdon në gabim, atëherë është edhe gabimi edhe *kader*-i, dhe nuk mund të arsyetohesh me *kader*, kur gabimi është prezent.

Për atë, nuk i takon asnjë njeriut të arsyetohet me *kader*, as në dunja e as kur të dalim para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

- A lejohet mbështetja në kader?

Nëse njeriu mbështet në *kader*, pa i marur *sebeb*-et (shkaqet), ky është keqkuptim i *kader*-it. Njeriu mund të mbështetet në *kader*, atëherë kur i merr *sebeb*-et, e nëse i merr *sebeb*-et, atëherë kërkohet prej tij të mbështet në All-llahun, e All-llahu e din për secilin, se cila është më e mirë për të dhe për fenë e tij.

³⁰² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

- A lejohet përdorimi i shprehjes "rastësisht"?

Ka prej atyre që thonë se nuk lejohet të thuhet "rastësisht", sepse çdo send është me *kader* dhe nuk ka rastësisht në këtë dunja.

Për All-llahun (*subhanehu ve te'ala*), nuk ka rastësisht, Ai e din çdo send, ndërsa për njerëzit, ka rastësisht, për atë lejohet shprehja "rastësisht" për neve (njerëzve). Për shembull, ka raste kur nuk e ke në plan ta takosh dikënd, por duke e kryer një punë tjetër apo duke shkuar rrugës, e takon atë rastësisht. Rastësisht don të thotë: pa e bërë plan.

Pra, lejohet përdorimi i shprehjes "rastësisht", nëse kuptimi është që për neve ajo është diçka e rastit, ndërsa për All-llahun (*subhanehu ve te'ala*) nuk ka rastësisht.

Thënia "rastësisht" nuk kundërshtohet me *kader*-in dhe lejohet përdorimi i kësaj shprehjeje. *Shej'h* Ibn Utnejmini (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Kështu bile është përdorur edhe në disa *hadith*-e, që Sahabet kanë thënë: "Rastësisht u takuam me Pejgamberin (*sal-lallahu 'alejhi ve sel-lem*)"."

- A lejohet përdorimi i shprehjes "sikur"?

Fjala "sikur", varet se në çfarë rasti përdoret. Nëse dikujt i ndodhë ndonjë *musibet*, është haram (e ndaluar) përdorimi i shprehjes "sikur". Për shembull, të thuash: "Sikur ta kisha dërguar fëmijun në spital, do të ishte shëruar" apo "nuk do të kishte vdekur" etj.. Pejgamberi (*sal-lallahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nëse dikënd e goditë ndonjë *musibet*, mos të thotë "lev (sikur)", ngase me këtë ia hapë derën shejtanit".³⁰³

Në raste tjera, nëse është në pyetje për të njoftuar për diçka, për të lajmruar për diçka etj., lejohet përdorimi i fjalës "sikur". Këtë All-llahu e ka përmendur në Kur'an, ku thotë:

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا ...

³⁰³ Transmeton Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

"Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë përveç All-llahut, si qiejt, ashtu edhe toka, do të shkatërroheshin." (El-Enbija': 22)

Kjo është vetëm njoftim (lajmërim), e nuk është për të kaluarën dhe për ndonjë *musibet*. Kështu edhe Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), kur e përmendi rastin e Musait me 'Hidrin (*'alejhim-mes-selam*), tha: "Sikur Musai të kishte bërë durim, All-llahu do të na kishte treguar edhe shumë gjëra tjera nëpërmjet 'Hidrit".

Dhe rasti tjetër është: nëse përdoret fjala "sikur" për diçka të ardhmen, që ti dëshiron ta arrish atë. Nëse e përdorë për të mirë, ke shpërblim, ndërsa nëse e përdorë për haram, ka gjunah para All-llahut. Për shembull, të thuash: "Sikur All-llahu të më jep pasuri, do të kisha dhënë edhe unë në rrugë të All-llahut", etj.. Nëse thua kështu, me bindje dhe sinqeritet, atëherë ke shpërblim para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Apo të thuash: "Sikur të kisha pasur pasuri, do të kisha shkuar në filan vendin dhe do ta kisha bërë këtë haram dhe atë haram", etj.. Nëse thua kështu, me bindje dhe sinqeritet, atëherë ke gjunah para All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Pra, fjala "sikur", varet se si përdoret, dhe në çfarë aspekti përdoret, ashtu edhe e mer gjykimin.

- A mund të ndryshojë kader-i?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Nuk e kundërshton (ndryshon) kaderin, përveç se *du'a*-ja (lutja) ndaj All-llahut".

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) përmendë në Kur'an se ka mundësi diçka të fshihet dhe të shkruhet diçka tjetër, dhe *kader-i* (caktimi) i All-llahut është dy lloje:

1. *Mubram* – *Kader-i* i cili është i shkruar në *Leuhi Mahfudh*, i cili është vetëm te All-llahu dhe këtë nuk e dinë as *melaiket*, as Pejgamberët e askush tjetër pos All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Kjo nuk ndryshon kurrë, mbetet ashtu.

2. *Mu'alak* – *Kader-i* i cili është i lidhur (i varur), i cili është te *melaiket*. Kjo ka mundësi të ndryshojë, nëse njeriu e lutë All-llahn (*subhanehu ve te'ala*).

Imam Ibn Kajjimi (*rahimehull-llah*) ka thënë: "Varet *du'a*-ja sa është e fuqishme (*kader-i* zbret prej All-llahut, ndërsa *du'a*-ja ngritet te All-llahu). Nëse *du'a*-ja është e fuqishme

(me sinqeritet), e ngritë *kader*-in që është te *melaiket*, ndërsa nëse *du'a*-ja është e dobët (me maje të gjuhës), *kader*-i e mposhtë *du'a*-në dhe ndodhë *kader*-i i cili është te *melaiket*".

Edhe *du'a*-ja që e bën njeriu, e cila e ndryson *kader*-in që është te *melaiket*, edhe kjo *du'a* është *kader*, e cila është e regjistruar në *Leuhi Mahfudh*.

Pra, çdo send që është në *Leuhi Mafudh*, nuk ndryshon asnjëherë. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

يَمْحُوا اللَّهُ مَا يَشَاءُ وَيُثَبِّتُ وَعِنْدَهُ أُمُّ الْكِتَابِ

"All-llahu fshin çfarë të dojë e ngulitë çfarë të dojë (në këtë libër); dhe tek Ai është Libri amëz." (Er-Ra'd: 39)

- Cilët janë dobitë e besimit në kader?

Besimi në *kader* i ka disa dobi (fryte). Prej tyre:

1. Ai i cili beson në *kader*, është i qetë në jetën e tij

Çdo send që ndodhë, ai e din që është me *kader*-in e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ibrahim El-Harbi ka thënë: "Ai i cili nuk e beson *kader*-in, nuk ka mundësi të rahatohet në jetën e tij, sepse nuk mundet t'i kuptojë gjërat".

2. Ai i cili beson në *kader*, i shtohet trimëria

Kjo, ngase ai beson që jeta dhe vdekja janë me *kader*-in e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*). Ai e din që lufta nuk ia shkurton jetën, dhe e din që rahatia nuk ia zgjatë jetën, etj.. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Ajo që të ka ndodhur, nuk ka mundësi mos të të ndodhë, dhe ajo që nuk të ka ndodhur, nuk ka mundësi të të ndodhë".

3. Ai i cili beson në *kader*, i shtohet durimi (*sabri*)

Nëse i vjen ndonjë sëmundje, ai bën durim, ngase e din që është me *kader*. Nëse i ves dikush, ai bën durim, ngase e din që është me *kader*. Nëse ka fukarallëk, ai bën durim, ngase e din se është me *kader*. Dhe kështu me rradhë.

4. Ai i cili beson në kader, i largohet inati dhe xhelozia

Shumë prej njerëzve kanë xhelozitë të madhe dhe nëse e shoh që dikush është duke ecur përpara (është duke përparuar), xhelozia e prishë dhe e sëmurë atë. Edhe pse dijetarët kanë thënë se xhelozia është më e drejtë se të gjitha cilësitë tjera, nëse e shkatërron dikënd, së pari e shkatërron atë që është xheloz. Ndërsa ai i cili beson në *kader*, nuk ka nevojë që ta prishë vetveten, ngase e din se ato ndodhin me *kader*.

Dhe shumë dobi tjera që vijnë prej besimit në *kader*.

Kapitulli i gjashtë:

**BESIMI NË VULËN E
PEJGAMBERËVE**

**** Bid'at-i ****

- Çka don të thotë bid'at?

Në aspektin gjuhësorë, fjala *did'ah* nënkupton: diçka e re, e cila nuk ka qenë më herët.

Në aspektin fetarë, dijetarët *bid'at*-in e kanë definuar në mënyra të ndryshme, edhe pse kuptimi i gjithë asaj është i njëjtë. Disa dijetarë kanë thënë: Afrimi te All-llahu (*subhanehu ve te'ala*), me atë që All-llahu nuk e ka kërkuar, është *bid'at*. Disa dijetarë tjerë kanë thënë: Një rrugë e shpikur, e cila nuk ka bazë në Kur'an dhe në *Sunnet*, nëse e pason atë për t'u afruar te All-llahu, është *bid'at*.

Në formë më të përgjithshme dhe më të plotë, themi: Çdo gjë e cila nuk ka bazë në Kur'an dhe nuk ceket në *hadith* të vërtetë dhe Sahabet nuk e kanë vepruar, duke pasur mundësi ta veprojnë atë, ajo është *bid'at*.

- Kur një gjë llogaritet bid'at?

Dijetarët kanë thënë: Për tu llogaritur një gjë *bid'at*, duhet të plotësohen tri kushte:

1. Nëse ajo është e re, nuk ka qenë në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)
2. Nëse ajo i mvishet fesë së All-llahut (*subhanehu ve te'ala*)
3. Nëse ajo nuk ka bazë në Kur'an dhe *Sunnet*

Të gjitha këto kushte janë bazuar në një *hadith* të shkurtë të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), i cili ka thënë: "Kush e shpik një gjë në fenë tonë, që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar".³⁰⁴

Pra, nëse një gjë është e re, e cila nuk ka qenë në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), dhe i mvishet fesë së All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), dhe nuk ka bazë në Kur'an dhe *Sunnet*, ajo llogaritet *bid'at*.

- Sa lloje është *bid'at*-i në aspektin e besimit?

Nga ana e besimit, *bid'at*-i është dy lloje:

1. *Bid'at* i cili është *kufir*
2. *Bid'at* i cili nuk është *kufir*

Bid'at-et të cilat janë *kufir* dhe të nxjerrin nga feja, janë disa bindje të reja të disa grupeve të devijuara. Për shembull, disa kanë thënë: "Kur'ani është i krijuar!"; apo xehmitë, të cilët i kanë mohuar cilësitë e All-llahut; apo kaderit, të cilët kanë thënë: "All-llahu nuk e din atë që do ta bëjnë njerëzit, e kur e bëjnë ata, atëherë All-llahu e kupton!"; etj..

Ndërsa *bid'at*-et të cilat nuk janë *kufir*, për të cilat ka gjuhë, por nuk të nxjerrin nga feja, janë të gjitha *bid'at*-et të cilat i shohim ne sot nëpër vendet e muslimanëve: *'ibadet*-et të cilat nuk janë prej *Sunnet*-it të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Për shembull: *mevludi*, *kelime tevhid*-i, festimi i netëve të ndryshme: festimi i vitit të ri *Hixhr* dhe shumë e shumë *bid'at*-e të tjera që bëhen në mesin e muslimanëve.

- Sa lloje është *bi'dat*-i në aspektin e adhurimit?

Në aspektin e *'ibadet*-it (adhurimit), *bid'at*-i është dy lloje:

³⁰⁴ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga A'isheja.

1. *Bid'at* i cili nuk ka bazë në Islam fare

Për shembull: adhurimi i varrezave (*tavaf*-i rreth tyre), etj..

2. *Bid'at* i cili ka bazë në Islam, por duke iu ndryshuar mënyra, forma, vendin, koha dhe disa gjëra tjera

Për shembull: të falësh namaz nate në "natën e *Regaib-it*"; t'i falësh njëqind *rek'at-e* namaz *nafileh*, duke e lexuar në çdo rekat *Suran El-Kadr*; leximi i *Sura-s I'hlas* tre herë para *ikamet-it*; etj..

- Cilat janë shkaqet e paraqitjes së *bid'at-eve*?

Ka disa shkaqe, prej të cilave kanë filluar të paraqiten *bid'at-et*; prej tyre janë:

1. *Injoranca*

Shumë prej *bida't-eve* janë paraqitur për shkak të injorancës, dhe kur njerëzit nuk e njohin fenë e All-llahut, Kur'anin dhe *Sunnet-in*, atëherë paraqiten *bid'at-e* dhe vazhdojnë ato me qindra vite, e pastaj është shumë vështirë të ndryshohen.

2. *Pasimi i epshit*

Ka shum njerëz, të cilët dëgjojnë se çka është *Sunnet-i* e çka është *bid'at-i*, por epshi i tyre nuk i len që ta kundërshtojë atë që e kanë bërë më herët. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) thotë:

... إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ ...

"... sepse shpirti (*nefs-i* i njeriut) është fort i prirur për të keqen ..." (Jusuf: 53)

3. *Heshtja e hoxhallarëve dhe e atyre që e dinë*

All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka mallkuar ata që heshtin, kur i shohin gabimet me sy.

4. *Përkrahja e vetë hoxhallarëve ndaj *bid'at-eve**

Ka shumë prej hoxhallarëve, të cilët jo që nuk i kundërshtojnë, por ata edhe i prkrahin, i praktikojnë vetë dhe i ndihmojnë të tjerët në *bid'at*-e.

- A ka *bid'at* të mirë në Islam?

Ka njerëz, të cilët thonë se ka *bid'at* të mirë dhe ka *bid'at* të keq. All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) i ka ndërprerë këto thënie, me *ajet*-in që ia zbriti Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në të cilin thotë:

... **الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا ...**

"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj." (*El-Maideh: 3*)

Ata të cilët thonë se ka *bid'at* të mirë, bazohen në dy argumente:

1. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në Ramazan, e fali *teravi*-në me *xhem'at*, dy apo tre netë dhe pastaj nuk doli më. Ditën e tretë apo të katërt, Sahabet dolën në xhami, pritën një kohë dhe e panë që Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) nuk doli. Ditën e nesërme i thanë: "O i Dërguari i All-llahut, të kemi pritur mbrëmë të dalësh në xhami për *teravi*, por nuk dole?!" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Pata frikë mos të ju bëhet juve farz (obligim)". Pas vdekjes së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) e ringjalli atë që e kishte filluar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe filluan që ta falnin *teravi*-në në xhami, gjatë gjithë Ramazanit. Dhe 'Umer (*radijall-llahu 'anhu*) tha: "Sa *bid'at* i mirë që është ky!".

Kundërpërgjigje dhe sqarim:

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Çdo *bid'at* është *dalalet* (*devijim, humbje*) ...", ndërsa 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) ka thënë: "Sa *bid'at* i mirë që është ky!", e a ka mundësi që 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) ta kundërshtojë fjalën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)? Përgjigja është: Jo, asnjëherë. Por, pse atëherë ka thënë ashtu? Dijetarët kanë thënë: 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*) e ka thënë atë në aspektin gjuhësorë: ta nisësh një diçka të re, e jo në aspektin fetarë, i cili është i nënçmuar dhe çdo *bid'at* është *dalalet* (*devijim*). Por, edhe nëse atë e ka filluar 'Umeri (*radijall-llahu 'anhu*), edhe pse atë i

pari e ka filluar Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), përsëri është *sunnet*, ngase Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Vazhdojeni dhe pasojeni rrugën e atyre të dyve pas meje: Ebu Bekrit dhe 'Umerit".³⁰⁵ Prandaj, ta pasosh rrugën e 'Umerit (*radijall-llahu 'anhu*), nuk mundet të jetë *bid'at*.

2. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Kush e fillon një rrugë (punë) të mirë në Islam, ai do ta ketë shpërblimin e vet dhe të gjithë atyre që do ta bëjnë atë, pa ju mangësuar atyre fare".³⁰⁶

Kundërpërgjigje dhe sqarim:

Themi: Pse e tha Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) këtë *hadith*? Atëherë kthehemi dhe e kuptojmë *hadith*-in siç ka ardhur në kohën e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), duke qëndruar një ditë, erdhën disa fukara dhe kërkua prej Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe Sahabeve që të ju ndihmonin atyre. Kur i pa Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) se ata ishin në fukarallëk shumë të rëndë, i erdhi keq atij dhe i nxiti Sahabet që të dilnin dhe t'i ndihmonin këto fukara. Dhe nuk filluan gjithë Sahabet që të ju ndihmonin, po sikur e morën atë fjallë ashu me lehtësim. Pastaj erdhi njëri prej ensarëve, i cili i kishte mbushur krahët e tij me pasuri dhe e solli pranë Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Kur e panë Sahabet tjerë, shkuan gjithë, morën pasuri dhe e sollën. Atëherë u gëzua dhe ndryçoi fytyra e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe tha: "Kush e fillon një rrugë (punë) të mirë në Islam, ai do ta ketë shpërblimin e vet dhe të gjithë atyre që do ta bëjnë atë, pa ju mangësuar atyre fare".³⁰⁷ Pra, ky njeri nuk shpiki ndonjë *'ibadet*, por dha *sadaka*, ndërsa *sadaka*-ja ka bazë në Islam dhe kjo nuk llogaritet *bid'at*. Kjo është, për shembull, nëse dikush e ringjallë një *Sunnet*. Kjo është kuptimi i *hadith*-it, e jo të shpikësh ndonjë *'ibadet*. Sepse, nëse ka *bid'at* të mirë, atëherë meret nëpër këmbë feja e All-llahut dhe kujt t'i kujtohet mund ta nxjerrë nga një *bid'at*.

Kur themi: Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Çdo *bid'at* është *dalalet*", ata thonë: Fjala "çdo" ka mundësi të vijë dhe mos t'i përfshijë të gjitha. Atëherë ne e vazhdojmë *hadith*-in: "Çdo *bid'at* është *dalalet* dhe çdo *dalalet* çon në zjarr". Nëse themi "çdo *bid'at*" - ka mundësi të ketë edhe *bid'at* të mirë, atëherë mund të themi edhe "çdo *dalalet*" - ka *dalalet* të mirë. E nëse fillojmë kështu, atëherë duhet t'i devijojmë fjalët e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Përfundimisht, nuk ka *bid'at* të mirë në Islam.

³⁰⁵ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Hudhejfe ibn El-Jemani.

³⁰⁶ Transmeton Muslimi - Nga Ebu 'Amr Xherir ibn 'Abdull-llah.

³⁰⁷ Transmeton Muslimi - Nga Ebu 'Amr Xherir ibn 'Abdull-llah.

- Cili është rreziku i bid'at-it?

Bid'at-i e ka një rrezik shumë të madh: nëpërmjet *bid'at*-it, njerëzit e lënë *Sunnet*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*). Njerëzit, në vend që ta praktikojnë atë që është *Sunnet* dhe të marrin shpërblim, e praktikojnë atë që është *bid'at* dhe nuk marrin shpërblim dhe ndoshta marrin edhe gjuhah.

Sufjan Eth-Theuri (*rahimehull-llah*) ka thënë: "*Bid'at*-i është më i rrezikshëm se mëkati, ngase prej mëkateve njeriu pendohen, ndërsa ai i cili bën *bid'at*-e, nuk pendohet prej tyre (ngase ai mendon se është duke bërë mirë)".

Imam Ibn Kajjimi (*rahimehull-llah*), kur i përmendë etapat e mashtrimit të Shejtanit, thotë: "Shejtani kur don ta devijojë dikënd, i ka disa etapa: ai mundohet që muslimanin ta çojë në *kufri*; nëse nuk e realizon, atëherë mundohet që ta çojë në praktikim të *bid'at*-eve; nëse nuk e realizon, atëherë mundohet që ta çojë në gjuhah të mëdhaja; nëse nuk e realizon këtë, atëherë mundohet ta çojë në gjuhah të vogla; ...".

Pra, rreziku i *bid'at*-eve është më i madh se rreziku i gjuhahëve, dhe nëpërmjet *bid'at*-eve lihet (braktiset) *Sunnet*-i i Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Cilat gjëra nuk janë kusht në bid'at?

Në *bid'at* nuk është kusht që të ndodhin disa gjëra. Prej tyre:

1. Nuk është kusht për *bid'at*-et që të ketë argumente direkte që i ndalojnë ato

Nuk është kusht që për çdo *bid'at* të thotë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), se kjo është *bid'at* dhe ajo është *bid'at*, ngase *bid'at*-et kundërshtohen në formë të përgjithshme: "*Çdo bid'at është dalalet*", e jo për çdo *bid'at* të ketë nga një argument. Ndërsa për haramet (gjuhahet), për çdo haram ka argument.

Pra, nuk është kusht që për çdo *bid'at* të ketë nga një argument, ngase *bid'at*-et janë shumë dhe për çdo ditë dalin *bid'at*-e dhe nuk ka mundësi të ketë *hadith*-e për çdo *bid'at*, që ta ndalojë atë.

2. Nuk është kusht që, ai i cili i praktikon *bid'at*-et, mos ta ketë qëllimin e mirë

Ka mundësi që, ai i cili i bënë *bid'at*-et, ta ketë qëllimin e mirë, por kjo nuk e arsyeton. Qëllimi i mirë nuk e arsyeton veprën e gabuar.

3. *Nuk është kusht që, praktikimi i bid'at-eve, të mos ketë asnjë dobi*

Ka mundësi që ndonjë *bid'at* të ketë ndonjë dobi, edhe pse në përfundim, shumica e tij është gabim dhe dëm i Islamit dhe muslimanëve.

4. *Nuk është kusht që bid'a-ti mos të ketë bazë fare*

Ka mundësi që *bid'at*-i të ketë bazë të përgjithshme, por pastaj t'i ndryshohet mënyra dhe forma dhe të shëndërrohet në *bid'at*.

- Si të sillemi ndaj njerëzve të bid'at-it?

Kur flitet për njerëzit e *bid'at*-it, dijetarët flasin për ata njerëz të devijuar, që kanë bindje të devijuara, si 'Havarixhët, Mu'tezilet, Xhehmitë, Murxhiet, Kaderitë, etj..

Ndërsa, kur flitet për njerëzit e *bid'at*-eve në përgjithsi, të cilët kanë *bid'at*-e që nuk janë të *kufri*-it, ata edhe nëse bëjnë *bid'at*-e, ata përsëri janë musliman dhe janë vëllezërit tanë, dhe është përgjegjësi e jona që të sillemi me ta me sjellje të mirë dhe me dituri, dhe t'i thërrasim ata në pasimin e *Sunnet*-it të Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), në pasimin e rrugës së vetme, e cila çon në Xhennetin e All-llahut (*subhanehu ve te'ala*).

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), një ditë prej ditëve, e vizatoi një rrugë (një vizë) në tokë dhe i vizatoi disa rrugica (viza) anash, dhe tha: "Kjo rruga drejt është rruga e pastërt, ndërsa këta të tjerat janë rrugica, në çdo rrugicë ka nga një Shejtan i cili thërret në atë rrugë". Pastaj e lexoi fjalën e All-llahut, ku thotë:

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَن سَبِيلِهِ ۗ ...

"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që të ju shmangin nga rruga e Tij" (El-En'am: 153)³⁰⁸

³⁰⁸ Transmeton Nesaiu, Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi në "Musned" - Nga Ibn Mes'udi.

E, nëse njerëzit e *bid'at*-it të kundërshtojnë, të luftojnë dhe të armiqësojnë, atëherë muslimanët kanë të drejtë t'i bojkotojnë ata, nëse bojkotimi ju bën dobi atyre, ndërsa nëse bojkotimi nuk ju bën dobi atyre, por ua shton të keqen edhe më shumë dhe qëndrimi i tyre me njerëzit e *Sunnet*-it nuk bën dëm, atëherë më mirë është që ata mos të bojkotohen.

**** Besimi në Vulën e Pejgamberëve ****

- Si të besojmë Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)?

Besimi në Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është kusht i *iman*-it. Është e patjetërsueshme për çdo njeri, i cili dëshiron të jetë musliman, i cili dëshiron të hyjë në Islam, që ta ketë të plotë Shehadetin e tij. Shehadeti nuk mjafton vetëm me *LA ILAHE IL-LALL-LLAH*, por patjetër duhet të vazhdojë dhe të plotësohet edhe ky kusht: *MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH*.

Duhet të besojmë që Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është Pejgamberi i fundit, Vula e gjithë Pejgamberëve. Duhet të besojmë që Muhammedi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) është njeri i zgjedhur prej All-llahut, të cilin All-llahu e zgjodhi dhe e dërgoi që t'i udhëzojë njerëzit në rrugën e shpëtimit dhe t'i largojë ata prej devijimeve, prej adhurimeve të kota dhe t'i drejtojë ata në adhurimin ndaj All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), që t'i largojë njerëzit prej errësirave të *kufir*-it dhe të *shirk*-ut dhe t'i drejtojë ata në dritën e Islamit.

Është obligim (kusht) që secili ta besojë Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe mosbesimi i tij llogaritet *kufir* që e nxjerrë njeriun prej Islamit.

Pastaj, jemi të obliguar ta pasojmë rrugën e tij.³⁰⁹

Përveç kësaj, jemi të obliguar që edhe ta duam Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), më shumë se veten tonë, më shumë se sa prindërit tanë, më shumë se sa fëmijët tanë dhe më shumë se çdo send tjetër, ndërsa nëse nuk e duam atë më shumë se çdo send tjetër, atëherë *iman*-i jonë ka mangësi të mëdha.

Andaj, besimi në Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ngërthen të gjitha këto gjëra, që *iman*-i të jetë i plotë dhe i pastërt.

³⁰⁹ Nuk ka të drejtë asnjë musliman, që ta pasojë ndonjë rrugë tjetër, qoftë edhe të ndonjë Pejgamberi tjetër.

- Çka e prishë besimin mbi Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

Besimin mbi Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e prishin disa gjëra. Prejt tyre:

1. Përgënjeshtrimi i Pejgamberisë së tij

Nëse dikush e përgënjeshton Pejgamberinë e tij dhe nuk pranon se ai është Pejgamber i All-llahut, ai bën *kufër*. Kështu janë krishterët dhe jehudët.

2. Mendimi se Xhibrili ('alejhis-selam) ka gabuar në Shpalljen ndaj tij

Nëse dikush mendon se Xhibrili ('alejhis-selam) ka gabur dhe Shpalljen ia ka dërguar gabimisht Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), ai bën *kufër*. Kështu janë rafidit dhe grupet e devijuara ekstremiste të shi'ave.

3. Besimi se pas tij ka Pejgamber

Kush beson se Muhammedi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) është Pejgamber i All-llahut, por pas tij ka Pejgamber tjetër, bën *kufër*. Kështu janë ahmedit apo kadjanit, të cilët besojnë pejgamber pas Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem).³¹⁰

4. Nënçmimi i tij, sharja e tij dhe tallja me të

Çdo nënçmim, çdo fjalë, qoftë edhe e vogël, për ta nënçmuar Pejgamberin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), është *kufër*. Mos të flasim sharja e tij, tallja me të dhe këshu me rradhë.

Të gjitha këto gjëra e prishin Shehadetin dhe e prishin fjalën MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH. Dhe të gjitha ato gjëra që e prishin fjalën LA ILAHE IL-LALL-LLAH, e prishin edhe fjalën MUHAMMEDUR-RASULULL-LLAH.

³¹⁰ Ahmeditë e besojnë Ahmed Gulamin si pejgamber pas Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem).

- Cilat janë emrat e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Unë i kamë pesë emra: unë jamë Muhammed; dhe unë jamë Ahmed³¹¹; dhe unë jamë El-Mahi (ai me të cilin do të fshihet kufri); dhe unë jamë El-Hashir (i cili do të ringjallet i pari); dhe unë jamë El-'Akib (Pejgamberi i fundit, që pas tij nuk ka më Pejgamber)".³¹² Ndërsa në një transmetim tjetër, i ka përmedur edhe dy emra tjerë dhe ka thënë: "Unë jamë Nebijjut-Tevbeh (Pejgamberi i pendimit); dhe unë jamë Nebijjur-Rahmeh (Pejgamberi i mëshirës)".³¹³

Disa prej dijetarëve i kanë marur edhe disa emra apo cilësi që janë përmendur në Kur'an. All-llahu (subhanehu ve te'ala) në Kur'an e ka përmedur edhe me disa emra tjerë Pejgamberin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), si: Mubesh-shir, Nedhir (përgëzues), Da'ijen il-llah (thirrës në rrugë të All-llahut); etj.. Ndërsa disa dijetërë tjerë kanë thënë se këto janë cilësi të Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) dhe nuk janë emra. Disa dijetarë tjerë kanë përmbledhur libra të plotë me emrat e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). E disa prej tyre i kanë përmbledhur nëntëdhjetë e nëntë emra. E disa prej sufive i kanë përmbledhur një mijë emra të Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). Megjithatë, këto janë gjëra të tepruara.

Pra, emrat e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) janë: Muhammed, Ahmed, El-Mahi, El-Hashir, El-'Akib, Nebijjut-Tevbeh dhe Nebijjur-Rahmeh.

E disa pastaj i kanë përmendur edhe emrat *Ja Sin* dhe *Ta Ha* dhe kanë thënë se janë emra të Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). Ndërsa këto dy emra nuk qëndrojnë, ngase këto dy emra janë shkronja që vinë në fillim të *Sura-ve* të Kur'anit, ndërsa kuptimin e tyre e din vetëm All-llahu (subhanehu ve te'ala). Nëse themi se *Ja Sin* është emër i Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), atëherë duhet të themi se edhe *Elif Lam Mim, Ha Mim, Ta Sin, Elif Lam Mim Sad* etj. janë prej emrave të Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem). Pra, emri *Ja Sin* dhe *Ta Ha* nuk janë emra të Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem).

³¹¹ Gjithashtu, këtë emër e përmendi All-llahu në Kur'an, me fjalët e 'Isait ('alejhis-selam), ku thotë: "... dhe për t'ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emir i të cilit është Ahmed ..." (Es-Saff: 6).

³¹² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Hurajrah.

³¹³ Transmeton Muslimi.

- Cilat janë veçoritë e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

Pejgamberin e fundit, Muhammedin (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), All-llahu (subhanehu ve te'ala) e ka dalluar atë me disa gjëra. E ka dalluar atë me disa gjëra prej Pejgamberëve tjerë dhe e ka dalluar atë me disa gjëra prej njerëzve të këtij ummet-i.

Veçoritë me të cilat Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) është dalluar prej Pejgamberëve tjerë, janë gjashtë gjëra. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Jam dalluar prej Pejgamberëve tjerë me gjashtë gjëra: më është dhënë mua (xhevamiul kelim) të flas pak, por me kuptim shumë të gjërë; dhe jam ndihmuar me frikë ndaj armikut, një muaj më herët; dhe më është lejuar plaçka e luftës³¹⁴; dhe më është bërë toka xhami (vend falje) dhe e pastërt³¹⁵; dhe jam dërguar te gjithë njerëzimi; dhe është vuosur me mua Pejgamberllëku".³¹⁶

Veçoritë me të cilat Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) është dalluar prej njerëzve të këtij ummet-i, janë:

1. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e ka pasur të ndaluar sadaka-në

Nëse atij i është ofruar dhuratë, ka pasur të drejtë ta marrë, ndërsa nëse i është ofruar sadaka, e ka pasur të ndaluar ta marrë atë.

2. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e ka pasur të lejuar të martohet, nëse femra nuk ka pasur përgjegjës, apo nëse asaj nuk i ka dhënë mehër

Ndërsa, nëse një musliman dëshiron të martohet, është patjetër që vajza të ketë përgjegjës (babain, e nëse jo, vëllaun etj.) dhe nëse atë e merr pa lejen e përgjegjësit, një martesë e tillë nuk vlen. All-llahu (subhanehu ve te'ala), Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem), i tha:

... خَالِصَةً لَّكَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ ...

"Kjo të është lejuar vetëm ty e jo edhe besimtarëve të tjerë." (El-Ahzab: 50)

3. Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) e ka pasur të lejuar të ketë më shumë se katër gra

³¹⁴ Te popujt më herët, e kanë tubuar plaçkën e luftës dhe pastaj ka zbritur një zjarr dhe e ka djegur atë.

³¹⁵ Dijetarë kanë thënë: "më është bërë toka e pastërt" don të thotë: ke të drejtë të marrësh tejemmum prej saj dhe ke të drejtë të falesh mbi tokë, kudo që të jeshë (përvëç vendeve të ndaluara: vendeve të fëlliqura, varrezave dhe vendeve ku rrinë devet).

³¹⁶ Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi.

Ndërsa muslimani e ka të ndaluar (*haram*) të ketë më shumë se katër gra.

4. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e ka pasur të lejuar ta vazhdojë agjërimin

Për shembull, nëse ka agjëraur një ditë, ka pasur të drejtë ta vazhdojë (duke mos ngrënë iftar dhe syfir) edhe dytën e dytë, edhe ditën e tretë, deri sa disa Sahabe filluan të agjëronin kështu, por pastaj Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ndaloi. Dhe kur i thanë: "O i Dërguari i All-llahut, po ti po e vazhdon agjërimin?!" Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) tha: "Unë nuk jam sikur ju, mu më ushqen All-llahu!".

5. Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), si dhe gjithë Pejgamberët tjerë, nuk kanë lënë trashëgimi, por ajo që ka mbetur prej tyre është shpëndarë sadaka

6. Nëse të thërret Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), edhe nëse je në namaz, e ke obligim ta ndërprësh edhe namazin dhe t'i përgjigjesh atij

Kështu Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) e thirri njërin prej Sahabeve, i cili ishte duke e falur namazin, e kur e përfundoi, shkoi dhe i tha: "O i Dërguari i All-llahut, isha duke u falur". Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i tha: "Edhe nëse je në namaz, duhet të përgjigjesh. A nuk ka thënë All-llahut:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اسْتَجِيْبُوْا لِلّٰهِ وَلِلرَّسُوْلِ اِذَا دَعَاكُمْ ...

"O besimtarë! Bindjuni All-llahut dhe të Dërguarit kur ju thërret ..." (El-Enfal: 24)

7. Shejtani nuk ka mundësi të paraqitet në ëndër në formën (pamjen) e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*)

Dhe veçori tjera, të cilat e dallojnë Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) prej njerëzve tjerë, prej muslimanëve të *ummet*-it të tij.

Gjithashtu, edhe në Ditën e Gjykimit, Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) do të veçohet prej gjithë njerëzve me disa veçori:

1. Do të jetë zotëriu i gjithë bijëve të Ademit

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Unë jamë zotëriu i gjithë bijëve të Ademit në Ditën e Gjykimit".³¹⁷

³¹⁷ Shih faqen 191-192.

2. *Do të ndërmjetësojë për të filluar llogaria*³¹⁸
3. *Do të ndërmjetësojë për t'u hapur dera e Xhennetit*³¹⁹
4. *Do të jetë në shkallën më të lartë në Xhennet, e cila quhet El-Vesileh*³²⁰

³¹⁸ Shih faqen 191-192.

³¹⁹ Shih faqen 192.

³²⁰ Shih faqen 204-205.

**** Ehli Bejt-i ****

- Kush janë Ehli Bejt-i?

Ehli Bejt-i ose *Alul Bejt-i* janë familja e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), të cilët jemi të obliguar t'i duam.

Familja e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) janë ata të afëmit e tij, të cilët e kanë pasur haram *sadaka*-në, e kanë besuar Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe e kanë pasuar atë. Këtu hyjnë fëmijët e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe gratë e tij.

- Cilët janë fëmijët e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) i ka pasur shtatë fëmijë, tre djem dhe katër vajza.

Djemt e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) janë: *Kasim*, 'Abdull-llah dhe *Ibrahim*.

Vajzat e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) janë: *Zejneb*, 'Ummu Kulthum, *Rukajeh* dhe *Fatimeh*.

Gjithë fëmijët e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) kanë vdekur duke qenë gjallë Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe i ka varrosur me duart e tij, përveç *Fatimes*, e cili ka vdekur gjashtë muaj pas vdekjes së Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

- Cilat janë gratë e Muhammedit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem)?

Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) i ka pasur njëmbëdhjetë gra dhe dy robëresha.

Gratë e Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) janë: 'Hatixheh, Seudeh, A'isheh, Hafsa, Zejneb bintu Xhahsh, Zejneb bintu 'Huzejm, Safijjeh, Xhuvejrijeh, 'Ummu Selemeh, 'Ummu Habibeh dhe Mejmuneh.

E para që ka vdekur, ka qenë 'Hatixheja (radijall-llahu 'anhu), pastaj duke qenë gjallë Pejgamberi (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) ka vdekur edhe Zejneb bintu 'Huzejm (radijall-llahu 'anha). Pas vdekjes së Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) kan mbetur gjallë nëntë gratë e tij dhe pastaj kanë vdekur secila me kohë, ndërsa e fundit që ka vdekur ka qenë 'Ummu Selemeh (radijall-llahu 'anha).

Robëreshat e Pejgamberit (sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem) janë: Marije dhe Rajhane.

**** Sahabet ****

- Kush janë Sahabet?

Sahabet janë shokët e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*).

Sahabeh quhet ai i cili e ka takuar Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), e ka besuar atë dhe ka vdekur duke qenë musliman.

- Si të besojmë mbi Sahabet?

Besojmë që Sahabet, shokët e Muhammedit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), janë njerëzit më të mirë që kanë egzistuar në këtë *ummet*.

Për ta, All-llahu (*subhanehu ve te'ala*) tha:

... رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ...

“All-llahu është i kënaqur me ta, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij.” (Et-Teubeh: 100)

Gjithashtu thotë:

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ

وَنُصَلِّهِ ۖ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ۖ

"Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjekë rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcjellim në zjarrin e Xhehennemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!" (En-Nisa': 115)

Dijetarët kanë thënë: "rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve" nënkupton "rrugë tjetër nga ajo e Sahabeve", se musliman në atë kohë kanë qenë Sahabet.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Shekulli (gjenerata) më e mirë është gjenerata ime (Sahabet), e pastaj ata që vijnë pas tyre (*tabi'inët*), e pastaj ata që vijnë pas tyre (*etba'i tabi'inët*)".³²¹

Pra, besojmë që Sahabet kanë qenë njerëzit më të mirë të këtij *ummet*-i dhe ata kurrë nuk janë bashkuar në një çështje e cila është *dalalet* (devijim, gabim etj.). Ndonjë individ pret tyre ka pasur mundësi të bjerë në gabim, ndërsa gjithë Sahabet, nuk kanë pasur mundësi të binë në gabim asnjëherë.

Pejgamberi (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) ka thënë: "Mos i shani shokët e mirë". Pastaj e tregoi vlerën e tyre dhe tha: "Sikur dikush prej jush të jep ari sa kodra e Uhudit, nuk ka mundësi ta arrijë vlerën e tyre dhe shpërblimin e tyre, qoftë edhe nëse ata japin sa një grusht *sadaka*".³²²

- Sa është numri i Sahabeve?

Ebu Zura Er-Razi, i cili ka qenë hoxha i Imam Muslimit, ka thënë: "Sahabet kanë qenë: njëqind e katërbëdhjetë mijë (114 000)". Këtë mendim e përkrahë edhe Imam Sujutit.

Disa dijtare tjerë kanë thënë se Sahabet kanë qenë njëqind e njëzet e katër mijë (124 000).

Shumë prej dijetarëve kanë thënë se, nëse nuk e dimë saktësisht me numra dhe preciz, atë që e dimë sigurtë, është se Sahabet kanë qenë mbi njëqind mijë.

³²¹ Transmeton Bu'hariu, Muslimi dhe Ibn Maxheh - Nga Ibn Mes'udi dhe 'Imran ibn Husejni.

³²² Transmeton Bu'hariu dhe Muslimi - Nga Ebu Se'idi dhe Ebu Hurajrah.

Përfundim

Me ndihmën e All-llahut dhe me lejen e Tij, e përfundova këtë libër. Falënderimi i takon All-llahut (*subhanehu ve te'ala*), ndërsa *salavat*-et dhe *selam*-et qofshin mbi Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), familjen e tij të ndershme, shokët e tij besnik dhe të sinqertë dhe mbi gjithë ata që e ndjekën dhe do ta ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Pastaj, falënderoj hoxhën e nderuar Omer Ef. Bajramin, të cilin All-llahu e bëri shkak dhe nëpërmejt tij ma mësoi rrugën e vërtetë, fenë e All-llahut, *Sunnet*-in e Pejgamberit (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*) dhe të gjitha çështjet e fesë. Lus All-llahun (*subhanehu ve te'ala*), që ta shpërblejë hoxhën e nderuar, t'i japë atij shëndet, ta mëshirojë atë, ta ruajë atë, ta forcojë atë, t'i ndihmojë atij në rrugën e *da'vet*-it dhe të na bashkojë me të në Xhennetin *Firdevs*, bashkë me Muhammedin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), me Pejgamberët tjerë, me Sahabet, me Shehidat dhe me gjithë njerëzit e mirë. AMIN!

All-llahu i shpërbleftë edhe të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij libri.

"O All-llah, pranoje këtë vepër, më mëshiro mua, prindërit e mi, familjen time, shokët (vëllezërit) e mi dhe të gjithë muslimanët deri në ditën e fundit! O Zot, na i prano veprat e mira dhe na i shlyej mëkatet tona, na udhëzo në rrugën e drejtë dhe na përqëndro në të! O Zot, na mundëso të jeojmë si musliman dhe na mundëso të vdesim si musliman, na mundëso të ta dorëzojmë shpirtin në formën më të mirë!

*O All-llah, na shpëto nga dënimi i varrit dhe nga sprovat e tij! O All-llah, na shpëto në Ditën e Gjykimit dhe nga vështirësitë e saj! O All-llah, mos na tako me Xhehennemin dhe na shpëto prej tij! O All-llah, në këtë botë na bashko me të mirët dhe ata që janë në hakk, e në botën tjetër na bashko në Xhennetin *Firdevs*, bashkë me Pejgamberin (*sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem*), me Pejgamberët tjerë, me Sahabet, me Shehidat dhe me gjithë njerëzit e mire! Amin!"*

Lutja jonë e fundit është:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعٰلَمِيْنَ

"Falëndereimi i takon All-llahut, Zotit të botërave!"

Hetem Ibrahim

Përmbajtja

Parathënie	5
Hyrje	7
Çka don të thotë 'Akideh?	7
Cilat janë bazat e 'akide-s?	7
A ka 'akideh vetëm në Islam?	8
Sa lloje është 'akide-ja?	9
Cila është 'akide-ja e vërtetë?	9
Kush është Ehli Sunne-ti?	9
Cilat janë veçoritë e Ehli Sunne-tit?	10
Çfarë rëndësie ka 'akide-ja?	12
Kapitulli i parë: BESIMI NË ALL-LLAHUN	
Teuhid-i	15
Cili është obligimi i parë i robërve?	15
Çka don të thotë teuhid?	15
Sa lloje është teuhid-i?	16
Teuhidi Rububij-jeh	17
Ç'është teuhid-i rububij-jeh?	17
Teuhid-i 'Uluhij-jeh	19
Ç'është teuhid-i 'Uluhij-jeh?	19

'Ibadet-i	20
Çka don të thotë 'Ibadet?	20
Cilat janë kushtet për pranimin e ibadet-it?	20
Teuhid-i Esmā'i ves-Sifat	22
Ç'është teuhid-i esma'i ves-sifat?	22
Kush quhet emër i All-llahut?	22
Sa janë emrat e All-llahut?	23
Çka don të thotë t'i mësosh emrat e All-llahut?	24
Sa lloje janë emrat e All-llahut?	24
A lejohet emërtimi i njerëzve me emrat e All-llahut?	25
Si duhet besuar cilësitë e All-llahut?	26
A duhet shtrembëruar cilësitë e All-llahut?	27
A nxjerret emër prej cilësive të All-llahut?	28
Sa lloje janë cilësitë e All-llahut?	29
Ku është All-llahu?	29
A ka dallim ndërmjet 'Arshit dhe Kursijës?	32
A del prej Islami ai që i mohon cilësitë e All-llahut?	34
Çka don të thotë emir All-llah?	35
Cili është emir më i madh i All-llahut?	38
Shehadeti	40
Çka don të thotë Shehadeti?	40
A mjafton Shehadeti?	41
Cilat janë kushtet e Shehadetit?	42
Kush quhet tagut?	43

A është obligim mësimi i kushteve të Shehadetit?	44
Islami	45
Çka don të thotë Islam?	45
Cili është vendimi i Sheri'atit për atë i cili e mohon një prej shtyllave të islamit?	46
Cili është vendimi i Sheri'atit për atë i cili nuk e vepron asnjë prej shtyllave të islamit?	46
Iman-i	48
Çka don të thotë Iman?	48
A shtohet dhe a pakësohet iman-i?	49
Sa mund të pakësohet iman-i?	50
Sa degë ka iman-i?	50
Ihsan-i	51
Çka don të thotë Ihsan?	51
Cila është shkallë (kategori) më e lartë?	51
Kufr-i	52
Çka don të thotë kufr?	52
Sa lloje është kufr-i?	53
Ç'është kufr-i i madh?	53
Ç'është kufr-i i vogël?	54
Sa lloje është kufr-i i madh?	55
Tekfir-i	57
Çka është tekfir-i?	57
Cili është rreziku i tekfir-it?	57
Cilat janë gabimet në tekfir?	58

Shirk-u	60
Çka don të thotë Shirk?	60
Sa lloje është shirk-u?	60
Çka është shirk-u i madh?	60
Çka është shirk-u i vogël?	61
Cili është rreziku i shirk-ut?	62
Kur dhe si filloi shirk-u?	64
A ekziston shirku në këtë ummet?	66
Çka është nifak-u i madh?	67
Çka është nifak-u i vogël?	68
Sa lloje është vizita e varrezave?	69
Kush janë evlija-të?	70
Sa lloje është sihr-i?	71
Çka thotë Islami për sihr-in?	71
Si bëhet njeriu sihrbaz?	71
Çka thotë Islami për sihrbazët?	72
A janë të lejuara rukje-t?	73
A lejohet shkuarja te falltorët?	73
A janë të lejuara hajmalitë?	74
Çka don të thotë tevessul?	75
Sa lloje është tevessul-i?	75
Cili tevessul është i lejuar?	76
Cili tevessul është i ndaluar?	78
Çka don të thotë teberruk?	79

Sa lloje është teberruk-u?	79
Cili teberruk është i lejuar?	80
Cili teberruk është i ndaluar?	81
Kapitulli i dytë: BESIMI NË MELAIKET	83
Melaiket	85
Çka janë melaiket?	85
Si i besojmë melaiket?	85
Kur janë krijuar melaiket?	86
Sa është numri i melaikeve?	86
Cilat janë dallimet ndërmjet njerëzve dhe melaikeve?	87
A mund të shihen melaiket?	88
A vdesin melaiket?	89
Cilat janë frytet e besimit në melaiket?	90
Xhinnët	92
A ekzistojnë vërtetë xhinnët?	92
Si është jeta e xhinnëve?	93
A mund të shihen xhinnët?	94
A ka prej xhinnëve Pejgamber dhe Sahabeh?	96
Si të mrohemi prej xhinnëve?	97
Kapitulli i tretë: BESIMI NË PEJGAMBERËT	99
Pejgamberët	101
Si i besojmë Pejgamberët?	101
Pse janë dërguar Pejgamberët?	102
Cilat janë cilësitë e Pejgamberëve?	103

Cilat janë veçoritë e Pejgamberëve?	104
Sa është numri i gjithë Pejgamberëve?	106
Sa janë Pejgamberët e përmendur në Kur'an?	107
Cili është dallimi ndërmjet Nebijj dhe Rasul?	108
A janë të gjithë Pejgamberët në një shkallë?	109
Mu'xhize-t (Mrekullit)	110
Çka janë mu'xhize-t?	110
Çfarë mrekulli kishin Pejgamberët?	110
Keramet-et	113
Çka janë keramet-et?	113
Si i besojmë keramet-et?	113
Kapitulli i katërt: BESIMI NË LIBRAT	115
Librat e zbritura	117
Cilat janë Librat e zbritura?	117
Si i besojmë Librat e zbritur?	117
Pse ndryshuan librat e mëparshëm?	118
Si u ruajtë Kur'ani nga ndryshimet?	120
Kapitulli i pestë: BESIMI NË RINGJALLJEN	123
Jeta e varrezave (Berza'h-u)	125
Çka është jeta e Berza'h-ut?	125
A do t'i shpëtojë dikush vdekjes?	125
Si i merret njeriut shpirti?	127
Cilat janë shpërblimet në varreza?	128
Cilat janë dënimet në varreza?	129

A e ndjen dënimin në varr trupi apo shpirti?	130
A takohen shpirtërat në varreza?	131
A e dinë të vdeurit gjendjen e të gjallëve?	131
Ku qëndrojnë shpirtërat e të vdekurve?	132
Kijameti dhe shenjat e tij	134
Kur do të ndodhë Kijameti?	134
Sa lloje janë shenjat e Kijametit?	135
Cilat shenja të Kijametit kanë dalur?	135
A kanë mbetur ende shenja të vogla të Kijametit?	138
Cilat janë shenjat e mëdha të Kijametit?	140
Cila është fitneja e Dexhhalit?	140
A do të zbret 'Isai (' <i>alejhis-selam</i>) përsëri në tokë?	141
Kush janë populli Je'xhuxh dhe Me'xhuxh?	143
Si do të ndodhë fundi i botës (Kijameti)?	145
Besimi në Ringjalljen	147
Si e besojmë ne Ringjalljen?	147
Cilat janë argumetet e Ringjalljes?	147
Emrat e Ditës së Gjykimit	151
Cilat janë emrat e Ditës së Gjykimit?	151
Ringjallja	154
Si do të bëhet ringjalja e njerëzve?	154
Kush do të ringjallet i pari?	154
Në çfarë gjendje do të ringjallen njerëzit?	155
A do të ringjallen kafshët?	155

Sur-i	157
Çka është Sur-i?	157
Sa herë do t'i fryhet Sur-it?	157
Gjendja e njerëzve në Ditën e Gjykimit	159
Si do të jetë gjendja e jobesimtarëve në Ditën e Gjykimit?	159
A do t'u vlejné punët e mira jobesimtarëve?	160
Çka do të thotë Shejtani në A'hiret?	162
Si do të jetë gjendja e mëkatarëve në Ditën e Gjykimit?	164
Si do të jetë gjendja e besimtarëve në Ditën e Gjykimit?	165
Llogaria (Hisab-i)	167
Si do të jetë Llogaria para All-llahut?	167
Si do të llogariten besimtarët?	168
A do të merren në pyetje Pejgamberët?	169
A do të llogariten jobesimtarët?	170
Për cilat gjëra do të pyetet njeriu?	171
Zbritja e librave	173
Si do t'u zbresin njerëzve librat e tyre?	173
Çka do të ketë të shkruara në librat e zbritura?	174
Mizan-i (Peshorja)	176
Si e besojmë ne Mizan-in (Peshoren)?	176
Sa peshore do të ketë atë ditë?	177
Cilat gjëra do të vendohen në Peshore?	177
Cilat gjëra peshojnë rëndë atë ditë?	179
Haudi	180

Çka është Haud-i?	180
Sa vetë do të pijnë prej Haud-it?	180
Kush nuk do të mund të pijë prej Haud-it?	181
A kanë Haud edhe Pejgamberët tjerë?	181
Çka është Keuther-i?	182
A egzistojnë Haud-i dhe Keuther-i sot?	183
Ura e Sirat-it	184
Çka është Ura e Sirat-it?	184
Si do të jetë gjendja e njerëzve në Urën e Siratit?	185
Si e kujtonin selef-i Urën e Sirat-it?	186
Kantarrah	188
Çka është Kantarah?	188
Ndërmjetësimi (Shefa'at-i)	189
Sa lloje është shefa'at-i?	189
Cili shefa'at është i kotë (i papranuar)?	189
Cili shefa'at është i vërtetë (i pranuar)?	190
Cili shefa'at është i veçant për Muhammedin (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	191
Në cilat raste do të ndërmjetësojnë edhe tjerët?	193
Cilat vepra do të ndërmjetësojnë për njerun?	193
Disa çështje të rëndësishme	195
Si do ta bërballojnë njerëzit diellin mbi koka?	195
Kush janë As'habul A'raf-i?	195
Ku është vendi i atyre që nuk u ka arritur Islami?	196
Ku është vendi i fëmijëve të vdekur të muslimanëve?	198

Ku është vendi i fëmijëve të vdekur të idhujtarëve?	199
Xhenneti	200
A egziston tash Xhenneti?	200
Kush do të hyjë i pari në Xhennet?	201
Kush është i fundit që do të hyjë në Xhennet?	201
Cilat janë dyert e Xhennetit?	203
Kur hapen dyert e Xhennetit?	203
Sa shkallë ka Xhenneti?	204
Kujt i takojnë pallatet e Xhennetit?	205
Si t' i mbjellësh pemët tua në Xhennet?	207
Cilët janë lumenjtë e Xhennetit?	207
A ka natë në Xhennet?	209
Si do të jenë njerëzit në Xhennet?	209
Burra apo gra ka më shumë në Xhennet?	210
Çka ka për gratë në Xhennet?	211
Në cilën gjuhë do të flasin banorët e Xhennetit?	212
Cila është kënaqësia më e madhe në Xhennet?	212
Xhehennemi	214
Ku është Xhehennemi?	214
Sa dyer ka Xhehennemi?	215
Kur mbyllen dyert e Xhehennemit?	215
Sa është nxehtësia e zjarrit të Xhehennemit?	216
Si do të jenë njerëzit në Xhehennem?	218
Sa janë rojet e Xhehennemit?	218

Pse grate janë më shumë në Xhehennem?	219
A do të përfundojë Xhehennemi?	220
Kapitulli i gjashtë: BESIMI NË KADER	223
Besimi në kader	225
Si të besojmë në kader?	225
Cilat janë etapat e kader-it?	226
Cilët njerëz kanë devijuar rreth kader-it?	228
A ndodhin edhe të këqiat me kader?	229
A është njeriu i lire apo i imponuar?	230
A mund të arsyetohet njeriu me kader?	231
A lejohet mbështetja në kader?	232
A lejohet përdorimi i shprehjes “rastësisht”?	233
A lejohet përdorimi i shprehjes “sikur”?	233
A mund të ndryshojë kaderi?	234
Cilët janë dobritë e besimit në kader?	235
Kapitulli i shtatë: BESIMI NË VULËN E PEJGAMBERËVE	237
Bid’at-i	239
Çka don të thotë bid’at?	239
Kur një gjë llogaritet bid’at?	241
Sa lloje është bid’at-i në aspektin e besimit?	240
Sa lloje është bid’at-i në aspektin e adhurimit?	240
Cilat janë shkaqet e paraqitjes së bid’at-eve?	241
A ka bid’at të mirë në Islam?	242
Cili është rreziku i bid’at-it?	243

Cilat gjëra nuk janë kusht në bî' dat?	243
Si të sillemi ndaj njerëzve të bid'at-it?	245
Besimi në Vulën e Pejgamberëve	247
Si të besojmë Muhammedin (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	247
Çka e prishë besimin mbi Muhammedin (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	248
Cilat janë emrat e Muhammedit (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	249
Cilat janë veçorit e Muhammedit (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	250
Ehli Bejt-i	253
Kush janë Ehli Bejt-i?	253
Cilët janë fëmijët e Muhammedit (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	253
Cilat janë grate e Muhammedit (<i>sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-lem</i>)?	254
Sahabet	255
Kush janë Sahabet?	255
Si të besojmë mbi Sahabet?	255
Sa është numri i Sahabeve?	256
Përfundim	257
Përmbajtja	259

